

**AISHJA**

**Nëna e pashoqe e besimtarëve**

## **PËRMBAJTJA**

Parathënie

Ambienti ku u rrit

Pranimi i Islamit

Fejesa

Kujtime nga Meka

Propozimi për martesë

Ndalesa e parë

Adresa e dytë

Këshilla e dhënë Umu Rumanit

Emigrimi i shenjtë

Hixhreti

Murtaja e Medinës

Martesa

Qëndrimi i babait të saj pas dasmës

Shtëpia e Aishes

Thjeshtësia e vazhdueshme

Përfaqësuesja e grave

Dashuria e saj për të Dërguarin e Allahut

Dashuria e Profetit

Arsyet e vërteta të kësaj dashurie

Aishja brenda shtëpisë

Zbavitja

Gara

Kërkesa për një emër të ri

Ndjeshmëria

Adhurimi i saj

Devotshmëria dhe përlësia e saj

Bujaria e saj

Kujdesi i saj për Hixhabin

Udhëzimi i të tjerëve dhe rrëfimi i Mesazheve hyjnore

Pjesëmarrja e Aishes nëpër fushata ushtarake

Begatia e tejumumit

Shpifja

Sëmundja e Aishes

Reagimi i sahabëve dhe besimi

Lajmi i mirë

Bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut dhe Aishja



Hatixhja

Bashkëshortet e tjera të të Dërguarit të Allahut

Statusi i Aishes

Ndalesa (Tahrimi)

Aishja dhe Fatimja

Ditët e fundit me të Dërguarin e Allahut

Epoka e Katër Kalifëve të drejtë dhe e Muavijes

Kalifati i Ebu Bekrit

Kalifati i Omerit

Kalifati i Osmanit

Kalifati i Aliut

Sprova e myslimanëve me vëllezërit e tyre: Ndodhia e Devesë

Kalifati i Muavijes

Aishja dhe Diya

Aishja ishte burim dijeje për çdo njeri

Aishja dhe transmetimi i dijes

Interpretimi (tefsiri)

Hadithi

Fikhu: Jurisprudenca islame

Teologjia islame (Kelam)

Aftësitë letrare të Aishes

Aftësitë poetike dhe oratoria

Mjekësia

Nxënësit e saj

Urve ibn Zubejri

Kasim ibn Muhamedi

Amra Bint Abdurrahman

Muadhe el Adeuije

Mosha në të cilën u martua Aishja me Profetin (s.a.s.)?

Aliu dhe Aishja

Bibliografia

## Parathënie

Hatixhja dhe Aishja zinin një vend të veçantë ndër bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut; ndërsa e para ishte si një mëkëmbëse besnike për Të në Mekë për pesëmbëdhjetë vjet me radhë, para se shpallja të bëhej publike, kjo e fundit e ka kryer të njëjtin mision gjatë periudhës së Medinës e mandej. Kur ato shihen nën këndvështrimin e misionit që kanë kryer, secila prej tyre kishte karakteristikat e veta specifike. Zoti i Plotfuqishëm e pajisi të Dërguarin e Tij me një karakter të fortë: në Mekë, ku besimi, sakrificat dhe trimëria ishin aq të nevojshme, Allahu (xh.xh.) i dha Atij Hatixhen; në Medinë, ku nevoja për dituri, inteligjencë dhe arsyetim ishte më e ndjeshme, Allahu (xh.xh.) i dhuroi Atij Aishen.

Sigurisht, Hatixhja ishte asokohe ndoshta gruaja më e guximshme e Mekës. Ajo i siguroi mbështetje të palëkundur të Dërguarit të Allahut gjatë ditëve më të vështira, kur problemet ishin në kulmin e tyre, gjatë ditëve të tij të vuajtjeve, kur problemet dhe fatkeqësitë pasonin njëra-tjetrën. Kur ai filloi të thërriste njerëzit në Islam, ajo u bë përkrahësja e Tij më e madhe, si materialisht ashtu edhe shpirtërisht. Hatixhja ishte myslimania e parë, duke besuar në të Dërguarin e Zotit në një moment jetik, kur ai kishte më shumë nevojë për të, dhe kjo nënkuptonte një vend të veçantë në anën e Zotit dhe të Dërguarit të Tij.

Pozicioni i Aishes ishte paksa i ndryshëm, ajo ishte një ndihmëse e veçantë për të Dërguarin e Allahut pas Hixhretit në Medinë, kur ishte nevojat për të punuar në shërbim të fesë ishin të mëdha. Aishja, me një mendje të ndritshme, kureshtare dhe një zgjuarsis të rrufeshme, u shqua menjëherë në shtëpinë e Profetit. Allahu i Plotfuqishëm e kishte pajisur atë me një madhështi të jashtëzakonshme. Ajo kishte një natyrë kureshtare dhe nuk e pranonte verbërisht atë që dëgjonte. Ajo ishte kritike ndaj çdo gjëje që dëgjonte, nëse ato nuk ishin sipas kritereve të vetë Kuranit dhe Sunetit të Profetit. Veshi i saj ishte gjithnjë në gatishmëri të shpalljes dhe sytë e saj ishin të përqendruara në rezultatet e saj. Aishja ishte si një urë lidhëse mes kohës së Profetit dhe të ardhmes së fesë islame.

Aishja përfaqësoi vitalitetin e shpalljes gjatë gjysmë shekulli me radhë pas vdekjes së të Dërguarit të Zotit, dhe nuk i privoi kurrë nxënësit e saj nga drita e profetësisë. Vendi i saj ishte mes katër kalifëve të Rugës së Drejtë, njëlloj siç është një udhëkryq për udhëtarët nga drejtime të ndryshme. Kur shfaqeshin polemika të më të shumëllojshmet, Aishja ishte arbitri që gjente zgjidhje të menjëhershme. Ajo ishte një korrektuese dinjitoze për gabimet në çështjet fetare që dolën në pah më vonë, dhe njëkohësisht një shembull i vendosmërisë dhe i durimit në rrugën e drejtë të Islamit.

Kudo ku ajo shkonte, ai vend fitonte gjallërim. Njerëzit që hynin në ambientet e saj, ndjenin se ndriçoheshin veçanërisht nga drita e shpalljes dhe ktheheshin të mbushur me ekzaltim dhe gjallëri, njëlloj sikur të kishin vizituar të Dërguarin e Zotit (s.a.s.). Askush nga ata që trokitën në portën e saj për të gjetur zgjidhjen e ndonjë problemi nuk ndodhi që të kthehej pa marrë më parë një përgjigje të pëlqyeshme. Ajo e zgjidhte çdo çështje të sajën thuajse menjëherë nëpërmjet ilaceve të Kuranit Famëlartë, si dhe gjente zgjidhje për problemet e të tjerëve drejtpërdrejt, po nga Kurani dhe nga Suneti i Profetit tonë të Dashur (s.a.s.). Në çështje të tjera, ajo vlerësonte, krahasonte dhe interpretonte mbi bazën e njohurive të shumta që ajo vetë kishte në fushën e fesë.

Aishja ishte nëna e të gjithë besimtarëve. Ndër gjërat që erdhën deri në ditët tona prej saj, kishte informacion të atillë, që nëse nuk do të ishte ajo, do të ishte zhdukur, sepse normalisht do të mbetej si pjesë e parrëfyer private në mes të bashkëshortëve. Prapa dyerve të mbyllura, ajo shtroi për diskutim çështjet më intime të të Dërguarit të Zotit, njëlloj sikur të hidhte një unazë të jetës për ne.

Aishja është duke i riftuar njerëzit e ndërgjegjes në Rrugën e Drejtë të Islamit. Shpresojmë se ky libër që ndodhet në duart tuaja, të shërbejë si një ftesë, dhe një mjet afrimi drejt veprave më të mira...

## NËNA E PASHOQE E BESIMTARËVE

### Ambienti ku u rrit

Aishja e nderuar erdhi në jetë përafërsisht katër apo pesë vjet para se Allahu i Madhëruar të nderonte Profetin Muhamed me shpalljen hyjnore<sup>1</sup>. I ati ishte Ebu Bekri, ndërsa e ëma, Umu Rumani. Të dy prindërit ishin pjesëtarë të fisit Kurejsh; i ati nga dega *Tejm*, ndërsa e ëma nga dega *Kinane*, dhe të dy binin kushërinj me Profetin, përkatësisht në brezin e gjashtë dhe të njëmbëdhjetë.

U rrit në një familje të vyer. Edhe pse në epokën e injorancës, në një kohë kur të gjithë vlerat humane ishin kthyer përmbys, i ati, Ebu Bekri nuk u përlye asfare nga papastërtitë e ambientit, duke jetuar bashkë me familjen një jetë dinjitoze. Pranimi i Islamit dhe ngritja vertikale e tij do të bazohej pikërisht mbi këtë botë të tijen të kulluar. Ebu Bekri edhe para se të bëhej mysliman ishte një person i respektuar dhe që i dëgjohej fjala. Çështjet lidhur me Gjobat, borxhet, gjakmarrjen dhe trashëgiminë, pyeteshin fillimisht tek ai dhe vetëm më pas merreshin vendimet. Ebu Bekri pranohej gjerësisht si njohës i mirë i gjenezës.

Edhe e ëma, Umu Rumani ishte ndër të parat që i dhanë besën Profetit, dhe si e tillë do të kujtohet gjithmonë. Ajo kaloi së bashku me të shoqin të gjitha vuajtjet dhe torturat e idhujtarëve. Emigroi bashkë me vajzat e saj në Medinë krahas Profetit.

Nëna e besimtarëve, Aishja e nderuar, u rrit në një shtëpi me të vëllanë, Abdullahun dhe të motrën, Esmanë, vëlla e motër nga martesja që i ati kishte patur para se të bëhej mysliman.

Veçoria më e madhe e Aishes së nderuar ishte pikërisht të qenit vajzë e një njeriu të ndritur si Ebu Bekri, të cilin as epoka e injorancës nuk e kishte influencuar aspak. E rritur në një shtëpi të bekuar ku ndotja nuk e kishte përkitur, ajo tashmë po edukohet nga një baba tepër i ndjeshëm.

### Pranimi i Islamit

Që nga momenti i parë në të cilën Aishja e nderuar nisi të njohë vetveten, në shtëpinë e saj nuk u fol gjë tjetër veç dritës së Islamit. Prindërit i kishte parë veçse duke falur namaz dhe duke diskutuar rreth ajeteve të Kuranit. Gjithmonë kishte ndjekur me admirim të thellë se si i ati përlohej teksa lexonte Kuran. Më vonë, vetë ajo do të shprehej kështu:

“Që në kujtimet e mia fillestare, mbaj mend se prindërit i kisha besimtarë.”<sup>2</sup>

Ishin vitet e para të profetësisë. I Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të kishte zbritur nga Hira dhe Drita që kishte sjellë Ai sapo kishte nisur të ndriçonte qiellin e Mekës. Ebu Bekri sapo ishte kthyer nga një udhëtim me qëllim tregtie nga Jemeni, dhe menjëherë kishte rendur për te Profeti për të pranuar Islamin. Kështu, Ebu Bekri u bë i pari mburrë i lirë që pranonte Islamin. Pa kaluar shumë, Islamin e pranoi edhe bashkëshortja, Umu Rumani. Tani radha ishte familjarët e tjerë.

Ndërkohë, Aishja ishte ende pesë vjeç. Megjithëse e vogël në moshë, bashkë me të motrën, Esmanë, nën përkujdesjen e të atit, edhe ajo pranoi Islamin. Kështu ajo u radhit ndër myslimanët e parë.

Ajo do të rritej kësisoj me çdo ajet që zbriste dhe do të zgjohej çdo ditë me një mesazh të ri nga oqeani i besimit. Çdo lajm i ardhur nga Xhebraili do të shkulte me radhë të gjitha zakonet e errëta të

<sup>1</sup> Nga vlerësimi i të gjitha burimeve lidhur me moshën e saj, kjo duket të jetë më afër të vërtetës. Gjithsesi, në fund të librit kemi veçuar një kapitull të tërë kushtuar kësaj teme.

<sup>2</sup> Buhari, *Salat* 52; *Fedail* 74. Hanbel, *Musned* 6/198; Bejheki, *Sunen* 6/204.

inJORANCËS dhe i shndërronte besimtarët në një kështjellë të pamposhtur besimi. Ajo i ndiqte me vëmendje dhe inteligjencën e saj karakteristike, dhe i regjistronte me përkushtim të gjitha në memorien e saj për t'i transmetuar ato në vitet e mëpasme.

## Fejesa

Një ditë, dikush trokiti në derën e Ebu Bekrit dhe ishte pikërisht Mut'im ibni Adiji<sup>3</sup> që pyeste nëse ata e jepnin vajzën e tyre Aishen si nuse për djalin e tij, Xhubejrin. Mut'im ibni Adiji ishte një personi rrallë, i cili po si Ebu Bekri, ishte i ditur në fushën e gjenealogjisë, kështu që ishte e natyrshme të donte të bashkonte familjen e tij me atë të një personi të veçantë siç ishte Ebu Bekri. Meka në ato kohë ishte aq e vogël, saqë njerëzit e njihnin njëri-tjetrin deri në imtësi, prandaj Mut'im ibn Adiji ishte në gjendje të parashikonte të ardhmen e Aishes, natyrën, qëndrimin dhe sjelljet e saj. Ai ëndërronte të kishte një nuse të re si Aishja, e cila për më tepër ishte inteligjente, e respektueshme, e sjellshme dhe e pastër. Atë ditë Ebu Bekri nuk e refuzoi kërkesën. Për disa, mosrefuzimi i një kërkesë të tillë ishte i njëvlershëm me një fejesë në ato kohë. Por Ebu Bekri, i cili e konsideronte deklaratën e tij si një kontratë, kishte vendosur t'i kushtonte vëmendje të veçantë kërkesës. Megjithatë, ndërkohë që ditët kalonin, dyshimet nisën të shfaqeshin. Meqenëse nuk iu kthye asnjë përgjigje, familja e ibni Adijit filloi të dyshonte fort nëse djali i tyre duhej të martohej me vajzën e Ebu Bekrit, e në këtë mënyrë ata filluan të mos e vizitonin më aq shpesh Ebu Bekrin.

Më vonë u kuptua mirë se si qëndronte gjendja. Duke gjykuar se kushtet kishin ndryshuar, familja e ibni Adijit u mund nga disa dyshime të vetat. Kur Profetit Muhamed (s.a.s.) i filloi shpallja në shpellë, atje në malin Hira, Ebu Bekri pranoi Islamin. Ajo ishte një periudhë kur besimtarët filluan të përcillnin mesazhin nga shtëpia e ibni Erkamit, thirrja e njerëzve në Islam u bë publike dhe adhurimi nuk u fsheh më në Mekë ashtu siç ndodhte më parë. Si më të dashurit dhe të besuarit e shokëve të Profetit, Ebu Bekri bashkë me familjen e tij qëndronin në pararojë. Vizitat nga familja e ibn Adijit te familja e Ebu Bekrit u ndalën, dhe familja e ibni Adijit i shihte prej së largu gjykimet e Ebu Bekrit, vajzën e të cilit ata e kishin kërkuar me aq këmbëngulje për djalin e tyre.

## Kujtime nga Meka

Por jeta vazhdonte. Çdo mëngjes Meka gdhihej me shkëlqimin e lajmeve të reja rreth besimtarëve të rinj, që hynin nga dita në ditë në besimin islam. Çdo natë, Meka bëhej edhe më e errët nga vështirësitë dhe detyrimet që u shkaktoheshin besimtarëve.

Duke përjetuar gëzim dhe vështirësi së bashku, Aishja vërente çdo gjë me imtësi, dhe më vonë ishte ajo që do t'i përshkruante këto situata me përpikëri për brezat e ardhshëm. Ndjenja e saj e natyrshme e kureshtjes bëri që ajo të regjistronte çdo zhvillim të ri që përjetonte, gati sikur të ishte duke mbledhur një album fotografik të të gjithë jetës së saj. Ajo e dinte se ku ishte shpallur ky apo ai ajet, cili u bë mysliman, andaj kur një ditë, shumë vite më vonë, një burrë nga Iraku erdhi në Medinë dhe e pyeti në lidhje me periudhën mekase, përgjigjja që ajo i ktheu ishte një analizë e mprehtë dhe mjaft domethënëse në lidhje me gjithë rrethanat e periudhës në fjalë.

Periudha e Mekës ishte e mbushur me kujtime, sa të paharrueshme aq edhe pikëlluese për Aishen. Shkëlqimi i vetëm në jetën e saj ishte i Dërguari i Zotit (s.a.s.). Ai e vizitonte shpesh

---

<sup>3</sup> Mut'im ibni Adiji ishte një udhëheqës i fisit Beni Neufel. Ai ishte personi, i cili e mbrojti dhe e strehoi Profetin Muhamed pas kthimit të Tij nga qyteti i Taifit. Po kështu, Ibni Adiji ishte një figurë kyçe kur iu dha fund bojkotit tre-vjeçar ndaj myslimanëve.

shtëpinë e Ebu Bekrit dhe i ngushëllonte vazhdimisht. Aishja e shprehu gjithmonë kënaqësinë që ndjente për këtë me fjalët:

“Që kur mbaj mend, i kam parë prindërit e mi si besimtarë të devotshëm. I Dërguari i Zotit na vizitonte pothuajse çdo ditë në mëngjes ose në mbrëmje.”<sup>4</sup>

### **Propozimi për martesë**

Dy vite kishin kaluar që nga vdekja e Hatixhes, dhe i Dërguari i Zotit jetonte vetëm me tri vajzat e Tij. Një ditë, gruaja e Osman ibni Maz'unit, Haula binti Hakimja, erdhi tek i Dërguari i Zotit plot druajtje dhe e pyeti:

“A dëshiron të martohesh?”

I Dërguari i Zotit ishte pesëdhjetë vjeç asokohe, dhe së bashku me tri vajzat e Tij e ndjente thellë pikëllimin për vdekjen e Hatixhes, ndaj iu përgjigj:

“Dakord, por me kë?”

E përgatitur për përgjigjen, Haula iu përgjigj pyetjes së Tij me një tjetër pyetje, duke i thënë nëse ai do të parapëlqente më shumë një grua të ve apo dikë të pamartuar më parë. Qëndrimi i saj ishte ai i një gruaje të aftë që mund t'i gjente të dyja. Profeti ynë i dashur e pyeti në lidhje me mundësinë e dytë.

“Është Aishja, e bija e Ebu Bekrit, një mik të cilin ti e do më tepër se këdo tjetër në mesin e njerëzve.”

Pastaj Ai e pyeti Haulan se cila ishte mundësia tjetër. Ajo doli se ishte Seude binti Zam'a, një nga myslimanet më të hershme. Seudeja e kishte pranuar Islamin gjatë ditëve më të vështira në Mekë, madje edhe kishte emigruar në Abisini për t'i shpëtuar persekutimit. Fatkeqësisht, burri i saj Sekran ibni Amri kishte vdekur në Abisini dhe sakaq ajo u gjend e detyruar të kthehej. Që të dyja ishin të përshtatshme, andaj Ai i kërkoi Haulas që më parë të merrte mendimin e tyre.

### **Ndalesa e parë**

Haula ishte e lumtur, sepse ajo shpresonte të pakësonte problemet e Profetit. Seudeja ishte një grua e besueshme dhe e pjekur. Anipse në zemrën e saj ajo ende mbante zi për bashkëshortin, kjo ofertë ishte e një natyre të tillë që të mund t'ia fashiste krejt dhimbjet. Seudeja kishte një baba të moshuar dhe ajo vendosi të merrte më parë bekimin e tij. Edhe kjo detyrë iu ngarkua Haulës. Ajo shkoi tek i ati i moshuar i Seudes dhe i tha atij se Muhamedi, i biri i Abdullahut, kërkonte dorën e vajzës së tij për martesë. Plaku, me të dëgjuar emrin, “Muhamedi, i biri i Abdullahut”, u ngrit dhe tha:

“Ai është një burrë bujar dhe një gjetje mjaft e mirë. Por si ndjehet shoqja jote për këtë?”

Haula u përgjigj menjëherë:

“Edhe asaj i pëlqen kjo ide.”

Edhe pse Seudeja e dha pëlqimin, disa prej të afërmve të saj e kundërshtuan menjëherë këtë martesë. Vëllai i saj Abdullah ibn Zam'a, i cili e mori vesh më vonë lajmin, protestoi ndaj vendimit

---

<sup>4</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/198; Bejhekiu, *Sunen*, 6/204.

të të atit.<sup>5</sup> Gjithashtu edhe xhaxhai i Seudes ulëriti me anë të një vjershe, duke e kundërshtuar haptazi këtë martesë.

### **Adresa e dytë**

Mandej Haula shkoi tek shtëpia e Ebu Bekrit dhe foli me gruan e tij Umu Rumanin:

“I Dërguari i Allahut më nisi këtu që t’ju kërkoj dorën e vajzës suaj Aishes për martesë.”

Umu Rumani mbeti pa fjalë nga gëzimi. Por asaj iu kujtua diçka që kërcënonte të errësonte këtë gëzim që sapo e kishte ndriçuar gjithë atmosferën përreth. Asaj i erdhi ndër mend premtimin që i shoqi i saj i kishte dhënë kohë më parë Mut'im ibn Adijit. Kështu që, Umu Rumani këshilloi që ato të prisnin më mirë derisa të vinte edhe Ebu Bekri. Kur Ebu Bekri arriti në shtëpi, Haula i dha atij lajmin e gëzueshëm. Ai sigurisht që dëshironte të bëhej i afërm i Profetit Muhamed paqja qoftë mbi Të, por kishte një dyshim në mendjen e tij. Sipas traditave para-islame, martesë e fëmijës me fëmijën e një miku të ngushtë nuk ishte e lejuar. Kur i Dërguari i Zotit dëgjoi për këtë, ai tha se vëllazëria e tyre ishte vëllazëri në fe, kështu që nuk kishte asnjë pengesë që kjo martesë të kryhej. Ebu Bekri u lumturua aq shumë sa që iu rrëmbushën sytë me lot. Megjithatë, ai nuk e kishte harruar aspak problemin tjetër që i qëndronte mbi krye. Ai shkoi në shtëpinë e Mut'im ibn Adijit që të çlirohej nga një premtim që sa më tepër t'i rrinte mbi krye mund t'i shkaktonte edhe mjerim nga çasti në çast. Ata nuk mendonin më për një fejesë siç e kishin planifikuar, e ajo që Ebu Bekri kishte filluar të mendonte nuk ishte më e ndryshme nga ajo.

Haula dhe Umu Rumani morën frymë lehtësisht kur e dëgjuan lajmin e mirë.

"Tani, mund të shkosh dhe ta ftosh të Dërguarin e Allahut.", - i tha Ebu Bekri Haulës.

Ishte muaji i Sheualit në vitin e dymbëdhjetë të shpalljes kur u bë fejesa mes Profetit tonë të Dashur dhe Aishes së nderuar (r.a.). Katërqind derhemë, të cilat konsideroheshin një shumë paksa bujare për atë kohë, u caktuan si prikë për nusen e re.<sup>6</sup>

Që nga ajo ditë, për Aishen filloi një periudhë e re jete. Ajo tanimë ishte më e lumtura e grave të reja, pasi ajo do të bëhej gruaja e robit më të dashur të Allahut (xh.sh.). Në të njëjtën kohë, një përgjegjësi e madhe, përgjegjësia e të qenit nënë e gjithë besimtarëve<sup>7</sup>, nisi të rëndonte mbi supet e saj që në moshë fare të re. Duke pasur një marrëdhënie kaq të ngushtë me robin më të dashur të Zotit, asaj iu dha mundësia të fitonte njohuri të një natyre të atillë që askush tjetër nuk mund t'i arrinte.

Aishja ishte e ndërgjegjshme për përgjegjësitë e saj. Procesi i shpalljes, i cili ishte ndjekur prej saj me kujdes deri në atë ditë, tani do të trajtohej edhe me më shumë kujdes, duke regjistruar çdo ngjarje si një fotografi në mendjen e saj.

### **Këshilla e dhënë Umu Rumanit**

Nëna e Aishes, Umu Rumani, ndjeu një barrë të rëndë mbi supet e saj, sepse e bija ishte duke u bërë gruaja e Profetit (s.a.s.). Ajo u bë shumë e ndjeshme ndaj sjelljes energjike të vajzës së saj. Kur shihte diçka që nuk i pëlqente, ajo e qortonte Aishen, nganjëherë edhe shumë ashpër. I Dërguari i Zotit, i cili erdhi për t'i vizituar, pasi kishte ndodhur një incident i tillë, e ndjeu atmosferën e ftohtë

<sup>5</sup> Më vonë, Abdullah ibni Zam'a do të bëhej mysliman dhe do të shprehte keqardhjen për reagimin që pati shfaqur faqe të gjithëve atë ditë.

<sup>6</sup> Nesai, *nikah*, 66; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/427.

<sup>7</sup> Ahzab, 6; Aty thuhet se bashkëshortet e Profetit janë nënat e besimtarëve.

në shtëpi dhe pyeti për arsyen e kësaj gjendjeje. Umu Rumanu u vu në siklet, megjithatë ia shpjegoi Atij se çfarë kishte ndodhur mes saj dhe së bijës. Profeti u kthye nga Umu Rumanu dhe i tha:

“O Umu Ruman! Të lutem për hatrin tim, trajtoje mirë Aishen dhe mos ja ceno të drejtat!”<sup>8</sup>

### **Migrimi i shenjtë**

Aishja vijoi të jetonte në shtëpinë e prindërve të saj. Gjatë asaj periudhe, i Dërguari i Allahut vizitoi mjaft fise, duke i ftuar ata të hynin në Islam. Ai ishte në kërkim të zemrave të hapura që do t'i nënshtroheshin Allahut dhe shkoi në Taif me atë qëllim, por u kthye me telashe të mëdha. Por pastaj, diçka ndodhi tek i Dërguari i Zotit që e bëri Atë të harronte të gjitha gjërat e papëlqyeshme që ishin duke ndodhur. Udhëtimi i Natës dhe Ngjitja në Qiell (Isra dhe Miraxhi) ishin produkt i këtyre ditëve të vështira. I Dërguari i Zotit u dërgua në Xhaminë Aksa në Jerusalem një natë ku ai udhëtoi nëpër qiell dhe u kthye sërish po atë natë. Kur idhujtarët e Mekës dëgjuan për ngjitjen e Profetit në qiell, u gëzuan duke menduar se pamundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të tillë do të ishte një mundësi e përkryer, për t'i bërë njerëzit të mos besojnë më në të Dërguarin e Zotit. Por incidenti krijoi një perde ndërmjet besimit dhe mosbesimit, duke i shtyrë besimtarët të arrijnë thellësi të tjera të besimit. Ebu Bekri arriti gradën e besnikërisë. Si një anëtare e shtëpisë së Ebu Bekrit dhe si gruaja e ardhshme e të Dërguarit të Zotit, Aishja e ka ndjekur nga shumë afër atë çfarë ndodhi.

Idhujtarët në Mekë e vijuan persekutimin e besimtarëve. Profeti dhe shokët e Tij ishin afër fundit të qëndrimit të tyre në Mekë. Në fakt, i Dërguari i Zotit kishte një ëndërr, ndërsa u tregonte shokëve të Tij rrugët e Medinës për të kapërcyer problemet në Mekë. Por kjo nuk ishte e lehtë.

Për të Dërguarin e Zotit, shtëpia e Ebu Bekrit ishte si shtëpia e Tij; vështirë se ka kaluar një ditë në të cilën ai të mos e ketë vizituar shtëpinë e Ebu Bekrit.

Një ditë, ai erdhi për vizitë në mesditë, një kohë e pazakontë për Të. Të gjithë u habitën dhe pjesëtarët e shtëpisë menjëherë e lajmëruan babanë e tyre në lidhje me vizitën.

Ebu Bekri e njihte më mirë se kushdo karakterin e Profetit. Ai e dinte se sa i ndjeshëm ishte ai në lidhje me respektimin e të drejtave të të tjerëve, se sa mundohej Ai të shmangte bezdinë që mund t'u shkaktonte të tjerëve duke i vizituar në kohën e pushimit të drekës. Meqenëse Profeti e kishte vizituar, pavarësisht ndjeshmërisë së tij, Ebu Bekri mendoi menjëherë se mund të bëhej fjalë për diçka të rëndësishme që kërkonte ngut.

Sapo ai hyri në shtëpi, Profeti i tha se dëshironte të fliste në mënyrë private. Ebu Bekri u përgjigj:

“T’u bëfshin kurban prindërit e mi, o i Dërguari i Zotit. Këta janë të gjithë nga umeti yt.”

Ai kishte të drejtë. Që të dyja si Esmaja ashtu edhe Aishja ishin të afërta për të Dërguarin e Zotit qysh në vitet e para të shpalljes dhe ato mund t'i ruanin mjaft mirë edhe sekretet. Të dyja motrat qëndruan aty për t'u bërë dëshmitare të kësaj bisede të rëndësishme.

Profeti tha:

“Më është dhënë leje për të lënë Mekën dhe për të migruar.”

Kjo ishte një fjali të cilën Ebu Bekri kishte kohë që e priste. Ai u gëzua sepse e dinte se më në fund persekutimi i Mekës do të merrte fund. Por a do të ishte ai së bashku me të Dërguarin e Allahut në udhëtimin e Tij? Tërë padurim ai e pyeti:

---

<sup>8</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/6.



"A do të jemi bashkë, o i Dërguari i Zotit?"

Ebu Bekri priste përgjigjen me ankth të madh. Profeti u kthye nga ai, dhe nga buzët e Tij të bekuara dolën fjalët e mëposhtme:

"Po, bashkë do të jemi!"

Ebu Bekri i dilyn lot prej gëzimit.<sup>9</sup> Nga ky çaste e tutje, familja e Ebu Bekrit nuk fliste për asgjë tjetër përveç migrimit të ardhshëm. Aishja dhe motra e saj, Esmaja, së bashku me nënën e tyre Umu Rumanin, kishin filluar saora përgatitjet e udhëtimit.

Kjo do të thotë se Esmaja dhe motra e saj dhjetë vjeçe më e re, Aishja, ishin dëshmitarët e para të migrimit të shenjtë. Ato ishin të parat që u njohën me planet e udhëtimit të babait të tyre dhe të Dërguarit të Zotit. Ato ndoqën nga afër skemën që përfshinte çështje të tilla si rrugëtimin, rregullimin e lëvizjes, vendet në malin Theur, ku ata do të fshiheshin dhe të prisnin për tri ditë, derisa gjithçka të qetësohej, si dhe informacion në lidhje me njerëzit të cilët do t'i vizitonin ata, dhe se çfarë përgjegjësie do të merrnin ata.

Kur mosbesimtarët e Mekës dëgjuan që bashkësia e të Dërguarit të Zotit po migronte për në Medinë, u përpoqën që t'i ndalonin me mënyra të ndryshme. Ata vunë roje në rrugë të ndryshme që shkonin drejt Medinës, dhe i detyruan disa prej tyre të ktheheshin; disa prej njerëzve ua ndaluan fizikisht të largoheshin; morën pasurinë e disa besimtarëve, disa besimtarë i ndanë nga familjet e tyre, por në fund, ata nuk qenë në gjendje t'i detyronin myslimanët të hiqnin dorë nga plani i tyre i emigrimit.

Në fund, mosbesimtarët u mbledhën së bashku dhe morën një vendim përfundimtar që ta vrisnin Profetin e Bekuar.

Në këto ditë, rrugët e zbehura të Mekës, sikur të kishte rënë vetë vdekja, po përgatiteshin për t'u dhënë lamtumirën "dy udhëtarëve". Kur erdhi koha, një pikëllim i thellë mbushi zemrat e familjes së Ebu Bekrit. Sigurisht Aishja po përjetonte dyfishin e shqetësimit të Esmasë. Të gjithë ndiheshin të dëshpëruar e të trishtuar nga të qëndruarit larg të Dërguarit të Allahut, por dëshpërimi dhe trishtimi i Aishes ishte shumë i ndryshëm. Që nga ajo ditë e tutje, veshët e Aishes do të rrinin të ngritur pipëz për të dëgjuar ndonjë lajm që vinte nga përreth. Ankthi i saj rritej si rezultat i reagimeve jo normale të politeistëve në Mekë, kështu që ajo mendohej të merrte lajme nga çdo burim i mundshëm. Idhujtarët e Mekës u zemëruan kur nuk mundën ta kapnin dhe vrisnin dot Profetin, ndaj në këtë mënyrë, ata prematuan një shpërblim prej njëqind devesh për këdo që mund t'i sillte të vdekur ose të gjallë udhëtarët e arratisur. Nuk është çudi, që kreu i idhujtarëve ishte Ebu Xhehli; ai shkoi me zemërim në shtëpinë e Ebu Bekrit dhe i pyeti se ku ishte babai i tyre. Ata nuk e dinin, por ky nuk ishte arsye për Ebu Xhehlin. I zemëruar, ai e qëllloi Esmanë, e cila ishte gjashtë muajshe shtatzënë.<sup>10</sup>

Të dy udhëtarët ishin larguar, duke e mbajtur destinacionin e tyre sekret. Por një turmë e formuar rreth Qabes tërhoqi vëmendjen e Esmasë dhe ajo u afrua më afër për të dëgjuar çka po thuhej. Një njeri i kishte parë dy njerëzit më të përsosur të kësaj bote, të udhëtonin drejt Medinës. Kur Esmaja u tregoi ato që kishte dëgjuar njerëzve të tjerë të shtëpisë, të gjithë psherëtinë të lehtësuar dhe falënderuan Zotin që i kishte mbrojtur babanë e tyre dhe të Dërguarin e Zotit, pavarësisht përpjekjeve të idhujtarëve të Mekës.

<sup>9</sup> Taberi, *Tarih*, 1/569; ibni Hisham, *Sira*, 3/11.

<sup>10</sup> Ebu Nuajm, *Hiljetu'l Eulija*, 2/56; ibni Hisham, *Sira*, 3/14.

## Hixhreti

Tre muaj kishin kaluar dhe ende nuk kishte asnjë lajm prej Ebu Bekrit dhe të Dërguarit të Zotit. Një ditë, Aishja dhe Esmaja panë Abdullahun, vëllanë e tyre tek vinte në drejtim të tyre i gëzuar. Menjëherë, ato e kuptuan dhe rendën drejt tij me gëzim. Babai i tyre Ebu Bekri, u kishte dërguar një letër në të cilën i ftonte anëtarët e familjes të shkonin në Medinë.<sup>11</sup>

Letra u soll nga Zejd ibni Harithi dhe Ebu Rafiu. Abdullah ibn Urejkiti, udhërrëfyesi i migrimit të shenjtë, gjithashtu u bashkua me ta në udhëtimin e tyre. Në fund të letrës së dërguar të birit, Abdullahut, kërkohej nga babai i tij që t'i merrte motrat dhe nënën dhe të shkonin në Medinë.

Detyra e Ebu Rafiut dhe Zejd ibni Harithit ishte e përcaktuar qartë; ishte i Dërguari i Allahut Ai i cili i kishte nisur ata. Ai u kishte dhënë me vete dy deve dhe pesëqind dërhemë, duke u kërkuar të shpinin edhe familjen e tij në Medinë bashkë me familjen e Ebu Bekrit.

Pak kohë më vonë, përgatitjet kishin përfunduar dhe të dyja familjet filluan të migrojnë së bashku në një kohë kur jobesimtarët e Mekës nuk e kishin mendjen. Ata ishin duke shkuar në Medinë, në qendrën e qytetërimit, dhe pranë të Dërguarit të Zotit me synimin që të mos ndaheshin më kurrë prej Tij. Ata kishin nisur një udhëtim të trazuar që linte pas çdo farë problemi.

Rruga e tyre ishte plot me të papritura. Sapo kishin lënë Medinën dhe ishin drejtuar drejt Minës, kur u takuan me Talha ibn Ubejdullahun, i cili gjithashtu ishte nisur për të bërë migrimin. Gëzimi i tyre arriti caqet kur u takuan këtë burrë besnik, i cili ishte angazhuar me misionin e Profetit qysh në ditët e para të shpalljes. Lumturia e tyre shihej qartë në sytë që u shkëlqenin. Pastaj grupi vijoi rrugën. Mirëpo deveja e Aishes u nervozua dhe refuzonte të ndiqte karvanin. Shqetësimi i Umu Rumanit rritej kur mendonte se ajo deve, mbartte mbi shpinë bashkëshorten e ardhshme të të Dërguarit të Allahut (s.a.s). Deveja nisi të vraponte sipas dëshirës. Dukej se nuk mund të bëhej asgjë për ta ndalur. Umu Ruman, frika e së cilës rritej me çdo hap që hidhte deveja, e cila po ia largonte sa vjen e më shumë të bijën, u frikësua shumë se mos i ndodhte ndonjë gjë e keqe dhe i thirri:

“Lëshoja frerin!”

Ajo shpresonte që këshilla e saj të kryente punë, kur as veprat nuk pinin ujë. Ajo shpresonte që freri i devesë të kapej pas ndonjë dege ndërsa zvarritej në tokë, dhe ta ndalte sakaq devenë që të mos ecte më tej.<sup>12</sup>

Dhe me të vërtetë kështu ndodhi. Deveja që po ngiste Aishja, litarin e së cilës ajo e lëshoi përtokë sipas këshillës së të ëmës, ndali së ecuri. Koka e litarit ishte kapur për një dege, duke e ndaluar saora devenë e pabindur.

Anëtarë të tjerë të karvanit vrapuan drejt saj, dhe e bënë devenë të vazhdonte rrugën. Çdo gjë ishte stabilizuar dhe hapat e tyre nisën të përshpejtoheshin sërish në drejtim të Medinës.

Udhëtim do të thoshte një vështirësi më shumë për Esmanë, të motrën e Aishes, e cila ishte shtatzënë në ato kohë. Dhimbjet e lindjes së Esmasë u shtuan gradualisht, dhe kur ata arritën në Kuba, ajo nuk mund të duronte dot më. Edhe pse ata ishin shumë afër destinacionit të tyre, iu desh të ndaleshin, që Esmaja të lindte djalin e saj. Ata e morën foshnjën me vete tek i Dërguari i Zotit. Ai e mbajti njëherë në krahë të miturin, u mendua, dhe e quajti Abdullah.<sup>12</sup>

---

<sup>11</sup> Thuhet se Profeti mori pesëqind dërhemë borxh nga Ebu Bekri. Kur ata erdhën tek një vend i quajtur Kadid, Zejdi i bleu të trija devetë që do përdoreshin gjatë udhëtimit. Shih Ebu Nuajm, *Hiljatul Evlija* 9:227; Dhahabi, *Sijar* 2:152.

<sup>12</sup> Taberani, *Mexhmau'l Kebir*, 23/183; Hejthem, *Mexhmuatu Zeuaid*, 9/366; Tehmez, *Sejdatu Aisha*, 27.

## Murtaja e Medinës

Udhëtimit të tyre tremujor i erdhi fundi, dhe sakaq ata mbërritën në qytetin e Medinës. Në këtë kohë, i Dërguari i Zotit ishte i zënë me ndërtimin e xhamisë së Tij, Mesxhidi Nebeui. Problemet që kishin përjetuar në Mekë dukej sikur kishin sosur, megjithatë, ata përjetuan edhe këtu një ngjarje të atillë, e cila do ta eklipsonte lumturinë e tyre; migruesit, të cilët nuk ishin mësuar me kushtet klimaterike të Medinës, ishin duke vuajtur nga një sëmundje e panjohur deri më tani. Në mes tyre ishte edhe Ebu Bekri. Ai flinte i mbytur në ethe, në pritje të një dore të mëshirshme që ta shpinte përsëri drejt shëndetit. Ata kishin rënë të sëmurë nga murtaja e Medinës. Disa prej tyre madje nuk kishin as fuqi për të qëndruar në këmbë dhe për këtë arsye i falnin namazet të ulur ndenjor, por kurrsesi nuk ndodhte që të hiqni dorë prej tij. Atëherë i Dërguari i Allahut, u kthye drejt tyre dhe u tha:

“Ju duhet ta dini se ai që falet ulur merr vetëm gjysmën e shpërblimeve që merr ai që falet në këmbë.”<sup>13</sup>

Pas kësaj, sahabët u përpoqën me mish e me shpirt, që këndej e tutje t'i falnin namazet e tyre në këmbë.

Pasi mori leje nga i Dërguari i Allahut, Aishja shkoi të vizitonte babanë e saj, i cili dergjej shumë i sëmurë. Bilal Habeshiu dhe Amir ibni Fuhejre ndanin të njëjtën dhomë me Ebu Bekrin. Aishja iu afrua të atit, por zemra e saj nuk mund ta përballonte pikëllimin që i shkaktonte pamja që i shfaqej përpara syve; ngjante sikur i ati ishte larguar dhe në vend të tij, rrinte dikush tjetër, ashtu duke u dridhur nga ethet e sëmundjes. Ai njeri aq aktiv, tani ishte duke u përpëlitur në ethe, në gjendje krejt të pavetëdijshme. Ajo i shkoi afër dhe i tha:

“O babai im i dashur, si je? Si e ndien veten?”

Sytë e Ebu Bekrit farfuritën. Dukej sikur një dritë po zbardhte nga brendia e tij dhe buronte nga fakti që tani gjendej afër vajzës së tij të dashur. Megjithatë, shpirti i tij ishte larg nga fjalët e saj. Ai i hodhi një vështrim kuptimplotë së bijës, të cilën kishte kohë që nuk e kishte parë, pasi ai kishte qenë larg për muaj të tërë, dhe i tha:

“Secili zgjohet në shtëpinë e vet, por vdekjen e ka më afër se lidhëset e këpucëve.”

Aishja u shokua. Vërtet, vdekja është gjithnjë kaq pranë, por edhe jeta ende vazhdon për një njeri të sëmurë. Ebu Bekri dëshironte të jepte këshilla me gjuhën e sëmundjes, së pari Aishes, mandej edhe gjithë të tjerëve. Por ajo mendoi:

“Me siguri, babai im tani është i pavetëdijshëm, e nuk di se ç'flet.”

As Bilal Habeshiu as Amir ibni Fuhejre nuk ishin të vetëdijshëm. Sëmundja kishte lënë gjurmë të thella në zemrat e tyre; qëndrimi në shtëpinë e re ngjante t'i kishte përkeqësuar më shumë.

Aishja u largua e dëshpëruar prej andej. Ajo s'mund të shtirej sikur nuk kishte ndodhur asgjë. Shkoi tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe i tregoi Atij ato që kishte parë e dëgjuar, sepse e dinte se Ai ishte në gjendje t'i gjente zgjidhje çdo problemi. Aishja i tha:

“Ata kishin rënë në kllapi prej temperaturës së lartë. Janë të pavetëdijshëm për ato që flasin.”

I Dërguari i Allahut u trishtua shumë; Ai i ngriti duart drejt qiellit dhe u lut sërish kundër atyre që ishin shkaktarët e kësaj gjendjeje, ata që, për vite me radhë, nuk kishin reshtur së persekutuari myslimanët:

---

<sup>13</sup> Buhariu, *Menakibu'l Ensar*, 45; Muslim, *edeb*, 25-26; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/54, 206.

“O Zoti im! Unë po t’i lë Ty në dorë Utbe ibni Rebian, Shejbe ibni Rebian dhe Umeje ibni Halefin; ishin ata që na detyruan të ikim nga qyteti ynë e të vijmë në këtë vend ku ka pllakosur murtaja; jepu atyre atë që meritojnë!”

Pastaj u kthye dhe u lut për shokët e Tij me fjalët:

“Zoti im! Na bëj ta duam Medinën po aq shumë, madje edhe më shumë nga sa na e bërë të dashur Mekën. Bëje këtë qytet një vend sa më të shëndetshëm dhe sa më të begatë. Hiqe këtë sëmundje dhe dërgoje tutje, në drejtim të Xhuhfes.”<sup>14</sup>

Atë natë, I Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi Të pa në ëndërr një grua me pamje të zymtë e të rrudhur, e cila udhëtonte nga Medina drejt Xhuhfes. Ëndrra nënkuptonte se lutja i ishte pranuar. Pas këtij momenti, emigrantët nuk vuajtën më kurrë nga temperatura e lartë apo nga ndonjë sëmundje tjetër, që mund të kishte lidhje me klimën e Medinës.<sup>15</sup>

---

<sup>14</sup> Tirmidhiu, *salat*, 247; Ibn Maxhe, *salat*, 141; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2:192, 203, 214; Ibni Kethir, *el Bidaje*, 3:224.

<sup>15</sup> Buhari, *Fedailu Medina*, 11; *Fedailu Sahabe*, 75; Merda, 8.

## MARTESA

Aishja, e cila kishte emigruar së bashku me anëtarët e familjes së saj, natyrisht jetonte përkohësisht në shtëpinë e të atit. Shtëpia ishte në lagjen Beni Harith ibni Hazrexh. Në atë kohë, i Dërguari i Zotit qëndronte si mysafir në shtëpinë e Halid ibni Zejdit.

Më pas ishte Aishja ajo që ra e sëmurë. Trupi i saj ishte i dobët dhe kushtet e udhëtimit e të Medinës ishin tejet të vështira për të. Ajo kishte humbur shumë peshë dhe kishin nisur t'i binin flokët. Nëna e saj, Umu Rumani provoi gjithë ç'kishte në dorë që vajza e saj të rifitonte shëndetin e humbur. Ebu Bekri, i cili tani ishte disi më mirë, e vizitonte vajzën e tij të sëmurë vazhdimisht, dhe ia përkëdhelte kokën me dhembshuri. Ai i lutej Allahut që t'ia rikthente vajzës së tij shëndetin e mëparshëm.

Pas një muaji që kur kishte rënë e sëmurë, Aishja nisi të ndjehej më mirë, madje rifitoi ca peshë si rezultat i kujdesit të veçantë të nënës. Sakaq, Profeti e kishte përfunduar së ndërtuari xhaminë e re dhe qytetërimi që do të rritej përreth saj, filloi të lulëzonte në Medinë.

Xhebraili (a.s.) erdhi tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe i tha:

“Martohu me të, meqenëse ajo është gruaja jote.”

Pastaj, edhe Ebu Bekri erdhi dhe e pyeti gjithashtu:

“O i Dërguari i Allahut, a ka ndonjë arsye që të pengon të rrish së bashku me gruan tënde Aishen?”

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Sadaku!”

Sadaku ishte njëfarë prike, e cila duhej dhënë në dorë nuses direkt pas martese. Në fakt, për Ebu Bekrin, nuk kishte asnjë vlerë monetare që mund të krahasohej me të Dërguarin e Allahut. Ebu Bekri ia dha Profetit sasinë e nevojshme të parave dhe Ky, pa humbur kohë nga ana e Tij, ia dha Aishes ato para. Më përpara, të drejtat e grave nuk merreshin fare parasysh dhe paratë e kurorës i merrte i ati i vajzës, dhe jo vetë vajza. Çdo ditë që kalonte, praktikat e reja të Profetit korrigjonin çdo veprim të gabuar, për ta zëvendësuar menjëherë me parimet islame.<sup>16</sup>

Ebu Bekri kishte edhe gjëra të tjera për të bërë; ai nisi të ndërtonte një shtëpi të vogël me një dhomë gjumi, pranë xhamisë, me shpenzimet e tij. Pastaj ai ndërtoi edhe një dhomë të vogël për Aishen. Ajo ishte aq e vogël, sa që kur i Dërguari i Allahut ngrihej në këmbë, koka e Tij pothuajse prekte tavanin dhe kur Aishja shtrihej për të fjetur, pjesa e mbetur e dhomës ishte e pamjaftueshme për të rënë në sexhde. Nga pikëpamja fizike, ajo ishte një dhomë e vogël dhe modeste, por nga pikëpamja shpirtërore, ajo ishte aq e madhe sa mund të ndriçonte gjithë botën.

Me këtë iu dha fund qëndrimit shtatë-mujor si mysafir në shtëpinë e Halid ibn Zejdit.

Kishin kaluar tetë muaj që nga koha e Hixhretit. Përzgjedhja e muajit të Sheualit për t'u martuar, kishte gjithashtu domethënien e vet, për shkak se njerëzit nuk preferonin të martoheshin në atë muaj, pasi ata mendonin se kjo gjë nuk të sillte fatmbarësi. Shumë vite më vonë, Aishja ia rekomandoi të gjithëve Sheualin si muajin më të përshtatshëm për martesë, njëfarësoj edhe për të eliminuar mbeturinat e periudhës paraislame, duke thënë:

---

<sup>16</sup> Po aty.

“I Dërguari i Allahut dhe unë u fejuam në muajin e Sheualit, dhe u martuam po në atë muaj. Tani më thoni, cila nga bashkëshortet ishte më e dashur për të Dërguarin e Allahut?”<sup>17</sup>

Kishte ardhur koha e duhur, andaj Umu Rumani e çoi Aishen në një vend ku ishin mbledhur gratë medinase. Ato ecnin aq shpejt sa kishin mbetur pothuajse pa frymë. Duke e vëzhguar nusen më të çmuar në botë, gratë thoshin:

“Allahu i dhuroftë bekime dhe të mira me bollëk, iu shtoftë lumturia!”<sup>18</sup>

Kjo ndodhte dy ose tre orë para mesditës. Me shoqe të tilla si Esma bint Jezidi, Aishja hodhi hapin e saj të parë në shtëpinë e re, shtëpi e cila më vonë do të njihej si “shkolla e Profetit”. Gjithçka ishte ndryshe nga sa ajo priste dhe Aishja, e cila përpara kishte qenë e shqetësuar dhe e frikësuar, tani ndjehej mjaft e qetë. Kur ajo hyri, i Dërguari i Zotit i dha një tas me qumësht. Aishja pati turp, e uli kokën pa pasur guximin për të hedhur sytë në fytyrën e ndritshme të Profetit. Shoqet e saj i thanë:

“Merre tasin nga dora e tij, mos ia kthe!”

Me të dëgjuar këto fjalë, Aishja e mori tasin nga dora e robit më të dashur të Allahut dhe nisi të pijë. Profeti i tha asaj t’u jepte ca edhe shoqeve të saj.

Por ato nuk pranuan dhe thanë:

“Ne nuk duam të pimë.”

I Dërguari i Allahut këmbënguli:

“Gënjeshttrat dhe uria nuk mund të qëndrojnë së bashku.”

Pasi dëgjoi këto fjalë, Esmaja tha:

“O i Dërguari i Allahut, nëse dikush thotë ‘Nuk dua të pi, ndërkohë që dëshiron, a konsiderohet kjo një gënjeshtë?’”

Profeti u përgjigj:

“Po. Përderisa një gënjeshtë regjistrohet si gënjeshtë, edhe një gënjeshtë e vogël, regjistrohet si gënjeshtë e vogël.”<sup>19</sup>

Kështu mori fund pa bujë dhe pa pompozitet kjo ceremoni e thjeshtë martese. Sipas rrëfimit të Aishes, i Dërguari i Allahut nuk theri madje sa edhe një deve apo dele atë ditë; përkundrazi, ishte udhëheqësi i Hazrexhëve, Sa’d ibn Ubade i cili solli me vete ushqimin në shtëpinë e Profetit dhe ky ushqim në këtë mënyrë, shërbeu si darka e dasmës.

Që nga ajo ditë, Aishja u bë gruaja e shtëpisë së Profetit, e cila do ta pasonte atë edhe kur ai të ikte nga kjo botë, duke marrë edhe vendime të rëndësishme për njerëzimin. Ajo ishte një grua e madhe e kohës së saj, e cila ndihmoi që gjërat të zhvilloheshin për mirë; një mendje brilante e cila i ndiqte me vëmendje ngjarjet dhe nxirrte kuptimin e tyre; një rrëfyesë e mrekullueshme e cila shpjegoi me mjeshtëri ato që kishte parë e dëgjuar në shtëpinë e Profetit. Profeti më i dashur dhe më i mëshirshëm i Allahut, i dërguar si mëshirë për njerëzimin, pati pranë një person të talentuar, e cila hapi mjaft dyer që për shumë të tjerë nuk do të ishin hapur dot kurrë, veçanërisht për sa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me jetën familjare dhe problemet e grave. Ajo ishte një udhërrëfyesë për të gjithë, si meshkujt ashtu edhe për femrat, si dhe një këshilluese e shkëlqyer, shembullin e së cilës duket ta ndjekë medoemos çdokush.

---

<sup>17</sup> Taberani, *El Mu’xhemul Kebir*, 23:25; Ibni Abdibarr, *Istiab*, 4:1937; Ibni Sa’d, *Tabakat*, 8:63.

## Qëndrimi i të atit pas martesës

Në Kuran, Allahu shprehet qartë në lidhje me privilegjin që kanë ato të cilat martohen me Profetin: *“O ju gra të Profetit! Ju nuk jeni sikurse gratë e tjera...”*<sup>18</sup>. Kjo veçanti përbënte një meritë, por nëse nuk përmbushej siç duhej, mbartte shumë rreziqe. Ndërsa shpërblime të mëdha mund të përfitoheshin nëpërmjet zbatimit rigoroz të parimeve islame, mëkatet e mundshme do të ishin dy herë më të rënda. Kështu që bashkëshortet e Profetit porositeshin t’i kryenin siç duhet detyrat e tyre, në mënyrë që të vdisnin të pastra e të shkonin në Xhenet.

Megjithëse Ebu Bekri ishte i ati i Aishes, ai e quante atë nënë dhe tregonte edhe më tepër respekt sesa për nënën e tij të vërtetë.

Ai pati dëgjuar se Mistah ibn Usase, kishte thënë gjëra jo të hijshme për Aishen gjatë periudhës së shpifjes rreth saj. Ai u mërzi dhe ndaloi së dërguari paratë që i jepte Mistahut rregullisht për nevojat e tij ditore. Pak kohë më vonë, pasi u shpall ajeti (Nur 24/22), i cili bënte fjalë për dhënien e parave për bamirësi njerëzve në nevojë, pavarësisht rrethanave, si dhe për faljen ndaj tyre nëpërmjet të harruarit të gabimeve të tyre të mëparshme, si shenjë e ftesës më domethënëse nga ana e Allahut për të përfituar nga falja e tij Hyjnore, ai e ndryshoi qëndrimin, u pendua dhe tha:

“Betohem në Allah, se unë me siguri që dëshiroj faljen e Tij.”

Pastaj, ai nisi t’i dërgojë përsëri Mistahut paratë që i nevojiteshin atij për nevojat ditore.

Ebu Bekri bëri një betim në vetvete:

“Betohem në Allahun se unë do të vazhdoj t’ia dërgoj paratë atij pa vonesë.”<sup>19</sup>

## Shtëpia e Aishes

Aishja nuk jetonte në ndonjë pallat të madh. Banesa e saj ishte një dhomë e vogël, e mjaftueshme vetëm për nevojat e saj. Pozicioni i saj ishte në anën lindore të xhamisë së Profetit dhe dera hapej nga ana perëndimore. Xhamia ishte si kopshti i shtëpisë së Aishes. Kur i Dërguari i Zotit qëndronte në xhami për adhurim, sidomos gjatë Ramazanit, Aishja mund ta arrinte atë që nga dhoma e saj për t’i krehur atij flokët ose të shkonte shpejt e shpejt për të marrë ndonjë gjë për të nga dhoma e saj.<sup>20</sup> Muret e dhomës së saj, të cilat ishin mbushura me baltë, kishin gjatësinë e gjashtë apo shtatë krahëve. Tavani i saj, të cilin kushdo mund ta prekte me një dorë të ngritur lart, ishte i mbuluar nga gjethet hurmash dhe palme, i mbushur i tëri me lesh për të parandaluar shiun të rridhte poshtë. Dera e vetme prej druri e shtëpisë nuk rrinte kurrë e mbyllur për askënd.<sup>21</sup>

Aishja e shpjegon kështu madhësinë e dhomës së saj:

“Në qoftë se i Dërguari i Zotit ishte duke falur namazin, kur unë isha duke fjetur, ai do ta prekte këmbën time kur ishte në sexhde, dhe vetëm nëse unë mblidhja këmbët e mia, i Dërguari i Zotit mund të shkonte lehtësisht në sexhde.”<sup>22</sup>

Shtëpitë e grave të tjera nuk kishin ndonjë dallim kushedi se çfarë nga ajo e Aishes, përveç faktit se dyert e tyre hapeshin nga jashtë xhamisë dhe jo brenda në xhami. Duke përshkruar thjeshtësinë e dhomave të tyre, Hasani ka thënë:

---

<sup>18</sup>Ahزاب, 32.

<sup>19</sup>Buhari, *shehadet*, 15; *ejman*, 17.

<sup>20</sup>Buhari, *itikaf*, 4.

<sup>21</sup>Buhari, *edebul Mufred*, 1/272.

<sup>22</sup>Buhari, *salat*, 21.

“Njëherë, gjatë kalifatit të Osmanit të nderuar (r.a.), unë po vizitoja shtëpitë e bashkëshorteve të të Dërguarit të Allahut dhe kur ngrija dorën lart, arrija të prekja tavanin e tyre.”<sup>23</sup>

Kur u desh të zmadhohej xhamia e profetit dhe u shtrua për diskutim prishja e shtëpisë së Aishes së nderuar (r.a.), imami i famshëm Said ibn Musejebi, u ngrit në këmbë dhe i tha kështu kalifit të atëhershëm, Uelid ibni Abdulmelikut:

“Unë dëshiroj që ju të mos e shkatërroni këtë dhomë në mënyrë që njerëzit të mund të jenë të kënaqur me atë që kanë. Vetëm kësisoj, brezat e ardhshëm do të arrijnë ta kuptojnë se me çfarë lloj jete ishte i kënaqur i Dërguari i Zotit, edhe pse Ai kishte në dorë çelësin e gjithë thesareve të botës.”<sup>24</sup>

Në të ndodhej një minder prej hasre, një jastëk lëkure i mbushur me kashtë, një copë lëkure e varur në një gozhdë, një sapllak, një kovë për ujë dhe për të vënë në të hurmat, dhe një tas për ujë të pijshëm. Nuk kishte asnjë dritë në këtë shtëpi të vogël. Tregohet që, njëherë, Aishja pati thënë:

“Në kohën e të Dërguarit të Allahut, ne, mund të ndodhte që të kalonim edhe dyzet net rresht pa ndezur asnjë llambë ose ndonjë mjet tjetër për ndriçim.”<sup>25</sup> Në ato kohë, vaji i përdorur për ndriçim nuk ishte tjetër pos atij që përdorej edhe për të gatuar. Aishja thoshte:

“Sigurisht nëse do të kishte ndonjë fije vaj në llambë, atë medoemos do ta përdornim për të gatuar.”<sup>26</sup>

Aishja kontrollonte me duar nëpër dhomë kur trembej se mos i Dërguari i Allahut kishte ikur. Kushtet e grave ishin të njëjta me ato të shtëpive të tyre. Sipas Aishes, pjesëtarët e familjes së të Dërguarit të Allahut, nuk kanë ngrënë asnjëherë bukë gruri për tri ditë me radhë,<sup>27</sup> derisa i Dërguari i Allahut ndërroi jetë dhe shkoi pranë Zotit të Tij të Gjithëmëshirshëm. Në më të shumtën e herëve atyre u binte të hanin bukë apo gjellë të gatuar në furrë, dhe shpesh kalonte edhe një muaj i tërë pa zjerë asnjë gjellë.<sup>28</sup> Nganjëherë kalonin edhe tre muaj të plotë që ata hanin vetëm hurma dhe pinin ujë zemzemi.<sup>29</sup>

Kur hanin, ata uleshin së bashku në sofër dhe hanin në të njëjtën enë. Nganjëherë të afërmit e ndanin ushqimin me ta. Asgjë nuk ndryshoi në këtë shtëpi të lumturisë; as trofetë e luftës që fituan në vitet e mëpasme, e as dhuratat që u dërgonin përkrahësit e tyre, nuk e ndryshuan thjeshtësinë e jetës së Profetit Muhamed (s.a.s.). Deri në momentin kur Ai kaloi përmes perdes mes kësaj bote dhe botës tjetër, i Dërguari i Allahut mbeti më i pastri dhe më i përlururi ndër njerëzit.

Aishja, në lidhje me ditën kur ai ndërroi jetë, thoshte:

“Në ditën që i Dërguari i Zotit u nda nga jeta, për ushqim kishte mbetur vetëm pak elb mbi dollap. Nuk kishte asgjë më shumë. Unë e hëngrta atë dhe kështu arrita të qëndroj në këmbë. Por meqenëse ajo ishte një sasi krejt e pakët, begatia e bekuar humbi dhe ajo sasi mbaroi mjaft shpejt.”<sup>30</sup>

Ndërsa rrethanat e jetës së saj me të Dërguarin e Zotit ishin të vështira, edhe 50 vitet që ajo i ka jetuar si një grua e ve nuk ishin të ndryshme; ajo shpërndante lëmoshë për të tjerët nga çdo gjë që zotëronte, madje në më të shumtën e herëve mbante për vete vetëm ujë zemzemi dhe hurma. Ajo thoshte:

---

<sup>23</sup> Ibni Sa'd, *Tabakat*, 1/506; Tahmaz, *Sejidatu Aisha* 32.

<sup>24</sup> Ibni Sa'd, *Tabakat*, 1/500; 8/167; Sujuti, *Durru'l Mensur*, 7/554.

<sup>25</sup> Tajalisi, *Musned*, 207.

<sup>26</sup> Harith ibni Ebi Usame, *Musnatu'l Hadith*, 2/996; Taberani, *El-Muxh'amul Eusat*, 8/360; Ishak ibni Rahuja, *Musned*, 3/1000.

<sup>27</sup> Buhari, *et'ime*, 73; Muslim, *zuhd*, 20.

<sup>28</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/217.

<sup>29</sup> Buhari, *rikak*, 17.

<sup>30</sup> Buhari, *hums*, 3.



“Kurrë nuk kam ngrënë deri në ngopje, edhe pasi vdiq i Dërguari i Allahut.”<sup>31</sup>

Ajo vazhdoi të praktikonte një më një, të gjitha ato që kishte parë dhe dëgjuar nga Profeti ynë i Dashur. Një ditë, i Dërguari i Zotit i tha:

“O Aishe, shpëtoje veten nga zjarri i Xhehenemit, qoftë edhe duke dhënë vetëm një gjysmë hurme për bamirësi, pasi kjo do të lehtësojë edhe urinë e dikujt, por edhe do të shërbejë si lehtësim për ndonjë nevojë të madhe tënden.”<sup>32</sup>

Një person i varfër dhe në nevojë erdhi në shtëpinë e Aishes dhe ajo ia dha atij çdo gjë që kishte si bamirësi. Më vonë, ajo u kërkoi njerëzve rreth saj për t’ia sjellë përsëri personin që ajo kishte ndihmuar. I Dërguari i Allahut, me ta parë këtë skenë, e ndërpreu dhe i tha:

“Jep dhe mos mat, po deshe që edhe ndaj teje të mos mbahet llogari.”<sup>33</sup>

Një ditë tjetër, ajo dëgjoi të Dërguarin e Zotit duke u lutur:

"Zoti im! Më bëj mua të jetoj si njeri i varfër, ma merr jetën time si njeri i varfër, dhe më ringjall mua së bashku me njerëzit e varfër në Ditën e Gjykimit!"

“Pse, o i Dërguari i Allahut?”, - e pyeti ajo.

Ai u përgjigj:

“Sepse të varfrit do të hyjnë në Xhenet më shumë se dyzet vjet para të pasurve. O Aishe! Duaji njerëzit e varfër e që janë në nevojë; mbaji ata gjithnjë afër, sepse në Ditën e Ringjalljes Allahu ka për të të lavdëruar.”<sup>34</sup>

Një ditë, Profeti Muhamed paqja dhe bekimi qofshin mbi Të, hyri në dhomën e Aishes dhe vuri re se ajo kishte vendosur unaza të argjendta. Ai, me një ton që shprehte pakënaqësi, e pyeti:

“Çfarë janë ato, o Aishe?”

“I vura që të të pëlqej ty, o i Dërguari i Allahut.”, - iu përgjigj ajo.

Ai i tha me të njëjtin ton:

“A ke paguar zekat për to?”, - ia ktheu Ai me të njëjtin ton.

Ajo e dinte se zekati nuk ishte i detyrueshëm për të tilla unaza, vlera e të cilave ishte tejet e vogël, por me sa dukej, kjo ishte një tjetër situatë në të cilën të ndenjurit afër Profetit do të thoshte të ishte ndryshe nga të tjerët; thellësisht e hidhëruar, ajo u përgjigj në mënyrë mohuese. Pas përgjigjes së saj, i Dërguari i Zotit, i cili dëshironte që edhe ata që gjendeshin rreth tij të bënin një jetë të thjeshtë si të vetën, i tha se ky incident i vogël mund të jetë i mjaftueshëm për ta çuar atë në Xhehenem.<sup>35</sup>

Fjalët e tij e goditën shumë rëndë atë, duke e bërë madje edhe të humbiste ndjenjat për një çast. Pas kësaj, Aishja nuk mbajti më asnjëherë asgjë për vete, pavarësisht sa e vogël ishte, pa menduar veç për jetën e përtejme. Ajo dhuroi gjithë ç’kishte. Ajo mësoi se pasuria e saj më jetike, në këtë botë dhe në botën tjetër, ishte veç afërsia e saj me të Dërguarin e Allahut; humbja e një pasurie të tillë ishte e paimagjinueshme për një femër kaq të zgjuar. Një ditë, i Dërguari i Zotit i kërkoi asaj që të bënte diçka pas vdekjes së Tij:

<sup>31</sup> Ebu Nuajm, *Hiljetul Eulija*, 2/46; Tahmaz, *es-Sejdatu Aisha*, 38.

<sup>32</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/79.

<sup>33</sup> Ibni Hibban, *Sahih*, 8/151; Bejhekiu, *Sunen*, 7/12.

<sup>34</sup> Tirmidhiu, *zuhd*, 37; Bejhekiu, *Sunen*, 7/12.

<sup>35</sup> Ebu Davud, *zekat*, 3; Hakim, *Mustedrek*, 1/547; Bejhekiu, *Sunen*, 4.

“Nëse synon të ribashkohesh me mua, duhet të jetosh si një udhëtar në këtë botë! Rri larg nga të qenit pranë pasurisë dhe mos mendo për blerjen e një veshjeje të re përpara se ajo që ke, të vjetërsohet aq sa të mos mund të përdoret më.”<sup>36</sup>

I Dërguari i Zotit ishte një njeri i moderuar, i cili dinte t'i vinte në baraspeshë nevojat e kësaj bote dhe të ahiretit në mënyrën më të mirë të mundshme. Përmes mesazhit që iu shpall, Allahu i Madhëruar e bëri Atë të kuptonte se Ai duhet vazhdimisht të kërkonte shpërblimin në jetën e përtejme, pa harruar detyrat e tij të kësaj bote<sup>37</sup>. Në natyrën njerëzore ekziston një shkallë ambicieje që nuk njihet të ngopur; njerëzit janë krijuar në mënyrë të tillë që të mbeten gjithmonë të pakënaqur me botën dhe çdo gjë në të. Kjo ambicie, në Islam ka për qëllim të përdoret për të fituar jetën e përtejme, sepse Kurani tregon se individët, të cilët jetojnë vetëm për këtë botë dhe nuk e marrin në konsideratë botën tjetër, do të humbasin gjithçka. I Dërguari i Zotit ishte edhe më i vetëdijshëm për këtë, dhe kur Ai erdhi në shtëpi pas shpalljes së ajetit në fjalë, u kthye nga gratë e Tij dhe i nxiti ato që të tregonin të njëjtën ndjeshmëri:

“Në qoftë se një njeriu i jepen dy lugina të mbushura me ar, ai do të synojë për të tretën. Vetëm toka është ajo që mund ta ngopë. Megjithatë, pasuria është dhënë për të bërë të mundur kryerjen e adhurimeve të përditshme dhe për të përmbushur kërkesat e zekatit. Nuk ka dyshim se Zoti e pranon pendimin e njerëzve që e kërkojnë.”<sup>38</sup>

Pavarësisht se nga bashkëshortet e tij varfëria e tyre kurrë nuk konsiderohej si një problem, i Dërguari i Zotit, megjithatë, u përpoq që si e si t'i ngushëllonte ato. Kur Ai vizitonte dhomat e tyre, i pyeste:

“A ka ndonjë gjë për të ngrënë në shtëpi?” Me të mësuar se nuk kishte asgjë, ai thoshte: “Unë jam duke agjëruar, dhe saora përqendrohej përsëri në adhurim.”<sup>39</sup>

Medinasit ndonjëherë përpiqeshin të lehtësonin problemet që kishte Profeti, duke i dërguar Atij ushqime dhe pije.<sup>40</sup> Por kjo ishte jeta që Ai e kishte zgjedhur vetë; Ai parapëlqeu të jetonte në mënyrë sa më të thjeshtë; megjithatë ajo që bënë sahabët për Të, ishin nga një mirësi më vete që padyshim do të shpërblehet. I Dërguari i Zotit ishte i ndjeshëm, Ai asnjëherë nuk rrezikonte të konsumonte qoftë edhe një mirësi të vogël që i përkiste jetës së përtejme, qysh në këtë botë. Ai kishte vetëm një dyshek të thjeshtë të mbushur me kashtë të ashpër. Një ta parë atë një grua nga medinaset, shkoi menjëherë tek Aishja me një dyshek të ri të mbushur me lesh si dhuratë. Kur i Dërguari i Zotit u kthye në shtëpi, ai e pyeti menjëherë:

“Ç’është ky, o Aishe?”

Aishja iu përgjigj:

“O i Dërguari i Zotit! Një grua nga ensarët, e pa shtratin tënd kur erdhi në shtëpinë tonë, dhe me t’u kthyer në shtëpi, dërgoi këtë.”

Edhe pse mirësia e gruas medinase ishte për t’u vlerësuar, parapëlqimi i Tij për një shtrat të thjeshtë ishte një gjest edhe më i bukur akoma. Ai u kthye nga Aishja dhe i tha:

<sup>36</sup> Tirmidhiu, *libas*, 38; Hakim, *Mustedrek*, 1/547

<sup>37</sup> Kasas, 77.

<sup>38</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/55, 5/218.

<sup>39</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/49; Ibni Hibban, *Sahih*, 8, 393.

<sup>40</sup> Buhari, *hibe*, 1; Ibni Maxhe, *zuhd*, 10.

“Ktheja mbrapsht! Betohem në Allahun e Gjithëfuqishëm, se nëse unë do të dëshiroja, Allahu më vinte në dispozicionin tim malet, duke i kthyer tërësej në ar dhe argjend.”<sup>41</sup>

Edhe pse mëndafshi dhe ari janë të lejuara për gratë, i Dërguari i Zotit dëshironte që gratë më të afërta të Tij të ishin më të kujdesshme, andaj Ai u kërkoi atyre të qëndronin larg edhe nga mirësitë e përditshme. Një ditë, ai pa dy rrathë të artë në dorën e Aishes, dhe i tha:

“A dëshiron të të tregoj diçka më të mirë se këto? Nëse i heq ato dhe blen dy byzylykë argjendi në vend të tyre dhe pastaj i ngjyros me shafran, do të ishte më mirë.”<sup>42</sup>

I Dërguari i Zotit, jo vetëm jepte këshilla, por Ai gjithashtu ndiqte me vëmendje ndryshimet që ndodhnin në rrethin e Tij të ngushtë. Ishte e qartë nga thjeshtësia që ai kishte zgjedhur për vete, se Ai dëshironte gjithashtu sjellje të ngjashme edhe nga njerëzit që ishin më afër Tij. Ai dëshironte t'i mbante ata larg nga çdo gjë që do t'i lidhte pas kësaj bote, gjë e cila do t'i bënte të harronin ahiretin. Kur Ai dhe ushtria e Tij shkuan për të luftuar në Tebuk, që ishte vend-takimi me perandorinë bizantine, mbretërinë më të madhe të kohës, Aishja kishte blerë një copë leckë që kishte një pikturë mbi të dhe e kishte varur si perde në njërën anë të shtëpisë. Kur i Dërguari i Zotit u kthye nga Tebuku dhe e pa, u shpreh i nevrikosur:

“Ma hiq atë nga sytë! Ndërroje, sepse sapo hyj në shtëpi dhe shoh atë, më kujtohet kjo botë.”<sup>43</sup>

Pas betejës së Hajberit, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) caktoi tetëdhjetë arka me hurma dhe njëzet arka me elb që do të akordoheshin çdo vit për gratë e Tij të dëlira. Por për shkak të bujarisë së Aishes dhe numrit të madh të vizitorëve të saj, kjo sasi nuk ishte e mjaftueshme që t'i përmbushte të gjitha nevojat.

Në ditën kur Profeti i Zotit u ngjit në Banesën e Qashtër, në shtëpinë e Tij nuk kishte asgjë më shumë sesa gjysmë tasi me elb. Madje, edhe ajo ishte huazuar nga një fqinj çifut pas dhënies së parzmores prej hekuri të të Dërguarit të Allahut si garanci.<sup>44</sup>

Aishja ka jetuar në këtë shtëpi në kushte mëse modeste. Jeta e saj e thjeshtë, që tregon se kënaqësia dhe lumturia e vërtetë nuk rrjedh nga pasuria e kësaj bote, u ruajt me fanatizëm edhe pas ikjes së Profetit nga kjo botë. Dhoma e saj, e vogël në sipërfaqe, ka vijuar me vite t'u shërbejë brezave të tërë të myslimanëve, ashtu si një burim i cili derdhet në shumë lumenj. Në ditët e mëvonshme, njëllonj si atëherë kur i Dërguari i Zotit ishte ende gjallë, përgjegjësia kryesore për Aishen ishte të ushqyerit e zemrave dhe mendjeve të njerëzve.

### Thjeshtësia e saj

Netët e Aishes ishin po aq të ndritshme sa edhe ditët e saj; ajo në përgjithësi i kalonte netët me namaz dhe ditët me agjërim. Qëndrimi i saj ishte i qartë dhe dallohej në çdo detaj të thjeshtësisë dhe devotshmërisë. Disa dijetarë të tillë si Kasimi, i cili ishte njëri prej nxënësve të saj më të afërt dhe një udhëheqës i brezit të mëvonshëm të myslimanëve, tabiinëve, ka thënë se ajo agjëronte gjatë gjithë vitit përveç ditëve të Fitër Bajramit dhe Kurban Bajramit. Aishja kaloi çdo ditë të jetës në pendim, duke kërkuar falje nga Zoti, duke menduar me keqardhje për ditët e shkuara. Shembulli i saj ishte po ai i të Dërguarit të Zotit, dhe ajo besonte me gjithë zemër se nevojitej të përdroreshin të gjitha mundësitë e dhëna për të bërë progres të përditshëm.

<sup>41</sup> Bejhekiu, *Shuabu'l iman*, 2/173; Taberani, *Mu'xhemul Eusat*, 6/141.

<sup>42</sup> Nesai, *zina*, 39.

<sup>43</sup> Ibni Hibban, *Sahih*, 2/447; Nesai, *Sunetu'l Kubra*, 5/502.

<sup>44</sup> Buhari, *xhihad*, 88; Tirmidhi, *buju*, 7.

Aishja gjithashtu mendonte se ndjekja me rigorozitet i çdo akti të veçantë adhurimi ishte i detyrueshëm për të. Ajo ishte mjaft e vendosur në këtë pikë dhe askush nuk ishte në gjendje t'ia kthente mendjen. Kur disave u dukej i çuditshëm ky entuziazëm i saj, Aishja u thoshte:

“Edhe nëse babai im do të ngrihej nga varri dhe do të më kërkonte të mos e kryej më, qoftë edhe njërin nga adhurimet vullnetare që unë kam filluar t'i kryej qysh në kohën e të Dërguarit të Zotit, unë prapëseprapë nuk do të hiqja dorë prej tyre.”<sup>45</sup>

Aishja mezi plotësonte nevojat bazë të saj, por megjithatë jepte çdo gjë që kishte për të varfrit. Një ditë, Xhabiri erdhi për ta vizituar atë, e ajo kishte veshur një fustan tepër të vjetruar, të mbushur plot arna. Duke dashur të përmbushte përgjegjësinë e tij, Xhabiri i tha:

“Përse nuk vesh një fustan tjetër?”

Por Aishja, si nënë e besimtarëve nuk mendonte njëlloj me Xhabirin, andaj iu përgjigj:

“Një ditë, i Dërguari i Zotit më ka thënë: ‘Nëse kërkon të ribashkohesh me mua, nuk do ta ndryshosh veshjen tënde derisa ajo të bëhet e papërdorshme, dhe nuk do të mendosh për atë që ke nevojë për më shumë se një muaj përpara’. Më thuaj, a mendon se unë duhet ta ndryshoj atë që Ai më urdhëroi për të bërë deri në çastin kur unë do të takohem përsëri me të?”<sup>46</sup>

Por Aishja nuk mjaftohej me kaq. Sapo vërente gjendjen pikëlluese të të varfërve dhe të atyre që ishin në pikë të hallit, ajo jepte gjithçka kishte ose shiste në treg çfarëdolloj sendi me vlerë që zotëronte, për t'ua dërguar paratë menjëherë atyre. Ndërsa jepte sadaka, ajo nuk mendonte asnjëherë për nevojat e saj, por gjithmonë përpiquej për të lehtësuar më parë brengat e të tjerëve. Një ditë ajo dha krejt çka kishte për të varfrit dhe nuk i mbeti më asnjë kacidhe për atë ditë. Por prapëseprapë ajo nuk reshti asnjëherë së dhëni; ajo shiti ca sende të vetat në treg dhe pa ngurruar aspak, i dha paratë për bamirësi. Në mbrëmje, kur i erdhi koha për të prishur agjërimin, ajo kishte vetëm një copë bukë elbi për të ngrënë.

Modestia e qëllimshme e Aishes përfaqësonte një mënyrë të njëjtë jetese edhe për njerëzit e afërt të saj dhe ajo ka vazhduar të jetonte në të njëjtën mënyrë edhe pasi ndërroi jetë i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të. Vullneti i vërtetë është ai i një personi, i cili është i fuqishëm dhe ka mundësi të pakufizuara, dhe ishte pikërisht për shkak të këtij vullneti, që Aishja deri në fund të jetës së saj zgjodhi për mënyrë jetese të njëjtën jetë modeste siç kishte bërë kur jetonte me Profetin e nderuar (s.a.s.), plot delikatesë dhe ndjeshmëri, deri në frymën e saj të fundit. Aishja mund të kishte jetuar si të dëshironte, megjithatë, ajo zgjodhi të Dërguarin e Zotit, dhe ishte pikërisht kjo zgjedhje që e çoi atë në zgjedhjen tjetër të saj për të jetuar përrulësisht, ashtu siç kishte bërë Ai.

Vërtet, kjo ishte një zgjedhje krejt e vullnetshme. Aishja ishte një nga njerëzit më të afërt të të Dërguarit të Zotit e për më tepër, afërsia e tyre ishte e ndryshme nga ajo e të tjerëve. Edhe pas vdekjes së Profetit Muhamed (s.a.s.), Aishja ndoqi hapat e Tij, një më një, edhe pse ajo i kishte të gjitha mundësitë për të jetuar disi më ndryshe. Megjithatë, ajo kurrë nuk e ndryshoi mënyrën e të jetuarit që kishin pasur kur jetonin së bashku. Pasuria e saj qëndronte në thjeshtësinë dhe devotshmërinë që i buronte prej të qenit një myslimane e devotshme.

## Përfaqësuese e grave

---

<sup>45</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/138.

<sup>46</sup> Taberani, *Mu'xhemul Eusat*, 7/113.

Aishja e shihte jetën nga ky këndvështrim modest dhe jetonte thjesht në çdo detaj. Përgjegjësia e saj buronte që nga ajo kohë kur ajo u martua me të Dërguarin e Zotit paqja qoftë mbi Të. Pa dyshim, përgjegjësia serioze që ajo mbartte mbi supe, duhet të kishte peshë të ndryshme nga pesha që mbartnin njerëzit e zakonshëm. Ajo u bë një përfaqësuese për gratë, që kur hyri në shtëpinë e Profetit, duke vepruar si ndërmjetëse mes të Dërguarit të Zotit dhe grave të çdo kategorie. Pozicioni i saj e bënte atë një besnike të jetës, sidomos për sahabet femra.

Gratë e asaj shoqërie kanë qenë qytetare të dorës së dytë, si rezultat i traditave shumëshekullore. Ndjeshmëritë e Aishes për gratë, duke përfshirë edhe përpjekjet e saj për të dhënë informacione kuptimplota për shoqet e saj të ngushta në shtëpinë e saj dhe ndarjen e pjesës më të madhe të kohës për gratë, kishin për qëllim ofrimin e zgjidhjeve për problemet që buronin nga këto tradita të vjetra.

I Dërguari i Zotit nganjëherë bëhej edhe vetë dëshmitar i përpjekjeve të saj. Në fakt, kur Ai shkonte në shtëpi, shoqet e Aishes ngriheshin të iknin, por i Dërguari i Zotit i thërriste ato të ktheheshin prapa. Duke mos dashur t'ua prishte bisedën, Ai largohej dhe gratë mbeteshin përsëri vetëm.<sup>47</sup>

Aishja nganjëherë mbante edhe lodra në shtëpinë e saj për t'u zbavitur sadopak. Një ditë, i Dërguari i Allahut pa një kalë me dy krahë dhe e pyeti:

“Çfarë është ai o Aishe?”

Ajo u përgjigj pa ngurrim:

“Një kalë.”

I Dërguari i Allahut e pyeti përsëri:

“A kanë kuajt krahë?”

Aishja e kishte gati përgjigjen, gjë e cila tregonte se ajo e lidhte çdo gjë me Kuranin, madje edhe në lojërat e zakonshme të fëmijëve dhe në zbavitje:

“Po, kali i Sulejmanit, a nuk kishte edhe ai krahë?”

I Dërguari i Allahut iu përgjigj me një buzëqeshje kësaj përgjigjeje të mençur.

Që prej ditës kur u bë banore e shtëpisë së lumturisë, Aishja ishte në qendër të "detyrës për të eliminuar zakonet injorante të paraardhësve të tyre, të formuara gjatë periudhës paraislame që njihet si Epoka e Injorancës. Afërsia e saj me të Dërguarin e Allahut, njohuritë e saj mbi Kuranin, si dhe qëndrimi i saj i vëmendshëm ndaj problemeve të grave si përpara, ashtu edhe pas martesës së saj, kanë përbërë një përparësi të madhe për gjithë gratë e tjera.

Në Epokën e Injorancës, gratë përgjithësisht trajtoheshin me përbuzje, ato zor se mund të viheshin edhe në rangun e qenieve njerëzore. Megjithëse shumë njerëz kishin pranuar fenë islame, zakonet e vjetra të shoqërisë nuk ishin çrrënjësuar ende plotësisht. Shumë gra nuk kishin as vlerë e as të drejta dhe vijonin të ishin në një situatë që ishte më beter se skllavëria.

Megjithatë, gratë tashmë e kishin një përfaqësuese me mjaft ndikim në krah të të Dërguarit të Allahut. Aishja ishte si një lloj këshilltareje për gratë; duke i rrëfyer asaj problemet e tyre private, ato ktheheshin në shtëpi me zgjidhjen e tyre në xhep. Ato nga natyra ishin të ndrojtura për t'i ndarë me të tjerët detajet e tyre intime. Njëherë, një grua erdhi tek Aishja dhe i tha me hidhërim të madh:

“Burri im as nuk më ndan, as nuk më lë të lirë, e as nuk ka marrëdhënie martesore me mua.”

---

<sup>47</sup> Buhari, *edeb*, 81.

Gruaja qante, e paaftë për të shtypur valën e emocioneve që kishin shpërthyer brenda shpirtit të saj. Me lot në sy, ajo shpjegoi gjendjen e dhimbshme që kishte përjetuar prej shumë vitesh. Ajo nuk ishte asgjë më shumë sesa një lodër në duart e burrave të tyre. Fillimisht, ai i kishte thënë se donte të ndahej prej saj, por pak përpara se të përfundonte periudha e pritjes, ai u kthye tek ajo duke pretenduar se kishte ndryshuar mendim. Nga ky moment e tutje, ai kishte vijuar lojën e tij, as kështu as ashtu, duke luajtur me ndjenjat e saj. Synimi i tij i vërtetë me sa dukej ishte të parandalonte gruan e tij, me të cilën ai donte të divorcohej, që të martohej me dikë tjetër.

Kur Profeti u kthye në shtëpi, Aishja e informoi atë për situatën. Ai u ndje i shqetësuar. Dukej qartë se kjo ishte një martesë tiranie, megjithatë, asnjë ajet apo urdhëresë hyjnore nuk kishte zbritur nga engjëlli Xhebrail (a.s.) për këtë çështje. Kështu ai vendosi të priste.

Pastaj Xhebraili u shfaq dhe zbriti një ajet, i cili i paralajmëronte besimtarët se martesa është një çështje serioze dhe jo një çështje dosido:

*“Lëshimi (pas të cilit mund të bëhet rikthimi), është dy herë, e (pastaj) ose jetë e njerëzishme (bashkëshortore), ose shkurorëzim me mirëkuptim...”<sup>48</sup>*

Tashmë u bë e qartë se një deklaratë e tretë e shkurorëzimit do të thoshte se burri dhe gruaja ishin përfundimisht të ndarë. Kjo çështje ishte më serioze sesa dukej, sepse për një burrë tani ishte e ndaluar të kthehej tek një grua të cilën e kishte ndarë tri herë. Edhe në qoftë se ai do të ndjente pendesë, kjo mundësi do të ishte e mbyllur për të. Përrjashtimi i vetëm ishte nëse gruaja martohej dhe divorcohej edhe me një njeri tjetër; vetëm atëherë ajo mund të martohej edhe një herë me burrin e mëparshëm. Kjo ishte një sprovë e vështirë për burrat. Pas kësaj, të gjithë i dhanë fund praktikave arbitrare të shkurorëzimit, kështu që një tirani e tillë nuk u tolerua më.<sup>49</sup>

Një ditë tjetër, Haula bint Thalebeja vizitoi Aishen. Ajo ishte në një gjendje të mjerueshme. Vitet tërë vuajtje dhe vështirësi që kishte kaluar dukeshin qartë në pamjen e saj. Ajo ia shpjegoi Aishes problemet e saj një nga një. Burri i saj e kishte ndarë atë sipas një zakoni të vjetër. Sipas këtij zakoni, kur burri i thoshte gruas së tij: “më je bërë si ime më.”, e ndalonte veten nga çdo lloj marrëdhënieje martesore me të. Një grua në këtë gjendje nuk lejohej të rimartohej. I vetmi që mund të zgjidhë problemin e saj ishte i Dërguari i Zotit (s.a.s.). Kur ai erdhi në shtëpi, Haula u kthye nga ai dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, atij ia fala rininë time dhe i dhashë gjithçka pata. Kur u plaka dhe nuk qeshë në gjendje të lindja më fëmijë, ai u nda nga unë duke më thënë: ‘më je bërë si ime më.’” Kjo ishte një situatë e ndërlikuar. Ajo tha se fëmijët ishin rritur dhe se ajo jetonte e vetme me të shoqin. Kështu që nëse ai ndahej prej saj, ajo do të mbetej e vetme, pa pasur askënd pranë që ta mbronte. Ajo shtoi se i shoqi ishte i gatshëm ta ripranonte atë si grua, por për shkak të zakoneve, diçka e tillë ishte e palejueshme. Me duar të ngritura lart, ajo u lut për shqetësimin që e torturonte, e po ia ndrydhte shpirtin:

“O Zoti im! Vetëm ty të ankohej për gjendjen time!”

Profetit të mëshirshëm paqja qoftë mbi Të i dhembti zemra nga gjithë ato çfarë dëgjoji, por shtypja e saj nuk do të zgjaste përgjithmonë; edhe për shkak të lutjes së Haulas, Allahu zbriti ajete të posaçme që e sqaronin deri në imtësi këtë çështje. Një mesazh i zbritur nga Xhebraili e shtjelloi plotësisht situatën e Haulas, duke parashtruar edhe zgjidhjen për probleme të ngjashme, të cilat mund të haseshin te të gjitha gratë. Ajetet shpjegonin se këto praktika të gabuara i përkisnin epokës para Islamit, dhe ishin krejtësisht të pavlefshme. Ato gjithashtu shpjegonin se çfarë duhet të bëjnë

<sup>48</sup> Bekare, 229.

<sup>49</sup> Ebu Davud, *talak*, 9; Ibni Maxhe, *talak*, 13.

gratë në një situatë të tillë, dhe se cili ishte ndëshkimi për të gjithë ata që vazhdonin të vepronin në kësajsoj:

*“Vërtet, Allahu dëgjoi fjalët e asaj, e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te Allahu; Allahu e dëgjoi bisedën tuaj, Allahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë. Ata prej jush që bëjnë ‘Dhihar’ (epërsia ime ndaj teje është haram si epërsia ndaj nënës sime) ndaj grave të veta, në të vërtetë, ato nuk janë nënat e tyre, nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur ata, ndërsa ata janë duke thënë fjalë të tepruara dhe gënjeshtër, por Allahu është i atillë që shumë (prej njerëzve) i lë pa marrë në përgjegjësi, dhe shumë të tjerë i fal. Ata që i krahasojnë (me nënat) dhe largohen nga gratë e veta, e pastaj zmbrapsen nga ajo që kanë thënë, janë të detyruar që para se të kontaktojnë ndërmjet veti të lirojnë një rob. Kjo është dispozitë me të cilën porositeni, e Allahu njeh hollësisht me atë që ju punoni. E kush nuk gjen (rob për lirim), atëherë le të agjërojë dy muaj rresht para se të kontaktojë, e kush nuk mundet, atëherë le të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo dispozitë ju shërben për të vërtetuar se ju besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e jo zakonet e prapambetura. Këto pra, janë përcaktimet e Allahut. Ndërkaq mohuesit kanë dënim të rëndë.”<sup>50</sup>*

Në një rast tjetër, gruaja e Thabit ibn Kajsit, Habibe binti Sehli, erdhi për të vizituar Aishen dhe i tha se ajo dëshironte të ndahej nga burri i saj, ndaj për këtë i duhej edhe ndihma e saj. Habibja ishte e bija e Abdullah ibn Ubej ibn Selulit, kreut të hipokritëve; ajo u martua me Thabit ibn Kajsin një ditë pas vdekjes së burrit të saj, Handhales, në betejën e Uhudit. Ajo shquhej si në bukuri ashtu dhe për sjellje, dhe ishte trajtuar gjithmonë me kujdes të madh nga familja e saj. Edhe pse Thabiti ishte i njohur për aftësitë e tij oratorike, ai ishte i shkurtër dhe i shëmtuar. Më shumë gjasa, Habibja ndjente mbi vete trysinë shoqërore për t’u divorcuar prej të shoqit. Kur i Dërguari i Allahut erdhi, Habibja i shpjegoi situatën:

“O i Dërguari i Zotit. Unë nuk po e kritikoj burrin tim as për fenë as për karakterin e tij. Megjithatë, unë kam frikë se mund ta braktis besimin tim, pasi pranova Islamin, veç nuk dua as të shkurorëzohem nga burri im.”

Habibja dukej mjaft e vendosur. I Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të e pyeti:

“A do t’ia rikthesh atij kopshtin?”

“Po.” - u përgjigj ajo pa as më të voglin ngurrim.

Pas kësaj, i Dërguari i Zotit thirri Thabitin dhe e pyeti në lidhje me martesën. Thabiti nuk kishte ç’të thoshte tjetër. Me sa duket, problemet ishin zmadhuar dhe plaga ishte acaruar së tepërmi, duke u kthyer në një plagë të pashërueshme. Në këto kushte, kjo martesë nuk mund të vazhdonte më tej. Megjithëse divorci konsiderohet si gjëja e lejuar, të cilën Allahu e urren më shumë, nuk kishte zgjidhje tjetër. Mendimi i Thabitit ishte i njëjtë. I Dërguari i Allahut i tha:

“Merre kopshtin dhe ndahu prej saj!”<sup>51</sup>

E parë në kontekstin e kohës, kjo ngjarje do të thoshte një zgjerim i rëndësishëm në të drejtat e grave - një grua mund të ushtrojë vullnetin e saj dhe të vendosë që të shkurorëzojë burrin e saj.

Kur u pa se këto çështje ishin zgjidhur me autoritet, numri i njerëzve me probleme të ngjashme që nisën të trokasin në derën e Profetit u rrit së tepërmi. Haula binti Hakimi, gruaja e Osman ibn Madhunit, i cili ishte në mesin e myslimanëve të parë, e gjeti zgjidhjen e problemit të saj në derën e Aishes. Ajo ishte mjaft e shqetësuar. I Dërguari i Zotit e njihte Haulan; vite më parë, ajo kishte

<sup>50</sup> Muxhadele, 1-4.

<sup>51</sup> Ibni Maxhe, *talak*, 22; Muvatta, *talak*, 11.

ndërmjetësuar për martesën mes Tij dhe Aishes. Kur i Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi Të u kthye në shtëpi dhe e pa atë në një gjendje të tillë, u kthye nga Aishja dhe e pyeti:

“O Aishe pse është bërë kështu ajo? Çfarë i ka ndodhur?”

Aishja ia shpjegoi situatën që kishte të bënte me Osman bin Madhunin, burrin e Haulas.

“O i Dërguari i Zotit, është njëloj sikur ajo të jetë e pamartuar, në fakt, ajo është një grua e martuar pa burrë, sepse burri i saj i kalon ditët në agjërim dhe netët në namaz. Prandaj, ajo nuk është në gjendje të kontrollojë veten dhe siç e shikon, ajo është drobitur tërësej.”

Osman ibn Madhuni ia kishte përkushtuar veten plotësisht adhurimit, duke lënë kësisoj pas dore disa prej të drejtave të familjes së tij. Edhe pse ai ishte, njëloj si një çoban, përgjegjës për njerëzit që kishte nën mbikqyrje, ai e kishte lënë pas dore gruan e tij. Por këto rrethana të trishta u bënë shkak që prej Allahut (xh.xh.), të zbriste një tjetër ajet.

Pastaj i Dërguari i Zotit i dërgoi një mesazh Osman ibni Madhunit. Ai erdhi menjëherë tek i Dërguari i Allahut. Resulullahu paqja qoftë mbi Të i tha:

“O Osman, neve nuk na është urdhëruar që të jetojmë si murgj. A nuk jam unë një shembull i mjaftueshëm për ty? Apo mos do të dalësh prej sunetit Tim?”

Osman ibni Madhuni, që as nuk i kishte çuar nëpërmend këto gjëra, u çmerit krejtësisht. Synimi i tij në kryerjen e aq shumë adhurimeve kishte qenë të jetuarit e një jete sa më të pastër fetare, kështu që ai mendonte se ajo që ai bënte, i shërbente për jetën e përtejme.

“Kurrresi, o i Dërguari i Allahut, përkundrazi, unë përpiqem ta zbatoj sunetin Tënd, germë për germë.”, - u përgjigj ai.

Por sigurisht nuk mund të kishte asnjë dyshim se i Dërguari i Zotit e dinte me saktësi se çfarë ishte suneti. Pas fjalëve të Osmanit, i Dërguari i Zotit i dha atij këshillat e mëposhtme:

“Unë jam ai që i trembem Allahut më shumë nga të gjithë ju, dhe i respektoj më së miri kufijtë e fesë së Allahut (xh.xh.). Megjithatë, unë falem dhe fle, agjëroj dhe e prish agjërimin, dhe në të njëjtën kohë kujdesem për gratë me të cilat jam martuar. Kije frikë Allahun, o Osman, sepse edhe anëtarët e familjes sate kanë të drejtat e tyre mbi ty. Mysafirët që bujtin në shtëpinë tuaj kanë gjithashtu të drejta mbi ty. Vetja jote ka të drejta mbi ty. Prandaj të duhet që disa ditë të agjërosh, por të mos agjërosh në të tjerat, dhe duhet të falesh në një pjesë të caktuar të natës, por edhe flesh gjatë pjesës tjetër.”<sup>52</sup>

Ka pasur gjithashtu edhe sahabe femra, të cilat nuk flinin kurrë gjatë natës, duke tërhequr vëmendjen e të tjerëve, kështu që në shoqëri nisi të flitej mjaft rreth tyre. Njëra prej tyre ishte edhe Haula. Kur ajo erdhi tek Aishja, i përmendi sjelljet e saj dhe Aishja foli rreth tyre me të Dërguarin e Zotit. Kur Ai dëgjoi se ajo falej tërë natën, reagimi i tij nuk ishte edhe aq pëlqyes - zakone të tilla nuk mund të vazhdojnë për një kohë të pacaktuar dhe adhurimi i shkurtër por i vazhdueshëm, ishte më i parapëlqyer pranë Allahut.

“Çfarë? Ajo rri gjithë natën pa fjetur?”

Ai e përsëriti disa herë pyetjen sepse nuk donte t’u besonte veshëve. Pastaj tha:

“Ah, pse e ngarkoni veten me një barrë më të rëndë nga ajo që mund të mbartni? Mos harroni, kështu lodheni dhe rraskapiteni, dhe vetëm Allahu është Ai i cili kurrë nuk ka nevojë për pushim.”<sup>53</sup>

<sup>52</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/226; Ibni Hibban, *Sahih*, 1/185, 2/19.

<sup>53</sup> Buhari, *tehexhud*, 18.



Një ditë, një vajzë e re erdhi tek Aishja dhe i tha asaj me pikëllim të madh se i ati donte që ajo të martohej me kushëririn e tij, edhe pse ajo nuk ishte në një mendje me të.

Në ato kohë, vajzave nuk u lejohej të shprehnin mendimin e tyre lidhur me njeriun me të cilin ata ishin në fjalë për t'u martuar; ndjenjat e tyre konsideroheshin krejt të papërfillshme. Vendimi përfundimtar gjithmonë i përkiste babait dhe çfarë thoshte ai, ashtu bëhej. Por një tjetër zakon i gabuar do të ndryshohej nga Profeti i Allahut - kjo ishte ajo që kishte shpresuar edhe vajza.

Aishja e dëgjoi me vëmendje vajzën dhe i tha ashtu siç u kishte thënë edhe shumë të tjerave:

"Prit këtu derisa të kthehet i Dërguari i Zotit."

Aishja do ta vinte në dijeni Profetin rreth situatës dhe nëpërmjet kësaj vajze të re, një problem i përgjithshëm që rridhte që nga epoka e errësirës do të merrte rrugën e zgjidhjes sakaq nëpërmjet sqarimit të qartë të Tij.

Me të ardhur i Dërguari i Allahut, Aishja ia shpjegoi menjëherë se si qëndronte situata e vajzës. Profeti Muhamed paqja dhe bekimi qofshin mbi Të i dërgoi një mesazh të atit të vajzës, duke e thirrur edhe atë të vinte në shtëpinë e Tij. Kur i Dërguari i Zotit fton dikë, ishte e pamundur që ai të mos i përgjigjej ftesës së Tij. I Dërguari i Allahut e pyeti atë më në imtësi në lidhje me këtë çështje. Fjalët e vajzës lidhur me ngjarjen dolën se kishin qenë të vërteta, kështu që i Dërguari i Zotit i dha ca këshilla të atit. Kur Ai i fliste atij, ishte njëlloj sikur po i drejtohej mbarë shoqërisë në përgjithësi. Babai filloi ta kuptonte nga i Dërguari i Allahut se çfarë kishte bërë gabim dhe premtoi se nuk do ta detyronte vajzën e vet assesi të martohej kundër dëshirës së saj, dhe kjo çështje u zgjidh mirë e bukur.

Për herë të parë, po merrej në konsideratë dëshira e një vajzë e re. Të paktën, kjo ishte ajo që të gjithë po prisnin, pra ata të dy nuk do të martohehin. Megjithatë, situata përfundoi ndryshe. Kur i Dërguari i Zotit iu drejtua vajzës dhe i tha se i takonte asaj të vendoste, ajo ndryshe nga ç'pritej, tha:

"O i Dërguari i Zotit, unë e pranoj martesën që babai im ka rregulluar. Por duke kërkuar ndërhyrjen Tënde, dëshiroja t'u tregoja baballarëve të vajzave se nuk kanë asnjë të drejtë që t'i detyrojnë vajzat e tyre për martesë."<sup>54</sup>

Sigurisht, këto nuk ishin të vetmet gra që erdhën tek Aishja dhe ndanë problemet e tyre me të Dërguarin e Allahut nëpërmjet saj; pati edhe shumë gra të tjera të cilat erdhën tek Aishja dhe morën në fund një zgjidhje për problemet e tyre, duke u kthyer kështu të kënaqura dhe të qeta nëpër shtëpitë e tyre.<sup>55</sup>

Rasti i saj nuk paraqiste një justifikim të kotë apo të verbër të grave; Aishja i mbrojti ato sepse kishin të drejtë. Ajo nuk ua kursente qortimin grave të cilat e kishin gabim, atyre të cilat shkuan shumë larg, duke pretenduar edhe që të kapërcenin madje edhe vetë kufijtë e fesë. Drejtësia dhe barazia përbënin thelbin e vendimmarrjes së saj. Të jemi të qartë, Aishja nuk i mbronte gratë thjesht ngase ato ishin femra. Kur ishte e nevojshme, ajo i kritikonte ashpër ato, madje nuk hezitonte edhe t'i paralajmëronte, duke i ndihmuar më së pari të vërenin dhe të korrigjonin gabimet e tyre.

Me kalimin e viteve, dhe me zgjerimin e territoreve të reja, besimtarët hynë në kontakt me shoqëri dhe ide nga më të ndryshmet. Disa gra u ndikuan mjaft edhe prej këtyre rrethanave. Veçanërisht, disa gra nuk e ruajtën ndjeshmërinë e tyre të mëparshme, duke filluar kësodore të

<sup>54</sup> Ibni Maxhe, *nikah*, 12; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/136.

<sup>55</sup> Buhari, *libas*, 23.

shfaqnin sjellje të ndryshme nga ato të mëparshmet. E prekur thellë, Aishja e pat përmbledhur pikëllimin e saj si më poshtë:

“Në qoftë se i Dërguari i Allahut do ta shihte gjendjen e tanishme të grave, Ai do t'i ndalonte ato si gratë e bijve të Izraelit dhe nuk do t'ua lejonte që të hynin në xhami.”<sup>56</sup>

Fjalët e saj tregonin se sa mirë e njihte ajo të Dërguarin e Zotit paqja qoftë mbi Të. Në të njëjtën kohë, fjalët e saj ishin një tregues se koha mund t'i ndryshonte vendimet; kushtet në kohën e të Dërguarit të Zotit, ndoshta ishin më të përshtatshme për femrat që të merrnin pjesë në namazin me xhemat, gjë që qe rekomanduar për to. Por situata në ditët e mëvonshme ishte e ndryshme nga ajo e mëparshmja, dhe ndoshta duhej marrë një vendim i ri, duke marrë parasysh edhe ndryshimet.

Aishja ishte shumë i ndjeshme për sa i takon çështjes së mbulesës, andaj ajo i këshillonte gjithnjë gratë që nuk tregonin kujdesin e nevojshëm në këtë pikë. E përpiktë dhe kritike, ajo donte që të gjithë të tregonin të njëjtin kujdes për çështjet fetare dhe shpesh theksonte se në asnjë praktikë fetare nuk mund të ketë shpërfillje.

Një ditë, pranë saj erdhi për ta vizituar vajza e vëllait të saj, Abdurrahmanit. Një të parë shaminë e Hafsa bint Abdurrahmanit, ajo ia mori dhe e palosi përgjysmë. Pastaj ajo e mori pranë vetes Hafsën dhe e paralajmëroi:

“A e di se çfarë ka shpallur Allahu në suren Nur?”

Nëna jonë e nderuar kërkoi një shall më të trashë nga ata që gjendeshin përreth dhe e mbuloi me të kokën e mbesës së saj, duke i treguar asaj kështu, se si të mbulohej, e në njëfarë mënyre, t'i jepte fund njëherë e mirë kësaj çështjeje.<sup>57</sup>

Aishja shpjegonte se si mbuloheshin gratë në kohën e të Dërguarit të Zotit nëpërmjet kujtimeve të saj vetjake:

“Në kohën e të Dërguarit të Zotit, nëse kalorësit rendnin drejt nesh, teksa ne ishim veshur me rrobat e pelegrinazhit, ne e mbulonim fytyrën tonë menjëherë, e nuk i zbulonim fytyrat tona pa u larguar ata.”

Veshjet e pelegrinazhit janë veshur gjatë haxhit, dhe studiues të shquar, si Ebu Hanifja, kanë thënë se një grua mund ta zbulojë fytyrën e saj, ndërsa është e veshur me rroba pelegrinazhi, sepse aty është një vend adhurimi dhe mundësia e mendimeve të këqija në ato momente është e ulët në krahasim me rastet e tjera. Megjithatë, Aishja ishte shumë e ndjeshme, kur shpjegonte se ato i mbulonin fytyrat e tyre kur vërenin një të huaj që afrohej, edhe pse ato ishin të veshura me rrobat e pelegrinazhit. Për më tepër, ajo përmendte vështirësitë që kishte hasur në rastin e vendosjes së mbulesës dhe deklaronte se ishte e nevojshme një luftë e pakompromis në këtë drejtim. Kur ajo u sëmur gjatë Haxhit të Lamtumirës dhe nuk kishte zgjidhje tjetër, por të shkonte në Tanim me vëllain e saj me veshje pelegrinazhi, ajo pati shumë vështirësi, por kurrë nuk e humbi ndjeshmërinë e saj, qoftë atë ditë apo më pas. Ajo u tregoi njerëzve se ato që ajo thoshte ishin ato që ajo besonte vërtet dhe nuk ishin përralla por realitet.<sup>58</sup> Jeta e saj ishte një mësim për t'u nxënë, nga fillimi deri në fund. Aishja bënte aq sa mundej për ato që e vizitonin, por kur kishte ndonjë vizitor mashkull, ajo izolohej pas perdes edhe pse ajo ishte nëna e besimtarëve, e konfirmuar kjo edhe në Kuran. Kur ajo shihte ndryshimet shoqërore, rikujtonte me mallëngjim dhe nostalgji kohën e Profetit dhe fliste për

<sup>56</sup> Buhari, *Sifatu Salat*, 79; Muslim, *salat*, 144.

<sup>57</sup> Muvatta, *libas*, 4; Bejhekiu, *Sunen*, 2/235; Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/72.

<sup>58</sup> Buhari, *hajd*, 15.

shoqet e saj sahabe, rreth besimit të tyre të thellë dhe praktikimit të sinqertë të urdhrave të Allahut, ndaj duke shprehur respektin më të thellë për to, psherërinte dhe thoshte:

“Allahu dhuroftë mëshirën e Tij mbi femrat sahabe, muhaxhire, të kohëve të shkuara! Ato garonin për t’i përmbushur sa më shpejt urdhrat e Allahut për sa i përket mbulimit të tyre dhe sapo Allahu i pat urdhëruar të mbulonin kokën me shami deri tek supet, ato e zbatuan menjëherë urdhrin e Tij.”<sup>59</sup>

Ajo kishte dëgjuar se disa gra në krahinat e pushtuara kohët e fundit ishin duke vepruar pa marrë parasysh porositë hyjnore që kishin ardhur në të kaluarën dhe se ato silleshin të shkujdesura jashtë shtëpive të tyre. Ajo filloi të brengosej nga kjo gjë. Një ditë, kur një grup grash nga Humusi erdhi për ta vizituar, Aishja i qortoi duke u thënë:

“A jeni ju nga ato gratë që shkojnë nëpër banjot publike? Mos harroni se kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë, se *‘një grua që zhvesh rrobat e saj në një vend tjetër përveç shtëpisë së burrit të saj, do të thotë se ka grisur perden mes saj dhe Zotit.’*”<sup>60</sup>

Kur shihte se veshja e grave të cilat i bënin vizita asaj kishte ndryshuar dhe ishte bërë më e lehtë, Aishja i paralajmëronte:

“*Një grua që beson në suren Nur nuk mund të mbulohet në këtë mënyrë. Nëse ju jeni besimtare, mos harroni se po mbani veshur rroba të cilat nuk janë rrobat e besimtareve.*”<sup>61</sup>

Kur dikush vinte për ta vizituar atë, Aishja arrinte menjëherë t’i deshifronte qëllimet nga sjelljet dhe qëndrimi. Para se ato t’i bënin ndonjë pyetje, ajo e dinte qëllimin e tyre të vërtetë dhe i përgjigjej po nga ai këndvështrim. Njëherë erdhi për ta vizituar një grua, e cila kërkoi të dinte se çfarë mendonte Krenaria e Njerëzimit për kënanë, dhe ajo iu përgjigj:

“Të Dërguarit të Zotit i pëlqente ngjyra, por nuk i pëlqente aroma e saj!”<sup>62</sup>

Dialogu i saj me gratë nuk përbëhej vetëm nga detaje të tilla. Ajo e drejtonte bisedën në një drejtim për të cilin Allahu dhe i Dërguari i Tij do të ishin të kënaqur dhe i këshillonte që ato të vendosnin paqen në shtëpitë e tyre. Ajo besonte se harmonia brenda shtëpisë qëndronte pikërisht në vendosjen e një raporti të drejtë midis paqes në këtë botë dhe asaj në tjetrën. Ajo thoshte se të dy, si burri, ashtu edhe gruaja duhet të përmbushin përgjegjësitë e tyre dhe të jenë të prirur që të sakrifikojnë çdo gjë për njëri-tjetrin. Aishja tregonte respektin e duhur ndaj atyre që kishin qenë të afërt me të Dërguarin e Zotit dhe i furnizonte me ato që kishin nevojë. Edhe pse ajo përpiquej të bënte të pamundurën për t’i kënaqur të gjithë, ajo priste që edhe gratë që e vizitonin atë të tregonin të njëjtin nivel shqetësimi, si dhe dëshironte që edhe gratë e tjera të silleshin ndaj burrave të tyre në të njëjtën mënyrë që ajo ishte sjellë ndaj të Dërguarit të Zotit. Kur një grua erdhi dhe i kërkoi një këshillë, Aishja i tha:

“Nëse do të të krijohet mundësia që ta heqësh beben e syrit për ta zëvendësuar me një më të bukur në mënyrë që ta kënaqësh burrin tënd, bëje atë pa kurrfarë hezitimi.”<sup>63</sup>

Për të, lumturia familjare duhet të konsiderohet mbi çdo gjë tjetër, dhe për të përmbushur këtë objektiv, një rol i paçmueshëm i përket edhe gruas. Gruaja është burim i kënaqësisë familjare, dhe për këtë arsye, ajo duhet të veprojë më me kujdes kur asaj i duhet të përmbushë përgjegjësitë e veta

<sup>59</sup> Buharu, *tefsir*, 31.

<sup>60</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/41, 173; Tirmidhiu, *edeb*, 43.

<sup>61</sup> Kurtubi, *el Xhami*, 14/57.

<sup>62</sup> Ebu Davud, *taraxh’xhul*, 4; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/117.

<sup>63</sup> Ibni Sa’d, *Tabakatu’l Kubra*, 8/70-71; Dhehebiu, *Tarihu’l Islam*, 1/537.

ndaj të shoqit. Për gratë të cilat kishin pyetje në lidhje me këto çështje, Aishja u jepte përgjigjet më të gjata dhe më të matura nga sa i prisnin ato. Në qoftë se ato bënë pyetje në lidhje me çështje të ngjashme, ajo i jepte gjithashtu edhe këshilla shtesë. Njëra prej tyre një herë e pyeti:

“Unë kam qime në fytyrë. A duhet t’i heq ato që t’i dukem burrit tim më tërheqëse?”

Aishja iu përgjigj:

“Ashtu siç ti mban bizhuteri dhe zbukuron veten kur viziton dikë, njëlloj duhet të pastrosh çfarëdo problemi që të kesh dhe ta bësh veten të bukur për burrin tënd. Kur ai të urdhëron për diçka, duhet t’i bindesh atij. Nëse ai të kërkon diçka, mos e lër pas dore kërkesën e tij. Për më tepër, mos prano brenda shtëpisë tuaj dikë që burri yt nuk e pëlqen.”<sup>64</sup>

## DASHURIA E SAJ PËR TË DËRGUARIN E ALLAHUT

Aishja e donte shumë të Dërguarin e Zotit. Ai ishte robi më i dashur i Allahut, dhe Allahu u kishte kërkuar robërve e Tij që ta duan të Dërguarin e Tij besnik: *“Thuaj: nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë e t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu fal shumë, mëshiron shumë.”*<sup>65</sup>

Aishja e ka dashur thellësisht të Dërguarin e Zotit dhe ndjente dashuri të fortë ndaj Tij. Ajo nuk ishte e gatshme të ndante kohën e saj për të Dërguarin e Zotit me të tjerët dhe synonte të kalonte të

---

<sup>64</sup> Abdur’rezak, *Musannef*, 3/146.

<sup>65</sup> Al Imran, 31.

gjithë kohën që kishte në dispozicion vetëm me Të. Megjithatë Ai ishte i Dërguari dhe Profeti i të gjithëve. I Dërguari i Zotit kërkonte të arrinte tek të gjithë njerëzit, edhe ata që kishin qenë të paarritshëm, dhe kishte për qëllim të hapte dyert në të cilat askush nuk kishte hyrë më parë. Martesat e tij të mëvonshme ndoshta kanë ndodhur posaçërisht për këtë arsye. Aishja e kishte kuptuar me kohë këtë fakt. Njerëzit ishin rreshtuar të sakrifikonin jetën e tyre për hir të misionit të Tij. Ata i ishin përkushtuar Atij, dhe përkushtimi i tyre bëri që Aishja të rrinte në ankth. Ankthi i saj vazhdoi derisa u shpall ajeti në vijim: *“...ti je i lirë të lëshosh atë që do prej tyre dhe të mbash pranë vetes atë që do, e edhe të kërkosht afrimin e asaj nga e cila ke qenë larguar, dhe në këtë nuk ke mëkat”*<sup>66</sup>

Pas shpalljes së këtij ajeti, ajo u iu drejtua të Dërguarit të Allahut dhe i tha:

“Me sa po shoh, Allahu të dhuron gjithmonë atë që të dëshiron zemra.”

Rasti i saj ishte një pasqyrim i dashurisë, një shprehje e intimitetit. Ajo donte të ishte me të gjatë gjithë kohës, por kushtet nuk e lejonin këtë dhe përsëri ishte ajo që bëri sakrificën. Çdo bashkëshorte e të Dërguarit të Zotit ia merrte një ditë burrin e saj duke e lënë Atë larg prej saj. I Dërguari i Zotit hartoi një kalendar për gratë e tij dhe i ndante ditët në mënyrë të barabartë midis tyre. Ndërsa më parë kishte pasur mundësi që të ishte me Të mjaft shpesh, tani radha e saj vinte vetëm çdo nëntë ditë.

I Dërguari i Allahut nuk ndryshoi qëndrim edhe pasi u shpallën këto ajete. Edhe nëse Ai kishte ndonjë dëshirë të shmangej nga kalendar i që kishte përcaktuar, gjithmonë do t'i kërkonte leje për këtë grave të veta. Aishja e theksonte së tepërmi këtë pikë kur bënte analizën e qëndrimeve të të Dërguarit të Allahut:

“I Dërguari i Allahut vazhdonte të na kërkonte leje për ndryshimet në orar edhe pasi u shpall ajeti: *‘...ti je i lirë të lëshosh atë që do prej tyre dhe të mbash pranë vetes atë që do, e edhe të të kërkosht afrimin e asaj nga e cila ke qenë larguar, dhe nuk ke mëkat’*.”

Aishja, në ditën e saj, kërkonte të shpenzonte të gjithë kohën e saj me të Dërguarin e Zotit dhe ishte mjaft e ndjeshme ndaj çdo gjëje që ndërhynte në qëndrimin e tyre bashkë. Një natë, ajo u zgjua dhe kuptoi se i Dërguari i Zotit nuk ishte me të. Meqë nuk kishte asnjë dritë, Aishja nuk ishte në gjendje të shikonte përreth. Ajo ishte e merakosur se mos Ai e kishte lënë atë për të vizituar ndonjë nga gratë e tjera të Tij. Ajo preku përreth me shqetësim. Pasi dora e saj preku njërën nga këmbët e Tij, ajo u çlirua kur pa se Ai ishte në sexhde. Ajo u qetësua dhe mori frymë thellë. I Dërguari i Zotit nuk e kishte lënë atë, Ai ishte duke qarë, dhe po i lutej Zotit në cepin tjetër të dhomës. Aishja u prek kur dëgjoi lutjet e tij të singerta:

“O Zot, kërkoj strehë në kënaqësinë Tënde nga zemërimi Yt, dhe në faljen Tënde nga ndëshkimi Yt, unë gjithashtu mbështetem në veten Tënde prej Teje. Unë nuk mund të të lavdëroj Ty siç e lavdëron Ti vetveten.”

Aishja u turpërua nga merakuri i saj dhe duke u kthyer nga i Dërguari i Allahut, tha:

“T’u bëfshin kurban prindërit e mi! Si arrita të mendoj ashtu për Ty ndërkohë që Ti paske qenë i zënë me këtë punë?”<sup>67</sup>

Aishja u përball me të njëjtën situatë një tjetër ditë. Kur i Dërguari i Zotit ishte duke shkuar në shtrat, ai i vendosi sandalet pranë vetes dhe i vari rrobat në një vend të afërt, sikur të donte të ngrihej dhe të ikte menjëherë. Normalisht, Ai merrte përherë leje nga gratë e Tij edhe për të falur

<sup>66</sup> Ahzab, 51.

<sup>67</sup> Muslim, *salat*, 221; Tirmidhi, *daauat*, 76; Ebu Davud, *salat*, 152.

namazin e natës, duke pasur parasysh se të drejtat e të tjerëve mbi Të, Ai i konsideronte si thelbësore.<sup>68</sup> Ai ishte duke vepruar ndryshe atë ditë dhe Aishja nuk e kuptonte pse, dhe kështu ajo nisi të dyshonte. Ai filloi të pushonte.

Pas kishte kaluar ca kohë, i Dërguari i Zotit u ngrit ngadalë nga shtrati i Tij. Ai ecte në heshtje dhe kaloi vjedhurazi mbi Aishen, në mënyrë që të mos e zgjonte. Por Aishja nuk ishte duke fjetur; ajo po e shikonte atë me kureshtje. I Dërguari i Zotit veshi sandalet dhe rrobat e Tij me lëvizje të kujdesshme, pastaj hapi derën dhe u largua. Aishja u mërzit ngaqë i Dërguari i Zotit e kishte lënë vetëm.

Ajo u ngrit menjëherë dhe mbuloi fytyrën me vellon e saj. Pastaj filloi të ndiqte të Dërguarin e Zotit. Ai shkoi në varrezat e Medinës, ngriti pëllëmbët e Tij drejt qiellit dhe filloi të lutej me ofshamë. Kur krahët iu lodhën, Ai i uli ato, dhe pastaj pak më vonë, i ngriti sërish dhe vazhdoi të lutej.

Pastaj erdhi koha të largohej nga varrezat për t'u kthyer në shtëpi. Aishja nisi të ecte shpejt në mënyrë që të fshihej. Kur i Dërguari i Zotit ecte shpejt, ashtu bënte edhe ajo. Kur Ai ecte edhe më shpejt, Aishja vraponte.

Ajo mbërriti në shtëpi përpara të Dërguarit të Zotit, por kishte mbetur pa frymë. U shtri menjëherë duke u përpjekur të hiqej sikur nuk kishte dalë nga dhoma.

Por, kur i Dërguari i Allahut erdhi menjëherë pas saj, vuri re shqetësimin e saj dhe e pyeti:

“Çfarë të ka ndodhur, o Aishe?”

“Asgjë.”, - u përgjigj ajo.

Meqenëse i Dërguari i Allahut e njihte mirë, e pyeti përsëri:

“A do të ma thuash vetë apo të ma thotë Allahu i Gjithëdijshëm dhe i Plotfuqishëm?”

Zemra e saj regëtiu. Duke u kthyer nga i Dërguari i Allahut, ajo tha:

“O i Dërguari i Allahut, prindërit e mi të qofshin fli.”

Kjo ishte një mënyrë e tërthortë për të rrëfyer gabimin e saj. I Dërguari i Allahut e pyeti:

“A ishe ti ajo silueta e paqartë që pashë para meje, ndërsa isha duke ecur?”

“Po”, - rrëfeu ajo.<sup>69</sup>

Këto incidente i treguan asaj se i Dërguari i Zotit ishte larg çdo të mete, kështu që nuk ia vlente të shqetësohej më për asgjë.

Dashuria e saj për Të ishte aq e thellë, saqë ajo nuk mund të lejonte asgjë negative të thuhej rreth Tij. Një ditë, dikush i tha:

“Vdeksh më mirë.”<sup>70</sup>

Kur Aishja e dëgjo, u ngrit menjëherë dhe iu përgjigj:

“Ti ia uron vdekjen të Dërguarit të Allahut? Përkundrazi, Allahu të mallkoftë dhe të sjellë vdekjen.”

I Dërguari i Zotit e kuptonte ndjeshmërinë e saj dhe e vlerësonte gjestin bujar në fjalët e saj, por si profet, ai duhet t'i merrte në konsideratë të gjithë njerëzit si besimtarë të mundshëm. Mungesa e

---

<sup>68</sup> Bejhekiu, *Shuabul iman*, 3/383.

<sup>69</sup> Muslim, *xhenaiz*, 102; Nesai, *xhenaiz*, 103; *ishretu nisa*, 4.

<sup>70</sup> Në vend që ta përshëndesnin duke i urren paqe, siç vepronin gjithnjë besimtarët, mosbesimtarët thoshin “Vdeksh më mirë!” nëpër dhëmbë.

mirësjelljes e besimtarit potencial nuk duhet të shpërblehej me të njëjtën monedhë. Pra, i Dërguari i Zotit e qortoi Aishen dhe i tha:

“Qetësohu , o Aishe! Zoti i Plotfuqishëm është më i Buti dhe Ai na do që të jemi të tillë në të gjitha çështjet. Ai nuk i dhuron bekimet e Tij për ata që veprojnë pa mirësi.”

Aishja nuk ishte në gjendje të thoshte gënjeshtër në qoftë se dikush e pyeste për diçka. Nëpërmjet rrëfimit të dëshirës së brendshme për të mos qenë asnjëherë larg nga Profeti, ajo tregon se nuk mund të kishte vepruar ndryshe.

Kur i Dërguari i Zotit ishte duke u përgatitur për një ekspeditë ushtarake, ai hodhi short për të përzgjedhur se cila mes grave të tij do ta shoqëronte. Në fund, u përzgjedhën Hafsa dhe Aishja. Udhëtimi i tyre filloi dhe ata ecën shumë në ditën e tyre të parë. Kur ra nata dhe ata po bënë një pushim, i Dërguari i Zotit u ul dhe filloi të bisedonte me Aishen. Hafsa mendoi se kjo do të thoshte se natën e parë ai nuk do të ishte i saj, por i Aishes.

Pasi kishte kaluar ca kohë, Hafsa iu afrua Aishes dhe i sugjeroi:

“Ti hip tek deveja ime dhe unë po hip në tënden, dhe po shohim se çfarë do të bëjë i Dërguari i Allahut.”

Ngjante si një lojë e këndshme. Aishja ishte e sigurt se i Dërguari i Allahut do të zgjidhte devenë e saj, por ajo nuk dëshironte t’ia prishte shoqes dhe pranoi.

Kur ushtria po bëhej gati të nisej, i Dërguari i Allahut shkoi tek deveja e Aishes në pjesën e mbuluar të së cilës në vend të Aishes, ndodhej Hafsa. Kështu, Aishja e cila e kishte marrë mesazhin e vlerës së madhe që kishte në zemrën e Profetit, tani ishte e detyruar të privohej nga të qëndruarit me Të.

Ajo i kishte thënë ‘po’, kësaj loje, por nuk e kishte të lehtë të pranonte përfundimin e saj. I Dërguari i Allahut e kishte zgjedhur, por ajo nuk ishte me Të. Ajo e ndjeu veten të mjerë dhe nuk dinte se si të vepronte. Duke goditur barin me këmbë, ajo ndjeu keqardhje për veten dhe iu lut Allahut:

“O Zoti im, dërgoje një gjarpër të më kafshojë! I Dërguari i Allahut po largohet dhe unë nuk jam në gjendje t’i them Atij asgjë.”

Në sytë e Aishes, burri i saj ishte më i pashëm se Profetit Jusuf (a.s.), të cilin pasi gratë e kishin parë, nga magjepsja kishin prerë gishtat pa e vënë re. Ajo besonte se nëse ato gra do ta kishin parë Profetin Muhamed paqja dhe bekimi qofshin mbi Të, ato në vend të gishtave do të kishin ngulur thikat në gjoks.

Brenda shtëpisë së tyre të ngrohtë plot dashuri të ndërsjellë, nuk ekzistonte as edhe problemi më i vogël që mund të dëmtonte marrëdhëniet e tyre. Çdo ditë që kalonte e rriste dashurinë e tyre dhe çdo incident shërbente për të ushqyer dashurinë e tyre për njëri-tjetrin. As Aishja nuk abuzoi kurrë me dashurinë e Tij, as i Dërguari i Zotit nuk e ndjeu kurrë nevojën për të marrë masa të caktuara ndaj saj. Kjo ishte sjellja e përgjithshme e Profetit dhe, edhe dashuria e Tij me gratë e tjera ishte e ngjashme. Ai i kuptonte dëshirat e tyre para se ato t’i shprehnin, dhe i përmbushte kërkesat e tyre siç kishte bërë gjithmonë. Aishja ka thënë:

“ I Dërguari i Zotit nuk e ka goditur kurrë një grua me dorën e Tij, shërbëtor apo dikë tjetër.”<sup>71</sup>

Dashuria e saj për Profetin vazhdoi edhe pas vdekjes së tij. Nëna e besimtarëve, e cila vazhdoi të ruante stilin modest të jetesës që e kishte pasur me Profetin edhe pas vdekjes së tij, reagonte kundër

---

<sup>71</sup> Muslim, *fedail*, 79.

çdokujt që sillte orendi në shtëpinë e saj dhe e mbajti përherë veten larg prej të mirave materiale. Ata të cilët e shihnin atë si nënë të besimtarëve, garonin me njëri-tjetrin kush t'i sillte sa më shumë ndihma ndërsa ajo ua shpërndante të varfërve të gjitha ato që njerëzit i kishin sjellë për të; në shumicën e rasteve pa mbajtur asgjë për vete. Fillimisht, Aishja kishte pasur ndër mend t'i kthente mbrapsht të gjitha dhuratat që ishin të destinuara për të, por një frazë që e kishte dëgjuar nga i Dërguari i Allahut e bëri atë të mos ishte në gjendje t'i kthente ato, ndaj ishte e detyruar t'i pranonte të gjitha ato çfarë i ofroheshin.

Një ditë, delegati i Abdullah ibn Amrit erdhi t'i sillte ushqim dhe veshje Aishes. Ajo iu drejtua atij dhe i tha:

“O bir i dashur! Unë nuk pranoj asgjë nga askush.”

Ajo ia ktheu mbrapsht dhuratat. Edhe pse ai ishte thjesht një korrier, u prek. Qëllimi i tij i vetëm ishte thjesht të bënte një mirësi, sepse kur i jepnin diçka Aishes, iu dukej sikur ia jepnin të Dërguarit të Allahut. Ata e respektonin atë si nënën e tyre dhe dëshironin t'ia plotësonin nevojat, por ky ishte vullneti i saj. Korrieri e ndjeu veten të dëshpëruar gjatë rrugës për tek Abdullahu, duke u shqetësuar se çfarë do të mendonte ai se kishte ndodhur.

Në të njëjtën kohë, Aishja po reflektonte në lidhje me veprimin e saj. E zhytur në mendime të thella ajo trembej se mos kishte vepruar në kundërshtim me të Dërguarin e Allahut. Me vrull u kthye dhe u tha atyre që kishte afër:

“Thirreni përsëri!”

Kur ata e arritën, korrieri u shokua. Ai u rikthye tek shtëpia e Aishes plot ankth, duke mos e pasur idenë se çfarë mund t'i thoshte ajo.

Zemërimi i mëparshëm i Aishes ishte zhdukur si të ishte marrë me vete nga një puhizë deti. Ajo i foli në mënyrën më njerëzore të mundshme:

“Unë mbaj mend diçka që më pat thënë i Dërguari i Allahut. Ai njëherë më tha: ‘O Aishe, nëse dikush të jep diçka pa ia kërkuar, mos ia kthe kurrë, sepse ai është bekim nga Allahu që të ofrohet ty!’”<sup>72</sup>

Kuptimi i hadithit ishte i qartë, dhe korrieri u kthye me buzëqeshje.

## **Dashuria e Profetit**

Dashuria që Aishja kishte për Profetin nuk ishte e njëanshme. I Dërguari i Allahut, i Cili përbënte një shembull për shoqërinë në çdo çështje, e donte jashtëzakonisht Aishen. Ashtu siç bëri në çdo fushë të jetës, Profeti i Allahut ka jetuar me përsosmëri edhe në aspektin e marrëdhënieve familjare. Ai ka thënë:

“Më i miri ndër ju është ai i cili sillet më mirë me familjen e tij. Unë jam i pari në këtë gjë.”<sup>73</sup>

Baza e kësaj ishte dashuria e ndërsjellë. I Dërguari i Zotit e shfaqte hapur dashurinë që ushqente ndaj Aishes, duke e bërë më se të qartë edhe për të tjerët. Sigurisht, Profeti përfaqësonte drejtësinë, por dashuria nuk mund të kufizohet me vullnetin e njeriut. Dashuria e Tij për Aishen ishte një pasqyrim i pastër i vetë natyrës njerëzore. Ai kurrë nuk diskriminoi ndonjërin prej grave; ai kujdesej në mënyrë të barabartë për dispozitat e secilës, dhe u soll me mirësi ndaj tyre. Pasi kalonte

---

<sup>72</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/77.

<sup>73</sup> Tirmidhi, *menakib*, 64; Ibni Maxhe, *nikah*, 50.



nga një ditë me çdo grua, i Dërguari i Zotit i drejtohej Zotit dhe i lutej Atij për të zhdukur çdo mangësi që mund të shfaqej nga mosbarazia e ndjenjave të Tij:

“O Zoti im! Ky është ekuilibri që mund të mbaj unë; mos më gjyko me anën e balancës Tënde, sepse unë nuk jam në gjendje ta mbaj atë siç duhet.”<sup>74</sup>

Kjo lutje kishte të bënte me Aishen. I Dërguari i Allahut kishte një intimitet të veçantë me të në krahësim me lidhjet e Tij të tjera. I Dërguari i Allahut, i cili ishte më i ndjeshmi i njerëzve, dëshironte të ishte plotësisht i drejtë, por kërkonte strehë tek Allahu i Gjithëmëshirshëm për ndonjë padrejtësi që mund të ndodhte. Ishte një shpallje ajo që hodhi dritë mbi këtë çështje:

*“Ju kurrësi nuk mund ta mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpigëni, pra mos anoni plotësisht nga njëra dhe ta lini tjetrën si të varur. E nëse përmirësoheni dhe ruheni, Allahu ju fal dhe ju mëshiron”*<sup>75</sup>.

Disa sahabë filluan ta quanin Aishen “e dashura e të Dërguarit të Zotit.” Kur diçka negative për Aishen u tha në prani të Amar ibni Jasirit, ai u zemërua dhe bërtiti:

“Si mund të flisni keq për të ‘dashurën e të Dërguarit të Zotit’ dhe ta lëndoni atë?”<sup>76</sup> Amari e urdhëroi personin që kishte thënë këtë vërejtje t’i zhdukej nga sytë. Dashuria e tyre për njëri-tjetrin ishte aq e qartë, sa që sahabët parapëlqenin t’i jepnin Atij dhurata në ditët që i Dërguari i Zotit ishte me Aishen, sepse buzëqeshja në fytyrën e Tij ishte më e veçantë në ato ditë.<sup>77</sup>

Kjo ishte një situatë mjaft e qartë dhe në mënyrë që të shmangeshin problemet, të gjithë e paralajmëronin dhe përpiqeshin për të ndihmuar njëri-tjetrin. Një ditë, Omeri e këshilloi vajzën e tij, Hafsën:

“Bija ime e dashur! Unë shpresoj që gjendja e shoqes tënde mos të të shtyjë në ndonjë gabim, duke qenë se ajo është më e këndshme dhe e dashur sesa Ti për të Dërguarin e Allahut.”<sup>78</sup>

Omeri po përpiquej ta ndërgjegjësohte të bijën për statusin e veçantë të Aishes, dhe duke i dalë punës përpara, po e paralajmëronte të mos mendohej të konkurronte me të.

Një fqinj i tyre pers gatuante një supë shumë të shijshme dhe një ditë, ai e ftoi të Dërguarin e Zotit për drekë. I Dërguari i Zotit kurrë nuk mendonte ta pranonte ftesën vetëm për vete, dhe kërkoi të merrte edhe Aishen, e cila po vuante shumë nga uria. Duke i treguar me dorë Aishen, i Dërguari i Allahut e pyeti:

“A e fton edhe atë?”

Burri u përgjigj negativisht. Ndoshta ai kishte vetëm një sasi të vogël supe për të ngrënë ose ndoshta ai nuk e kuptoi se Profeti donte që ai të ftonte Aishen. Kështu që, Profeti iu përgjigj negativisht ftesës.

Pas pak, burri u kthye dhe e përsëriti ftesën e Tij. I Dërguari i Allahut bëri me gisht nga Aishja dhe e pyeti:

“A e fton edhe atë?”

Përsëri, burri i tha jo, dhe përsëri, i Dërguari i Zotit iu përgjigj ftesës negativisht.

<sup>74</sup> Tirmidhi, *nikah*, 41; Ebu Davud, *nikah*, 39.

<sup>75</sup> Nisa, 129.

<sup>76</sup> Tirmidhi, *menakib*, 63; Hakim, *Mustedrek*, 3/444.

<sup>77</sup> Buhari, *hiba*, 6,7.

<sup>78</sup> Muslim, *talak*, 30; Tirmidhi, *tefsiru'l Kuran*, 387.

Së fundi, burri erdhi për herë të tretë dhe e përsëriti ftesën e Tij përsëri. Përfundimisht, ai njeri e kuptoi se i Dërguari i Zotit nuk dëshironte të merrte pjesë pa Aishen. Kështu ai u përgjigj pozitivisht, ndaj i Dërguari i Zotit dhe Aishja shkuan së bashku në shtëpinë e persianit.<sup>79</sup>

Dashuria mes Aishes dhe Profetit ishte aq e qartë saqë njerëzit i dërgonin atij Aishen për të harruar konfliktet dhe për ta bënë atë të lumtur përsëri. Një ditë Safija e mori Aishen mënjane dhe i tha:

“O Aishe, a mund ta bësh të kënaqur të Dërguarin e Zotit? Nëse mundesh, unë do të ta jap ditën time.”

Aishja u përgjigj pozitivisht dhe pastaj shkoi dhe u ul pranë të Dërguarit të Zotit. Duke e ditur se kjo ditë nuk ishte e saj dhe se ai kurrë nuk e ndryshonte orarin, e shihte ardhjen e Aishes të çuditshme dhe i tha të shkonte në dhomën e saj.

Që nga momenti kur Ai e kishte filluar bisedën, ajo vazhdonte t'i përsëriste fjalët: “O i Dërguari i Zotit, ky është një bekim që më është dhuruar nga Allahu me atë që Ai e do më së shumti.”

Ajo kishte arritur të fitonte vëmendjen e pandërprerë të të Dërguarit të Zotit. Aishja i bëri të Dërguarit të Zotit një përshkrim të hollësishëm të bisedës që ajo kishte bërë me Safijen, duke e ndarë me të pikëllimin që kishte ndjerë kjo e fundit. Kjo ishte një përpjekje për paqe, dhe ndjeshmëria e Aishes e kënaqi të Dërguarin e Zotit. Qetësia që Ai ndjeu brenda vetes iu reflektua në fytyrë.<sup>80</sup>

Gjatë një udhëtimi së bashku, deveja e Aishes ngatërroi rrugën dhe u largua nga të tjerët, duke humbur në një vend të quajtur Harra. I Dërguari i Allahut u kaplua prej ankthit, kështu që, të gjithë filluar të kërkonin menjëherë për të. Me shqetësimin e humbjes së një njeriu të afërt nën kujdesin e Tij, Ai thirri, “*ue arusah*”, një shprehje trishtimi e cila përdorej kur dikush humbiste gruan.

Një herë tjetër, një sahab i njohur, Amr ibni Asi, erdhi dhe e pyeti të Dërguarin e Zotit:

“Kë do më shumë nga njerëzit?”

Ai shpresonte të verifikonte rëndësinë e vet në sytë e të Dërguarit të Zotit, e saora priste që të dëgjonte emrin e tij. Por i Dërguari i Zotit, pa hezitim, u përgjigj:

“Aishen.”

Amr ibni Asi vazhdoi ta pyeste duke pritur të dëgjonte emrin e tij ndaj i tha përsëri:

“Po nga burrat?”

Ai u përgjigj:

“Babanë e saj.”

Amr ibni Asi e kuptoi se ai nuk ishte prioriteti kryesor i Profetit, dhe se të pyeturit e mëtejshëm do të ishte diçka e rrezikshme. Duke llogaritur edhe mundësinë që ai mund të ishte ndër të fundit, Amr ibni Asi hoqi dori dorë nga pyetjet e mëtejshme të kësaj natyre.<sup>81</sup>

Ngjarjet e dëshmuara nga të gjithë ishin të ngulitura në kujtesën e tyre; çdo preferencë e të Dërguarit të Zotit bënte që njerëzit ta duan atë edhe më shumë. Kur ai shkoi në një ekspeditë dhe qëndroi larg nga gratë e Tij për rreth një muaj, kur u kthye, ai shkoi fillimisht në shtëpinë e Aishes.<sup>82</sup>

---

<sup>79</sup> Muslim, *eshribe*, 139; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/123.

<sup>80</sup> Buhari, *hiba*, 14; *shehadet*, 30.

<sup>81</sup> Buhari, *fedailu sahabe*, 5.

<sup>82</sup> Buhari, *nikah*, 83.

Po kështu, i Dërguari i Allahut kërkoi edhe opinionin e Aishes gjatë rastit kur Profeti iu la të drejtën bashkëshorteve të Tij të zgjidhnin të vazhdonin të jetonin me Të një jetë modeste, ose të divorcoheshin dhe të kërkonin të mirat e kësaj bote gjetiu.<sup>83</sup>

Kur myslimanët e Medinës filluan të dalin nga varfëria nga e cila kishin vuajtur për vite, disa prej grave të tij (të cilat ishin katër në atë kohë) e pyetën: “a mund të jetojmë më mirë edhe ne ashtu sikurse myslimanët e tjerë?” I Dërguari reagoi ndaj kërkesës së tyre duke shkuar në izolim. Ai justifikojte me vete, duke thënë: “Unë nuk mund ta përballoj atë që duan ato.” I Dërguari i Allahut i kishte përgatitur ato të ishin shembull për të gjitha gratë e atëhershme dhe të ardhshme myslimane. Ai ishte i shqetësuar veçanërisht për faktin se ato mund t’i konsumonin shpërblimet për veprat e tyre të mira qysh në këtë botë, dhe në këtë mënyrë të ishin të përfshira në ajetin:

*“E në ditën kur ata që nuk besuan paraqiten pranë zjarrit (e u thonë): ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe i përjetuat ato, sot për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se nuk respektuat urdhrat e Zotit, do të shpërbleheni me dënimin nënçmues.”<sup>84</sup>*

Kështu, këto gra të veçanta janë vënë përpara një sprove të madhe. Profeti i ka lejuar ato të zgjedhin mes shtëpisë e Tij të varfër dhe botës luksoze. Nëse ato do të zgjidhnin këtë botë, ai do t’u jepte atyre aq sa Ai mund të përballonte dhe pastaj do të prishte martesën me to. Nëse ato zgjidhnin Zotin dhe të Dërguarin e Tij, atëherë ato duhet të ishin të kënaqura me jetesën e tyre. Kjo ishte veçantia e familjes së Tij. Meqenëse kjo familje ishte unike, edhe anëtarët e saj duhej të ishin të pashoqë. Kreu i familjes ishte zgjedhur, ashtu siç ishin të zgjedhur edhe gratë me fëmijët. Kështu, i Dërguari më parë thirri Aishen dhe i tha: “Unë dua të diskutoj diçka me ty. Është mirë që të flasësh me prindërit tuaj para se të marrësh një vendim.” Pastaj i recitoi asaj ajetin e mëposhtëm:

*“O ti Profet, thuaju grave tuaja: ‘Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj, atëherë ejani: unë po ju jap furnizimin dhe po ju lëshoj ashtu si është e udhës. E në qoftë se e doni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurt se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë punë të mira.’”<sup>85</sup>*

Vendimi i Aishes ishte pikërisht ai që mund të pritej nga e bija besnike e një babai besnik: “O i Dërguari i Zotit, a kam nevojë të flas me prindërit e mi? Për Zotin, unë zgjedh Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”<sup>86</sup> Aishja vetë na tregon se çfarë ndodhi më tej: “I Dërguari mori të njëjtën përgjigje nga të gjitha gratë e tij. Askush nuk shprehu një mendim të ndryshëm. Të gjitha ato thanë atë që kisha thënë unë.”

Fatimja ia shpjegoi vetëm Aishes një sekret të cilin i Dërguari i Zotit ia kishte rrëfyer asaj para se ai të ndërronte jetë.<sup>85</sup>

Të gjitha këto incidente bërë që shoqëria të ishte më e kujdesshme kur kishte të bënte me Aishen. Preferenca e tij do të vazhdonte deri ditën që ai vdiq. Në ditën kur filloi sëmundja e tij fatale, ai pyeti:

“Me kë do të jem tani? Me kë do të jem nesër?” dhe me sy shprehte dëshirën që të ishte me Aishen gjatë sëmundjes së tij. Kjo ishte prova e fundit e intimitetit të tij me Aishen të cilin ajo do ta përshkruante me këto fjalë:

---

<sup>83</sup> Buhari, *medhalim*, 26.

<sup>84</sup> Ahkaf, 20.

<sup>85</sup> Ahzab, 28-29.

<sup>86</sup> Buhari, *medhalim*, 26; *tefsiru sure*, 276; Muslim, *talak*, 22.

“Ai vdiq ditën në të cilën ishte radha ime të rrija me Të. Allahu e mori shpirtin e tij kur e kishte kokën të mbështetur në prehrin tim.”<sup>87</sup>

Duke pasur parasysh gjithë sa thamë, Enes ibn Maliku ka thënë se dashuria e parë e madhe në Islam ka qenë dashuria e të Dërguarit të Zotit për Aishen. Kur imam Masruku rrëfen një hadith të transmetuar nga Aishja, ai do të shprehej:

Kjo më është rrëfyer nga një njeri i dashur, nga më e dashura e Allahut dhe nga gruaja, dëlirësia e së cilës është vërtetuar nga shpallja hyjnore, dhe e cila ishte vajza më besnike e njeriut më besnik.”<sup>88</sup>

### **Arsyeja e vërtetë e kësaj dashurie**

Askush nuk mund të mos mahnitet nga arsyet përse Profeti ndiente një dashuri kaq të madhe për Aishen në krahasim me bashkëshortet e tjera të Tij. Së pari, i Dërguari i Allahut gjithmonë iu rikujtonte të tjerëve se Aishja ishte vajza e shokut të Tij më të ngushtë.<sup>89</sup> Pa dyshim Aishja ishte një femër tërheqëse. E ëma, Umu Rumani njëherë e ngushëlloi kur ajo ishte e mërzitur me fjalët:

“Ki pak durim! Allahu do të japë qetësi. Betohe në Allahun se nuk ka asnjë femër tjetër që të jetë kaq e bukur sa ti dhe që ta dojë burri kaq shumë sa ty, që të ketë marrëdhënie kaq të mira me gratë e tjera të tij dhe që të mos ketë synime për intriga mes tyre. Për një grua si ti, normalisht që shpifet shpesh!”<sup>90</sup>

Ky ishte sikurse paralajmërimi që Omeri i kishte dhënë bijës së tij, Hafses, që kurrë nuk duhej të konkurronte me Aishen, ose ta mërziste atë. Ai ishte rezultat i së njëjtës ndjeshmëri ndaj Aishes, e cila zinte një vend të veçantë në zemrën e të Dërguarit të Zotit.<sup>91</sup>

Kur rrëfimet analizohen gjerësisht, nxjerrim se shkaku i dashurisë së tejskajshme të Profetit për Të ishte devotshmëria e saj në fe. Aishja e ka udhëhequr familjen e saj me madhështi dhe dituri, ndaj ishte një mësuese e shquar e anëtarëve të familjes së Profetit.

Ndërsa kishte shumë dëshmitarë të sjelljes publike të të Dërguarit të Allahut, Aishja i ka parë të dy aspektet e tij, si publike, ashtu edhe private. Ajo u bë interpretuesja më e rëndësishme e Kuranit, dhe mësuesja kryesore e hadithit, duke u bërë ndër transmetueset kryesore të fesë islame. I Dërguari i Zotit i këshillonte myslimanët që t'i mësonin prej saj detajet e fesë. Në një hadith të transmetuar nga Aishja, i Dërguari i Zotit thotë: “Me një grua martohesh për tri gjëra: për pasurinë e saj, bukurinë dhe fenë e saj. Megjithatë, ju duhet të preferoni aspektin fetar, në mënyrë që të mund të arrini qetësinë.”<sup>92</sup>

I Dërguari i Zotit e praktikonte më parë vetë diçka, pastaj ua këshillonte të tjerëve atë që njerëzit duhet të bënin në çdo situatë.

Disa prej grave të tjera të Tij ishin të njohura edhe për bukurinë e tyre. Pra në mënyrë të qartë, dashuria e Tij e veçantë për Aishen nuk mund të shpjegohet vetëm nga bukuria. Bukuria e tyre na është transmetuar nga Aishja vetë. Për shembull, kur Aishja e pa Xhujejrijen gjatë Luftës së Beni Mustalikut, bukuria e saj i tërhoqi vëmendjen, e atë saora e zuri një ndjesi ankthi. Aishja ka thënë:

---

<sup>87</sup> Buhari, *xhenaiz*, 94.

<sup>88</sup> Bejhekiu, *Sunen*, 2/458; Ibni Sa'd, *tabakat*, 8; Ibnu'l Athir, *Usdu'l Gabe*, 1.

<sup>89</sup> Muslim, *fedailu sahabe*, 83; Nesai, *ishretu nisa*, 3; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/88; Bejhekiu, *Sunen*, 7/299.

<sup>90</sup> Buhari, *shehadet*, 15.

<sup>91</sup> Buhari, *medhalim*, 25.

<sup>92</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/152.

“Ajo ishte një grua shumë e bukur dhe e këndshme, me një pamje tërheqëse. Ajo erdhi dhe e pyeti të Dërguarin e Zotit, teksa ishte me mua, për deklaratën që do t’i jepte asaj lirinë. Betohem se kur e kam parë për herë të parë, pata një lloj frike dhe meraku rreth çastit kur ajo do të shkonte tek i Dërguari i Allahut.”<sup>93</sup>

Aishja pati një ndjesi të ngjashme meraku kur pa për herë të parë Safijen. Safija, e cila erdhi në Medinë pas marrjes së Hajberit dhe qëndroi si mysafire në shtëpinë e Harithe ibni Numanit, tërhoqi menjëherë vëmendjen e grave të ensarëve, andaj nuk ngeli asnjëra prej tyre pa rendur për ta parë. Me fytyrë të mbuluar, edhe Aishja shkoi ta shihte. Pak pasi doli Aishja, edhe i Dërguari i Allahut doli nga shtëpia. E ndërsa i Dërguari i Allahut kishte planifikuar të martohej me Safijen, në mënyrë që të bënte për vete një numër të madh njerëzish me të cilët deri atëherë kishte luftuar, ai nuk donte as të lëndonte gratë e Tij. Ai erdhi tek Aishja dhe e pyeti:

“Si t’u duk o Aishe?”

Ai e kuptoi menjëherë se ajo nuk ishte e kënaqur me këtë gjendje. Safija kishte jetuar mes njerëzve të cilët i kishin bërë sahabët dhe të Dërguarin e Allahut të vuanin deri atë ditë. Tani asaj do t’i duhej të jetonte me një person nga Hajberi, me të cilin kishin luftuar për vite me radhë dhe që kishte qendër e shumë mizorive. Ajo iu përgjigj:

“Pashë një çifute.”

Në mënyrë që në të ardhmen të shmangte probleme të ngjashme, të cilat buronin nga e shkuara, u pa e nevojshme të mendohej dhe të sillej ndryshe. Cilatdo që të ishin mendimet apo veprimet e një grupi njerëzish, nuk ishte e drejtë që individët të gjykoreshin për shkak të veprimeve dhe qëndrimeve të të tjerëve. Ashtu siç ka në çdo shoqëri njerëz të mirë dhe të virtytshëm, gjithashtu ka edhe njerëz të privuar nga këto vlera. Në fund të fundit, të gjithë ishin pasardhësit e Ademit. Ishte e nevojshme të bëhej një pastrim rrënjësor i paragjykimeve të së shkuarës. Mirësia sjell mirësi dhe butësia zbut në fund edhe zemrat më të ashpra, ashtu siç rimarrin formë gurët nga forca e ujit të rrjedhshëm. Çdo incident ishte një mundësi progresi në gjirin e sahabeve dhe nënave të besimtarëve. Duke iu kthyer Aishes me një ton të dhembshur, i Dërguari i Allahut tha:

“O Aishe mos fol ashtu. Ajo u bë myslimane dhe konvertimi i saj ishte një gjë e mrekullueshme.”<sup>94</sup>

Aishja ishte e veçantë në të gjitha aspektet. Ajo ishte krijuar enkas për të përmbushur këtë mision në shtëpinë e Profetit. Ajo e pa Xhebrailin (a.s.) dy herë dhe ka marrë disa herë përgëzime nga ai me anë të Profetit. Shpallja ka ardhur vetëm në dy forma: ose kur i Dërguari i Zotit ishte vetëm, ose kur ai ishte me Aishen në dhomën e saj.<sup>95</sup> Duke pasur parasysh statusin e të Dërguarit të Zotit dhe faktin se Ai ishte paracaktuar nga Zoti për të publikuar shpalljen, është e mundur që baza e dashurisë së tyre të ishte Hyjnore. Ne nuk duhet të mohojmë rolin e saj në kohën e të Dërguarit të Allahut, ose në periudhën pas vdekjes së Tij. Aishja ishte kaq e paçmuar për të Dërguarin e Zotit, sa që njëherë ka thënë:

“Ka shumë burra që e kanë arritur përsosmërinë shpirtërore, megjithatë asnjë grua përveç Merjemit, bijës së Imranit, dhe gruas së Faraonit, Asijes, nuk arritën dot në këtë gradë. Superioriteti i virtyteve të Aishes me femrat e tjera është si superioriteti i mishit ndaj ushqimeve të tjera.

<sup>93</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/28; Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/116, 117.

<sup>94</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/126; Dhehebi, *sijer*, 2/227.

<sup>95</sup> Buhari, *fedailu sahabe*, 30.

## Aishja brenda shtëpisë

Shtëpia e lumturisë ishte një vend i qetësisë dhe i dashurisë së ndërsjellë. Në këtë shtëpi, ka pasur një lidhje të fuqishme ngritur mbi themelet e sakrificës. Marrëdhëniet nuk ekzistonin vetëm në kontekstin e të tashmes dhe të së ardhmes, por merrnin në konsideratë udhëtimin drejt jetës së përjetshme.

Në shtëpinë e saj, Aishja sakrifikoi veten për të përmbushur çdo dëshirë të të Dërguarit të Zotit paqja qoftë mbi Të. Bindja e saj ishte bindje absolute; ajo ishte e kënaqur vetëm në përmbushjen e dëshirave të Tij, dhe në të njëjtën kohë, u përpoq të parashikonte ndjenjat e Tij para se Ai t'i shfaqte ato. Ajo vazhdoi të bëjë këtë edhe pas vdekjes së Tij, deri në frymën e saj të fundit. Aishja vlerësonte çdo hap të saj para se ajo ta ndërmernte dhe merrte vendime në bazë të asaj që ajo e dinte prej Tij. Një ditë ajo i bleu një jastëk Profetit për t'u ulur në të. Megjithatë, ajo nuk e dinte mendimin e Tij për pikturat dekorative ose ndoshta piktura në jastëk nuk ia kishte tërhequr asaj vëmendjen. Por gjithçka që ndodhi kishte një qëllim. Nëpërmjet këtij keqkuptimi, u zbulua një fakt i panjohur, duke bërë që të shpreheshin mendimet e Tij mbi këtë çështje. Kur i Dërguari i Allahut mbërriti, Ai qëndroi para derës dhe nuk hyri brenda. Nëna e besimtarëve u shqetësua dhe e pyeti menjëherë:

“O i Dërguari i Zotit! Unë pendohem në Allahun, dhe kërkoj falje nga i Dërguari i Tij, mos kam kryer ndonjë mëkat?”

Toni i zërit të saj tregonte se zemra e saj po drithërohej nga merak. Ajo kishte frikë se mos kishte bërë ndonjë gjë, për të cilën Zoti dhe i Dërguari i Tij ishin kundër. I Dërguari i Zotit tha se Atij nuk i pëlqente jastëku i ri që ajo kishte blerë, dhe shpjegoi:

“Piktorët e këtyre vizatimeve do të dënohen dhe do t'u kërkohej që të sjellin në jetë atë që ata u përpoqën për të krijuar. Engjëjt nuk hyjnë në një shtëpi që ka piktura të tilla (që përshkruajnë qeniet e gjalla).”

Kur ndjenjat e tij u bënë të qarta, Aishja e hoqi jastëkun e pikturuar që pengonte engjëjt të hynin në shtëpinë e tyre.

Aishja i bënte vetë punët e shtëpisë. Me mundime dhe vuajtje, ajo bluante miell me dorë për të gatuar ushqimin e saj. Ajo rregullonte të gjithë çarçafët dhe jastëkët dhe përgatiste vetë ujin për abdesin e Profetit. Aishja thurte litarin që përdorej për devetë e Tij të kurbanit, pastronte rrobat e Tij, i krihte flokët dhe e spërkaste ndonjëherë atë me ndonjë erë aromatike. Ajo zbuste dhe përgatiste misvakun, me të cilën i Dërguari i Allahut pastronte dhëmbët.

Ajo priti mysafirët, duke u përpjekur që t'i plotësonte të gjitha nevojat e tyre, e njëkohësisht të kënaqte edhe të Dërguarin e Zotit. Një ditë, i Dërguari i Zotit mori disa nga njerëzit e Sufes<sup>96</sup> në shtëpinë e Aishes, në shtëpinë e lumturisë. Pastaj ai e pyeti Aishen:

“O Aishe përse nuk na jep ndonjë gjë për të ngrënë?”

E vetmja gjë e gatuar në shtëpi ishte nga bima *hashisha* dhe ajo ua ofroi atë vizitorëve. I Dërguari i Allahut i tha përsëri:

“O Aishe na sill ndonjë gjë tjetër.”

Kënaqja e vizitorëve do të thoshte kënaqja e të Dërguarit të Zotit, dhe kënaqja e të Dërguarit të Zotit do të thoshte të kënaqje Allahun. Si mund të mos e bënte ajo çfarëdo që i kërkonte i Dërguari i Zotit? Por kjo ishte si të përpiqeshe për të krijuar një ushqim nga hiçi. Së fundi ajo bëri një gjellë me përzierje gjize, hurme dhe gjalpi. Kur njerëzit e Sufes e shuan sadopak urinë, i Dërguari i Zotit i tha:

---

<sup>96</sup> Njerëzit që rrinin në paradhomën e xhamisë së Profetit, të cilët ia kishin kushtuar jetën e tyre adhurimit dhe dijes fetare.

“O Aishe na jep ndonjë gjë për të pirë.”

Aishja solli qumësht për vizitorët në një tas të madh. Por ishte e qartë se nuk kishte mjaftueshëm për të gjithë. Atëherë, i Dërguari i Allahut kërkoi ca qumësht më shumë. Ishte vetëm një sasi e vogël e mbetur, dhe do të ishte e çuditshme, nëse ajo do ta shërbente atë në një tas të madh, kështu që e shërbeu atë në një tas të vogël për vizitorët.<sup>97</sup> Aishja vinte nga një shtëpi e tillë, ku ajo e dinte shumë mirë se duke i dhënë atë pak që ke dikujt për hir të Zotit, ky do të ishte një shkak për shpërblim të përjetshëm, saora ajo veptoi në përputhje me këtë porosi.

I Dërguari i Zotit i bashkohej jetës shoqërore të anëtarëve të familjes së Tij dhe kujdesej për argëtimin e tyre. Ai merrte pjesë në aktivitete sociale. Herë pas here, ai nxiste garat në mesin e njerëzve. I Dërguari i Zotit ishte bashkëshorti dhe babai ideal. Një ditë, Aishja po i rrëfente diçka të Dërguarit të Zotit dhe ajo përdori fjalën *hurafe*, që ka kuptimin e blasfemisë. Ai e pyeti:

“A e di ti kuptimin e fjalës *hurafe*?”

Por Ai e dinte se ajo nuk ia kishte idenë, andaj vazhdoi ta shpjegonte pa e pritur përgjigjen e saj:

“Hurafe ishte një njeri nga komuniteti Uzra. Ai u rrëmbye nga xhindët gjatë periudhës së injorancës. Ai qëndroi me ta për një kohë të gjatë dhe një ditë ata e liruan. Ai nisi të shpjegonte gjërat e çuditshme të cilat i kishte parë kur kishte qëndruar me xhindtë, ndaj njerëzit, të cilët i dëgjonin historitë e tij dhe filluan t’i quanin ato ‘fjalët e Hurafes.’”<sup>98</sup>

Pak ditë para se të ndërronte jetë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), filloi t’i dhembte koka. Ai e dinte se së shpejti do ta linte këtë botë. Ai filloi të kërkonte falje për të gjithë ata që kishte takuar, jo vetëm për ata që ishin gjallë, por edhe për shokët që kishin ndërruar jetë kohë më parë. Duke vizituar varret e tyre nëpër varreza, Ai kthehej me shpresën se do t’i takonte ata të nesërmen. Një ditë, edhe Aishes nisi t’i dhembte koka, andaj dhe ofshau “Oh, mjerë koka ime!” I Dërguari i Zotit iu përgjigj: “Përse po ofshan ashtu?” me të cilën donte të thoshte se “krahësuar me dhimbjen time, e jotja nuk është asgjë.”

I Dërguari i Zotit po thoshte të vërtetën. Më pas vijoi:

“Çfarë fitimi do kishe sikur të vdisje përpara meje. Unë do të të laja, do të të mbuloja me qefin, do të të falja xhenazen dhe do të të fusja në varr.”

Me të dëgjuar këto fjalë të papritura, ajo i hapi sytë katër. A thua ai e kishte me shaka apo po shprehte një të vërtetë? Duke vërejtur se qëndrimi i Tij ishte i butë dhe plot mëshirë, ajo e kuptoi se Ai po e ngacmonte. Kështu edhe ajo e ngacmoi duke i thënë:

“Po, unë duhet të vdes në mënyrë që kur ta kesh kryer varrimin tim, të mund të bësh çfarë të duash me gratë e tjera, pasi unë të kem shkuar, apo jo?”<sup>99</sup>

Fjalët e saj e bënë të Dërguarin e Allahut të buzëqeshte, sepse përcollën tek Ai gjithë thellësinë e dashurisë së saj.

Aishja nganjëherë ndodhte të ndjehej e pikëlluar. Në një ditë të tillë, babai i saj Ebu Bekri erdhi në dhomën e saj. Ajo ishte e çuditshme dhe fliste me zë të lartë. Megjithëse Ebu Bekri e konsideronte Aishen si nënë të besimtarëve që nga koha kur e kishte fejuar me të Dërguarin e Allahut, ai nuk mund ta toleronte asgjë, e cila mund ta lëndonte të Dërguarin e Allahut. Sapo e vërejtë gjendjen e saj, e mori mënjanë dhe e qortoi;

<sup>97</sup> Ebu Davud, *edeb*, 103; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/426.

<sup>98</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/157.

<sup>99</sup> Buhari, *merda*, 16.

“O bijë, si mund të flasësh ashtu me zë të lartë në prani të të Dërguarit të Allahut?”

Ndërkohë që Ebu Bekri fliste, ai ngrinte dorën për të treguar se ajo duhet t'i duronte fjalët që ai po i thoshte. Ai e ndjente se kishte të drejtën ta qortonte atë meqenëse ishte vajza e tij. Për Ebu Bekrin, asgjë nuk mund ta lëndonte më shumë sesa vajza e tij t'i shkaktonte trishtim të Dërguarit të Zotit. Pastaj Ebu Bekri e kuptoi se i Dërguari i Zotit e kishte dëgjuar qortimin e tij, dhe ndjeu turp për këtë ndërhyrje në çështjet private brenda shtëpisë së Profetit. Ai e dinte se kishte gabuar, por e ndjente se e kishte bërë këtë për të parandaluar diçka më të keqe. Megjithatë, zemërimi që ai ndjente ndaj Aishes nuk u zbut - si mundej ajo të bisedonte me të Dërguarin e Zotit me një ton të tillë? Ai ishte i zemëruar, por prania e të Dërguarit të Zotit e pengoi të thoshte ndonjë gjë tjetër. Ai e nxori përfundimin e mësipërm nga qëndrimi Profetit dhe u largua në heshtje.

Pas largimit të tij, i Dërguari i Zotit shkoi tek Aishja e cila ndihej e turpëruar. Babai i saj i kishte thënë të vërtetën, askush nuk duhet të ngrinte zërin në prani të të Dërguarit të Zotit. Ajo e shikoi atë me siklet.

Kjo ishte koha për t'i dhënë me të mirë fund atij momenti. Meqë gabimi ishte kuptuar, i Dërguari i Zotit bëri një hap për ta kthyer mërzinë në shaka. Duke treguar vendin ku kishte qëndruar Ebu Bekri së fundmi, Ai tha:

“E pe se si ndërhyra mes teje dhe atij njeriu, dhe si të shpëtova prej zemërimit të tij?”<sup>100</sup>

Atë ditë, Ebu Bekri u largua plot trishtim, por kur erdhi përsëri pak kohë më vonë, ai pa një situatë krejtësisht të ndryshme. I Dërguari i Zotit dhe Aishja e mirëpritën atë me buzëqeshje në fytyra. Gjendja e mëparshme kishte qenë e përkohshme dhe kishte lënë pas vetëm gaz. Ebu Bekri ishte mjeshtër në të shprehur dhe e kuptonte se gjendja ishte e zbutur, por ai dëshironte ta dëgjonte atë prej tyre. Me një buzëqeshje në fytyrë, ai tha:

“Pse të mos i ndani edhe kënaqësitë tuaja me mua, ashtu siç ndani problemet tuaja?”<sup>101</sup>

Nganjëherë kishte edhe mosmarrëveshje mes bashkëshorteve të të Dërguarit të Allahut, të cilat Ai i zgjidhte me humor. Por nganjëherë sherret me fjalë rrezikonin të përfundonin me ndërhyrje fizike. Një ditë, Aishja kishte gatuar një gjellë me miell dhe qumësht dhe ia ofroi atë të Dërguarit të Zotit, ndërsa Seudeja ishte ulur pranë Tij. Por Seudeja nuk dëshironte ta hante ushqimin e saj. Aishja e kërcënoi:

“A do ta hash atë gjellë apo të ta hedh turinjve?”

Seudeja refuzoi sërish të hante, ndoshta sepse ato ishin pak a shumë të një moshe. Ky ishte një rast i artë për ta kthyer kërcënimin në shaka. Kështu Aishja e bëri të vetën, duke e hedhur ca ushqim në fytyrën e Seudes.

Kjo gjë e bëri të Dërguarin e Allahut të qeshte. Pastaj, Ai, i cili përpiqej përherë të shuante mosmarrëveshjet mes grave të Tij, e përdori këtë skenë si pretekst për solidarizim. Ai mori ca ushqim në dorë dhe duke ia dhënë Seudes, i tha:

“Përse nuk ia bën edhe ti të njëjtën gjë asaj?”

Kështu edhe Seudeja ia hodhi ushqimin Aishes në fytyrë, gjë e cila i bëri të gjithë të qeshnin.

Përfundimata ata dëgjuan zërin e lartë të Omerit, i cili thërriste të birin:

“O Abdullah! O Abdullah!”

<sup>100</sup> Ebu Davud, *edeb*, 92; Nesai, *Sunenu'l Kubra*, 5/139.

<sup>101</sup> Po aty.



Meqenëse Omeri ishte afër, ai nuk do të linte pa vizituar Profetin. Meqë i Dërguari i Allahut mendoi se ai mund të vinte brenda, u tha grave:

“Tani, shkoni dhe lani fytyrat.”

Edhe pse kjo kishte qenë një shaka, ajo kishte ndodhur në intimitetin e familjes së tyre dhe nuk duhet të ndahej me askënd tjetër, madje as me Omerin, i cili kishte një vend të veçantë në zemrën e të Dërguarit të Zotit. Aishja e rikujton ngjarjen e mësipërme duke nënvizuar:

“Pasi pashë qëndrimin e të Dërguarit të Allahut ndaj Omerit, edhe unë nisa ta trajtoj me shumë respekt Omerin.”<sup>102</sup>

Ka pasur edhe raste kur i Dërguari i Zotit ishte i zemëruar dhe nganjëherë, arsyeja për zemërimin e tij ishte vetë Aishja. Një ditë Ai erdhi në shtëpi me një rob që e la në dhomën Aishes. Në atë moment aty kishte edhe gra të tjera duke e vizituar dhe duke folur me Aishen. Meqenëse muhabeti u trash me kalimin e kohës, ato e harruan robin dhe ai gjeti rastin e iku.

Pak më vonë, i Dërguari i Zotit u kthye dhe pa se rob i ishte zhdukur. Ai u zemërua shumë. Lirimi i skllevërve ishte një gjë normale për të, dhe Ai ndoshta kishte planifikuar për ta lënë këtë njeri të lirë, si edhe të tjerët, por korrektesa ishte e rëndësishme. Duke iu drejtuar Aishes ai tha:

“O Aishe! Çfarë i ka ndodhur robit? Ku është ai?”

Aishja nuk dinte ç’të thoshte. Me keqardhje të madhe ajo i tha:

“Më iku kur po bisedoja me shoqet.”

Meqenëse nuk kishin shans ta kapnin përsëri robin, i Dërguari i Allahut i tha:

“Turp të kesh, t’u thafshin duart!”

Zemërimi i të Dërguarit të Allahut ishte i mjaftueshëm për ta bërë Aishen të tronditej. Ajo e dinte se duhet të kishte qenë më e kujdesshme në atë që i kishte qenë besuar asaj, pa marrë parasysh rrethanat. Pastaj i Dërguari i Zotit u largua dhe filloi të kërkonte ndër njerëz për të gjetur robin. Ai u gjet dhe iu soll të Dërguarit të Zotit. Problemi u zgjidh. Pak më vonë, i Dërguari i Zotit u kthye në shtëpi. Aishja rrinte duke vështuar duart e saj të kthyera përmbys dhe pastaj rrotullonte pëllëmbët lart e poshtë pa pushim. Kur i Dërguari i Allahut e pa Aishen në atë gjendje, e pyeti:

“Çfarë ke? Ke nevojë të marrësh abdes?”

“Ti më mallkove, dhe unë po pres të shoh se cila dorë do të më thahet.”

Kjo i ngjante kthimit të një fëmije tek nëna e tij, pasi ai dënohej prej saj. Ajo ishte edhe e frikësuar nga mallkimi i Tij, por në të njëjtën kohë, me shpresën se ky mallkim do t’i kthehej në një lutje për veten. I Dërguari i Zotit ngriti duart drejt qiellit dhe pas shumë frazave që lartësonin Allahun, shtoi:

“O Zoti im! Unë jam njeri dhe si të gjithë njerëzit zemërohem. Për cilindo besimtar, burrë apo grua, që kam mallkuar, të lutem konsiderojë mallkimin tim si një arsye për ta që të pastrohen nga mëkatet e tyre materiale dhe shpirtërore.”<sup>103</sup>

Si në çdo familje, edhe në familjen e tyre kishte moment kur Aishja ishte e pakënaqur apo kur i Dërguari i Allahut ishte i zemëruar. I Dërguari i Allahut e kuptonte kur ajo nuk ishte në qejf dhe ndërhynte menjëherë që ta zbuste situatën. Një ditë Ai i tha:

<sup>102</sup> Ebu Jala, *Musned*, 3/449; Taberani, *Mu’xhemul Kebir*, 7/158.

<sup>103</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/52.

“Ti e kupton menjëherë kur unë jam i kënaqur apo i zemëruar me ty, ashtu siç unë e kuptoj menjëherë kur ti je e kënaqur apo e zemëruar me mua.”

Aishja u habit dhe i tha:

“E si e kupton?”

I Dërguari i Allahut tha:

“Kur ti përdor shprehjen ‘betohem në Zotin e Muhamedit’ je e kënaqur me mua, ndërsa kur thua ‘betohem në zotin e Ibrahimit’, je e zemëruar me mua.”

Aishja u përgjigj:

“Kjo është e vërtetë. O i Dërguari i Allahut, Ti po thua të vërtetën. Betohem në Allah, se që sot e tutje nuk do të zë në gojë asnjë emër tjetër përveç emrit Tënd.”<sup>104</sup>

Një ditë, njëmbëdhjetë gra u ulën dhe i premtuan njëra-tjetrës se do t'i tregonin shoqja-shoqes mendimin e tyre të vërtetë për burrat e tyre. Secila prej tyre shprehte me radhë fillimisht cilësinë më të mirë të burrit të saj. Disa i lavdëronin burrat, ndërsa disa të tjera rendisnin veset e tyre. Aishja i dëgjonte me vëmendje, herë duke buzëqeshur, e herë duke ndjerë keqardhje. Kur erdhi radha e Umu Dherit, ajo shpjegoi se kishte qenë e bija e një çobani në kohën kur ishte martuar me Ebu Dherin. Ajo tha se ai kishte bërë shumë të mira ndaj saj dhe se ajo kishte shijuar çdo lloj kënaqësie me të. Ajo renditi gjithashtu një listë me të mirat e vjehrrës së saj, si dhe të djalit, të cilin Ebu Dheri e kishte pasur me gruan e parë si dhe të vajzës së tij. Por bashkëshorti i saj ishte divorcuar prej saj dhe ajo ishte martuar me një tjetër njeri. Burri i saj i ri ishte i mirë dhe bujar, por mirësia dhe bujaria e tij nuk kishin të krahasuar me ato të Ebu Dherit. Megjithëse Ebu Dheri ishte ndarë prej saj, ajo ende nuk arrinte ta harronte se dashamirësia e burrit të saj të ri nuk kishte të krahasuar me atë të Ebu Dherit.

Megjithëse edhe gratë e tjera rrëfyn historitë e tyre, ato çfarë tha Umu Dheri, e goditën Aishen dhe ajo më vonë e hapi këtë bisedë me të Dërguarin e Zotit. I Dërguari i Zotit u kthye nga Aishja dhe i tha:

“E shikon, ti dhe unë jemi si Ebu Dheri dhe Umu Dheri, por me një ndryshim, ai është divorcuar nga gruaja e tij, por unë nuk do ta bëj këtë.”

Ky ishte një përgëzim që i dha flatra Aishes, e sakaq ajo tha:

“Të qofshin fli nëna dhe babai im. Ti je më i mirë për mua se Ebu Dheri.”<sup>105</sup>

## Zbavitja

I Dërguari i Zotit ka lejuar nivele të moderuara të zbavitjes. Kur ai e pa se Aishja erdhi në shtëpinë e tij pa ndonjë pompozitet apo ceremoni ditën e martesës, Ai e pyeti:

“O Aishe, a nuk ke marrë me vete ndonjë gjë argëtuese? Të gjithë ensarët e pëlqejnë argëtimin.”<sup>106</sup>

Ka pasur raste të caktuara, kur Profeti i lejonte anëtarët e familjes së Tij të luanin disa lojëra. Më vonë Aishja shpjegonte:

---

<sup>104</sup> Buhari, *nikah*, 107.

<sup>105</sup> Buhari, *nikah*, 82.

<sup>106</sup> Buhari, *nikah*, 63.

“Mbaj mend njëherë se Dërguari i Zotit më mbuloi mua me rrobat e Tij dhe më çoi në xhami kur disa etiopas erdhën për të dhënë një shfaqje. Unë i pashë ata derisa u lodha.”<sup>107</sup>

Në festën e Bajramit, një grup njerëzish të veshur me mburoja dhe shtiza erdhën të argëtojnë turmat. Njerëzit u mbledhën për të shikuar, madje edhe Aishja u afrua për të parë se çfarë po ndodhte. Profeti e pyeti:

“A dëshiron vërtet të shohësh?”

Aishja pohoi me kokë.

Kështu, Profeti e ngriti atë përmbi shpatulla, faqet saj prekën faqet e tij, dhe i Dërguari i Allahut thirri:

“Jepi, o Beni Arfida!”

Pasi kaloi ca kohë, Profeti e pyeti:

“A u kënaqe?”

Aishja ishte lodhur dhe u përgjigj: “Po.”

Pastaj, i Dërguari i Allahut i tha:

“Tani mund të shkosh.”<sup>108</sup>

Megjithatë, është e vërtetë edhe se i Dërguari i Allahut gjithashtu ndërhynte kur kaloheshin kufijtë dhe e mbante argëtimin brenda kufijve të lejuar. Një ditë, një muzikante femër erdhi të luante te Aishja. Profeti e pyeti:

“Aishe, a e njeh atë?”

Aishja e vërejti gruan e panjohur dhe iu përgjigj në mënyrë mohuese.

Ai i shpjegoi se ajo ishte një muzikante nga një fis i caktuar, dhe shtoi:

“A dëshiron që ajo të luajë ndonjë pjesë për ty?”

Natyrisht, ajo pranoi meqenëse askush nuk i thoshte dot jo të Dërguarit të Allahut.

Pasi mori instrumentin e saj, gruaja nisi të luante muzikë dhe Aishja ndërkohë vërejti shenja pakënaqësie në fytyrën e Profetit. Aishja e kishte vërejtur edhe më parë këtë çehre të Tij njëherë, kur njëherë i Dërguari i Allahut kishte gjetur dy vajza duke vallëzuar në dhomën e Aishes. Kur njerëzit nisën të dilnin nga normat e lejuara, erdhi paralajmërimi. Atë ditë, si zëri ashtu edhe qëndrimi i muzikantes nuk përputhej me seriozitetin e besimit. Menjëherë, i Dërguari i Allahut u kthye nga Aishja dhe i tha:

“Djalli ka hyrë në zërin e kësaj gruaje.”<sup>109</sup>

## Gara

I Dërguari i Zotit i kishte gjithmonë parasysht njerëzit që e rrethonin, dhe hapat në trajtimin e tyre i ndërmernte posaçërisht sipas gjendjes së tyre. Ky ishte qëndrimi i Tij i përgjithshëm dhe ai e këshilloi umetin e tij të bënte të njëjtën gjë:

“Ecni me të njëjtin hap me më të dobëtin mes jush.”<sup>110</sup>

---

<sup>107</sup> Buhari, *ijdaïn*, 2.

<sup>108</sup> Po aty.

<sup>109</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/449; Taberani, *Mu'xhemul Kebir*, 7/158.

<sup>110</sup> Axhluni, *keshfu'l hafa*, 2/503.

Ai ishte një person i moderuar dhe e dinte se si duhej të vepronte në çdo mjedis. Si profet, Ai ishte i zënë me punët më të ndjeshme dhe përpiquej të kryente detyrën e Tij me kujdes. Ai megjithatë nuk mund ta kishte edhe familjen me standardet e Tij të ndjeshmërisë. Si njerëz të zakonshëm, ata do ta kishin pasur të pamundur të duronin këtë jetë. Dhe Ai ishte aty që t'ua bënte jetën më të lehtë.

Njëherë, gjatë një ekspedite ushtarake, Aishja ishte së bashku me të Dërguarin e Allahut. Në një çast të caktuar të udhëtimit, i Dërguari i Zotit i tha ushtrisë e Tij të vazhdonin rrugën, ndërsa Ai qëndroi prapa me Aishen.

Pastaj i Dërguari i Zotit i tha asaj.

“Hajde të bëjmë një garë.”

Aishja ishte e re në moshë dhe natyrisht më e shkathët, kështu që garën e fitoi ajo. Vite më vonë, ata ishin përsëri në një udhëtim tjetër së bashku. Koha që kishte kaluar e kishte bërë Aishen ta harronte garën e tyre të mëparshme. Por, Profeti nuk e kishte harruar, dhe përsëri u tha të tjerëve që të vazhdonin rrugën, ndërsa Ai qëndroi prapa me Aishen. Ai i tha:

“Hajde të bëjmë një garë.”

Ashtu si herën e parë, Aishja e pranoi sfidën. Ata filluan të garojnë përsëri, por këtë herë, i Dërguari i Zotit fitoi. Aishja kishte shtuar në peshë dhe kishte humbur ca nga shpejtësia e saj e mëparshme. I Dërguari i Allahut iu drejtua Aishes me një buzëqeshje dhe i tha:

“Ky ishte revanshi i garës sonë të mëparshme!”<sup>111</sup>

### **Kërkesa për një emër të ri**

Një ditë, Aishja kërkoi nga i Dërguari i Zotit t'i vinte asaj një nofkë të re. Njerëzit e rritur në shoqërinë arabe nuk thirreshin me emrin e tyre të lindjes, por emërtoheshin në raport me dikë tjetër. Kjo ishte një praktikë e zakonshme dhe një shenjë e rëndësishme e gradës dhe e nderit. Ka pasur një lloj konkurrence mes njerëzve në drejtim të emrave të tyre. Disa njerëz bëheshin kaq të njohur me nofkat e tyre, sa që njerëzit i kishin harruar emrat e tyre të vërtetë. Në përgjithësi këta emra vireshin në lidhje me fëmijën e tyre të parë të lindur; një baba bëhej Ebu Filani; një nënë bëhej Umu Filanja në emër të së bijës. Personat pa fëmijë thirreshin Ibni Filani (i biri i filanit) apo Binti Filania (e bija e filanes) në varësi të faktit nëse ishin meshkuj apo femra.

I Dërguari i Allahut e thërriste Aishen me shumë emra si Humejra, Uvejsh, Aish, Binti Siddik, Muvaffika si dhe Bintu Ebu Bekr. Por asnjëri syresh nuk arriti të mbetej një nofkë e përhershme. Meqenëse të gjithë personat që njihje e kishin nga një nofkë, Aishja pretendonte ta kishte edhe ajo një të tillë. E mërzitur tha:

“O i Dërguari i Allahut, të gjitha shoqet e mia kanë pseudonime!”

Edhe pse kjo ishte gjithçka ajo tha, i Dërguari i Zotit e kuptoi kërkesën e saj të sjellshme si kërkesë për një nofkë vetjake. Me shumë gjasa, kjo ishte një mënyrë delikate për të kërkuar diçka. Ndoshta Aishja ishte duke kërkuar për një fëmijë, i cili do ta bënte atë automatikisht me një nofkë të re, që do të ishte edhe trashëgimtari i të Dërguarin e Allahut paqja qoftë mbi Të.

Por ndoshta Profeti e kishte mbyllur përvojën e tij prindërore dhe nuk ishte e shkruar të kishte një pasardhës tjetër. Të tre djemtë e Tij kishin vdekur qysh foshnje dhe tri nga katër vajzat e Tij do

---

<sup>111</sup> Ebu Davud, *xhihad*, 68; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/39.

të vdisnin përpara se ai të ndërronte jetë - Rukija kishte vdekur gjatë Luftës së Bedrit dhe as Umu Kulthumi e as Zejnebi nuk do të jetonin pas Tij.

Një person i mprehtë dhe i mençur si i Dërguari i Allahut, nxori një konkluzion nga të gjitha këto; ndoshta Allahu nuk dëshironte që fëmijët e Tij të ishin gjallë pas vdekjes së Tij.

Kjo duhej t'i shpjegohej Aishes në një mënyrë sa më të këndshme dhe sa më delikate. Ai zgjodhi një përgjigje e cila as të mos e mërziste Aishen ,e as të mos i bënte bisht pyetjes:

“Atëherë ti duhet të mbash nofkën e emrit të djalit të motrës sate, Abdullahut.”

Fjalët e Tij ndoshta kishin kuptimin ‘Kjo është një rrugë e mbyllur për ty.’ Aishja e mprehtë, e kuptoi menjëherë dhe nuk e bëri kurrë më një kërkesë të tillë. Që nga ajo ditë, Aishja u quajt me nofkën e emrit të djalit të motrës, Abdullah ibni Zubejrit, pra u thirr Umu Abdullah.<sup>112</sup>

### Ndjeshmëria

I Dërguari i Allahut u dërgua për të përsosur moralin e mbarë njerëzimit. Gratë e Tij u ndikuan më së shumti nga udhëzimet e Tij morale. Si dëshmitare të gjithë porosive dhe deklaratave të Tij, si dhe të të gjitha veprimeve dhe sjelljeve të Tij, ato e mësuan sjelljen të mirë të Tij dhe e ndanë atë edhe me të tjerët. Ato fituan dituri të reja dhe mësuan një rrugë të përdorur më parë për moralin e lartë. Çdo person i cili erdhi në shtëpinë e lumturisë, çdo dhuratë që u soll aty, ose çdo ngjarje që ka ndodhur rezultoi në gjykimin fisnik të të Dërguarit të Allahut, përfaqësuesit të moralit të Kuranit.

Një natë, Aishja kishte pjekur një simite e vogël elbi për Profetin. Por Ai, me të ardhur, e mbylli derën, gjë që do të thoshte se donte të pushonte. Ai gjithmonë mbulonte pjesën e sipërme të enës së ujit, dhe gjithashtu mbulonte ndonjë tas me ushqim si dhe fikte ndonjë kandil që mund të kishte ngelur i pashuar.

Ndërsa ai po flinte, Aishes i erdhi gjumë. Pastaj i Dërguari i Zotit ndjeu pak të ftohtë dhe iu afrua Aishes që të ngrohej, duke vendosur kokën në prehrin e saj dhe sakaq ra përsëri në gjumë.

Ndërkohë, një dele që i takonte fqinjit të tyre hyri brenda në dhomë dhe mori simiten prej elbi. Aishja u përpoq të trembte delen që nga vendi ku ishte ulur, por kjo nuk funksionoi. Lëvizja e saj e zgjoi Profetin, kështu që Aishja kërceu dhe filloi të rendte pas deles. Duke e parë këtë skenë, i Dërguari i Zotit i thirri asaj nga pas:

“Nëse e kap, merr vetëm simiten dhe mos e shqetëso fqinjin për atë që bëri delja!”<sup>113</sup>

Në ato kohë, shumë veta e hanin mishin e hardhucës, mishi i së cilës nuk i pëlqente aspak të Dërguarit të Zotit, ndoshta për shkak të vetë natyrës. Megjithatë, ngrënia e hardhucave ishte hallall, dhe Ai ua bëri të qartë shokëve të tij se ajo ishte e lejueshme për t'u ngrënë.<sup>114</sup> Një ditë, në shtëpinë e tyre sollën mish hardhuce, të cilin Profeti nuk e hëngri. Aishja e pyeti:

“A t'ua jap nevojtarëve?”

Qëllimi i saj ishte i sinqertë; të tjerët mund të hanin atë që atyre nuk u pëlqente që ta hanin, pasi nuk kishte asnjë shpallje që ndalonte konsumin e këtij mishi. Por i Dërguari i Zotit nuk ndante të njëjtin mendim me Aishen, sepse ai mendonte rreth aspekteve që Aishja nuk i merrte parasysh. Ai e ndjeu se mund të diskriminonte të tjerët nëse merrej vesh se Ai nuk e hante këtë lloj mishi, e nëse

<sup>112</sup> Ebu Davud, *edeb*, 78; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/260.

<sup>113</sup> Buhari, *el-Edebul Mufred*, 1/54.

<sup>114</sup> Buhari, *temenni*, 15; Muslim, *sajid*, 42.

kjo merrej vesh, njerëzit e tjerë nuk do ta përdornin më. Ai kështu do t'i jepte mish dikujt tjetër vetëm sepse Ai nuk donte ta hante. Sakaq, Ai u kthye nga Aishja dhe i tha:

"Jo, mos ia jep kurrë të tjerëve gjërat që nuk i ha për vete."<sup>115</sup>

### **Adhurimi i saj**

Aishja bëri një jetë shembullore në çdo aspekt. Ajo ishte në kulmin e shërbimit të saj ndaj Zotit. Aishja ishte e qëndrueshme në adhurime si gjatë jetës së të Dërguarit të Zotit, ashtu edhe pas vdekjes së Tij. Ajo e shihte të Dërguarin e Allahut si një njeri që e donte adhurimin, i Cili i shërbeu Allahut me vullnetin e një të pasionuari. Aishja ka kaluar kohën më të frytshme të jetës së saj me personin i cili ishte i afërt me Zotin, një njeri i cili ka arritur lartësi të reja në njohuritë rreth Allahut, dhe i cili ishte robi më i dashur i Tij. Ai lutej gjatë natës derisa këmbët i ënjteshin - gjatë vetëm një rekati, Ai qëndronte mjaftueshëm në këmbë sa për të recituar me qindra faqe të Kuranit. Rukutë dhe sexhdet e Tij në namaz ishin po aq të gjata sa qëndrimi i tij në këmbë. Aishja ka thënë njëherë:

"As ju nuk mund të më pyesni, e as nuk jam në gjendje t'ju shpjegoj bukurinë e namazeve të Tij."<sup>116</sup>

Aishja ishte dëshmitare e qindra e mijëra mrekullive; ajo madje e pa me sytë e saj shpalljen e Kuranit, kur engjëlli Xhebrail (a.s.) dhe i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të u takuan së bashku. Ajo e konsideronte jetën e kësaj bote si hijen e një peme nën të cilën njerëzit ulen të pushojnë pak dhe pastaj ngrihen të vazhdojnë rrugën. Ajo ia përkushtoi jetën e kësaj bote vetëm jetës së përtejme. Bota dhe gjithçka që ekzistonte në të nuk kishte asnjë vlerë në sytë e saj, sepse i Dërguari i Zotit e kishte mësuar atë që të vlerësonte më së shumti botën tjetër. Gjatë nëntë viteve që ka jetuar me të Dërguarin e Allahut, Aishja e ndoqi shembullin e Tij dhe u përpoq ta vërë atë në praktikë.

Një natë, Profeti shkoi në dhomën e Tij pasi kishte përfunduar namazin e natës, lau dhëmbët dhe shkoi në shtrat. Në mesnatë, Ai u ngrit për të falur namazin e tehexhudit, i cila ishte i detyrueshëm vetëm për Të. Pasi kaluan dy të tretat e natës, Ai e zgjoi Aishen dhe i kërkoi të falej. Aishja gjithashtu u ngrit dhe fali tehexhudin, ndjekur më pas nga namazi i vitrit."<sup>117</sup>

Nganjëherë, Aishja i bashkohej të Dërguarit të Zotit dhe falej me Të, gjatë gjithë natës deri në agim. Në një natë të tillë, i Dërguari i Allahut recitoi suret Bekare, Al Imran, dhe Nisa në vetëm një rekat të vetëm. Kur lexonte ndonjë ajet që të bënte të dridheshe nga frika, Ai lutej për të gjetur strehim nga zemërimi i Allahut, dhe kur recitonte ndonjë ajet me lajme të mira, ai kthehej përsëri nga Allahu dhe kërkonte mëshirë.<sup>118</sup>

Para namazit të sabahut, i Dërguari i Zotit falte një namaz të shkurtër dy-rekatësh dhe flinte në anën e djathtë nëse kishte nevojë për pushim, ose bisedonte me Aishen derisa muezini thërriste për t'u falur. Aishja e ndiqte namazin me xhemat që nga dhoma e saj në afërsi të xhamisë. Në thelb, netët e saj ishin më të ndritshme sesa ditët.

Aishja i bashkohej shpesh të Dërguarit të Allahut edhe në agjërime. I Dërguari i Allahut i kalonte dhjetë ditët e fundit të Ramazanit në itikaf në xhami dhe Aishja bashkohej në namazet e Tij që nga

---

<sup>115</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/123; Bejhëkiu, *Sunen*, 9/325.

<sup>116</sup> Buhari, *tehexhud*, 16; *menakib*, 21.

<sup>117</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/55.

<sup>118</sup> Po aty, 6/92.

dhoma e saj. Ndonjëherë, Ai vendoste një çadër brenda në xhami dhe pasi udhëhiqte namazin me xhemat, vazhdonte izolimin e Tij brenda çadrës.<sup>119</sup>

Në Haxhin e Lamtumirës, Aishja ishte me Të dhe pa një turmë të madhe, ku i Dërguari i Zotit po i jepte lamtumirën popullit të Tij. Gjatë haxhit, Ai u sëmur rëndë, dhe kështu umeti i Tij mësoi se si mund të kryeshin ritet e pelegrinazhit edhe duke qenë të sëmurë.<sup>120</sup>

Duke mësuar drejtpërdrejt nga rob i dashur i Zotit se si ta adhuronte Allahun, Aishja i dinte, i shpjegonte dhe vazhdoi t'i kryente të gjitha adhurimet e rekomanduara.

Një ditë, Aishja e mori afër Abdullah ibni Kaksin dhe i tha:

“Mos ngurro që të ngrihesh natën dhe të falesh. I Dërguari i Allahut asnjëherë nuk e braktiste namazin e natës. Kur ishte i sëmurë, ose shumë i lodhur, ndodhte që Ai të falej edhe ulur, por kurrë nuk e braktisi atë.”<sup>121</sup>

Edhe për namazet jo të detyrueshme, Aishja mërzohej nëse nuk arrinte t'i kryente ato në kohë. Pasi e pa të Dërguarin e Zotit që falte namazin e duhasë, që nga ajo ditë ajo e konsideroi atë si farz, dhe nuk e la asnjëherë pa falur.<sup>122</sup>

Një mëngjes, shumë herët, nipi i Aishes së nderuar, Kasim ibni Muhamedi erdhi në shtëpinë e saj, ndërsa ajo ishte duke u falur. Nuk kishte ardhur ende koha për namazin e sabahut, ndërsa koha për namazin e jacisë kishte kaluar. Ai e pyeti:

“Çfarë namazi është ky?”

Me qëndrimin e atij që parapëlqen t'i fshehë veprat e Tij të mira, ajo iu përgjigj me gjysmë zëri:

“Kam lënë pa falur mbrëmë namazin dhe jam duke falur një namaz nafile.”

Abdullah ibni Ebu Musa, erdhi njëherë për ta pyetur atë për pikat kryesore rreth Islamit, ndërsa ajo ishte përsëri duke falur namazin e duhasë. Kur ai i tha: “do të të pres derisa ta kryesh namazin” me një zë paksa të lartë që mund të dëgjohej nga të tjerët, banorët e tjerë të shtëpisë, të cilët ishin mësuar me namazet e saj të gjata thanë:

“I mjeri ti!”<sup>123</sup>

Kjo donte të thoshte se atij i cili kishte ndër mend ta priste Aishen derisa ajo të përfundonte namazin, do t'i duhej të priste goxha gjatë. Kur ajo fillonte të falej, ishte sikur të humbiste lidhjet me botën dhe me gjithçka që kishte të bënte me të, për shkak të përqendrimit të saj të madh ndaj Allahut.

Aishja bënte një jetë tejet të thjeshtë. Ajo falte namazin e natës deri në mëngjes dhe i kalonte të gjitha ditët duke agjëruar. Kur Aishja recitonte ndonjë ajet që përmbante ndonjë paralajmërim ose kërcënim, ajo hezitonte, pastaj shkonte përsëri në fillim dhe e recitonte atë përsëri në mënyrë që ta ndjente më thellë pikëllimin. Njerëzit rreth saj dëshmonin se shama e saj e kokës ndodhte shpesh t'i lagej nga lotët.

Një ditë kur Aishja po recitonte ajetin: “*Dhe Allahu na dhuroi të mira dhe na ruajti prej dënimit të erës (flakës) së nxehtë të zjarrit*”<sup>124</sup>, ajo nuk mundi t'i përmbante lotët dhe filloi të qante me dënësë. Kjo shpjegohej me gjendjen e atyre që e kishin braktisur këtë botë dhe jetonin në paqen e shpëtimit

---

<sup>119</sup> Buhari, *itikaf*, 18.

<sup>120</sup> Buhari, *haxh*, 76.

<sup>121</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/125.

<sup>122</sup> Po aty, 6/138; Nesai, *Sunenul Kubra*, 1/181.

<sup>123</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/125.

<sup>124</sup> Tur, 27.

në botën e përtejme. Por Aishja mbeti përherë e shqetësuar në lidhje se si do të ishte gjendja e saj në jetën e përtejme, dhe kurrë nuk mendonte për veten si përfituese e garantuar e një mëshire të tillë. Kur ajo recitoi ajetin e mësipërm kërkoi strehë në Zotin e saj dhe iu lut:

“O Zot, të lutem më beko mua dhe më mbaj larg nga zjarri i Xhehenemit!”<sup>125</sup>

Nipi dhe njëkohësisht nxënësi i saj, Urveja, i cili e pa këtë skenë ndërsa po priste më kot që ajo të përfundonte namazin, u lodh duke pritur, andaj u largua për të punuar në pazar. Ai tha:

“Kur u ktheva nga pazari pasi mbarova tregtinë time, betohem në Zot se e gjeta prapë duke vazhduar po të njëjtin namaz, ashtu e mbytur.”<sup>126</sup>

Aishja gjithnjë përpiquej që ta falte namazin e saj me xhemat, ose pas Imamit, që nga dhoma e saj, e cila ishte ngjitur me xhaminë, ose duke u falur së bashku me gratë që vinin në dhomën e saj.<sup>127</sup> Të tjera herë, ajo urdhëronte Zekuan, skllaven të saj të shkolluar, që t’i printe në namaz.<sup>128</sup>

Ndjeshmëria e saj në lidhje me agjërimin ishte e vazhdueshme, ajo kaloi pothuajse të gjitha ditët në agjërim.<sup>129</sup> Një vit, në Ditën e Arafatit, ditën para Bajramit të Kurbanit, koha ishte tmerrësisht e nxehtë. Ajo po agjëronte. I vëllai, Abdurrahmani, e vizitoi dhe kur vërejti se ajo po agjëronte pavarësisht të nxehtit, dhe se ajo ishte e lodhur dhe e mbytur në djersë, i shqetësuar, i tha:

“Përse nuk e prish agjërimin?”

Por Aishja e cila synonte të ndiqte rrugën e të Dërguarit të Allahut iu përgjigj:

“Si mund ta prish agjërimin kur kam dëgjuar nga goja e të Dërguarit të Allahut fjalët: ‘*Sigurisht agjërimi i Ditës së Arafatit shlyen mëkatet e vitit të kaluar?*’”<sup>130</sup>

Aishja ka agjëruar edhe gjatë ditëve që ka qëndruar në Mina, edhe pse ngrënia dhe pirja gjatë atyre ditëve ishin të lejuara,<sup>131</sup> ajo kurrë nuk hoqi dorë nga agjërimi i saj edhe gjatë udhëtimeve ku prishja e agjërimit lejohej.<sup>132</sup>

Aishja vetëm njëherë e kishte kryer haxhin bashkë me të Dërguarin e Allahut, në Haxhin e Lamtumirës. Ajo shkonte shpeshherë në Mekë edhe pasi vdekjes së Profetit, si dhe tregoi një ndjeshmëri të lartë në këto pelegrinazhe.

Gjatë viteve të para, Qabeja nuk ishte e mbushur plot. Në vitet e mëvonshme, për shkak të turmës në rritje të besimtarëve, Aishja i bënte tavaf Qabes me shumë kujdes për të shmangur përzierjen me burrat, duke e bërë rrotullimin e saj në një rreth më të gjerë. Kjo i merrte më shumë kohë dhe rriste vështirësitë, por pavarësisht kësaj, ajo shikonte për ndonjë rast për të qenë vetëm aty. Kur ajo shihte që kishte shumë njerëz rreth Qabes, ajo largohej dhe i binte rrotull asaj nga sa më larg, si t’i binte mespërmes malit Sabir.

Aishja ishte tepër e përpiktë edhe në lidhje me umren. Para se ajo të shihte hënën në muajin e Muharremit, ajo shkonte në vendin e quajtur Xhuhfë dhe priste atje deri në daljen e hënës së re. Kur e shihte hënën, Aishja fillonte të përgatitej për umre, duke recituar lutjet dhe pastaj, pa humbur kohë, shkonte në Mekë.<sup>133</sup>

---

<sup>125</sup> Ibni Ebi Shejbe, *Musannef*, 2/25.

<sup>126</sup> Po aty.

<sup>127</sup> Tahmaz, *Sejdatu Aisha*; cituar në Abdur’rezak, *Musannef*, 2/182, 126, 141.

<sup>128</sup> Buhari, *xhemaat*, 26.

<sup>129</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/68.

<sup>130</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/128.

<sup>131</sup> Buhari, *saum*, 67.

<sup>132</sup> Abdur’rezak, *Musannef*, 2/560-561; Bejhekiu, *Sunen*, 4/301.

<sup>133</sup> Po aty.



Kur vinte koha për të çelur agjërimin e ditës së Arafatit, kërkonte vetëm ujë.

### **Thjeshtësia dhe përlësia e saj**

Aishja nuk përzihej në çështje të tjera përveç atyre që kishin të bënin me urdhëresat fetare dhe nuk e shpenzonte kohën duke u marrë me gabimet e njerëzve të tjerë. Në mesin e qindra dhe mijëra haditheve që ajo ka transmetuar nga Profeti, është e pamundur të gjesh një shprehje të shtrembëruar apo negative. Ajo paralajmëronte ata që keqtrajtonin të tjerët, dhe nuk shmangej nga vënia në dukje e asaj që ishte qartësisht e gabuar. Kur Hasan ibn Thabiti u qortua për fjalët e gabuara në incidentin e shpifjes nda Aishes, ky i fundit zuri ta dënonte dhe mallkonte veten. Aishja e ngushëlloi sahabin e vjetër duke i thënë:

“Përsëri ti nuk je njeri i keq siç po thua.”<sup>134</sup>

Ajo e ngushëlloi atë edhe pse Hasani e kishte lënduar atë vite më parë, me deklaratat e ngjashme. Aishja nuk ia ktheu shpifjet me shpifje, dhe nuk i mbajti armiqësi. Deri në vdekje, ajo ishte një shembull i faljes ndaj atyre që haptazi kishin punuar kundër saj. Një ditë, kur nipi dhe nxënësi i saj Urveja foli kundër Hasan ibn Thabitit, Aishja u zemërua dhe tha:

“Mos e dënoni atë, ai ishte një njeri i rëndësishëm i cili e mbrojti të Dërguarin e Zotit.”<sup>135</sup>

Kur njerëzit rreth saj merreshin me thashetheme ose përgojim, veçanërisht në lidhje me dikë që ishte i vdekur, Aishja hidhej përpjetë nga zemërimi dhe pastaj i lutej Allahut për faljen e personit për të cilin ishte folur. Ajo ka thënë:

“I Dërguari i Zotit ka thënë, ‘Flisni vetëm mirë për të vdekurit tuaj.’”

Ajo e praktikonte fenë e saj pikë për pikë. Një ditë, duke ecur në rrugë, ajo dëgjoi një zile dhe qëndroi aty ku ishte. Kumbimi i ziles ishte një tingull i padëshiruar dhe kështu ajo u përpoq për ta shmangur atë. Pak më vonë ajo e dëgjoi zilen nga pas dhe u dha këmbëve për të ikur sa më shpejt nga ky tingull i cili ishte i papëlqyeshëm për të Dërguarin e Allahut.<sup>136</sup>

Një ditë ajo dëgjoi se jetimët që qëndrojnë me të në shtëpinë e saj kishin sjellë aty një lojë të ngjashme me tavllën. Ajo u zemërua dhe u dërgoi një mesazh në të cilin u thoshte:

“Ose hidheni vetë atë përjashta, ose do të vij unë dhe do t’ju nxjerr juve jashtë.”<sup>137</sup>

Aishja ndjente shqetësim edhe për ëndrrat e saj. Ajo kurrë nuk mendonte se ato ishin të pakuptimta dhe mendonte se ndoshta ato përmbanin mesazhe të rëndësishme në lidhje me interpretimin e ngjarjeve. Një makth i vetëm ose e bënte atë të jepte sadaka (bamirësi vullnetare) ose të lironte një rob të nesërmen.<sup>138</sup>

Ajo zakonisht përdorte ndonjë justifikim të vogël për lirimin e ndonjë robi. Njëherë, ajo u dorëzua nga kërkesat e të tjerëve dhe prishi një betim që kishte bërë; më pas ajo në vend të një skllavi u dhuroi lirinë dyzet skllavëve si shlyerje për gabimin e bërë, megjithatë ajo prapë nuk e falte dot veten, dhe derdhi lot për këtë gjë gjatë gjithë pjesës tjetër të jetës, që i kishte mbetur. Pasi mori vesh se robinja e saj ishte nga fisi Temim, për të cilin i Dërguari i Zotit kishte thënë se rridhte nga e njëjta origjinë me Profetin Ismail (a.s.), ajo i dha asaj menjëherë lirinë.<sup>139</sup>

---

<sup>134</sup> Buhari, *megazi*, 32.

<sup>135</sup> Muslim, *fedailu Sahabe*, 155.

<sup>136</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/152.

<sup>137</sup> Buhari, *edebu'l mufred*, 1/435.

<sup>138</sup> Hejthemi, *Mexhmuatu'l zeuaid*, 1/484.

<sup>139</sup> Buhari, *itk*, 13.

Një ditë ajo u sëmur dhe njerëzit pyetën një njeri nga fisi Zat rreth sëmundjes, meqenëse ai kishte njohuri rreth saj. Duke ardhur në shtëpinë e Aishes, burri tregoi për atë që xhindet i kishin thënë:

“Ata më kanë thënë se një robinjë me një fëmijë në krahët e saj ka kryer magji mbi një grua, ata më thanë gjithashtu edhe se fëmija i robinjës kishte urinuar mbi trupin e gruas.” Dikush shkoi e gjeti robinjën dhe e çoi tek ai njeri. Aishja e njihte atë, andaj e pyeti:

“A më ke bërë magji mua?”

Robinja nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të tregonte të vërtetën, pasi me sa dukej të gjithë e dinin se çfarë kishte bërë vaki.

“Po”, - iu përgjigj ajo.

Pastaj Aishja e pyeti:

“Përse e bërë?”

“Për të qenë e lirë.”

Robinja e kishte lidhur lirinë e saj me jetën e Aishes, duke u shprehur se ajo do të fitonte lirinë ditën që do të vdiste Aishja.

Aishja u zemërua dhe tha:

“Betohem në Allah se nuk kam për t’ia dhënë kurrë lirinë.”

Kështu Aishja e shiti atë dhe bleu një skllave të re, të cilën e liroi menjëherë.<sup>140</sup> Nuk kishte njeri i cili të mos e dinte vendosmërinë e saj të palëkundur për këtë çështje; Aishja ka liruar afro gjashtëdhjetë e shtatë skllavër.<sup>141</sup>

Ajo fliste me të gjithë dhe nuk i ulte sytë poshtë për askënd. Një ditë, ajo i dha një qese të vogël me bukë një njeriu i cili i kishte kërkuar ushqim. Pasi ai kishte ikur, erdhi një tjetër i varfër dhe që dukej se ishte edhe i sëmurë mendor. Aishja e thirri pranë dhe i ofroi atij ushqimin e saj. Kur njeriu e kishte shuar urinë dhe qe larguar, Aishja u pyet përse ajo u soll në këtë mënyrë dhe ajo u përgjigj:

“Si mund të veproja ndryshe, kur vetë i Dërguari i Zotit ka thënë: ‘Trajtojini njerëzit sipas gjendjes në të cilën ndodhen?’”<sup>142</sup>

Pavarësisht nga çdo vështirësi që përjetoi, Aishja ka jetuar thjesht dhe kurrë nuk e çonte nëpër mend ta vinte dikë në borxh për një mirësi që ajo i kishte bërë. Ajo nuk ngurronte për të bërë mirë kur i vinte rasti. Aishja donte që njerëzit rreth saj të ushtronin të njëjtën disiplinë. Ajo kurrë nuk u ankua në lidhje me jetën e saj të thjeshtë, sepse ajo e kishte zgjedhur atë me vullnetin e vet të lirë dhe jetoi një jetë që synonte përherë vetëm kah ahireti. Kjo zgjedhje nuk ishte si rezultat i varfërisë, sepse ajo zgjodhi të njëjtën mënyrë jetese, edhe në kohën e bollëkut. Kur Omeri i dërgoi një qese me ar, ajo nuk arriti t’i mbante dot lotët dhe ia dha menjëherë qesen e arit atyre që gjendeshin përreth. Ajo ende nuk mendonte se kishte bërë mjaftueshëm, kështu që ajo iu lut Allahut që kurrë më të mos i vinte edhe njëherë një sprovë e tillë sërish.

Një nxënëse e saj e veçantë, Aishe binti Talha ka thënë njëherë për të:

“Njerëzit tanë, të cilët e ndienin veten afër saj, të rinj dhe të vjetër, sipas gjendjes që kishim, vinim tek ajo nga e gjithë bota dhe i shkruanim letra, madje ndonjëherë i çonim edhe dhurata. Unë ia tregoja asaj dhe i thoja: ‘O teze e dashur! Kjo është një letër nga filani dhe një dhuratë e filanit.’

<sup>140</sup> Buhari, *edebu’l mufred*, 1/68.

<sup>141</sup> San’ani, *Subulu selam*, 4/139.

<sup>142</sup> Ebu Davud, *edeb*, 23.

dhe ajo më thoshte: “O mbesë e dashur! Shkruaj një letër dhe dërgoji edhe ti një dhuratë si përgjigje. Nëse nuk ke çfarë t’i dërgosh, eja tek unë të ta jap dhuratën.” Dhe kështu ajo më jepte dhuratën që duhet të dërgoja.”<sup>143</sup>

Aishja kishte një vullnet mahnitës. As koha e as njerëzit që i qëndronin afër nuk arritën t’ia ndryshonin natyrën. Nuk hiqte dorë kurrë së trajtuari mirë të tjerët, edhe ata të cilët e lëndonin atë, shtypnin njerëzit përreth saj, apo përhapnin thashetheme, nuk ishin kurrësi të përjashtuar. Ajo kurrë nuk i bazonte veprimet e saja në gabimet e të tjerëve.<sup>144</sup>

Aishja kishte vetëm një veshje. Kur i ndotej, ajo e lante, e thante dhe e vishte përsëri. Kjo ishte një praktikë e përgjithshme e të gjitha bashkëshorteve të Profetit.<sup>145</sup> Por gjatë viteve të para të saj në Medinë, kur u bë sefte nuse në shtëpinë e lumturisë, ku jetonte me të Dërguarin e Allahut paqja qoftë mbi Të, Aishja kishte një veshje të cilësisë së lartë, e cila kushtonte pesë derhemë. Ajo i lumturonte jashtëzakonisht shumë gratë e Medinës, kur ua jepte atë hua nëpër dasma apo ngjarje të tjera të veçanta.<sup>146</sup>

Asaj nuk i shkante kurrë ndërmend të blinte një veshje të re, pa u vjetërsuar më parë ajo që kishte, madje derisa të bëhej krejt e papërdorshme. Nipi i saj Urveja pohon:

“Aishja nuk e zëvendësonte veshjen e saj derisa ajo të vjetrohej dhe të bëhej krejtësisht e papërdorshme, e shqyer dhe plot me arna.”

Në ato kohë njerëzit i thoshin:

“Allahu të ka dhënë mjaft, përse nuk përfiton prej të mirësive që Ai të falur?”

“Gjëja e re nuk do t’i rrijë mirë asaj që nuk është bërë për të.”<sup>147</sup>, - u përgjigjej ajo me një përgjigje të shkurtër dhe të drejtpërdrejtë.

Aishja thoshte se nuk do ta ndryshonte asnjëherë këtë sjellje të saj. Kur asaj i dërgohej ndonjë dhuratë, Aishes i kujtohej jeta e thjeshtë që bënte i Dërguari i Allahut (s.a.s.), si dhe thëniet e Tij në lidhje rreth kësaj çështjeje, kështu që asaj i mbusheshin menjëherë sytë me lot dhe ua shpërndante dhuratat njerëzve që ishin në nevojë. Gjatë kalifatit të tij, Muavija i dërgoi Aishes veshje, argjend dhe gjëra të tjera, të cilat mund t’i shërbenin asaj. Mirëpo, kur ajo i pa, nisi të lotonte dhe tha:

“I Dërguari i Allahut nuk mund t’i kishte asnjëherë nga këto.”

Aishja i ndau ato në pjesë dhe ua shpërndau njerëzve në nevojë. Deri në darkë, ajo i kishte shpërndarë të gjitha ato çfarë i kishte dërguar kalifi.<sup>148</sup>

Një ditë tjetër, asaj i sollën si dhuratë ca kosha me rrush. Aishja nisi menjëherë t’ua shpërndante të varfërve. Robinja, e cila e ndihmonte me punët e shtëpisë, e shoqëronte Aishen gjatë shpërndarjes së rrushit. Kur ra mbrëmja, robinja erdhi tek Aishja me një bistak rrushi. Aishja u habit, sepse mendonte se e kishte shpërndarë të gjithë sasinë e rrushit. Ajo e pyeti:

“Po kjo çfarë është?”

Skllavja nuk dinte çfarë t’i thoshte. Ajo e kishte ndarë fshehtazi veçmas atë vile nga Aishja, në mënyrë që t’ia jepte në darkë pas agjërimit. Aishja e qortoi dhe i tha:

“Vetëm një vile, ëëh?”

---

<sup>143</sup> Buhari, *edebul mufred*, 1/166.

<sup>144</sup> Muslim, *imareh*, 19.

<sup>145</sup> Buhari, *hajd*, 11.

<sup>146</sup> Buhari, *hibe*, 32.

<sup>147</sup> Buhari, *edebu’l mufred*, 1/165.

<sup>148</sup> Ebu Nuajm, *Hiljetu’l Eulija*, 2/48.

Sjellja e Aishes së nderuar e habiti tej mase. Vetëm tani po e kuptonte rëndësinë e atij gabimi. Aishja më pas shtoi:

“Betohem në Allah se as nuk do ta ha e as nuk do ta prek me dorë atë rrush.”, dhe u largua.<sup>149</sup>

Aishja vijoi përherë t’i shpërndante dhuratat që i vinin, përgjatë gjithë jetës, gjithmonë duke menduar vetëm si e si të ndihmonte të varfrit. Aishja e dinte se kur jepte sadopak për bamirësi, do të merrte shpërblim të pafundmë nga Allahu (xh.sh.), i Cili i ka të pafundme mundësitë për të dhuruar. Aishja kurrë nuk mendonte për përfitime personale. Duke u kujdesur për të mjerët, ajo shpresonte t’ua plotësonte edhe atyre sadopak nevojat që kishin. Asgjë nuk e kënaqte më tepër sesa buzëqeshja e një njeriu në nevojë, pasi e kishe ndihmuar me diçka.

Kur mbeti pa para, Aishja shiti sendet e saj dhe i dha të gjitha paratë për bamirësi. Nipi i saj, Abdullah ibn Zubejri(r.a.) ka thënë:

“Betohem në Allah, se ose nëna jonë Aishja do ta ndryshojë me të mirë këtë sjellje, ose unë do t’ia ndaloj.”

Aishja i dëgjoi këto fjalë nga dikush dhe pyeti:

“Vërtet ka thënë kështu? Ju betohem se nuk kam për të folur më me ibni Zubejrin deri në Ahiret.”

Dhe me të vërtetë, ajo nuk i foli më atij. Kjo e lëndoi mjaft Abdullah ibn Zubejrin dhe ai u mundua të gjente një zgjidhje për të rivendosur marrëdhëniet e dikurshme. Megjithëse vinte herë pas here tek dera e Aishes, ai nuk dëgjonte gjë tjetër veç:

“Jo! Betohem se as nuk kam për të ta kthyer fjalën, e as nuk do ta shkel betimin.”

Sa më tepër kalonte koha, aq më shumë e brente ndërgjegjja Abdullahun. Ai u kërkoi dy udhëheqësve Misuer ibn Mahremes dhe Abdurrahman ibn Abdul Esuedit të ndërhnin në këtë mesele. Ishte detyrë e çdo besimtari që të vendoste paqen midis dy besimtarëve.

Ata bënë një plan dhe shkuan tek dera e Aishes e i thanë:

“Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi ty, o Aishe. A na jep leje të hyjmë?”

Abdullah ibn Zubejri ishte me ta, por ata nuk i treguan asaj. Një zë nga brenda foli:

“Urdhëroni, mirë se të vini.”

Ata u lumturuan dhe e pyetën përsëri:

“Të gjithë ne?”

“Po, të gjithë ju.”

Plani i tyre funksionoi dhe bëri që Abdullah ibn Zubejri të hynte brenda. Sapo hyri, ai iu përgjërua asaj për ta falur që nga ana tjetër e perdes. Misuer ibn Mahreme dhe Abdurrahman ibn Abd Esuedi e mbështesnin Abdullahun, andaj i kërkuan Aishes falje në emër të tij, ndërkohë që sytë e tij ishin rrëmbushur në lot.

Dy ndërmjetësit, duke vazhduar planin e tyre i thanë:

“Ti e di se i Dërguari i Zotit ka thënë: “Nuk është e lejuar për një mysliman të qëndrojë i zemëruar me një tjetër mysliman për më shumë se tri ditë.”

Pastaj Aishja nisi të qante duke sjellë ndërmend fjalët e të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të dhe iu përgjigj:

---

<sup>149</sup> Po aty.

“Por unë kam bërë një betim dhe ju e dini se betimi është diçka shumë e rëndësishme.”

Zemra e saj u zbut menjëherë, zaten nuk kishte rrugë tjetër, përveçse të ndiqte porositë e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ajo nuk i hodhi poshtë të gjitha kërkesat e ndërmjetësuesve dhe e pranoi faljen e Abdullah ibni Zubejrit. Prej atëherë e tutje, ajo i foli atij, por kjo i kushtoi Aishes dyzet sklevër, sepse ajo kishte thyer një betim. Aishja qante kur sillte ndërmend betimin e saj dhe ato që kishte përjetuar; njerëzit pranë saj tregonin se shalli që mbante të veshur i lagej plotësisht nga lotët.<sup>150</sup>

Një ditë kur Profeti ishte ende gjallë, një grua erdhi te Aishja së bashku me dy bijat e saj në krahë. Ishte e qartë se ishin në nevojë dhe se jeta e tyre ishte plot me vështirësi. Aishja nuk kishte ndonjë bollëk në shtëpi, por ishte natyra e saj që kënaqej me atë çka kishte dhe nuk shqetësohej për atë që nuk e kishte. Ajo solli tri hurma nga shtëpia për to. Nëna ua dha dy nga hurmat të bijave. Fëmijët, të cilët kishin kohë që e ndienin mungesën e ushqimit, i hëngrën hurmat me kënaqësi. Nëna e tyre i shikoi ato me trishtim, ashtu si edhe Aishja. Kur fëmijët i hëngrën hurmat, shikimi iu përmbloodh mbi hurmën e mbetur në dorën e nënës së tyre. Ajo e ndau hurmën që e kishte ruajtur për vete me dashurinë e nënës në dy pjesë, dhe ua dha nga një gjysmë secilës nga vajzat. Ato i hëngrën të kënaqura. Asgjë nuk kishte mbetur për nënën, e cila megjithatë ishte e kënaqur kur shihte gëzimin në sytë e bijave të saj, sytë e të cilave shndrisnin prej gëzimi.

Sapo i Dërguari i Zotit u kthye në shtëpi, Aishja i tregoi ngjarjen që kishte ndodhur. Ajo ishte e prekur nga sakrifica madhështore e nënës. Pasi e dëgjoi me vëmendje, i Dërguari i Zotit shpalli sihariqin e mëposhtëm:

“Për atë që bëri, Allahu i dhuroi asaj Xhenetin dhe e shpëtoi nga zjarri i Xhehenemit!”<sup>151</sup>

Shumicën e kohës, sytë e Aishes rrinin të mbushur me lot, dhe zemra e saj ishte shumë e ndjeshme. Ajo nuk ishte në gjendje të mbante veten nga të qarët, dhe qante derisa lotët e saj dukej sikur të kishin shteruar. Ajo gjithmonë trishtohej kur nuk e kryente dot siç duhej detyrën, ose kur nuk ishte në gjendje të mbante fjalën e dhënë dhe gjithmonë paguante dëmshpërblim në kësi rastesh.

Por lotët e saj nuk derdheshin vetëm për veten. E zhgënjyer me shoqërinë myslimane, ajo qante edhe për brezat që do të vinin më pas. Një ditë, asaj iu kujtua Dexhali dhe filloi të qante duke menduar për trazirat dhe katastrofat që myslimanët do të përjetonin. Aishja bërtiti me aq zjarr, sa që nuk e kuptoi se i Dërguari i Zotit i kishte ardhur pranë. Kështu që e pyeti:

“Përse po qan?”

Aishja u kthye nga i Dërguari i Allahut dhe tha me hidhërim:

“O i Dërguari i Allahut. M’u kujtua Dexhali!”<sup>152</sup>

### **Bujaria e saj**

Aishja ka jetuar gjithnjë vetëm për të tjerët. Sa herë ndodhte që të shihte njerëz në nevojë, ajo harronte nevojat e saj dhe e jepte çdo gjë për ta. Ajo e dinte mirë hadithin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), që thoshte:

---

<sup>150</sup> Buhari, *edeb*, 62.

<sup>151</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/92.

<sup>152</sup> Po aty, 6/75.

“Shpëtojeni veten nga zjarri i Xhehenemit duke dhuruar qoftë edhe një gjysmë hurme për bamirësi.”<sup>153</sup>

Nuk ishte kollaj, Aishja ishte edhe e bija e Ebu Bekrit të nderuar (r.a.), më bujarit ndër njerëz. Zemërgjerësia ishte një karakteristikë e përgjithshme e kudogjendur në pjesëtarët e familjes së saj. Kur nipi i Aishes, Abdullah ibn Zubejri, i përshkruante karakteristikat e nënës së tij, Esmasë dhe tezes së tij, Aishes, thoshte se ato ishin rivale të njëra-tjetrës kur vinte puna për të dhënë sadaka.<sup>154</sup>

Kur Aishja nuk kishte asgjë ç’të jepte, nganjëherë, merrte hua nga dikush tjetër dhe e jepte si lëmoshë. Disave kjo u dukej e çuditshme dhe e pyesnin:

“Nga të ka lindur kjo ide që të marrësh hua për bamirësi?”

Ajo i referohej një hadithi të të Dërguarit të Zotit, i cili thoshte:

“Çdo robi të Allahut që ka ndërmend dhe përpiqet për ta larë borxhin, në ndihmë i vjen vetë Allahu i Plotfuqishëm.”<sup>155</sup>

Nipi i saj Urveja ka thënë:

“Jam dëshmitar se ajo njëherë dha shtatë mijë derhemë për bamirësi, ndërsa vetë ishte e veshur me një veshje të arnuar.”<sup>156</sup>

Aishja ia shiti shtëpinë Muavijes për njëqind e tetëdhjetë mijë apo dyqind mijë derhemë. Qysh përpara se të shpërngulej nga aty, ajo ia kishte shpërndarë të gjitha paratë të varfërve, pa mbajtur asgjë për veten.<sup>157</sup>

Një ditë një njeri i skamur erdhi pranë saj dhe i kërkoi një kafshatë bukë. Aishja kishte ca rrush dhe i tha një gruaqe që kishte afër për t’ia dhënë atë personit që po i lypte në derë. Gruaja e shikoi atë me çudi, duke menduar se Aishja kishte nevojë vetë për ushqim. Aishja i kujtoi asaj se edhe grimca më e vogël e veprave të mira do të shpërblehej:

“Përse po ngurron? A e di se sa grimca ndodhen në atë rrush?”<sup>158</sup> duke aluduar për ajetin “*E kush bëri ndonjë të mirë sa grimca, atë do ta gjejë.*”<sup>159</sup>

Një ditë një grua e varfër, me dy vajza, erdhi tek Aishja për t’i kërkuar ndonjë gjë për të ngrënë. Në atë çast nuk i gjendej asgjë në shtëpi; Aishja kërkoi kudo, por nuk gjeti tjetër veç një hurme, të cilën ia dha gruas tërë siklet. Pastaj sytë e saj u fiksuan tek reagimi i gruas - ajo e ndau hurmën përgjysmë dhe ia dha secilës prej vajzave të saj. Aishes iu kujtua rasti i asaj nënës që kishte e ndarë edhe pjesën e vet përgjysmë për dy vajzat e saj.

Aishja u mallëngjye thellë nga kjo që po i shihnin sytë. Edhe pasi gruaqa u largua, ajo vazhdoi të mendonte rreth saj. Kur i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të u kthye në shtëpi, Aishja ia tregoi krejt historinë. I Dërguari i Zotit u prek dhe i tha:

“Nuk ka asnjë dyshim se ato vajza do të jenë një mburojë kundër Zjarrit për atë që i trajton ato me mirësi.”<sup>160</sup>

---

<sup>153</sup> Buhari, *zekat*, 8, 9.

<sup>154</sup> Buhari, *edebu’l mufred*, 1/106.

<sup>155</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/99; Hakim, *Mustedrek*, 2/26.

<sup>156</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/67; Dhehebi, *sijer*, 2/47, 48.

<sup>157</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/65; Ebu Nuajm, *Hiljetu’l Eulija*, 2/47, 48.

<sup>158</sup> Malik, *Muvatta*, 2/997.

<sup>159</sup> Zelzele, 7.

<sup>160</sup> Buhari, *edebul mufred*, 1/59.

Një ditë, një grua e varfër erdhi tek Aishja, e cila kërkoi kudo dhe gjeti vetëm një copë bukë. Ajo ishte buka me të cilën ajo do të prishte agjërimin, por ia dha gruas pa kurrfarë hezitimi. Amvisa e Aishes u përpoq ta ndalonte:

“Po nuk do të kesh me ç’të prishësh agjërimin pastaj!”

Aishja e urdhëroi:

“Jepja bukën gruas.”

Amvisa nuk kishte zgjidhje tjetër ç’të bënte, andaj ia dha pa kundërshtuar mandej. Afër perëndimit të diellit, Aishes i erdhën ca dhurata ku kishte mish qengji dhe bukë. Zoti i bekon ata që japin për hir të Tij. Kur ishte koha për të ngrënë iftarin, Aishja bëri shaka me amvisën:

“Merre këtë dhe haje, është më e mirë se buka jote e thatë.”<sup>161</sup>

Diçka e ngjashme ndodhi edhe kur njëri nga nipat e saj, Abdullah ibn Zubejri, i dha asaj një shumë prej njëqind mijë dërhëmësh, dhe e pa atë tek i shpërndante ato të gjitha për të skamurit. Ishte një ditë agjërimi për Aishen, së cilës nuk i kishte mbetur më asgjë. Kur ra muzgu, Aishja i tha amvisës së saj, Umu Dherit:

“O Umu Dher, përse nuk na sjell diçka për të prishur agjërimin?”

Umu Dheri solli ca bukë me vaj ulliri dhe i tha:

“O nëna e besimtarëve, pse nuk mbajte diçka, qoftë edhe vetëm një dërhëm nga ajo që shpërndave në mënyrë që edhe ne të mund të blinim ca mish?”

Në fjalët e amvisës ndjehej sikleti i pamundësisë për të sjellë një ushqim të mirë për Aishen dhe habia kur shihte se Aishja kurrë nuk përfitonte nga gjithë ato mundësi që i jepeshin. Aishja e kuptoi dhe i tha me butësi:

“Mos më bërtit. Nëse do të më ishte kujtuar, mund ta kisha bërë këtë.”<sup>162</sup>

Aishja e dinte se do të përfitonte mjaft nga ajo ç’ka dhuronte, kështu që jepte pa reshtur. Ajo e kishte mësuar këtë prej vetë Krenarisë së Njerëzimit, Profetit Muhamed (s.a.s.).

Një ditë, ata flijuan një kafshë dhe Aishja e fali krejt mishin e saj derisa vetëm pak kocka shpatullash mbetën në duart e saj. Kur i Dërguari i Zotit u kthye në shtëpi, e pyeti:

“Çfarë bërë me kafshën e therur, a mbeti ndonjë gjë për ne?”

“E shpërndava të gjithë mishin, vetëm kockat e shpatullave ngelën,” - tha Aishja. Kjo ishte ajo që priste edhe i Dërguari i Zotit, sepse Allahu i Plotfuqishëm i kishte premtuar se Ai do t’ia shumëfishonte vlerën e shpërblimit për çdo gjë që do të jepnin për hir të kënaqësisë së Tij. Një vepër e mirë që është regjistruar për bamirësi e dhënë për hir të Zotit kurrë nuk do të humbasë, përkundrazi do të mbetet e përhershme. I Dërguari i Zotit pastaj tha:

“Jo e dashur Aishe, çdo pjesë e saja përveç kockave të shpatullave ka ngelur për ne si shpërblim i përhershëm.”

### **Kujdesi ndaj mbulesës**

Përderisa Aishja paralajmëronte të tjerët në lidhje me mbulesën, natyrisht edhe ajo i ka kushtuar vëmendje shumë të madhe atij. Si një grua e Profetit, ajo ishte një nënë edhe për myslimanët e tjerë.

---

<sup>161</sup> Malik, *Muvatta*, 2/997.

<sup>162</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/67; Dhehebiu, *sijer*, 2/187.

Përkundër kësaj, ajo u soll me kujdes dhe mbajti përherë një distancë mes vetes dhe njerëzve të cilët nuk ishin të afërm të saj.

Ajo rrinte e mbuluar edhe përpara njerëzve të verbër. Një ditë, Is'haku, një udhëheqës i tabiinëve, erdhi tek ajo dhe Aishja doli në anën tjetër të perdes. Is'hakut, duke qenë i verbër, sjellja e saj iu duk e çuditshme dhe i tha:

“A po mbulohesh për të mbrojtur veten prej meje? Por unë nuk mundem të të shoh ty.”

Aishja iu përgjigj:

“Vërtet ti mund të mos më shohësh mua, por unë të shoh ty.”<sup>163</sup>

Aishja ndjehej në siklet edhe kur burri i mëndeshës së saj erdhi brenda shtëpisë së saj, edhe pse ai konsiderohej si një xhaxha i afërt para të cilit ajo nuk ishte e detyruar të vishte shaminë. Atyre të cilëve kjo iu duk e çuditshme, ajo u tha:

“Mua më ka dhënë gji gruaja e tij, e jo ai.”

Ndoshta vendimi për këtë çështje nuk ishte bërë i qartë ende, kështu që Aishja po gabonte për shkak të kujdesit të tepërt. Me të ardhur Profeti, ajo e pyeti menjëherë, e ai iu përgjigj:

“Ai është xhaxhai yt. Lejoje të rrijë pranë teje.”<sup>164</sup>

Është thënë nga Ibni Abasi se Aishja e kishte zakon të mbulohej edhe kur dy nipat e Profetit, Hasani dhe Hyseni, e vizitonin shtëpinë e saj. Hasani dhe Hyseni, për shkak të kujdesit të saj, nuk shkonin aq shpesh për vizitë pranë bashkëshorteve të të Dërguarit dhe silleshin më me kujdes ndaj tyre.<sup>165</sup>

Edhe gjatë riteve fetare, ajo nuk përzihej me turmën dhe i sillej rrotull Qabes në moment qetësie. Njëherë, kur Aishja po i sillej rrotull Qabes, një grua i kërkoi të shkonin bashkë te Guri i zi.

“O nënë e besimtarëve, përse nuk shkojmë ta prekim apo ta puthim edhe ne Gurin e zi?”

Aishja i tha gruas të qëndronte larg prej saj, dhe u shpreh se ishte e pahijshme që gratë të lëviznin në mes të një turme të tillë.

Duke i ditur sjelljet e saj të kujdesshme, njerëzit shpesh u përpoqën ta bënë atë të ndihej më rehat ndërsa ajo sillej rrotull Qabes, duke hapur zonën e njerëzve. Në këtë mënyrë zona e rrotullimit përgatitej më përpara për Aishen. Ajo madje e mbante të mbuluar fytyrën e saj, ndërsa sillej rreth Qabes, duke mos lejuar askënd për të parë fytyrën e saj.<sup>166</sup>

Ajo ishte tepër e përpiktë, edhe gjatë vizitave në varreza. Pasi Omeri u martirizua dhe u varros, Aishja i kryente vizitat e saj më me shumë kujdes tek varret e të Dërguarit të Zotit dhe babait të saj, Ebu Bekrit.<sup>167</sup>

Ndjeshmëria e saj u reflektua edhe në mësimet që u jepte të tjerëve. Aishja i ka lejuar të gjithë të vijnë dhe të përfitojnë nga njohuritë e saj dhe ajo kishte nxënës nga çdo rajon. Studentët e saj më të shquar ishin nipat dhe të afërmit e saj. Edhe pse ishte më e lehtë për ta që ta vizitonin në shtëpinë e saj, ajo mbante një perde mes vetes dhe kushërinjve të një brezi më të largët, si dhe ndaj të huajve, duke i shpjeguar mësimet e saj që nga ana tjetër e perdes. Nëse i duhej të korrigjonte ndonjë gabim, Aishja ndërhynte duke i bërë shenjë me duar. Nxënësi i saj, Imam Mesruku ka thënë:

---

<sup>163</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/69.

<sup>164</sup> Buhari, *shehadet*, 7.

<sup>165</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/58.

<sup>166</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/85.

<sup>167</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/8.



“Unë dëgjoja zhurmën e duartrokitjeve të saj nga ana tjetër e perdes.”<sup>168</sup>

Aishja ndërtoi një ambient të dobishëm për klasat. Ajo sigurohej që gjithmonë ata të cilët vinin tek ajo për të marrë mësim të kishin qenë të ushqyer me gjë nga njerëzit e saj të afërt, në mënyrë që ajo të mund t'i shihte përsëri më vonë për hir të dijes. Ajo e dinte se i Dërguari i Allahut kishte dhënë një leje të ngjashme për gruan e Ebu Hudhejfes, Sehle binti Suhejlit, ndaj edhe pse i biri, Selimi kishte qenë i rritur, ajo i kishte dhënë qumësht në foshnjëri të tij, kështu që ata u bënë më se të afërm me njëri-tjetrin.<sup>169</sup>

Kur ishte e nevojshme, ajo ua mësonte përmes praktikës atë që ajo dinte për nxënësit e saj që kishin statusin e të afërmit të gjakut. Një nga të afërmit e saj të ngushtë kishte një shërbëtor që e quanin Selim, i cili dëshironte të mësonte se si merrej abdesi. Ajo e mësoi atë të merrte abdes njësoj siç merrte i Dërguari i Zotit, Muhamedi paqja qoftë mbi Të. Meqenëse Selimi ishte rob i njëjës prej të afërmeve të saj të ngushtë, ajo gjithashtu e pranoi atë si të afërm.

Pasi kishte kaluar ca kohë, i njëjti person erdhi sërish tek Aishja dhe i tha:

“O nënë e besimtarëve, të lutem bëj dua për mua.”

Aishja e pyeti përse.

Duke dashur ta ndante me të lumturinë e vet, ai i tha Aishes:

“Allahu i Madhëruar më dha lirinë.”

Ajo u përgjigj:

“Allahu të bekoftë.”

Sapo i tha këto fjalë, Aishja iku menjëherë dhe u fsheh pas perdes. Që nga ai moment, ai nuk e gëzonte më statusin e të afërmit, kështu që këndej e tutje ajo foli me Selimin nga ana tjetër e perdes.<sup>170</sup>

### **Udhëzimi i të tjerëve dhe transmetimi i mesazhit**

Rrëfimi i mesazhit hyjnor dhe udhëzimi i të tjerëve në rrugë të drejtë, përbënte synimin kryesor të jetës së Aishes pas ndarjes nga jeta të të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të. Me të parë kryerjen e ndonjë gabimi, ndërhynte, dhe tregonte menjëherë mënyrën se si i zgjidhte Profeti këto situata në të gjallë. Aishja i gëzohej së mirës dhe mundohej t'i vinte prita të keqes në çdo rrethanë; ajo bëri gjithçka që mundi për të udhëzuar popullin në rrugë të drejtë. Motivi prapa këtyre përpjekjeve të saj ishte angazhimi serioz për të vënë në jetë mësimet e Kuranit dhe të Sunetit.

Aishja njëherë pa një grua që po ecte ndërmjet Safës dhe Merues, e cila kishte veshur një mbulesë me piktura dhe sakaq e paralajmëroi:

“Çlirohu nga ato piktura në veshjen tënde. I Dërguari i Allahut zemërohej kur shihte veshje të tilla.”<sup>171</sup>

Aishja këmbëngulte në rrëfimin e dijeve që kishte dhe ligështoej kur diçka mbetej vetëm brenda saj. Mes këtyre dijeve, kishte edhe nga ato të cilat ajo kishte turp t'i thoshte për shkak të modestisë, kështu që ajo u thoshte grave t'i bisedonin ato me bashkëshortët e tyre. Një ditë ajo tha:

---

<sup>168</sup> Buhari, *adahi*, 15.

<sup>169</sup> Muvatta, *rada*, 2; Ebu Davud, *nikah*, 10.

<sup>170</sup> Nesai, *tahara*, 83.

<sup>171</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/225.

“Meqë kam turp t’ua them këto atyre, thuajuni burrave tuaj se ata duhet të përdorin ujë për t’u pastruar pasi kanë shkuar në tualet. Kështu ka vepruar edhe i Dërguari i Allahut.”<sup>172</sup>

Ajo i qortonte vajzat, madje edhe ato më të voglat fare të cilat mbanin bizhuteri nëpër duar, dhe i porosiste kur i vinin për vizitë për faktin se zbukurimet e tepërta ishin një ftesë për djallin, që do të thoshte privim i ambienteve të shtëpisë nga prania e engjëjve.<sup>173</sup>

Kurdoherë që shihte ndonjë gabim, asaj i lindte përbrenda një dëshirë e ethshme për ta ndrequr. Një ditë ajo pa të vëllanë, Abdurrahmanin teksa merrte abdes me nxitim sepse donte të shkonte në varrimin e Sa’d ibn Ebu Uakasit, dhe e paralajmëroi:

“Abdurrahman, të jesh më i kujdesshëm kur i lan këmbët ndërsa merr abdes. Kam dëgjuar nga i Dërguari i Zotit të thotë: *“Sa keq më vjen për thembrat që digjen nga zjarri!”*<sup>174</sup>

## PJESËMARRJA E AISHES NË LUFTËRA

Trimëria e Aishes ishte e madhe dhe ajo nuk i bënte asnjëherë bisht të qenit në vijën e frontit, edhe kur të tjerët tërhiqeshin së andejmi. Edhe pse ajo ishte grua, është gjendur shpesh në fushën e betejës krah për krah me të Dërguarin e Zotit (s.a.s.). Ajo nuk hezitoi kurrë të shkonte, madje edhe në betejat më të ashpra.

Aishja ishte së bashku me Profetin gjatë çasteve vendimtare si Betejat e Uhudit, Hendeku, Beni Kurejdha, ajo e Beni Mustalikut, Hudejbijes, si dhe në triumfin e Mekës.<sup>175</sup> Ajo i jepte zemër

---

<sup>172</sup> Tirmidhi, *taharet*, 15; Nesai, *taharet*, 41.

<sup>173</sup> Ebu Davud, *hatem*, 6.

<sup>174</sup> Muuatta, *taharet*, 35.

<sup>175</sup> Nedeui, *siratu sejidati Aishe*, 170.

luftëtarëve në fushën e betejës dhe në të njëjtën kohë, i shërbente të Profetit tonë të Dashur (s.a.s.). Enes ibn Maliku tregon:

“Gjatë betejës së Uhudit unë kam parë Aishe binti Ebu Bekrin dhe Umu Selemen të mbartnin ujë mbi supe; ato garonin me njëra-tjetrën kush të mbartte më shumë ujë, për t’i ardhur në ndihmë luftëtarëve të plagosur. Rruga që ato bënë për t’i prurë enët e mbushura me ujë ishte nga Medina deri në Uhud.”<sup>176</sup>

Aishja ishte vetë e pranishme e në betejën e Hendekut, kur mekasit u përpoqën të pushtonin Medinën. Ajo i shërbente Profetit, dhe mbartte ujë për burrat, së bashku me gratë e tjera.

Afër triumfit të Mekës, i Dërguari i Allahut i tha:

“O Aishe, Huzaave u ka ndodhur diçka e rëndësishme!”

Kur myslimanët ranë në marrëveshje me mekasit, në Hudejbije, fisi Huzaa ishte njëra nga palët aleate të myslimanëve. Menjëherë Aishes i shkoi mendja, mos vallë, kurejshët e kishin shkelur traktatin e Hudejbijes. Megjithatë e kishte të qartë se mekasit nuk mund ta bënin diç të tillë, pa menduar edhe pasojat që vinin nga pas; kjo do të ishte veç një marrëzi nga ana e tyre. Kështu, ajo pyeti nëse Profeti mendonte se kurejshët e kishin aq guxim sa ta shkelnin marrëveshjen. Por kjo rezultoi e vërtetë; mekasit e kishin sulmuar natën fisin Huzaa, dhe kishin vrarë njëzet e tre veta prej tyre, përfshirë edhe fëmijë. Kjo përbënte një shkelje të rëndë të traktatit të Hudejbijes. Megjithatë, i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të, i kushtoi vëmendje mençurisë hyjnore që qëndronte prapa kësaj ngjarjeje dhe tha se Kurejshët e shkelën marrëveshjen sepse vetë Allahu ka dëshiruar që diçka tjetër më e madhe të ndodhë.

Aishja e dinte se nëse Allahu dëshironte të ndodhte diçka, pasoja do të ishte medoemos e mirë. Megjithatë ajo e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, a do të dalë për mirë e gjithë kjo?”

“Po, o Aishe, ka për të dalë.”

Pasi kishte kaluar ca kohë, i Dërguari i Allahut i tha Aishes të bëhej gati për rrugë dhe ta mbante të fshehtë këtë që po i thoshte.

Ky udhëtim do të ishte i ndryshëm nga ata të mëparshmit. Ai do të ishte udhëtimi drejt vendlindjes, atij vendi, të cilit Allahu i plotfuqishëm i ka dhënë një vlerë të veçantë. Ndërsa ajo po përgatitej për udhëtimin, Ebu Bekri erdhi dhe e pyeti për arsyen e gjithë këtyre përgatitjeve. Meqenëse Aishja ishte e vendosur ta çonte deri në fund porosinë e Profetit, ajo, as babait të saj, nuk i tregoi asgjë.

Aishja përpiquej gjithashtu, kur ishte e domosdoshme, të gjente mbështetje financiare. Gratë myslimane i dhanë çfarëdolloj bizhuterish që zotëronin si vëthë, byzylykë këmbësh e duarsh, si dhe unaza ari për hir të çështjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).<sup>177</sup> Përpara luftës së Tebukut, Aishja shtri një çarçaf në dhomën e saj dhe gratë mundoheshin kush e kush të sillte sa më shumë gjëra të çmuara nga shtëpitë e tyre, dhe saora i hidhnin mbi çarçaf.

### **Begatia e tejemumit**

Ajetet që kishin të bënin me tejemumin u shpallen për shkak të Aishes. Gjatë një ndalese, kur ushtria po kthehej nga beteja me fisin Beni Mustalik, Aishja vuri re se i kishte humbur një varëse e

---

<sup>176</sup> Buhari, *fedailu sahabe*, 5.

<sup>177</sup> Uakidi, *megazi*, 1/992.

cila i përkiste së motrës së saj, Esmasë. I duhej të bënte të pamundurën, pasi ajo nuk ishte as e saja, por i së motrës. Ajo shikoi përreth nëpër errësirë, por nuk arriti ta gjente. Mandej, ajo shkoi tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe të dy së bashku nisën ta kërkonin varësen. Kur të tjerët vërejtën se i Dërguari i Allahut ishte duke kërkuar diçka, nisën të kërkonin edhe ata.

Por varësja nuk ishte aty. Kur të gjithë e kuptuan se nuk do të ishin në gjendje ta gjenin, zunë sërish të pushonin. I Dërguari i Zotit vuri kokën në prehër të Aishes dhe mbylli sytë.

Disa shkuan te Ebu Bekri, babai i Aishes, dhe i thanë:

“A e sheh çfarë na bëri vajza jote? Ajo e mbajti Dërguarin e Zotit dhe të gjithë ne në këtë vend ku nuk mund të gjesh as edhe një pikë uji!”

Kjo ishte e vërtetë. Nuk kishte mbetur më ujë, as në enët e tyre, e përreth nuk dukej asnjë gjurmë pusi ose burimi. Ata do të ngriheshin në mëngjes për të falur namazin e sabahut, por si mund të merrnin abdes pa ujë? Ata po vrisnin mendjen dhe nuk ishin në gjendje të gjenin një rrugëzgjdhje.

Ebu Bekri u zemërua. Po të mos ishte humbja e gjerdanit të vajzës së tij, ata nuk do të kishin mbetur atje, por do të kishin gjetur një burim uji, e atje do të kishin pushuar. Me zemërim, ai hyri në çadrën Aishes, i përgatitur për ta qortuar ashpër. Mirëpo aty pa Të Dërguarin e Allahut që po pushonte në prehrin e saj. E ndali hovin dhe pastaj iu afrua me ngadalë. Plot zemërim, por me zë të ulët, ai tha:

“Ti i bërë njerëzit dhe të Dërguarin e Zotit të qëndrojnë këtu, dhe tani kemi ngelur të gjithë pa një pikë uji.”

Aishja ishte në një situatë të vështirë, pasi ajo nuk kishte çfarë t’i thoshte dhe nuk mund të lëvizte dot, sepse i Dërguari i Zotit ishte ende duke fjetur. Por papritmas, Ai u zgjua dhe menjëherë e kuptoi se nuk kishte ujë. Ai mendoi për njerëzit, të cilët po vuanin dhe u duhej të faleshin, por nuk kishin ujë. Pikërisht në atë çast, të Dërguarit të Zotit i zbriti një ajet. Nëpërmjet Xhebrilit (a.s.) zbriti një ajet kuranor që fliste për një mënyrë të re pastrimi në mungesë të ujit:

*“...Nëse jeni të sëmurë, jeni në ndonjë udhëtim ose ndonjëri prej jush vjen nga ultësira (nevojtorja) ose keni takuar gratë, e nuk gjeni ujë, atëherë mësyjeni dheun dhe fërkoni me të fytyrat dhe duart (tejemum). Allahu shlyen dhe është falës i mëkateve”<sup>178</sup>.*

Shpallja e re e zgjidhi sakaq problemin e tyre. Tash e mbrapa, kur ata të ishin pa ujë, ata nuk do të shqetësoheshin më, duke e ditur se mund të pastroheshin edhe me dhë.

Ebu Bekri u bë dëshmitar i asaj shpalljeje të zbritur nga Allahu Mëshirues, dhe menjëherë nisi ta shihte me admirim të madh atë, me të cilën ai ishte zemëruar pak më parë, madje dhe e pati qortuar. Gabimi i saj ishte bërë shkak për ardhjen e një shpalljeje të re. I kapluar i tëri prej gëzimit, Ebu Bekri tha:

“O bija ime, sa njeri i bekuar që je. Si rezultat i vonesës që shkaktove ti, Allahu u dhuroi myslimanëve lehtësi dhe bekim.”<sup>179</sup>

Këtë epërsi e kuptuan edhe të tjerët që gjendeshin aty. Pak kohë më vonë, Usajd ibni Hudajri erdhi tek Ebu Bekri (r.a.) dhe i tha me admirim:

“Ky nuk ishte i pari bekim për ju, o familja e Ebu Bekrit.”<sup>180</sup>

---

<sup>178</sup>Nisa, 43.

<sup>179</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2/272; Ibni Maxhe, *taharet*, 90.

<sup>180</sup> Buhari, *tejemum*, 1.

Pasi namazi mbaroi, udhëtimi i tyre rinisi sërish. Pasi deveja e Aishes u ngrit nga vendi, ajo vuri re një objekt të shndritshëm që kishte qenë nën të. Ajo u përkul ta shihte më nga afër, dhe vuri re me gëzim se ajo nuk ishte tjerë pos varësës që ajo kishte huazuar nga Esmaja.<sup>181</sup>

## Shpifja

Ishte po gjatë së njëjtës ekspeditë që Aishja përjetoi pikëllimin më të madh në jetën e saj. Abdullah ibni Ubej ibni Seluli, udhëheqësi i hipokritëve, ishte duke parë për ndonjë mundësi për të rivendosur respektin, të cilin ai e ndjente se e kishte humbur qëkur myslimanët kishin emigruar në Medinë. Ai ëndërronte hakmarrje ndaj myslimanëve, e veçanërisht kundër të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të dhe Ebu Bekrit. Ai ishte përpjekur shumë herë deri atëherë, duke thurur skenarë nga më të ndryshmet, por ç'e do se mundi i shkonte përherë dëm. Mekasit i kishin dërguar mjaft letra për ta nxitur kundër myslimanëve të Medinës, dhe Ibni Seluli ishte përgjigjur se ishte i gatshëm t'i ndihmonte me ushtarë dhe në të holla nëse ata dëshironin. Ai ishte munduar të thyente vetëbesimin e ushtrisë myslimane gjatë Betejës së Uhudit, duke lënë fushëbetejën me një turmë që përbënte afërsisht një të tretën e ushtrisë. Ai kishte ndihmuar dhe nxitur ushtrinë mekase së bashku me disa fise hebreje, të tilla si Beni Kurejdha. Shumë nga planet e tij ishin ekzekutuar, por ai nuk ia arriti asnjëherë qëllimit të tij të kobshëm. Çdo ditë që kalonte punonte kundër tij dhe pasuesve të tij. Aleatët e tij, të tillë si Beni Nadr, Beni Kajnuka dhe Beni Kurejdha, nuk kishin respektuar traktatin e Medinës dhe kishin qenë të detyruar të largoheshin së andejmi. Me pak fjalë, Abdullah ibni Ubeji nisi të humbasë bazën e tij të mbështetjes, dhe dita ditës, ai shihte pushtetin e tij t'i zvogëlohej dhe ëndrrat t'i shkërmoqeshin në duar.

Këto ngjarje i prekën thellë hipokritët, dhe duke parë suksesin e armiqve të tyre, ata prodhonin urrejtje dhe smirë në zemra, gjë e cila i shtynte ata drejt tradhtisë. Edhe pse jo i shprehur me fjalë, qëllimi i vërtetë i Ibni Selulit ishte të dobësonte reputacionin e të Dërguarit të Zotit (s.a.s.), dhe për t'i mbajtur njerëzit sa më larg prej Tij dhe ideve që Ai shpërndante. Ebu Bekri, shoku më i afërt i të Dërguarit të Zotit, ishte objektivi i tij i parë. Në zonën e burimit të Murajsit, atij i erdhi në dorë një mundësi e artë.

Abdullah ibni Ubeji dhe miqtë e tij më të ngushtë morën pjesë vullnetarisht në Betejën e Beni Mustalikut, megjithëse ata kishin paraqitur gjithmonë justifikime për të qëndruar në Medinë gjatë betejave të mëparshme. Ata shpresonin të ekzagjeronin tensionet e vogla që kishin shpërthyer rastësisht në burimin Murajsi për të shkaktuar kështu një çarje mes ensarëve dhe muhaxhirëve. Ende jo i kënaqur, Abdullah ibni Ubej ibni Seluli ndërmoi hapa të kujdesshëm për ta fyer të Dërguarin e Zotit. Ensarët dhe muhaxhirët, të cilët kishin sakrifikuar jetën e tyre për njëri-tjetrin pa hezitim deri atë ditë, ishin kthyer gati në armiq për shkak të komploteve të tyre. Në qoftë se nuk do të kishte ndërhyrë i Dërguari i Zotit, aty padyshim që do të ishte ndezur një grindje e pafundme.

Ibni Seluli, duke parë se përpjekja e tij e parë po dështonte, vazhdoi të komplotonte rreth muhaxhirëve, në mesin e të cilëve ishte edhe i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të, dhe ai shkoi aq larg sa të thoshte se ata, me sjelljen e tyre, po kafshonin dorën që deri më sot i kishte ushqyer.<sup>182</sup> Ai gjithashtu i kërcënonte ata publikisht dhe privatisht:

---

<sup>181</sup> Buhari, *fedailu sahabe*, 5.

<sup>182</sup> Ibni Hisham, *sira*, 2/290; Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/107.

“Unë betohem në Zot, se kur të kthehem në Medinë, i denji do ta përzërë të urryerin prej andej.”<sup>183</sup> Me këtë ai nënkuptonte veten dhe të Dërguarin e Allahut.

Kur disa sahabë mendjemprehtë i kuptuan komplotet e tij, dhe u duk krejt sikur ai nuk mund të vazhdonte dot më, ai mohoi ato që kishte thënë dhe u soll sikur të ishte i pastër si dëbora. Erdhi një pikë, kur Omeri propozoi që ta vrisnin, por i Dërguari i Zotit tha:

“Jo, Omer! Pse? Që të thonë njerëzit pastaj, ‘Muhamedi është duke vrarë shokët e tij’? Kurrë!”

Pra, ishte gjëja më e mirë për t’i dhënë fund menjëherë udhëtimit të tyre dhe Profeti urdhëroi të vepronin kështu. Përkundër temperaturave të larta, ata do të ktheheshin në Medinë pa u ulur të flinin.

Mandej, Xhebraili (a.s.) erdhi dhe e informoi të Dërguarin e Zotit, një për një, për ato që hipokritët kishin bërë dhe thënë, duke shpallur saora suren Munafikun - *Hipokritët*.

Ibni Seluli, i cili kishte menduar se do të vijonte më tutje me intrigat e tij, më pas u izolua edhe nga fisi i tij dhe i braktisi të gjitha shpresat pasi u shpallën këto vargje. Njerëz të sinqertë nga fisi i tij, të cilin ai e kishte bindur për ta ndjekur, e fyen atë ashpër dhe e braktisën. Abdullahu, i biri i tij, ishte në mesin e tyre dhe ai ndjehej i turpëruar nga ajo që bënte babai i tij. Por kur një njeri i tha atij se babai i tij do të vritej, Abdullahu u mërzi të tepërmi. Ai priti për njëfarë kohe dhe pastaj erdhi tek i Dërguari i Zotit dhe i tha me hidhërim:

“O i Dërguari i Zotit, kam dëgjuar që ju doni ta vrisni Abdullah ibni Ubejin për shkak të informacionit që keni marrë për të. Nëse keni ndërmend ta bëni një gjë të tillë, ju lutem urdhëromëni mua që ta vras në vend, dhe unë do t’ju sjell këtu kokën e tij. Fisi Hazrexh e di se askush nuk është aq i ndjeshëm sa unë për të bërë mirë për babain e tij. Nëse ju ia jepni këtë urdhër një njeriu tjetër përveç meje, unë nuk mund të duroj kur ta shoh atë të cilin do të vrasë Abdullah ibni Ubej ibni Selulin të jetojë mes popullit tim, dhe unë mund ta vras. Atëherë unë do të vrisja një besimtar në vend të një jobesimtari, ndaj jam i shqetësuar se do të përfundoj në zjarr.”

Ky ishte një sugjerim për të ngrirë gjakun në venat e dikujt. Edhe pse ai ishte babai i tij, ai do ta vriste njeriun që e kishte lënduar të Dërguarin e Zotit. Por i Dërguari i Zotit ishte i mëshirshëm dhe i tha:

“Jo! Përkundrazi, për sa kohë që ai është mes nesh, trajtoje mirë dhe mundohu ta kënaqësh.”

Përkundër garancisë që mori nga i Dërguari i Zotit, zemra e tij nuk ishte ende e kënaqur. Ai e priti babanë e tij, në fillim ia shtriu të atit devenë poshtë, e tërhoqi nga këmisha dhe i tha:

“Unë nuk do të të lë të më ikësh pa më thënë: “I Dërguari i Zotit është dinjitozi dhe unë jam i urryeri.””<sup>184</sup>

Pas këtij zinxhiri ngjarjesh negative, ata vazhduan udhëtimin e tyre pa pushuar, derisa, nga ashpërsia zhuritëse e vapës, e ndjenë veten të rraskapitur. Së fundi, ata bënë një pushim, i cili nuk zgjati shumë, pasi i Dërguari i Zotit u dha urdhër të vazhdonin udhëtimin pa humbur kohë. Pas njëfarë kohe arritën ta kuptonin të gjithë se po i afroheshin Medinës.

Asgjë nuk e shqetësoi të Dërguarin e Zotit apo shokët e Tij derisa panë Safuan ibni Muatalin<sup>185</sup> i cili kishte shpejtuar hapin nga prapa me Aishen majë devesë së tij. Aishen e kishin harruar në zonën ku pushuan. Ajo ishte larguar sa për të kryer nevojat personale, dhe kishte vënë re sërish se varësja e

<sup>183</sup> Munafikun, 8.

<sup>184</sup> Buhari, *menakib*, 9.

<sup>185</sup> Safuan ibni Muattali u përgëzua nga Profeti Muhamed pagja qoftë mbi Të me fjalët: “Unë nuk di përveçse mirësi rreth tij” dhe “Personi, të cilin vetë Allahu e vesh me rroba në parajsë.”

motrës së saj kishte humbur, kështu që po kërkonte për ta gjetur. Meqenëse Aishja ishte tepër e imët, askush nuk e vuri re mungesën e saj teksa vendosën koshin e saj sipër devesë. Kur u kthye, ç'të shihte, ushtria ishte larguar! Fillimisht ajo i thirri, por askush nuk e dëgjonte, dhe ajo vetë nuk dëgjoi askënd. Ajo nuk kishte zgjidhje tjetër, pos të ulej e të priste që njerëzit të vërenin mungesën e saj, kësodore të ktheheshin për ta marrë. Pa kaluar shumë kohë, ia behu dhe Safuan ibn Muatali, i cili kishte mbetur prapa ushtrisë. Në distancë, sytë i tregonin një trup të padallueshëm, por kur iu afrua pa se ajo nuk ishte tjetër por nëna e besimtarëve, Aishja e nderuar. I çuditur, nga goja i dolën këto fjalë:

“Paskan harruar familjen e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.)!”

E trembur nga zëri, Aishja mbuloi menjëherë fytyrën e saj, por në vetvete ajo ishte e lumtur, pasi dikush kishte mbërritur, e mund ta ndihmonte për t'ia mbërritur ushtrisë.

Safuani as që ia kishte idenë se si mund të kishte mbetur pas bashkëshortja e Profetit dhe nëna e besimtarëve, andaj e pyeti:

“Allahu të mëshiroftë, si ngele këtu?”

Ndërsa e pyeste, ai mbante devenë afër. Për sahabët, nëna e besimtarëve meritonte më shumë respekt se vetë nënat e tyre. Në mënyrë që t'ia lehtësonte hipjen mbi deve, ai zbriti, e uli devenë, u largua pak mënjandë dhe i tha:

“Të lutem, urdhëro e hip.”

Teksa Aishja bënte për të hipur mbi deve, ai e mbante atë për freri në distancë. Udhëtuan në drejtim të karvanit me ushtarë, derisa ia arritën.

Ibn Seluli ishte i pari që e vërejti skenën e mbërritjes së Aishes dhe Safuanit; kjo ishte një skenë mjaft e përshtatshme për t'u përdorur prej dikujt që kërkonte medoemos të nxiste përçarje. Sytë e tij ndeshën në sytë e disa të tjerëve dhe së bashku ata filluan diç të pëshpëritnin për Aishen fisnike. Kjo nuk ishte hera e parë që hidhej baltë mbi një monument të dëlirësisë: tani Aishja i ngjante kryekreje Merjemit të nderuar.

Hipokritët planifikonin ta çarmatosnin të Dërguarin e Allahut duke e sulmuar në mënyrë të tërthortë. Duke pëshpëritur fshehurazi, ata e përhapën shpifjen duke shpresuar të shkaktonin një përçarje të re ndërmjet myslimanëve. Frika e Ibni Selulit e kishte lënduar atë keqas, por tani sytë e tij shkëlqenin prej kënaqësisë. Ky ishte një shans për të që të hakmerrej ndaj të Dërguarit të Allahut si dhe të spostonte vëmendjen nga fajet e veta nëpërmjet angazhimit të njerëzve me shpifjen ndaj Aishes. Ai shpresonte gjithashtu që njerëzit të lëkundeshin në lidhje me mesazhin e Profetit të Zotit dhe besimi tek Ai të lëkundej. Ai ishte i mbuluar me turp për veprimet e tij, por edhe fytyra i shkëlqente nga gëzimi.

Kjo ishte një shpifje sistematike. Përpara se të mbërrinin në Medinë, nuk kishte mbetur njeri i cili të mos e kishte dëgjuar. Në qoftë se e njëjta gënjeshtër përmendet kudo, njerëzit nuk dinë më se çfarë të besojnë vërtet. Në këtë mënyrë, hipokritët shpresonin të merrnin hak ndaj Profetit me urrejtjen që kishin grumbulluar përbrenda vetes për vite me radhë, dhe ëndërronin për kënaqësinë që do të arrinte shpirti i tyre në të ardhmen nga kjo mundësi e artë që u kishte ardhur në duar.

### **Sëmundja e Aishes**

Njëzet e tetë ditë kishin kaluar që nga dita kur ata ishin nisur në udhëtimin për në betejën e Beni Mustalikut. Kur ata u kthyen në Medinë, organizmi i dobët i Aishes, i pamundur të përballonte një

muaj të tërë sakrifica, u sëmur. Ajo vetë nuk e kishte idenë për shpifjen që ishte përhapur rreth saj. Por hipokritët vepronin me shpejtësi. I Dërguari i Allahut dhe familja e Aishes e kishin dëgjuar shpifjen dhe ishin lënduar. Ndoshta meqenëse as i Dërguari i Allahut e as familja e Ebu Bekrit nuk e besonin këtë shpifje, ata nuk e gjykuan të arsyeshme t'ia tregonin Aishes. Por Aishja e ndiente ndryshimin që kishte ndodhur në sjelljen e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) karshi saj. Gjatë kësaj sëmundjeje, Ai nuk po i qëndronte te koka siç kishte vepruar ngaherë. Një ditë kur Umu Rumani ishte me Aishen, Ai e pyeti shkurt për shëndetin e saj.

Aishja u prek dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, përse nuk më lejon të shkoj me nënën time për sa kohë jam e sëmurë, kështu mund të kujdeset ajo për mua?”

Profeti iu përgjigj:

“Ti e di çfarë është më e mira.”

Meqenëse Aishja nuk e kuptonte përse Profeti sillej në këtë mënyrë ndaj saj, instinkti e çoi atë në shtëpinë e prindërve. Ajo qëndroi atje, së bashku me nënën e saj Umu Rumanin, dhe pas njëzet ditëve, ajo e ndjente veten më mirë dhe mund t'i kryente vetë nevojat e veta. U ngrit nga shtrati, por nuk dinte asgjë nga ç'pëshpëritej rreth saj.

Gratë vinin ta vizitonin gjatë ditëve të sëmundjes dhe një natë ajo doli përjashta për të kryer nevojat personale me njërën nga këto gra, Umu Mistahun, një kushërirë e afërt e saja. Pikërisht në ato momente, Umu Mistahu iu përdrodh këmba dhe u rrëzua. Kur u ngrit dhe po shkundej, ajo mallkoi:

“I mallkuari Mistah!”

Aishja u shokua dhe u habit për mënyrën se si një grua e mallkonte të birin, i cili ishte aq i virtytshëm. Aishja, e cila njihej për njohuritë e thella që kishte në dijet islame, e ndjeu se duhej të ndërhynte për të ndrequr një gabim të tillë, andaj iu drejtua menjëherë asaj:

“Për Zotin! Çfarë gjërash të tmerrshme po thua rreth një njeriu i cili vjen nga gjiri i emigrantëve dhe ka qenë pjesëmarrës në Luftën e Bedrit?”

Umu Mistahu e shikoi tërë habi Aishen. Djali i saj Mistahu ishte një nga ata të cilët po e përhapnin këtë shpifje. Pas një heshtjeje, ajo e pyeti:

“O e bija e Ebu Bekrit, a nuk e ke marrë vesh se çfarë po thuhet për ty? Si ka mundësi, që një besimtare e merr një situatë të tillë me naivitet? Apo me të vërtetë nuk ke dëgjuar për atë që ka ngjarë?”

Edhe pse pyetja e futi në një oqean mëdyshjesh, Aishja as që nuk ia kishte idenë se ç'mund të kishte ndodhur. Ajo e pyeti:

“Çfarë është thënë? Për çfarë situatë e keni fjalën? Unë nuk di asgjë.” - dhe shihte me habi fytyrën e Umu Mistahut. Vështrimi i saj thoshte: “Tregomë menjëherë çfarë ka bërë vaki!”

Kështu që, Umu Mistahu nuk kishte zgjidhje tjetër, veç t'ia niste nga të treguarit:

“Për ty kanë dalë... disa... fjalë.”

Dhe i tregoi gjerë e gjatë, për shpifjen dhe ngatërresat, qysh nga fillimi e deri ç'kishte ndodhur mandej.<sup>186</sup>

---

<sup>186</sup> Ibni Hisham, *sira*, 2/464.



Ishte krejtësisht e pabesueshme. Aishes së nderuar, tanimë po i dukej sikur gjaku që e kishte ndjerë përherë tek i lëvizte ndër deje, po i ngrinte me acarim. Sëmundja, e cila ishte drejt shërimit, tani iu dyfishua, sytë iu mbushën me lot dhe zemra i ishte e plagosur. Ajo kishte vështirësi në frymëmarrje, dënesat e saj ishin mbytëse.

Ajo nuk kishte më forcë as të lëvizte këmbët, dhe ishte në gjendje të fikëti.

“A me të vërtetë ka ndodhur e gjithë kjo?” - e pyeti ajo.

Kjo ishte fjalja e fundit përpara se të binte pa ndjenja përdhe.

Pas pak, arriti të vinte në vete me një mundim të madh. Por përsëri nuk e kontrollonte krejtësisht veten. Ajo tha:

“Lëvduar qofsh o Allah! Si është e mundur që njerëzit t’ua nxërë goja e ta thonë diçka të këtillë?”

I kërkoi ndihmë Umu Mistahut, dhe u nis për t’u kthyer në shtëpinë e prindërve. Tanimë e ndjente veten të rraskapitur, dhe megjithëse dëshironte të mbërrinte sa më shpejt në shtëpi, këmbët nuk i bindeshin.

Kur mbërriti në shtëpi shkoi tek e ëma dhe e qortoi:

“Allahu të bekoftë! Përse nuk më ke treguar se njerëzit pëshpëritin për mua ndërmjet veti?”

Umu Rumani ishte tip i qetë, e pjekur dhe me një karakter të fortë. Në këto rrethana, ishte e nevojshme që të sillej me qetësi. Ajo filloi ta ngushëllonte butësisht vajzën e saj:

“O vajza ime e dashur, pak më ngadalë. Allahu do të të lehtësojë. Beto hem në Zot, se nuk ekziston një grua aq e bukur sa ti, e cila të jetë kaq e dashur sa ti nga burri i saj, dhe e cila gjithashtu t’i ketë shoqe gratë e Tij. Në këto rrethana a nuk mund të gjenden njerëz që shpifin kundër teje për të të turpëruar? Natyrisht që një situatë e tillë shoqërohet me shumë thashetheme.”<sup>190</sup>

Umu Rumani kishte të drejtë në këtë pikë, por kjo shpifje që po qarkullonte nuk ishte e atij lloji që edhe mund të tolerohej. Kaluan shumë net, por Aishja nuk ishte në gjendje të flinte.

Safuani kishte dëgjuar për shpifjen për të cilën atë e kishin akuzuar, dhe kishte mësuar se disa prej myslimanëve e kishin besuar atë. Ai shkoi tek njëri prej tyre, Hasan ibni Thabiti dhe u grind me të. Mosmarrëveshjet e tyre arritën deri në atë pikë sa që puna shkoi deri tek i Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi Të.

Ebu Bekri, i cili deri atë ditë e kishte ndihmuar dhe i kishte dhënë lëmoshë Mistahut, ndryshoi mendje. Kur dëgjoi se Mistahu e kishte përhapur shpifjen, ai tha se kurrë nuk do t’i jepte më sadaka atij njeriu.

Hipokritët, duke parë ecurinë e ngjarjeve, u kënaqën tej mase, sepse në të kaluarën e afërt, ndërkohë që ktheheshin nga Beni Mustaliku, kishin qenë objekt kritikash, kurse tani ishin harruar krejt prej myslimanëve.

### **Reagimi i sahabëve dhe besimi**

Thashethemi i hutoi edhe sahabët gjithashtu, edhe pse shumë pak prej tyre e merrnin në konsideratë dhe i besonin asaj shpifjeje. Shumica dërmuese thoshte:

“Lëvduar qoftë Allahu! Kjo është një shpifje e tmerrshme.”

Shumë prej tyre madje nuk e honepsnin nocionin se mund të bëhej fjalë që Aishja të kishte kryer shkelje të kurorës. Ata që besonin me tërë zemër në dëlirësinë dhe pastërtinë e Aishes, nuk reshtën asnjëherë së mbrojturi atë. Në fund të një dite të lodhshme, e shoqja e pyeti Ebu Ejub el Ensarin:

“A e ke dëgjuar ç’thonë njerëzit për Aishen?”

Megjithëse ai i kishte dëgjuar, u soll sikur të mos kishte dëgjuar asgjë prej gjëje, sepse e dinte mirë se kush e kishte përhapur i pari shpifjen dhe përse. Ai e dinte se një femre, e cila ishte bërë gruaja e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), nuk do t’i shkonte kurrë ndër mend një gjë e tillë. Ai tha:

“E kam dëgjuar, por nuk është e vërtetë.”

Ndoshta ai kishte frikë se e shoqja mund të ndikohej nga një shpifje e tillë, ose dëshironte që edhe ajo të ishte kundër një shpifjeje të tillë. Ai tha:

“O Umu Ejub, për hatër të Zotit të Madh, më thuaj, a do ta kishe bërë ti një gjë të tillë?”

Ajo u tmerrua vetëm nga ideja, sepse ata që besojnë në Zotin dhe në botën tjetër nuk do të binin kurrën e kurrës në një shthurje të tillë, ndaj ajo u përgjigj me një vrull të veçantë:

“Betohem në Allah se nuk do ta bëja kurrë një gjë të tillë.”

Ebu Ejubi, me një vështirësi të mprehtë, i tha:

“Mos harro se Aishja është më e virtytshme se ti.”

Në ajetet që do të shpалleshin më vonë, Zoti i Plotfuqishëm do shprehej se Ai ishte i kënaqur me ata si puna e Ebu Ejubit, që u shprehën me vendosmëri kundër shpifjes, dhe se besimtarët duhet të reagojnë gjithmonë në këtë mënyrë ndaj shpifjeve të kësaj natyre.

I Dërguari i Allahut ishte i shqetësuar rreth mungesës së Xhebrailit dhe trishtëhej kur mendonte se ende nuk kishte ndonjë shpallje në lidhje me këtë çështje. Zakonisht, shpalljet hyjnore vinin shpejt në rrethana të tilla, që e sqaronin çdo gjë plotësisht. Ndoshta Allahu i Madhëruar ishte duke përgatitur terrenin për zbritjen e shpalljes, në mënyrë që mesazhi të çimentohej plotësisht në mendjet e besimtarëve myslimanë.

Heshtja u dha më tepër zemër shpifësve, kësodore ata mundën madje t’ia mbushnin mendjen edhe disa besimtarëve në mes të myslimanëve. Situata kërkonte ndërhyrje të menjëhershme. Një ditë, pas namazit, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u kthye nga sahabët dhe u tha:

“O umeti im! O bashkësi e besimtarëve, çfarë ta ketë shtyrë atë njeri që na ka shkaktuar gjithë këtë trazim, mua dhe familjes sime? Unë nuk di asgjë tjetër përveçse të mirave për familjen time. Gjithashtu njeriu për të cilin shpifet, nuk ka ardhur kurrë në shtëpinë time kur unë të mos kem qenë aty.”

I Dërguari i Zotit ishte i lënduar thellë dhe sahabët nuk donin të lejonin më tej ekzistencën e kësaj gjendjeje, por jo të gjithë e dinin se cili ishte njeriu për të cilin fliste ai. Udhëheqësi i fisit Eus, Sad ibni Muadhi, u ngrit dhe tha:

“O i Dërguari i Zotit. Unë mund ta zgjidh këtë problem dhe t’ju sjell lehtësimin. Nëse ky njeri është prej fisit tim, unë do t’ia pres kokën! Nëse ai është nga fisi tjetër, Hazrexhët, të cilët janë vëllezërit tanë, ne do të bëjmë çfarëdo që ti të na urdhërosh.”

I prekur nga kjo deklaratë që përfshinte mbarë fisin e tij, Sad ibni Ubade u tensionua shumë, dhe ashtu u ngrit, me sa duket, duke e ditur se cili ishte fajtori. Ai iu përgjigj kështu kreut të fisit të Eusëve:

“Ti nuk e ke fuqinë të vrasësh njeri! Ti flet kështu, sepse e di se fajtori është prej Hazrexhit. Ti nuk do të flisje në këtë mënyrë nëse ai do të ishte prej fisit tuaj!”

Kështu u tha atë ditë që i Dërguari i Allahut po mbante hutben e xhumasë dhe tani situata po degjeneronte drejt një konflikti. Pastaj kushëriri i Sad ibni Muadhrit, Usejd ibni Hudajri u ngrit në këmbë dhe iu kundërvu Sad ibni Ubades, duke e akuzuar atë se po mbante anën e hipokritëve.

“Sigurisht që do ta vrasim. Betohej në Allah, se ai që ka shkaktuar tërë këtë zullumahi, meriton t’i pritët koka!”

Atmosfera u shtendos tejte shumë, sikur të kishin ekzistuar njëqind vjet tension. Problemi i vërtetë gati u harrua dhe krenaria fisnore u shfaq në mesin e fiseve Eus dhe Hazrexh. Ishte e pamundur për njerëzit që të mendonin me qetësi kur ndjenjat acaroheshin kështu. Atë ditë, askush nuk mundi të toleronte sadopak deklarata të tilla; palët ishin ndarë dhe një sherr u shfaq në horizont. Me sa dukej do të kishte një tjetër luftë mes fiseve Eus dhe Hazrexh, gjë e cila sigurisht ishte pikësynimi i vërtetë i hipokritëve.

Qetësimi i gjakrave ishte përsëri detyrë e të Dërguarit të Zotit paqja qoftë mbi Të, andaj Ai u kërkoi të dyja palëve që të heshtnin. I dha fund predikimit, dhe u nis në drejtim të shtëpisë.

Një të mbërritur, Ai thirri Usamen dhe Aliun që të këshillohej me ta. Ai nuk kishte dyshime në pafajësinë e së shoqes, Aishes, sepse çështja ishte e qartë si drita e diellit. Por i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të dëshironte të përfshinte edhe opinionet e të tjerëve në vendimmarrjen e Tij, sepse dëshironte që pastërtia e saj të dilte në pah faqe të gjithëve.

“O i Dërguari i Zotit. Ne nuk dimë asgjë tjetër përveçse vepra të mira në lidhje me Aishen, gruan tënde. Këto janë patjetër gënjeshtër dhe shpifje të pabaza!” - foli Usameja me vendosmëri.

Atëherë vështrimi i të Dërguarit të Allahut ra natyrshëm mbi Aliun. Aliu e kuptoi se i Dërguari i Zotit ishte në pritje të përgjigjes së tij, por në atë çast nuk ishte në gjendje të mendonte për ndonjë gjë tjetër përveç trishtimit që Profeti ndjente, dhe të cilin ai dëshironte ta çlironte. Ai e ndjente se kënaqësia e të Dërguarit të Zotit ishte më e vlefshme se e tërë bota dhe çdo gjë që ekzistonte mbi të, dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut përse e fut veten në kaq vështirësi? Allahu i Plotfuqishëm të mbrojtë nga përjetimi i vështirësive të mëtejshme. Ka plot gra të tjera përveç saj. Pse nuk e pyet këtë shërbëtoren, unë jam i sigurt se ajo do të të thotë diçka që të bën të ndjehesh më mirë.”

Fjalët e tij kishin kuptimin, “unë po mendoj vetëm për të mirën tënde, jo për veten time, ndoshta ti mund të pyesësh për Aishen ato të cilat e njohin atë më mirë.” Kështu, i Dërguari i Allahut e thirri shërbyesën e quajtur Berire, dhe e pyeti:

“A ke vërejtur ndonjë gjë që të ka bërë të dyshosh tek Aishja?”

Berire e ndjeu se kishte një përgjegjësi mjaft të rëndë, meqë u bë pjesë e këtij hetimi dhe u skuq. Ajo u përgjigj mjaft seriozisht:

“Unë betohem për Zotin që të ka dërguar të vendosësh drejtësi, që jo. Unë nuk di asgjë tjetër rreth saj, përveç mirësisë. Unë kurrë nuk kam vërejtur as edhe një të metë sado të vogël për të cilën të mund ta kritikoj. E vetmja gjë që di është se një ditë, kam lënë ca brumë tek Aishja dhe ajo ra në gjumë pranë tij, e pastaj një dele erdhi dhe e hëngri atë brumë. Për sytë dhe veshët e mi, Aishja është e dëlirë, e pastër dhe e ndershme si ari.”

Kjo ishte një dëshmi e përsosur, por i Dërguari i Zotit nuk e la me kaq, Ai kërkoi gjykim edhe prej shumë të tjerëve.

I Dërguari i Zotit (s.a.s.) vendosi që të konsultohet edhe me gratë e tjera të tij, dhe ai zgjodhi Zejneb binti Xhahshin, me të cilën Aishja kishte ca ndjesi konkurrence. Ai gjithashtu e kishte

zgjedhur Zejnebin, sepse motra e saj, Hamne, i kishte besuar thashethemeve të ngritura rreth Aishes. Ai e pyeti:

“O Zejneb, po ti, çfarë më thua? A ke dëgjuar ndonjëherë ndonjë gjë të keqe për të?”

Ajo gjithashtu u përgjigj se nuk kishte dëgjuar asgjë, veç të mirave për Aishen.<sup>187</sup>

### **Sihariqi**

Pasi kishin kaluar disa ditë, i Dërguari i Allahut erdhi tek shtëpia e Ebu Bekrit dhe pasi i përshëndeti njerëzit e shtëpisë u ul. Kjo ishte vizita e Tij e parë tek ata pasi ishte kthyer nga Beni Mustaliku.

Në atë kohë, Aishja ishte në dhomën tjetër me të ëmën duke qarë dhe duke iu lutur Krijuesit të Gjithëmëshirshëm në lidhje me shpifjen. Bashkë me të ndodhej një grua nga ensarët, prej së cilës Aishja përpiquej që të nxirrte sa më tepër detaje, të cilat ajo nuk kishte arritur t'i merrte nga nëna dhe babai i saj.

Pasi fali namazin aty, Profeti ynë i Dashur, u kthye nga Aishja dhe i foli. Ai kërkoi nga ajo që t'i tregojë Atij të vërtetën, dhe në qoftë se ajo me të vërtetë e kishte bërë një gjë të tillë, Ai do të kërkonte falje për të tek Allahu. Ai gjithashtu i tha se në qoftë se një gjë e tillë nuk ka ndodhur, dhe nuk kishte asnjë dyshim për këtë, atëherë Allahu i Plotfuqishëm do të dërgonte shpallje për të vërtetuar pastërtinë e saj. Ai arriti në përfundime, duke thënë se në qoftë se një rob i Allahut e pranon fajin e Tij dhe pendohet tek Zoti, atëherë i Plotfuqishmi ia pranon pendimin robit të tij.

Çdo fjalë e të Dërguarit të Zotit po e godiste Aishen si një vare. Edhe pse fjalët e Tij ishin pohime të sihariqit, kjo bisedë e kishte shkatërruar Aishen për faktin se Ai e kishte përmendur edhe shkeljen e kurorës si një mundësi, kur ajo do të sakrifikonte me dëshirë jetën e saj për Të. Ajo ndjehej e rraskapitur. As lot nuk i kishin mbetur më për të qarë, gjaku ndër vena i ishte tharë krejt.

Aishja çuditej se si mund të bisedonte dhe t'i ndante problemet e saj me Të, në qoftë se i Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi Të e shikonte çështjen nga një këndvështrim i tillë.

Me gjuhë të lidhur, Aishja e ndjente veten të mpirë dhe për një çast mendoi se zemra e saj do ndalej vendit. Ajo shikonte në fytyrat e të atit dhe të së ëmës, duke u lutur në heshtje, që ata të mos e linin në baltë. Por ata rrinin të heshtur dhe vetëm thanë:

“Betohemi në Zot, se ne nuk e dimë se si t'i përgjigjemi të Dërguarit të Allahut.”

Prej shpifjes ishin ndikuar sadopak, qoftë edhe njerëzit e saj më të shtrenjtë, familja. Ajo u kthye nga i Dërguari i Allahut, dhe filloi të fliste me kurajë:

“Unë betohem për Zotin, se kurrë nuk do të pendohem ose të kërkoj falje për këtë çështje. Zoti e di se kjo shpifje nuk është e vërtetë, dhe se unë jam tërësisht e pastër; në qoftë se unë do të pendohesha për atë që njerëzit thonë për mua, kjo do të thotë të pendohem për diçka që nuk ka ndodhur. Nëse unë e mohoj atë, duke thënë: “ky incident nuk ka ndodhur,” ju prapëseprapë nuk keni për të më besuar. Asgjë tjetër nuk më vjen në mendje tani, përveçse gjendja e babait të Jusufit, kështu që unë do të them ato fjalë që ka thënë ai: *‘Halli im është! Do bërë durim i mirë. Allahu është Ai, nga i Cili kërkohet ndihmë për diçka të tillë.’*”<sup>188</sup>

---

<sup>187</sup> Buhari, *shehadet*, 15.

<sup>188</sup> Jusuf, 18.

Asaj tashmë i ngelej vetëm një mundësi. Ajo iu lut të Vetmit, i Cili është gjithçka për ata që nuk kanë askënd. Ajo donte që pafajësia e saj të njihej edhe prej Profetit. Ajo kishte bindje të plotë se lutja nuk do t'i refuzohej, kështu që vazhdonte t'i drejtohej veç Allahut (xh.xh.).

Pak më vonë, asaj i tërhoqi vëmendjen një ndryshim në gjendjen fizike të të Dërguarit të Allahut; bulëza djerse u shfaqën në fytyrën e Tij. Mund të kuptohej lehtë nga pamja e Tij se atij po i vinte një mesazh hyjnor nga Xhebraili (a.s.), i Cili nuk ishte shfaqur për një muaj rresht. Ngjante sikur nga çasti në çast Atij do t'i dilte shpirti nga barra e rëndë e marrjes së këtij mesazhi. Aishja filloi të shpresonte. Dera e së vërtetës ishte hapur; po vinte një mesazh i ri për t'i dhënë njëherë e mirë zgjidhje kësaj çështjeje. Ajo nuk mund të shihte dot as prindërit e saj, fytyra e të cilëve ishte zbehur prej ankthit. Zemrat e tyre mezi rrihnin, të shqetësuara se mos zbriste ndonjë shpallje që konfirmonte të vërtetën e shpifjes. Por Aishja ishte e qetë, sepse ajo e dinte që një ditë do të vinte drejtësia hyjnore e do të shfaqej.

Më pas gjendja e të Dërguarit të Zotit(s.a.s.) u kthye në normalitet dhe Ai i shikoi njerëzit e familjes së Ebu Bekrit, duke fshirë pikat e djersës që ishin mbledhur mbi ballin e Tij. Vendin e pikëllimit të deriatëhershëm e zuri gëzimi dhe ata të gjithë mundën të vërenin se si shpërndaheshin retë e zeza një e nga një nga fytyra e të Dërguarit të Allahut, sepse Ai tashmë po buzëqeshte. Ai kishte fituar sërish qetësinë e munguar për shkak se hipokritët ishin munduar ta kthenin qytetin përmbys nga poderja. Ai iu drejtua Aishes me një zë të butë:

“Kam lajme të mira për ty, o Aishe! Allahu i Plotfuqishëm shpalli një ajet ku thuhet se ti je e pastër dhe larg gjithë atyre shpifjeve. Ngrehu dhe falënderoj Allahun!”

Asgjëmangut, mori fund një muaj i tërë telashesh. Ajo që Aishja kishte pritur, u shpall. Sytë e Aishes shndritën prej gëzimit. Ajo tha:

“Lëvduar qoftë Allahu!”

Si Ebu Bekri ashtu edhe gruaja e tij Umu Rumani u qetësuan. Duke përjetuar kënaqësinë e të Dërguarit të Allahut, Umu Rumani u kthye tek Aishja, vajza e saj dhe nëna e besimtarëve, dhe i tha:

“Ngrihu dhe falënderoj të Dërguarin e Allahut.”

Por në atë moment, Aishja ishte trazuar prej ndjenjash të trazuara. Pastërtia dhe ndershmëria e saj ishin konfirmuar drejtpërdrejt nga vetë Allahu i Plotfuqishëm dhe e tillë do të mbetej përgjithmonë deri në fundin e botës. Ajeti përgënjeshtroi direkt shpifjet që ishin përhapur rreth saj një muaj me radhë. Ajo i ndjehej mirënjohëse vetëm Allahut, për ndihmën që i dha, andaj tha:

“Jo, unë nuk do ta falënderoj atë. Unë falënderoj vetëm Allahun e Plotfuqishëm, dhe vetëm Atij i lutem.”<sup>189</sup>

Që nga ai çast, në Kuran kanë ekzistuar vargje posaçërisht për Aishen, duke i informuar besimtarët e çdo epoke në lidhje me pastërtinë e jetës së saj.

I Dërguari i Zotit (s.a.s.), doli i ngazëllyer për t'ia bërë të njohura vargjet e shpallura popullit, duke i recituar ato si më poshtë:

*“S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen, janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që barti pjesën më të madhe (të shpifjes) i takon dënimi më i madh.”<sup>190</sup>*

---

<sup>189</sup> Buhari, *shehadet*, 85.

<sup>190</sup> Nur, 11.

Sahabët morën frymë thellë, sepse të gjithë e dinin se kush bënte pjesë në atë grup. Por ata vetë e kishin ruajtur gjuhën e tyre dhe kurrë nuk i ndotën zemrat në atë batac. Por ajeti në vijim kishte të bënte edhe me ta: *“E përse kur e dëgjuan atë (shpifje) besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thonin: ‘kjo është një shpifje e qartë!’?”*

Me sa duket, duke zgjedhja e një paramendimi të mirë është e domosdoshme. Është e nevojshme të mbyllet veshët ndaj një thashethemi përpara se vërtetësia e tij të bëhet e njohur. Rruga më e sigurt për myslimanët ishte që të besojnë në pafajësinë e dikujt derisa faji të vërtetohet. Vargu në vijim që u adresohet shpifësve ishte si një shuplakë në fytyrat e tyre: *“Përse ata nuk i sollën katër dëshmitarë për këtë? E derisa nuk sollën dëshmitarë, ata pra të Allahu janë shpifës.”*

Në mënyrë që një grua të mund të akuzohet për shkeljen e kurorës, duhet të ketë të paktën katër dëshmitarë, ose akuzuesi supozohet të jetë fajtor për shpifje, për të cilën do të dënohet si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën. Edhe në Ditën e Gjykimit, një shenjë e pashlyeshme mbi ballin e tij do të tregojë se ai është një gënjeshtar, që të mbahet mend përgjithmonë si i tillë. Megjithatë Aishja kishte vuajtur shumë për një muaj, ajo kishte fituar bekime hyjnore për shkak të lëndimit të saj të pamerituar. Për shkak të këtij incidenti, ishin shpallur shumë direktiva fetare që kishin të bënin veçanërisht me jetën shoqërore myslimane. Gjykimet e bazuara mbi dyshime do të eliminoheshin dhe do të themelohej një model i ri shoqëror i bazuar në virtutin.

Ishte e rëndësishme për sahabët për të treguar solidaritet mes tyre në raste të diskutueshme, sepse i Dërguari i Zotit ishte në mesin e tyre. Për hir të Profetit, ata ishin të siguruar nga fatkeqësitë natyrore që u kanë ndodhur shoqërive të tjera rebele. Vargjet vazhdojnë si më poshtë: *“E sikur të mos ishte mëshira e Allahut dhe mirësia e Tij ndaj jush, në këtë dhe në botën tjetër, ju do t’ju kapte dënim shumë i madh për shkak të asaj në të cilën u hodhët.”*<sup>191</sup>

Atëherë sahabët e kuptuan se ata duhet ta falënderojnë Allahun për ato bekime që u kishte dhuruar. Ata gjithashtu e kuptuan se mëkatet duhet të merreshin seriozisht dhe të mos konsideroheshin kurrë si të parëndësishëm, duke e ruajtur veten qysh në fëmijëri, përpara se të arrinin moshën e pjekurisë.

Kurani u drejtohet edhe atyre të cilët e kishin dëgjuar shpifjen, por nuk i kishin kushtuar rëndësi:

*“Kur ju atë (shpifjen) e përcollët me gjuhën tuaj dhe për atë që nuk kishit kurrfarë dijeje, flisnit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme, ndërsa te Allahu ajo është e madhe. E përse kur e dëgjuat atë nuk thatë: ‘ne nuk na takon të flasim për këtë. I lartë je Ti, kjo është shpifje e madhe!’ Allahu ju këshillon që një gjë e tillë të mos përsëritet kurrë, nëse jeni besimtarë të denjë. Allahu sqaron për ju argumentet, sepse Ai është i Dijshëm, i Urtë.”*<sup>192</sup>

Kurani e përshkruan Jusufin (a.s.) dhe Merjemen si shembuj të dëlirësisë dhe pastërtisë, dhe si njerëz për të cilët është shpifur. Aishja ishte e ngjashme me ta. Ajo u quajt “gruaja besnike” dhe trajtohej si “e bija besnike e njeriut besnik” duke iu referuar kështu të atit, Ebu Bekrit. Ishte nxënësi i saj, Imam Masruku ai që i dha titullin e dytë. Të tjerë e quajtën atë “gruaja besnike (Sidika) Aishe.”

Si në rastin e Jusufit (a.s.) dhe të Merjemes, edhe Aishja u vu në provë, duke u akuzuar për tradhti bashkëshortore përkundër dëlirësisë së saj, dhe tregoi se e meritonte plotësisht titullin e saj për shkak të besnikërisë dhe durimit që tregoi. Ashtu si Merjemja, Aishja kishte lindur në një shtëpi ku adhurimi i Allahut ishte i endur në pëlhurën e përditshme të jetës. Pastaj ajo u bë gruaja e të

<sup>191</sup> Nur, 14.

<sup>192</sup> Po aty, 15-18.

Dërguarit të Zotit, shërbëtorit më të dashur të Tij dhe kurrë nuk u martua me ndonjë burrë tjetër përveç Tij, edhe pas vdekjes së Profetit. Ajo ishte objekt i shpifjeve të hipokritëve dhe aleatëve të tyre, të cilët dëshironin të përbaltnin reputacionin e saj të pastër. Muaji i saj i trazuar u mbyll me një shpallje pafajësie. Ashtu si edhe për dy të tjerët, pafajësia e saj është bërë e qartë nga Zoti i Plotfuqishëm - edhe pse në rastin e Jusufit (a.s.), ai u justifikua nga dikush afër tij, dhe në rastin e Merjemes, ajo u lirua nga akuzat nga djali i saj foshnjë - Aishja u shpall e pafajshme nga fjalët e drejtpërdrejta të Zotit në Kuran. Kjo i dha një rëndësi të veçantë asaj si gruaja e të Dërguarit të Fundit të Allahut.

## **AISHJA DHE BASHKËSHORTET E TJERA TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT**

Gratë që kishin fatin e madh për t'u bërë bashkëshortet e robit më të dashur të Allahut ishin nënat e besimtarëve, një titull i dhënë atyre direkt nga Zoti i Plotfuqishëm. Por ato ishin qenie njerëzore. Ato nganjëherë mendonin ndryshe nga njëra-tjetra, dhe kështu marrëdhëniet mes tyre ndikoheshin nga këto gjëra. Por gjithsecila prej tyre e kishte nga një arsye për sjelljet e veta dhe secila duhet të llogaritet në përputhje me kohën dhe situatën specifike. Përndryshe, çdo gjë, që nga mënyra se si njerëzit i drejtoheshin njëri-tjetrit, se si komunikonin e kështu me radhë, do të keqkuptohej dhe vlera e këtyre grave fatmira nuk do të mund të kuptohej.

Këto gra të bekuara ishin të besuarat e të Dërguarit të Zotit dhe të sahabëve në rrugën e Zotit. Në fjalën e tyre, ashtu si edhe në heshtjen e tyre, fshihej dituria. Çdo vlerësim i cili nuk e njeh vlerën e tyre, apo ndonjë interpretim i bërë duke nxjerrë fjalët prej kuptimit kontekstual, nuk ka asnjë përfitim tjetër përveçse të tregojë injorancën e të tillë interpretuesve dhe komentuesve. Tani kur ne

analizojmë bisedat e Aishes dhe marrëdhëniet e saj me gratë e të Dërguarit të Zotit, dalin në pah dy situata të veçanta - njëra me Hatixhen, dhe tjetra me pjesën tjetër të nënave të besimtarëve.

## Hatixhja

Hatixhja vdiq përpara se i Dërguari i Zotit të martohej me Aishen, kështu që ato nuk jetuan një jetë të përbashkët, dhe kurrë nuk i ndanë ditët e Tij me njëra-tjetrën. Pavarësisht nga kjo, Aishja e kishte zili Hatixhen më tepër nga të gjitha gratë në mesin e grave të të Dërguarit të Zotit, sepse në vetvete ajo ishte e dashura e rinisë së Tij dhe këshilltarja e Tij e vetme gjatë atyre viteve të vështira. Gjatë pesëmbëdhjetë viteve që ata kaluan së bashku përpara shpalljes, ajo ishte partnerja e Tij besnike. Në mjedisin kaotik të shpalljeve të para, ajo ishte përkrahësja e Tij më e madhe. Në fund, duke qenë një grua e fortë dhe e palëkundur, ajo ishte ndihmësja e Tij më e fuqishme. Vdekja e saj përkoj me fundin e periudhës së vështirë. I Dërguari i Zotit kurrë nuk harroi gruan e Tij të parë, me të cilin Ai ishte aq i afërt dhe me të cilin Ai kaloi ditët e Tij më të trazuara. Në çdo rast që i jepej, Ai e kthente bisedën nga Hatixhja, edhe gjatë momenteve kritike.

Njëherë Ai u trondit kur pa gjerdanin që vajza e Tij, Zejnebja, kishte dërguar për të shpëtuar të shoqin, pra dhëndrin e Profetit, Ebu Asin, i cili ishte në mesin e robërve të luftës së Bedrit. Profeti u prek sepse iu kujtua se kjo ishte një dhuratë për martesën e tyre nga Hatixhja. Gjerdani i ndezi kujtimet Profetit, duke i kujtuar sakaq Hatixhen siç kishte qenë në ato ditë. Pas pak ai u kthye nga njerëzit e tjerë dhe u kërkoi ta linin të lirë burrin e Zejnebes, si dhe t'ia rikthenin gjerdanin përsëri asaj.<sup>193</sup> Ebu Asi u lirua për hir të kujtimit të Hatixhes.

Situata nuk ndryshoi as në vitet e mëvonshme. Gjatë triumfit të Mekës, kur Ai po ecte së bashku me mijëra njerëz nëpër qytet, njerëzit vërejtën se Ai ndryshoi drejtim dhe u nis për në Haxhun. Njerëzit e panë me kureshtje dhe përsëri u bënë dëshmitarë të një shembulli besnikërie, sepse Profeti po shkonte të vizitonte varrin e gruas së Tij të dashur, Hatixhes. Përpara se të hynte në Mekë, një ngjarje kjo që ndryshoi historinë, Ai u lut për një kohë tepër të gjatë mbi varrin e saj.

Dashuria dhe besnikëria e Tij vazhduan deri në vdekje. Kur i vinte ndonjë dhuratë, Ai do t'ia dërgonte së pari të afërmeve të Hatixhes. Ai i nderonte dhe tregonte shumë respekt për ta, duke iu dhënë madje edhe jastëkun në të cilin ulej. Kur dikush e pyeti për këtë sjellje, Ai i tha:

“Unë i dua ata të cilët i ka dashur edhe ajo.”<sup>194</sup>

Ai nuk lejonte kurrë të flitej keq për Hatixhen dhe menjëherë ndërhynte nëse ndokush e bënte një gjë të tillë. Një ditë, kur ra fjala për Hatixhen, Aishja i tha me përkëdheli:

“Sikur nuk ka ekzistuar njeri tjetër në botë, veç Hatixhes!”

Këto fjalë e fyen të Dërguarin e Allahut dhe Ai u kthye drejt Aishes duke i përmendur asaj cilësitë e Hatixhes një e nga një. Pastaj Ai shtoi se prej saj kishte pasur edhe fëmijët, të cilët ia kujtonin përherë bashkëshorten e dashur.<sup>195</sup>

Një ditë, ndërsa i Dërguari i Allahut ishte duke ndenjur në shtëpi, dikush trokiti në derë. Ai vrapoi ta hapte duke thënë:

“O Zoti im, Hale, e bija e Huvejlidit, erdhi Hale!”

<sup>193</sup> Ebu Davud, *xhihad*, 121; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/276.

<sup>194</sup> Jamani, *Ummul Mu'mininun*, 13.

<sup>195</sup> Buhari, *fedailu sahabe*, 50.



Ai kishte njohur zërin e motrës së Hatixhes, Hales. Edhe një herë tjetër, i Dërguari i Allahut u krodh në të shkuarën përmes zërit të saj dhe ndërkohë që ajo kërkoi leje të hynte brenda, Ai në të vërtetë vërente Hatixhen në personalitetin e së motrës.

Aishja, e cila e vuri re këtë ngazëllim të tij, e shikonte me habi dhe admirim. I Dërguari i Allahut ende e donte Hatixhen nga thellësia e zemrës. Nëse Ai kishte pasur këtë grua aq të vyer në krah të Tij, asaj nuk do t'i duhej të shqetësohej as për këtë botë e as për tjetrën. Ajo ishte një dashuri rraskapitëse, kështu që Aishja kërkoi të dinte sekretin e saj dhe arsyet e vërteta që qëndronin prapa kësaj dashurie, ndaj e pyeti:

“Cila është arsyeja e vëmendjes tënde për këtë grua, e cila ka vite që ka vdekur e të ka lënë? Allahu i Madhëruar të ka bekuar me gra më të reja e më të këndshme që nga ajo kohë!”

Pyetja e saj e shfaqte hapur atë që ajo po bluante në mendje; Aishja dëshironte që Ai t'i shpjegonte dashurinë e Tij për Hatixhen. Ishte e pamundur që një grua aq e mprehtë sa Aishja të mos e kuptonte se si ndjehej Ai, por me shumë gjasa, ajo dëshironte ta dëgjonte drejtpërsëdrejti nga goja e Tij vlerën e Hatixhes.

I Dërguari i Allahut përsëri u mërzit dhe me një zë që tregonte pakënaqësi e pyeti:

“A ka pasur ndonjë tjetër si ajo? Betohem në Allah se Ai kurrë nuk më ka dhënë ndonjë më të mirë se ajo! Kur njerëzit ngulnin këmbë në mosbesim, ajo erdhi tek Unë dhe besoi. Kur njerëzit më akuzuan për gënjeshtar, ajo konfirmoi ato që Unë thoja. Kur njerëzit m'i morën pronat, ajo më solli gjithçka kishte dhe m'i dha Mua. Dhe Allahu nuk më dha fëmijë me asnjërën përveç saj.”<sup>196</sup>

Aishja e mori përgjigjen që kërkonte. Ajo zinte një vend të veçantë në krah të të Dërguarit të Allahut por ta doje atë nuk do të thoshte të mos i doje të tjerat. Falë kuriozitetit të Aishes, Hatixhja u bë e njohur në të gjithë umetin mysliman si një person për të cilin nuk mund të thuhej asgjë negative.

Pastaj Aishja i kërkoi falje të Dërguarit të Allahut. Ajo premtoi se nuk do të thoshte kurrë më ndonjë gjë kundër Hatixhes.<sup>197</sup> Allahu i Madhëruar e bekoi Hatixhen me një lloj dashurie, të cilën asnjëra nuk mundi ta fitonte kurrë. Ajo qëndroi me të Dërguarin e Allahut edhe pas vdekjes së saj. Aishja do t'i shprehte kështu ndjenjat e saj për Hatixhen: “Megjithëse unë nuk jetova kurrë bashkë me Hatixhen, nuk kisha zili asnjërën prej grave të tjera të të Dërguarit të Allahut më shumë sesa Hatixhen. I Dërguari i Allahut e përmendte aq shpesh atë dhe fliste për të kaherë me dashuri dhe admirim. Kurdoherë që therte ndonjë dele, një pjesë të mishit do t'ia dërgonte të afërmeve të Hatixhes.”<sup>198</sup>

### **Bashkëshortet e tjera të Të Dërguarit të Allahut**

Vite më vonë, pas vdekjes së Hatixhes, Seudeja do të ishte gruaja e parë që do të kishte nderin të bëhej bashkëshortja e Profetit. Në fakt, gruaja e cila organizoi dy martesat e Profetit i pati përmendur emrat e Aishes dhe Seudes në të njëjtën kohë. Megjithatë, ndërsa martesa Seudes me të Dërguarin e Allahut u bë dhjetë vjet pas shpalljes, martesa me Aishen ka ndodhur pas një vonese katër vjeçare.

---

<sup>196</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/117.

<sup>197</sup> Taberani, *Mu'xhemul kebir*, 23/11.

<sup>198</sup> Buhari, *nikah*, 107.

Të gjitha gratë që u martuan me Profetin u bashkuan përfundimisht me familjen e Tij pas emigrimit. Ato u bënë nënat e besimtarëve si vijon: Hafsa në vitin e tretë pas emigrimit, Umu Seleme në vitin e katërt, Xhujejrija dhe Zejneb binti Xhahshi në vitin e pestë, Umu Habibja në vitin e gjashtë, Mejmunah dhe Safija në vitin e shtatë. I Dërguari i Zotit ishte pesëdhjetë e katër vjeç kur u martua me Aishen, pesëdhjetë e gjashtë, kur u martua me Hafsanë, pesëdhjetë e shtatë kur u martua me Umu Selemen, pesëdhjetë e tetë kur u martua me Xhujejrijen dhe Zejnebin, pesëdhjetë e nëntë kur u martua me Umu Habiben dhe gjashtëdhjetë vjeç kur u martua me Mejmunen dhe Safijen.

Këto gra me fat, që ndanin të njëjtën shtëpi me të Dërguarin e Zotit, u bënë nënat e besimtarëve. Njëherë, Seudeja kishte frikë se i Dërguari i Allahut nuk ishte i kënaqur me të, dhe se planifikonte të divorcohej prej saj, ndaj i tha:

“Të përgjërohem të mos ndahesh nga unë dhe të mos më përzësh. Radha ime nuk ka rëndësi, po deshe ia jap ditët e mia Aishes.”<sup>199</sup>

Por Profeti nuk u nda nga ajo dhe ajo do ta mbajë përherë, deri në Ditën e Gjykimit titullin e lartë “nënë e besimtarëve.”

### **Statusi i Aishes**

Por fati kishte përcaktuar role të veçanta për disa nga gratë e të Dërguarit të Allahut. Statusi i Aishes, në veçanti, ishte i veçantë dhe i njohur nga gratë e tjera. Ishte për shkak të Aishes që Kurani shpalli dënimin për shpifje, dhe dënimi është aplikuar drejtpërdrejt nga i Dërguari i Zotit. Në mënyrë të tjera, gjithashtu, Aishja ishte e ndryshme nga gratë e tjera. Gjithashtu për shkak të Aishes, u shpall ajeti për tejmumin, dhe myslimanët mësuan se si të pastronin vetveten në një vend ku nuk kishte ujë. Në Mekë, ajo iu shfaq të Dërguarit të Allahut në ëndërr, dhe Atij iu komunikua nga vetë Xhebraili se ajo do të ishte gruaja e Tij.

Aishja ishte gruaja e vetme e të Dërguarit të Zotit e cili ishte virgjëreshë kur ata u martuan. Gratë e Tij të tjera ishin të gjitha të veja.

Aishja ishte e vetmja që e kishte nënën dhe babanë që ishin prej muhaxhirëve. Një dallim tjetër i familjes së saj ishte se katër brezat e së njëjtës familje - duke përfshirë gjyshin e saj, babain, vëllain dhe dy nipat besuan tek i Dërguari i Allahut dhe ishin nga sahabët e Tij.

Aishja ishte e vetmja e cila ishte e pranishme kur i vinte shpallja Profetit të Njerëzimit. Sahabët që dëshironin të sillnin ndonjë dhuratë për të Dërguarin e Zotit, preferonin t’ia dërgonin në ditën kur Ai ishte me Aishen, duke besuar se në atë ditë Ai do të ishte më i lumtur dhe me shumë gjasa do ta pranonte atë.

Aishja ishte e vetmja që e pa Xhebrailin në formën e njeriut, madje edhe u përshëndet prej Tij.

Prika e e Aishes ishte më e rëndësishme se ajo e të tjerave. Vite më vonë, ajo e shpjegoi këtë dhe pranoi se vetëm Umu Habibja kishte patur një prikë më të veçantë duke qenë se dasma e saj u organizua nga mbreti i Etiopisë.”

Që pas ditës kur Seudeja ia fali ditët e saj Aishes, koha që Aishja kaloi me të Dërguarin e Zotit ishte dyfishi i të tjerave.

Aishja kishte një lloj tjetër marrëdhënieje me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), i Cili dëshironte ta kënaqte atë. Shpeshherë ajo llastohej për shkak të pozicionit të saj të favorshëm në raport me gratë e tjera dhe vërente me kënaqësi se si i Dërguari i Allahut përpiquej ta kënaqte atë.

---

<sup>199</sup> Buhari, *nikah*, 97.

Të Dërguarin e Zotit e nxitën kundër saj dy herë gjatë jetës së tij.

I Dërguari i Zotit ka thënë se ai e kishte parë Aishen në qiell, dhe e përshkroi bardhësinë e shndritshme të pëllëmbëve të saj. Ajo ishte me siguri më e mira në mesin e nënave të besimtarëve, me të cilin i Dërguari i Zotit ishte i kënaqur derisa ndërroi jetë.

Aishja u bë e shquar në dituri dhe asnjë tjetër, qoftë bashkëshorte e Profetit, qoftë ndonjë femër tjetër në mesin e sahabeve nuk ka transmetuar aq shumë hadithe sa ajo. Thellësia e dijes së saj kishte një ndikim më të fortë se e çdo gruaje tjetër, duke përfshirë edhe bashkëshortet e tjera të të Dërguarit të Zotit. Kur ata, të cilët nuk ishin në gjendje të vendosnin për një çështje, dhe vinin për ta pyetur lidhur me çështjen, largoheshin prej saj të lehtësuar dhe me një zgjidhje të menjëhershme të problemit për të cilin kishin ardhur.

Kur iu përkeqësua sëmundja, i Dërguari i Zotit kërkoi t'i kalonte me të katërmbëdhjetë ditët e Tij të fundit. Ai vdiq me kokën në prehrin e saj. Aishja ka vazhduar të jetojë në të njëjtën dhomë me të Dërguarin e Allahut edhe pas vdekjes së Tij. Pasi vdiq, i Dërguari i Zotit u varros në tokë në dhomën e Aishes, aty ku dheu është më i shtrenjti në botë. Pas vdekjes së Tij, Aishja u bë burimi më i mirë i informacionit në lidhje me sjelljen e tij. Të gjithë, madje edhe sahabët më të mëdhenj shkonin të konsultoheshin me Të, dhe të gjithë ktheheshin me një përgjigje.

Devotshmëria e saj në adhurim, ndjeshmëria e saj rreth agjërimit dhe lutjes, thjeshtësia e saj dhe përkushtimi ndaj Zotit, si dhe dëshira për të dhuruar çdo gjë që kishte, kanë qenë karakteristika të njënjëshme që shfaqnin virtytin e saj.

Njerëzit që e trajtonin Aishen sipas superioritetit të saj të lindur, e respektonin më shumë, dhe konkurronin me njëri-tjetrin për ta kënaqur sa më shumë Atë, në mënyrë që të fitonin duatë e saj në emër të tyre. Omeri e ka trajtuar atë edhe me më shumë respekt sesa nënat e tjera të besimtarëve, duke përfshirë edhe vetë vajzën e tij Hafsanë, dhe rezervonte për Aishen më shumë gjëra se për këdo tjetër, kur ndante plaçkat e luftës gjatë periudhës së kalifatit të tij.

Duke e parë situatën e saj nga jashtë dhe duke marrë parasysh karakteristikat femërore, do të kishte qenë krejt normale për Aishen ta kishte zili Seudenë, me të cilën i Dërguari i Zotit ishte martuar katër vjet më parë se me të. Por kjo nuk ishte e vërtetë, përkundrazi, Seudeja ishte njëra nga nënat e besimtarëve me të cilën Aishja kishte më tepër intimitet dhe miqësi. Aishja ka thënë:

“Çfarë gruaje fisnike që ishte! Unë nuk kam parë një grua më të këndshme se Seudeja, që aq shumë kam dëshiruar që t'i ngjaja.”<sup>200</sup>

Vajza e Omerit, Hafsa po ashtu u bë mike e afërt me Aishen; ngjante sikur aleanca midis etërve të tyre reflektohej edhe tek ato gjithashtu. Ato kalonin kohën së bashku, konsultoheshin për çdo gjë me njëra-tjetrën, si dhe i kuptonin e i respektonin mendimet e njëra-tjetrës.

Umu Selemja ishte gjithashtu e njohur për intelektin e saj të lartë. Roli i saj në uljen e tensioneve në Hudejbije ishte aq i rëndësishëm sa që nuk mund të nënvlerësohet.<sup>201</sup>

Aishja e vlerësonte mjaft edhe sjelljen e mirë të Xhujejrijës:

“Unë nuk njoh ndokënd tjetër që të jetë kaq e dobishme për popullin e saj sa ajo.”<sup>202</sup>

Aishja ka përdorur shumë shprehje të ngjashme kur fliste në lidhje me nënat e tjera të besimtarëve, por natyrisht secila prej tyre ia merrte të Dërguarin e Zotit për një ditë. Në rrethana

---

<sup>200</sup> Muslim, *rada'*, 47.

<sup>201</sup> Buhari, *shurut*, 15.

<sup>202</sup> Ebu Davud, *itk*, 2; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/277.

normale, dikush tjetër në pozicionin e saj mund t'i shihte me sy tjetër ato që e mbanin robin më të dashur të Allahut larg prej saj. Me përjashtim të disa incidenteve të vogla, qëndrimi Aishes nuk ndryshoi, dhe ajo kurrë nuk ka pasur vështirësi në pranimin e preferencave të të Dërguarit të Allahut.

Para se të shprehte ndonjë dëshirë i Dërguari i Zotit, ajo e kuptonte se çfarë donte. Aishja kujdesej për plotësimin e nevojave të Tij para se Ai të fliste. Ajo e dinte se Ai ka pasur arsye të ndryshme për secilën prej martesave të Tij - me disa ai kishte për qëllim për të krijuar lidhje fisnore me mekasit, me ndonjë tjetër Ai shpresonte të zgjidhte problemet me fiset hebreje dhe me të tjerat, ai donte të ndihmonte disa fise të afroheshin në Islam. Ky nuk ishte një mision i pamundur, sepse falë martesave të Tij, pati shumë vetë që hynin në fenë myslimane.

Disa nga martesat e Tij erdhën si rezultat i porosive që vinin prej shpalljes, siç ishin martesat e tij me Umu Habibën dhe Zejnebën. Mund të thuhet pa frikë se triumfi i Mekës filloi në ditën kur i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të u martua me Umu Habibën<sup>203</sup>, dhe se si rezultat i martesës së Tij me Zejnebën<sup>204</sup>, shumë zakone dhe praktika të gabuara të shoqërisë u eliminuan pa grindje, duke u zëvendësuar nga bukuria e Islamit.

Shtëpia e tyre ishte si një shkollë, ajo vazhdimisht prodhonte përgjigje për pyetjet që njerëzve mund t'u vinin në mendje në të ardhmen. Dolën në pah shembuj nga të gjitha ndjenjat që mund të lindin tek gratë, dhe njerëzit shqyrtuan me imtësi mënyrën e jetesës së të Dërguarit të Allahut për të përcaktuar qasjen e tyre. Nga një këndvështrim vizionar, ndoshta kjo mund të thuhet se këto ngjarje në shtëpinë e lumturisë ishte e nevojshme të ndodhnin në mënyrë që të ishin nga një shembull për myslimanët në të ardhmen. Përndryshe, do të kishte qenë e pamundur të gjendej mënyra më e mirë për të zgjidhur probleme të ngjashme në mesin e grave, ndjeshmëria e të cilave është e lindur. Ndjenjat e tyre ishin rezultatet e përkohshme dhe kalimtare të një sërë situatash. I Dërguari i Zotit ka qenë gjithashtu një objekt xhelozie dhe zilie për to.

Nuk ishte e ndaluar për të vënë re një dallim të miratuar nga Allahu. Aishja ndonjëherë e bëri këtë për të fituar miratimin e të Dërguarit të Allahut për veten. Një ditë, ajo shkoi tek i Dërguari i Zotit dhe në mënyrë lozonjare i tha:

“O i Dërguari i Allahut, në qoftë se do të ishe në një luginë plot me pemë frutore dhe do të shihje disa pemë, frutat e të cilave janë ngrënë dhe disa të tjera që nuk janë prekur, ku do të zgjidhje të pushoje dhe të ushqeheshe?”

Kuptimi i saj ishte i qartë, dhe i Dërguari i Zotit e kuptoi; ajo ishte gruaja e Tij e vetme që kishte qenë e virgjër deri në martesën e tyre. I Dërguari i Zotit i dha përgjigjen që ajo priste:

“Pranë pemëve frutat e të cilave janë të paprekura!”<sup>205</sup>

Gratë e shtëpisë së Profetit kishin secila një natyrë të ndryshme, dhe natyrisht disa e preferonin shoqërinë e njëra-tjetrës. Ndërsa Aishja ishte më e afërt me Hafsane, Seuden dhe Safijen, Zejnebja ishte më afër Umu Selemes dhe disa të tjerave.<sup>206</sup>

---

<sup>203</sup> Dihet se Profeti u martua me Umu Habibën pas shpalljes së ajetit: “Pritet që Allahu të vërë miqësi ndërmjet jush dhe atyre që kishin armiqësi, Allahu është i fuqishëm; Allahu është Falës, Mëshirues.” (Mumtehine, 7)

<sup>204</sup> Ahzab, 37.

<sup>205</sup> Buhari, *nikah*, 9.

<sup>206</sup> Buhari, *hibe*, 7.

Me përjashtim të Aishes, Zejnebja kishte ndoshta ndikimin më të madh në shtëpi; ajo ishte vajza e hallës së Profetit, dhe motra e Abdullah ibni Xhahshit, një sahabi besnik. Martesa e saj me Profetin ishte porositur drejtpërdrejt me anë të shpalljes.

Preferencat e disa grave mbi të tjerat nuk përbënin klishe. Të qenit i afërt me dikë nuk do të thotë të jesh i largët për dikë tjetër. Edhe pse ato kishin mendime dhe ndjenja të ndryshme, e gjithë sjellja e tyre ishte në shërbim të kënaqjes së të Dërguarit të Zotit, dhe çështjet e tyre janë zgjidhur në mënyrë paqësore.

Pavarësisht gjithçkaje, midis tyre ka ekzistuar gjithmonë respekti reciprok. Zejnebja ishte më kryesorja në mesin e atyre që e përgatitën Aishen për martesën e saj pas Hixhretit, si dhe në mesin e atyre që e mbrojtë kur ndodhi problemi i shpifjes.<sup>207</sup>

Shumicën e kohës bashkëshortet e Profetit konkurronin me njëra-tjetrën për të fituar sa më shumë shpërblime, si dhe për të bërë sa më shumë vepra të mira; ato kërkonin për veten e tyre sa më shumë sevape, ashtu si të tjerat, por pa i pakësuar sevapet e tyre.

Kur i Dërguari i Zotit dëshironte të izolohej në xhami (*itikaf*), pranë xhamisë së Profetit ngrihej një tendë, dhe Ai qëndronte në çadër gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit. Njëherë edhe Aishja e vendosi një tendë të tillë në oborrin e xhamisë. Pastaj dëshira për të kryer një adhurim të tillë u shfaq edhe tek nënat e tjera të besimtarëve, të cilat dëshironin të ishin sa më afër Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ndaj edhe ato bënë kërkesë për tendë. Fillimisht Hafsaja e pastaj edhe Zejnebja, kërkuan leje për të vendosur tendat e tyre. Kur i Dërguari i Allahut i pa tendat në oborrin e xhamisë, pyeti:

“Çfarë janë këto?”

Pasi dëgjoi përgjigjen, i Dërguari i Allahut shfaqti shenja pakënaqësie dhe tha:

“Pra të gjitha ju kërkonin të fitoni sevape me këto tenda?”

Ishte e pamundur për gratë të kryenin siç duhet adhurimet, ndërkohë që ishte ndezur ndjenja e garës ndërmjet tyre. Me ndërhyrjen e Tij, i Dërguari i Allahut urdhëroi që tendat të çmontoheshin dhe e la izolimin e tij përgjysëm, duke planifikuar ta kryente atë në muajin e ardhshëm.<sup>208</sup>

Në një udhëtim të të Dërguarit të Allahut, patën rastin ta shoqëronin Zejnebja dhe Safija. Udhëtimi ishte i gjatë dhe kushtet ishin të këqija, prandaj deveja që po ngiste Safija u lodh dhe nuk mund të ecte më. Meqenëse Zejnebja kishte një deve tepër, i Dërguari i Allahut i tha:

“Meqenëse deveja e Safijes nuk mund të ecë, dua që t’ia japësh asaj njërën prej deveve.”

Ky ishte një sugjerim mjaft i arsyeshëm. Por arabët kishin një lloj mërie ndaj fiseve hebreje, kryesisht ndaj atyre të Beni Kajnukas, Beni Nadrit, Beni Kurejdhas dhe Uadi Kuras. I ati i Safijes, Huxhaxh ibni Aktabi kishte udhëhequr mjaft fushata kundër myslimanëve, gjë e cila kishte bërë që ndër arabët të rrënjosehin paragjykime të thella ndaj hebrenjve. Pa u menduar gjatë, ajo tha:

“Unë, t’ia jap asaj çifutes?!”

Fjalët e saj të pamatura e lënduan thellë të Dërguarin e Zotit dhe sakaq Ai u zemërua. Ai kishte thënë më parë se ky nuk ishte qëndrimi i një besimtari dhe se kjo sjellje i përkiste pluhurit të historisë. Ai mbajti një qëndrim mjaft të ashpër ndaj Zejnebes, dhe për ta bërë më të qartë qëndrimin e Tij, e shmangu atë për disa muaj me radhë. Zejnebja u trishtua mjaft dhe e pagoi shtrenjtë atë çfarë kishte thënë. Ajo humbi kënaqësinë e të qenit së bashku me të Dërguarin e

---

<sup>207</sup> Buhari, *tefsir*, 18.

<sup>208</sup> Buhari, *itikaf*, 6.

Allahut, gjë që përbënte lumturinë e saj më të madhe në këtë botë. Zejnebja u pendua dhe kërkoi falje nga Zoti, si dhe iu lut Atij që të kthehej përsëri, si më parë. Meqë periudha e ftohtësisë kishte zgjatur kaq shumë kohë, ajo filloi të mendonte se ishte vetëm një iluzion ideja që ata do të mund të pajtoheshin ndonjëherë. Ajo madje nisi të paketonte plaçkat. Si shpresë të fundit ajo kishte Aishen. Zejnebja i bëri një vizitë asaj, ku i kërkoi të ndërmjetësonte tek i Dërguari i Allahut për ta shpëtuar nga kjo situatë aq trishtuese.

Kjo ishte një ide e mirë, sepse Aishja zinte një vend të veçantë në zemrën e të Dërguarit të Allahut dhe me siguri, situata do të shkonte drejt zgjidhjes. Një ditë, jo shumë kohë më pas, i Dërguari i Allahut shkoi për drekë tek Zejnebja. Kështu ditët e trishtuara morën fund dhe retë e zeza u shpërndanë, duke u zëvendësuar me shkëlqimin e fytyrës së ndritur të të Dërguarit të Allahut, i cili zuri vendin që i takonte në shtëpinë e saj. Por tani kishte një ndryshim, tani e tutje askush nga gratë nuk do të fliste më me përçmim për njëra-tjetrën.<sup>209</sup>

Megjithëse pozita e Aishes ishte e lakmuar nga të gjitha gratë për shkak të vendit të veçantë që zinte tek i Dërguari i Allahut, ajo ka thënë për Zejneben këto fjalë lavdëruese:

“Unë nuk kam parë ndonjë grua më të ndjeshme në çështjet fetare sesa Zejnebja. Sigurisht ajo ishte më e devotshmja dhe më e nënshtruara ndaj Allahut; fanatizmi i saj ishte nga më të sinqertët dhe ajo kujdesej më shumë nga të gjithë për të afërmit. Zejnebja e ka kaluar jetën duke dhënë sadaka dhe duke sakrifikuar mjaft nga vetja për të ndihmuar të tjerët dhe ajo ishte më e paarritshmja në afërsinë e saj me Allahun. Megjithëse kishte një temperament të zjarrtë, zemërimi i saj shuhej menjëherë.”<sup>210</sup>

Një ditë i Dërguari i Allahut u tha atyre:

“Ajo prej jush e cila do të më bashkohet më shpejt pas vdekjes është ajo që i ka krahët më të gjatë.” Pasi Ai vdiq, bashkëshortet e Tij sollën ndër mend fjalët e mësipërme dhe u mbledhën që të masnin krahët për të gjetur, se cila do t’i bashkohej më parë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ato i shtrinin krahët dhe mundoheshin t’i masnin por ishte e pamundur të arrihej në një përfundim të saktë. Aishja shpjegoi:

“Ne vazhduam të masnim krahët tanë derisa vdiq Zejneb binti Xhahsh. Kur ajo vdiq, ne e kuptuam se fjala kishte qenë për të, por jo në kuptimin fizik. Shprehja ‘krahët më të gjatë’ kishte kuptimin e dhënies për bamirësi për të ndihmuar njerëzit e varfër. Ne të gjitha u jepnim njerëzve në nevojë, por ajo u jepte aq shumë me dorën e saj, duke kursyer pak nga pak çdo qindarkë për t’ua shpërndarë më pas të varfërve për hir të Allahut.”<sup>210</sup>

Një ditë Aishja i përmendi të Dërguarit të Allahut gjatësinë e vogël trupore të Safijes dhe i tha me përkëdheli:

“Për të është e mjaftueshme çfarë të teprojë.”

Me këtë ajo donte të thoshte se nuk ishte e nevojshme t’i jepej më shumë kohë asaj për të kaluar me të Dërguarin e Allahut. Kjo sjellje e zemëroi jashtë mase të Dërguarin e Allahut ndaj ai tha:

“Nëse ato që the do të mund të hidheshin në oqean, me siguri, edhe atë do ta turbullonin.”

Edhe Aishja u mërzi. Ajo nuk kishte për qëllim, as të zemëronte të Dërguarin e Allahut e as të kritikonte Safijen. Ajo tha:

“Unë vetëm desha ta përshkruaj atë.”

<sup>209</sup> Ebu Davud, *Sunen*, 4; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/131.

<sup>210</sup> Buhari, *zekat*, 10.

Por i Dërguari i Allahut u kthye nga ajo dhe i tha:

“Edhe po të më dhurohej krejt bota, unë nuk do të isha i kënaqur me atë lloj përshkrimi!”<sup>211</sup>

Pas kësaj, për të mbajtur zemrën e saj larg nga çdo lloj negativiteti, Aishja e mori Safijen në dhomën e vet dhe u bë shoqja e saj, duke punuar së bashku në gjëra të rëndësishme.

Safija ishte e famshme për talentin e saj në gatim, ashtu si edhe për fytyrën e saj të bukur, dhe lakmohej nga gratë e tjera për shkak të aftësive të saj në gatim. Ajo la njëqind mijë dërrhemë si trashëgimi kur u nda nga jeta, duke ia lënë kështu një të tretën e tyre djalit të motrës së vet. Aishja me të mësuar se disa nuk donin t’ia jepnin të nipit një sasi të tillë të madhe parash për arsye se ai ishte hebre, menjëherë ndërhyri:

“Kijeni frikë Allahun dhe jepjani atij atë që i është lënë trashëgim!”<sup>213</sup>

Gratë e Profetit janë përpjekur që të jenë të drejta, dhe kur njëra prej tyre ishte e lënduar, ato menjëherë përpiqeshin ta kënaqnin dhe ta ndihmonin të harronte se çfarë kishte ndodhur. Si gratë e të Dërguarit të Allahut, ishte e pamundur që ato të mos e dëshironin thjeshtësinë dhe pastërtinë e jetës së tyre.

Kur Umu Habibja ishte duke vdekur, ajo u kthye nga Aishja, e cila ishte mbi kryet e saj dhe i tha:

“Që të dyja kemi qenë gratë e të Dërguarit të Zotit, është e mundur që ndonjëherë të të kam rënë në qafë dhe anasjelltas. Allahu i Plotfuqishëm na faltë si ty ashtu edhe mua.”

Burimet në dispozicion nuk tregojnë as edhe një problem të vogël në mes Aishes dhe Umu Habibes. Por këto gra të bekuara ishin aq të ndjeshme për shkak se ato gëzonin kënaqësinë e të qenit bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut, dhe ato ishin aq të vetëdijshme për përgjegjësitë e tyre, sa që nuk donin të linin pas vetes asgjë të krisur apo të papërfunduar ndërsa kalonin nga kjo botë në ahiret. Në përgjigje të kësaj, Aishja u lut:

“Allahu i Plotfuqishëm të faltë për gjithçka, të faltë për mospërsosmërinë tënde dhe të mbajttë larg nga problemet.”

Umu Habibja u lumturua shumë. Ajo shikoi nga Aishja dhe i tha:

“Ti më bërë mua të lumtur, Allahu të bëftë të lumtur edhe ty gjithashtu!”<sup>212</sup>

Ato ishin shembujt më të mirë të virtytit dhe marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën ishin gjithashtu virtuoze. Edhe njëherë mund të japim një shembull ku tregohet se xhelozitë apo zilitë e vockla që shfaqeshin ndonjëherë, ishin të rastësishme dhe jo të përhershme. I Dërguari i Allahut me veprimet e Tij, si dhe shpalljet hyjnore, i bënë ato të pendoheshin thellë dhe t’i riktheheshin drejtësisë dhe tolerancës.

Një ditë, bashkëshortet e Profetit shkuan tek dhoma e Seudes dhe po diskutonin në lidhje me pozitën e Aishes tek i Dërguari i Allahut. Pas një bisede të gjatë ato dolën me përfundimin:

“O Umu Seleme, betohemi në Allah se ti e sheh se njerëzit presin ditën e Aishes për t’i dhuruar ndonjë gjë të Dërguarit të Allahut. Meqenëse Aishja nuk do tjetër veç mirësi, edhe ne nuk dëshirojmë gjë tjetër, por të fitojmë mirësi. Përse nuk shkon tek i Dërguari i Allahut e t’i kërkosh që t’u thotë njerëzve t’i sjellin dhuratat në çdo kohë e jo sipas kësaj preference?”

Ky ishte mendimi i përgjithshëm, kështu që Umu Selemja ia tha këtë të Dërguarit të Allahut. Ai u mërzi dhe iku. Umu Selemja u kthye e pikëlluar dhe u shpjegoi grave çfarë kishte ndodhur, por

<sup>211</sup>Ebu Davud, *edeb*, 40; Tirmidhi, *sifatul kijameh*, 51.

<sup>212</sup>Hakim, *Mustedrek*, 4/24; Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/100.

ato ngulën këmbë që ajo të shkonte përsëri. Reagimi ishte përsëri i njëjtë - i Dërguari i Allahut ishte i pakënaqur nga ky këndvështrim. Umu Selemja u kthye përsëri tek ato e pikëlluar. Megjithatë, ato i kërkuan të shkonte dhe t'i thoshte përsëri, dhe kur Umu Seleme shkoi tek i Dërguari i Allahut për herë të tretë me të njëjtën kërkesë, Ai u zemërua dhe i tha:

“O Umu Seleme, mos më vër në pozitë të vështirë me Aishen. Betohem në Allah se Mua kurrë nuk më vjen shpallja kur jam me ndonjërin prej jush, përveç asaj.”

Duke e kuptuar rëndësinë e çështjes, Umu Selemja menjëherë e ndryshoi qëndrimin e saj dhe hoqi dorë nga kërkesa:

“I kërkoj falje Allahut meqenëse të vura në pozitë të vështirë me Aishen, o i Dërguari i Allahut.”

Gratë e tjera, të cilat nuk e kishin ndier as atmosferën dhe as forcën e përgjigjes së Profetit, ndoshta menduan se Umu Selemja nuk kishte qenë në gjendje ta shprehte mendimin e tyre në mënyrë të qartë. Këtë herë, ato i kërkuan Fatimes të ndërmjetësojë:

“Shko tek i Dërguari i Zotit dhe tregoji Atij për gjendjen tonë duke i thënë: ‘Gratë tuaja presin drejtësi nga ti në lidhje me vajzën e Ebu Bekrit, për hir të Allahut.’”

Ndoshta jo e vetëdijshme për atë që kishte ndodhur, Fatimja ia përcolli të Dërguarit të Zotit mesazhin nga gratë. Ajo vuri re një ndryshim të madh në fytyrën e Tij. Ai papritmas u zemërua dhe e pyeti:

“O bija ime, a e do ti atë që dua unë?”

Kjo ishte një pyetje retorike dhe ajo iu përgjigj ‘po’ pa ngurrim.

Siç dukej, të Dërguarit të Zotit nuk i pëlqente që palët e treta të ndërhynin në një çështje mes Tij dhe bashkëshorteve të Tij. Toni i Tij e ngriu Fatimen; ajo hoqi dorë nga kërkesa dhe ua shpjegoi pastaj situatën grave të Tij. Ato donin që ajo të shkonte edhe një herë dhe t’ia shpjegonte më qartë Atij qëllimin e tyre, por Fatimja refuzoi. Për vajzën e Profetit kjo derë ishte mbyllur dhe e gjithë këmbëngulja e tyre shkoi dëm, sepse ato nuk qenë në gjendje t’ia mbushnin më mendjen.

Pastaj, gratë vendosën të nisnin Zejneben për të dërguar mesazhin. Ajo shquhej në mesin e grave të tjera, pasi martesë e saj i ishte shpallur të Dërguarit të Allahut nëpërmjet Xhebrailit në një ajet që ia pat recituar vetë ai. Afërsia e saj me të Dërguarin e Allahut, gjithashtu i jepte asaj pjekuri dhe autoritet. Zejnebja shkoi tek Ai dhe këmbënguli:

“Gratë tuaja kërkojnë drejtësi në lidhje me vajzën e të birit të Ebu Kuhafes, për hir të Allahut.”

Ajo e ngriti pak zërin dhe Aishja e dëgjoi. Me të vërejtur se ajo e kapi situatën, i Dërguari i Allahut i hodhi një vështrim të shpejtë Aishes dhe priti se si do të reagonte ajo. Pastaj Zejnebja dhe Aishja filluan të diskutojnë mes tyre. Aishja ishte aq brilante dhe kishte aq shumë talent për oratori, sa që në fund Zejnebja u dorëzua. Pasi e kishte vërejtur këtë skenë pa folur asnjë fjalë, i Dërguari i Allahut në fund tha:

“Në fund të fundit, ti je e bija e Ebu Bekrit!”<sup>213</sup>

### **Ndalesa (Tahrimi)**

I Dërguari i Allahut e kishte zakon t’i vizitonte bashkëshortet e Tij pas namazit të drekës. Ai i pyeste për shëndetin, interesohej nëse kishin nevojë për ndonjë gjë dhe kalonte ca kohë me to. Ai kishte përcaktuar një orar të rregullt për secilën prej tyre, vetëm e vetëm për të ndenjur me to. Pasi

---

<sup>213</sup> Buhari, *hiba*, 7.



kjo gjë u përsërit shumë herë, bashkëshortet e Profetit filluan të ndjenin një lloj padurimi për vizitat e Tij dhe qëndronin të gatshme për ta pritur të Dërguarin e Allahut pas çdo namazi të drekës.

Një ditë, ndërsa ishin ulur dhe po prisnin të Dërguarin e Allahut, ato vunë re se koha kishte kaluar dhe ai nuk ishte bërë i gjallë. Çdo minutë që kalonte e shtonte ankthin e tyre sepse ato e kuptonin se po humbisnin një nga momentet më të lumtura të ditës, vizitën e të Dërguarit të Allahut, vizitë me të cilën tashmë ishin mësuar aq shumë.

Por menjëherë më pas u shfaq i Dërguari i Allahut ndaj ato u gëzuan dhe i uruan Atij mirëseardhjen. Megjithëse pak me vonesë, fytyra e Tij e shndritshme u shfaq, duke e nderuar shtëpinë e tyre me praninë e Tij. Por një dyshim brente zemrat e tyre. Aishja foli edhe në emër të grave të tjera dhe e pyeti për shkakun e vonesës. Profeti tha:

“Një grua nga fisi i Zejnebes më solli një qyp me mjaltë si dhuratë.”

Gratë e kuptuan se shkakun e vonesës kishte qenë Zejnebja. Atyre u hipi një ndjenjë zilie, por nuk i thanë gjë të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të.

Ndërsa flisnin mes tyre, ato rikujtuan faktin se i Dërguari i Allahut ishte i ndjeshëm ndaj erës së keqe dhe mendohej ta shmangte atë.<sup>214</sup> Kështu, kur i Dërguari i Allahut iu afrua ato vendosën ta pyesnin: “Çfarë ke pirë?” dhe “Çfarë është kjo erë?” Ai u përgjigj: “Kam pirë sherbet mjalti” dhe pastaj secila prej tyre do të shprehte nga një mendim për efektin e tij, ndoshta “ngaqë bletët e kishin mbledhur nektarin nga lulet me erë të keqe.”

Ndodhi siç ato e kishin parashikuar. Cilësdo që afrohej, i Dërguari i Allahut i jepte të njëjtin reaksion. Çdo herë ai thoshte:

“Jo, kam pirë vetëm sherbet mjalti tek Zejnebja.”

Megjithëse përgjigjja e Tij ishte e butë, i Dërguari i Allahut u mërziu dhe u fye, ndaj u betua të mos pinte më sherbet mjalti.<sup>215</sup>

Një betim i tillë kaq i parëndësishëm për një njeri të zakonshëm ndoshta do të kalonte pa u vënë re, por i Dërguari i Allahut nuk ishte njeri i zakonshëm. Ai ishte marrësi i vetëm i mesazhit i cili vazhdonte të shpallej. Feja është formuar nën dritën e shpalljes. Kështu që në çdo fjali që dilte nga buzët e Tij do të ndërtohej një gjykim që do të bëhej shembull për pasuesit e Tij.

Pak kohë më vonë, Xhebraili erdhi me një shpallje të re. I Dërguari i Allahut djersinte dhe dukej mjaft i vuajtur nën peshën e përgjegjësisë që mbante mbi supe, sikur të ishte i gjymtuar.

Pastaj një buzëqeshje u shfaq sërish në fytyrën e Tij. Allahu i Madhëruar i ishte drejtuar atij:

*“O ti Profet, pse ia ndalon vetes atë që Allahu ta lejoi? A kërkon me të pajtimin e grave tua? Allahu është Mëkatfalës, Mëshirues.”*<sup>216</sup>

Nga ky ajet, ndjehej ngrohtësia e të qenit i afërt me Zotin, dhe ai shpallte aspekte të reja të fesë për njerëzimin nëpërmjet mishërimit të tyre tek i Dërguari i Allahut. Aspekti i parë ishte se një person nuk duhet të konsideronte si të paligjshme diçka që nga ana e Allahut ishte e lejueshme. E dyta ishte se një qëndrim i tillë do të lypte që ne të kërkonim falje duke e ditur se kjo falje mund të na jepet vetëm nga Allahu, me anë të atributëve të Tij si Mëkatfalës dhe Mëshirues. Së treti, sqarohej se ata të cilët bënin një betim për të hequr dorë nga gjërat e lejueshme, duhej ta kthenin betimin e tyre në pagim haraçi. Pastaj ajeti tjetër vazhdon:

---

<sup>214</sup> Buhari, *hixhal*, 11.

<sup>215</sup> Buhari, *tefsiru sure*, 386.

<sup>216</sup> Tahrim, 1.

*“Allahu ju ka përcaktuar juve zgjidhjen e betimeve tuaja; Allahu është kujdestari juaj; Ai është i gjithëdijshmi, i urti.”*

### **Aishja dhe Fatimja**

Midis vajzave të të Dërguarit të Allahut, Fatimja kishte marrëdhënie më të ngushta me Aishen. Ato jetuan së bashku në të njëjtën shtëpi për njëfarë kohe, derisa Fatimja u martua me Aliun. Aishja ishte njëra nga ato të cilat e përgatitën Fatimen për dasmën e saj. Megjithatë jeta e tyre nuk ishte e lehtë, kënaqësia që ndjenin ishte e pafundme. Ndërsa rrëfen për atë ditë, Aishja thekson fjalët e mëposhtme:

“I Dërguari i Allahut na tha ta përgatisnim Fatimen sepse ajo do martohej me Aliun. Ne menjëherë vajtëm në shtëpi, dhe sollëm ca dhë të butë nga Batha, të cilën e shpërndamë nëpër tokë. Pastaj mbushëm dy jastëkë me lesh deleje. Më pas shtypëm ca hurma dhe rrush dhe ia shtuam ca ujë pijes, dhe pastaj vendosëm një hu në njërin skaj të dhomës për të varur rrobat, enët dhe pjatat. Unë nuk kam parë ndonjëherë dasëm më të bukur se atë të Fatimes!”<sup>217</sup>

Vetëm një mur e ndante dhomën ku banonte Fatimja me Aliun nga dhoma e Aishes, dhe ai mur kishte një dritare. Ndonjëherë ato rrinin së bashku dhe bisedonin përmes kësaj dritareje.<sup>218</sup>

Aishja ishte shoqja më e mirë e Fatimes dhe ajo ndante pothuajse gjithçka me të. Fatimja i fliste për gëzimet, brengat dhe objektivat, të cilat ajo nuk ishte në gjendje t’i arrinte. Një ditë, kur duart e saj u ënjtën nga bluarja e grurit, Fatimja i kërkoi të Dërguarit të Allahut t’i sillte ndonjë sklave për ta ndihmuar në punët e shtëpisë. Asaj nuk iu plotësua dëshira dhe Aishja ishte e vetmja së cilës ajo ia qau hallin.<sup>219</sup>

Fatimja e donte shumë Aishen. Dashuria dhe respekti i tyre ishte reciprok, sepse për Aishen Fatimja zinte një vend unik. Një ditë, Aishja u pyet:

“Kush ishte njeriu më i dashur nga njerëzit e të Dërguarit të Allahut?”

Pa u menduar farë ajo u përgjigj: “Fatimja.”<sup>220</sup>

Aishja pastaj shtoi:

“Pas babait të saj, unë nuk kam parë njeri tjetër më të mrekullueshëm sesa Fatimja.”<sup>221</sup>

Ajo nuk e pa kurrë Fatimen me keqdashje. Njëherë ka thënë:

“Unë nuk kam parë askënd që t’i ngjante të Dërguarit të Zotit më shumë sesa Fatimja, e cili i ngjante Atij më shumë në aspektin e dinjitetit, qetësisë, sjelljes, elegancës dhe mirësjelljes, si dhe në mënyrën e të ecurit. Kur ajo hynte në vendin ku ishte i Dërguari i Allahut, Ai ngrihej në këmbë për të, e uthhte dhe e ulte pranë vetes. Kur i Dërguari i Zotit shkonte tek Fatimja, ajo do të bënte të njëjtën gjë.”

Virtytet e Fatimes, u përcollën për shoqërinë myslimane nëpërmjet Aishes. Duke marrë fillimisht Fatimen, pastaj Aliun, Hasanin dhe Hysenin nën batanijen e Tij të leshtë, i Dërguari i Zotit tha:

“Këta janë familja ime.”<sup>222</sup>

---

<sup>217</sup> Ibni Maxhe, *nikah*, 24.

<sup>218</sup> Nedeui, *siratu sejidati Aishe*, 122.

<sup>219</sup> Buhari, *hums*, 6.

<sup>220</sup> Tirmidhi, *menakib*, 61.

<sup>221</sup> Taberani, *mu'xhemul eusat*, 3/137; Ebu Ja'le, *Musned*, 8/153.

Ishin ditët e fundit përpara vdekjes së të Dërguarit të Allahut. Bashkëshortet e tij u mblodhën dhe u ulën pranë Tij. Pastaj erdhi Fatimja, me stilin e saj të të ecurit që ishte krejt si i të atit, madje edhe hapat e saj ishin paralel me të Tijët. Me të vërejtur ardhjen e saj, i Dërguari i Zotit tha:

“Mirë se erdhe bija ime.”

Me merak dhe respekt të madh, Ai urdhëroi që ajo të ulej pranë Tij. Ishte sikur të mungonte dikush dhe ardhja e saj bëri që skena të bëhej e plotë.

Pastaj, gratë panë se i Dërguari i Allahut u përkul dhe i tha Fatimes diçka sekrete në vesh. Në dhomë mbizotëroi një heshtje e thellë. Ajo nisi të qante. Ngashërimi i saj me sa duket e preku të Dërguarin e Allahut dhe për ta ndalur, Ai iu afrua përsëri dhe i tha diçka tjetër në vesh. Çuditërisht, Fatimja, e cila deri atëherë po qante me dënësë, zuri të qeshte. Aishja nuk mundi të duronte pa e mësuar të fshehtë e këtyre fjalëve dhe shkoi tek Fatimja dhe e pyeti:

“I Dërguari i Allahut të tha diçka veçmas, pavarësisht se aty ishin edhe gratë e Tij. Të lutem, a mund të më thuash çfarë të tha?”

Fatimja iu përgjigj:

“Unë nuk mund ta tregoj sekretin e të Dërguarit të Allahut.”

Fatimja nuk donte t’ia tregonte askujt ato çfarë i kishte thënë i Dërguari i Allahut, madje as Aishes. Megjithatë, Aishja nuk do të hiqte dorë derisa ta shuante kureshtjen e saj.

Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, Aishja e pyeti përsëri Fatimen:

“Të lutem për çfarë ke më të shtrenjtë, çfarë të pëshpëriti atë ditë në vesh i Dërguari i Allahut?”

Kur Fatimja iu përgjigj “Tani mund të ta tregoj”, Aishja u lumturua aq shumë sa t’i kishin dhuruar gjithë botën, sepse ajo do të mësonte një sekret të cilin e dinte vetëm Fatimja, dhe i cili kishte të bënte me ndjenjat e të Dërguarit të Allahut për njerëzit e Tij. Fatimja tha:

“Kur më pëshpëriti për herën e parë në vesh, më tha se megjithëse Xhebraili zakonisht vinte një herë në çdo Ramazan për ta recituar me mua gjithë Kuranin, këtë vit ka ardhur dy herë. Ai tha ‘mendoj se vdekja ime është afër!’ dhe pastaj më këshilloi ‘Bëhu e durueshme, kije frikë Allahun dhe mos hiq dorë nga devotshmëria.’”

“Kur ai pa se unë fillova të qaj, Ai u përkul përsëri dhe më tha lajmin e mirë se unë do të jem e para në mesin e familjes së Tij, e cila do të ribashkohej me Të. Ai tha, ‘O Fatime! A dëshiron të jesh zonja e parë në mesin e besimtareve apo zonja e parë e kësaj bote?’ Kjo ishte arsyeja e buzëqeshjes që ju patë tek unë.”<sup>223</sup>

### **Ditët e fundit me Të Dërguarin e Allahut**

Ditët kalonin njëra pas tjetrës. Dita kur Aishja u martua me të Dërguarin e Zotit ishte ende e freskët në kujtesën e saj, sikur të kishte ndodhur dje, edhe pse kishin kaluar dhjetë vjet. Ajo gjatë kësaj kohe kishte jetuar një jetë krejtësisht të ndryshme. Qysh prej një dekade ajo ishte nëna e besimtarëve, dera e hapur e të vuajturve, jetimëve, grave, dhe atyre që kërkonin dituri. Por, sinjalet po tregonin fundin e jetës së tyre të përbashkët me Profetin. Gjatë vitit të fundit, kishte lindur një ndjesi e lamtumirës.

---

<sup>222</sup> Tirmidhi, *menakib*, 61; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/304.

<sup>223</sup> Buhari, *menakib*, 22.

Ishte e hëna e fundit e muajit Sefer. Profeti shkoi në Xhenetul Baki për të vizituar shokët e Tij, duke rikujtuar kohët që kishte kaluar me ata që ishin në ato varreza.

Kur po kthehej, koka filloi t'i dhimbte shumë dhe kishte temperaturë. Temperatura e lartë mund të ndihej nga përmbi çallmën e mbështjellë rreth kokës së Tij.

Në të njëjtën kohë, edhe Aishja filloi të ankohej nga dhimbja e kokës. Për t'i treguar atij se ata ishin së bashku edhe në vështirësi, Aishja u kthye nga i Dërguari i Zotit dhe i tha:

“Oh e shkreta koka ime!”

Ajo shpresonte ta bënte të Dërguarin e Zotit të fliste pak dhe të harronte paksa problemet e Tij. Por, ajo mori një përgjigje që nuk e priste:

“E shkreta koka ime!”<sup>224</sup>

Ajo e shikoi të Dërguarin e Zotit me dhembshuri. E Tija ishte qartazi një lloj tjetër dhimbje koke të cilën ajo nuk e kishte vënë re në fillim, dhe e cila nuk kishte ndër mend të lehtësohej.

Gjendja e tij vazhdoi kështu edhe për njëmbëdhjetë ditët e ardhshme. Por ai vazhdonte të vinte në xhami për të udhëhequr umetin e Tij gjatë faljes së namazit me xhemat.

Edhe pse ishte afër vdekjes, sjellja e Tij e mirë dhe ndjenja e drejtësisë e bëri atë t'i përmbahej kalendarit të paracaktuar për gratë e Tij. Megjithatë, bashkëshortet e Tij e kuptuan se si zemra ashtu edhe mendja e Tij ishin me Aishen. Çdo gjë që ata kishin përjetuar deri në atë ditë e kishte ngritur nivelin e të kuptuarit të tyre deri në një pikë sa ata filluan t'i konsideronin preferencat e Tij si të natyrshme. Aishja, e cila zotëronte një sens të pashembullt perceptimi dhe mprehtësie, duhej të përjetonte së bashku me Profetin ditët e Tij të fundit për të regjistruar me saktësi atë që ajo pa dhe dëgjoi. Të gjitha bashkëshortet e Tij hoqën dorë nga radha e tyre, dhe për shkak se preferenca e tyre vullnetare e bëri të Dërguarin e Zotit të lumtur, kjo e kënaqi edhe më shumë Aishen. I Dërguari i Zotit i kaloi ditët e tij të fundit me Aishen, derisa u ribashkua me të Dashurin e Amshuar.<sup>225</sup>

I Dërguari i Zotit kishte vështirësi të qëndronte në këmbë, dhe shumicën e kohës, mund të ecte vetëm duke zvarritur këmbët. Ai shkoi në dhomën e Aishes me ndihmën e dy personave. Ai do të qëndronte atje deri në frymën e Tij të fundit.

Ai u shfaq në mesin e njerëzve përsëri të enjten, dhe pavarësisht dhimbjeve që ndiente, Ai donte që ata të shkruanin ato që Ai do t'u thoshte për t'i mbajtur larg nga hapat e gabuara pas vdekjes së Tij. Ai u tha atyre që kishte afër vetes:

“Ejani pranë meje t'ju diktoj diçka, në mënyrë që ju të mos bini në herezi pas meje.”

Kjo ishte një skenë prekëse, por shumë veta që i shihnin me dhimbje vuajtjet e Tij thanë: "A nuk e shikoni se si janë shtuar dhimbjet e të Dërguarit të Allahut dhe se sa vuan? Ne kemi Kuranin, dhe libri i Allahut është i mjaftueshëm për çdo gjë.”

Sahabët u ndanë në dy pjesë. Njëri grup e mendonte kështu, ndërsa grupi tjetër mendonte se kërkesa e Tij duhej të plotësohej dhe se ata duhet të merrnin shënim ato që do t'u thoshte ai. Ndërsa debati vazhdonte, Profeti nuk e ndjeu veten mirë dhe u kthye drejt tyre e u tha:

“Mjaft, largohuni!”

---

<sup>224</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/239.

<sup>225</sup> Buhari, *xhenaiz*, 94.

Ai u rikthye tek dhoma e Aishes. Pavarësisht temperaturës së lartë dhe fortësisë së dhimbjeve të Tij, Ai vijoi të shfaqej në mesin e njerëzve dhe të falte namazet me ta. Ai shkoi në xhami për namazin e akshamit dhe recitoi të gjithë suren Murselat gjatë namazit.

Pastaj u rikthye përsëri në shtëpi, dhe kjo skenë e frikësoi mjaft Aishen, sepse sëmundja e Tij rëndohej çdo minutë e më shumë. Ai dukej sikur nuk kishte më forcë për të qëndruar në këmbë. U kthye nga Aishja dhe e pyeti:

“A është falur namazi me xhemat?”

Namazi me xhemat nuk ishte falur ende. Deri atë ditë, sahabët e kishin falur çdo namaz me xhemat në xhami pas të Dërguarit të Allahut. Meqë i Dërguari i Zotit nuk kishte ardhur ende, ata ishin duke pritur për Të, pa e falur namazin përpara mbërritjes së tij. Aishja i tha:

“Jo, o i Dërguari i Allahut. Po të presin ty.”

Ai i mbloodhi të gjitha forcat për t’u ngritur në këmbë dhe tha:

“Më përgatit ujin se dua të marr abdes.”

U ngrit dhe me shumë vështirësi dhe mori abdes. Ndërsa po nisej për në namaz, gjatë rrugës, i ra të fikët. I Dërguari i Allahut nuk qe në gjendje të shkonte në xhami siç kishte bërë çdo ditë. Në shtëpinë e lumturisë u bë një turbullirë e tmerrshme dhe Aishja vinte rreth e rrotull me dëshpërim. Për fat të mirë, Ai erdhi në vete menjëherë dhe e pyeti:

“A e falën njerëzit namazin?”

Aishja iu përgjigj:

“Jo, o i Dërguari i Allahut. Po të presin ty.”

Megjithëse pritja e Profetit ishte një gjest i këndshëm nga ana e tyre, Ai mendoi se nuk do të ishte në gjendje t’i udhëhiqte ata. Ai i tha Aishes:

“Thuaji Ebu Bekrit t’u prijë njerëzve në namaz.”

Kjo u kuptua edhe si miratim që shoku i Tij më i ngushtë të bëhej udhëheqësi i myslimanëve pas vdekjes së Tij. Por Aishja i tha:

“O i Dërguari i Allahut, babai im është një person zemërbutë. Ai nuk mund t’i mbajë lotët kur të fillojë të recitojë Kuranin! Pse të mos caktosh dikë tjetër në vend të tij?”

Pas përgjigjes së saj ishte frika se askush nuk mund ta zëvendësonte dot pozitën udhëheqëse të të Dërguarit të Zotit. Ajo e ndjente se njerëzit do të kritikonin çdo person, i cili do të tentonte për të plotësuar mungesën e Tij, sepse ata do ta ndjenin boshllëkun e mungesës së të Dërguarin të Zotit, ndaj Aishja po kërkonte të mbronte babanë e saj nga kritikata. Por i Dërguari i Zotit këmbënguli:

“Thuaji Ebu Bekrit t’u prijë njerëzve në namaz!”

Aishja e pyeti përsëri, por përgjigjja e Tij nuk ndryshoi. Këmbëngulja e saj e mërziti të Dërguarin e Zotit, dhe për të treguar se këmbëngulja e saj ishte e kotë, ai i tha:

“Po sillesh si ato gratë që u zunë për Profetin Jusuf. Thuaji Ebu Bekrit se ai duhet të jetë imam dhe t’u prijë njerëzve në namaz.”<sup>226</sup>

Aishja e kuptoi. Udhëheqja e popullit pas vdekjes së të Dërguarit të Zotit do të ishte e vështirë, por i Dërguari i Zotit ishte duke zgjedhur pasardhësin e Tij. Kjo do të thoshte se i ati i saj, Ebu Bekri, do t’i kryente siç duhet detyrat e Tij. Kështu ajo i dërgoi një mesazh Ebu Bekrit dhe ai e udhëhoqi

---

<sup>226</sup> Buhari, *xhemat*, 11, 18.

namazin. Por roli i Tij nuk do të kufizohej vetëm me faljen e një namazi. Që prej atij momenti, i Dërguari i Zotit nuk mundi të shkonte përsëri në xhami, dhe Ebu Bekri do t'i udhëhiqte prej atëherë e tutje.<sup>227</sup>

Të dielën, Profeti shpërndau çfarëdo që zotëronte, me sa duket me qëllim që të largohej nga kjo botë ashtu siç kishte ardhur në të. Ai dha sadaka në një masë të tillë sa që Aishja e dërgoi llambën e tyre të vajit, e cila ishte krejtësisht e zbrazur tek një grua dhe iu lut asaj për disa pika vaji, në mënyrë që të mos e linte të Dërguarin e Allahut në errësirë.<sup>228</sup>

Në shtëpinë e tyre nuk kishte mbetur më ushqim. Ata ia dhanë parzmoren prej hekuri të Profetit, të fituar në betejë, si garanci një fqinji hebre për tridhjetë njësi elbi.<sup>229</sup>

Të hënën, i Dërguari i Zotit largoi mënjane perden që mbulonte dritaren që shihte nga xhamia në dhomën e Aishes, dhe vështroi edhe njëherë umetin. Ai u kënaq nga skena që pa - namazi po falej me rregull, duke ndjekur imamin dhe duke i kryer siç duhej detyrat e adhurimit. Ai e mbylli perden me kënaqësi dhe u rikthye në dhomën e Aishes.<sup>230</sup>

Pasi i Dërguari i Zotit i pëshpëriti vajzës së Tij, Fatimes ato fjalë në vesh, ai i thirri bijtë e saj, Hasanin dhe Hysenin, i puthi ata dhe i këshilloi që të sillen mirë. Në këtë kohë, bashkëshortet e tjera hynë në dhomë të Aishes, për të përjetuar momentet e fundit të të Dërguarit të Zotit. Gratë e të Dërguarit të Zotit ishin në mesin e atyre që ndodheshin aty, kur Ai i këshilloi për herë të fundit në këtë ndarje.

Ai u kthye nga Aishja dhe e pyeti:

“O Aishe, çfarë ke bërë me arin?”

Aishja shkoi menjëherë dhe ia solli arin në fjalë.

Duke i marrë në dorë copat e arit ai numëronte, “...pesë, gjashtë, shtatë. Si mund të shkojë Muhamedi tek Allahu nëse këto copa ari janë me të? Merri dhe jepi si sadaka!”<sup>231</sup> Dhimbjet iu bënë më të mëdha dhe Ai i tha Aishes:

“O Aishe, mos ki dyshim se unë ende e ndiej vuajtjen e ushqimit që hëngra në Hajber. Më duket sikur damarët po më shqyhen sot nga helmi i asaj dite!”<sup>232</sup>

Ai e mbuloi fytyrën me një copë të zezë leshi. Kur ndjeu vapë dhe përgjumje, e zbuloi fytyrën. Ndërkohë foli për namazin:

“Namazin, namazin.” Ai e përsëriti shumë herë këtë fjalë. Ai u tha njerëzve të jenë të ndjeshëm dhe të sillen njerëzishëm ndaj skllevërve dhe shërbëtorëve.<sup>233</sup> Ai dha këshilla për ndonjë çështje për të cilën frikësohej se njerëzit do ta linin pas dore.

Ndërkohë, Aishja u ul pranë Tij dhe lexoi suret Nas dhe Felek duke prekur lehtë me dorën e saj trupin e Tij të bekuar sipas mënyrës që ajo e kishte mësuar prej Tij.<sup>234</sup> Pas çdo recitimi, ajo lëshonte frymën e saj mbi të, dhe i lutej Allahut për ta shëruar.

---

<sup>227</sup> Që nga namazi i jacisë i së enjtes deri në namazin e sabahut të së hënës, Ebu Bekri priu gjithsej shtatëmbëdhjetë namaze, derisa i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të, të ndërronte jetë.

<sup>228</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/239.

<sup>229</sup> Buhari, *xhihad*, 88.

<sup>230</sup> Buhari, *sifatu salat*, 12.

<sup>231</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/49.

<sup>232</sup> Buhari, *megazi*, 78.

<sup>233</sup> Hakim, *Mustedrek*, 3/59.

<sup>234</sup> Buhari, *Megazi*, 78.

Shenjat ishin të qarta se i Dërguari i Allahut së shpejti do të largohej nga kjo botë për në botën tjetër. Ai pushoi me kokën e mbështetur në gji të Aishes dhe i nguli sytë në tavan. Djali i Ebu Bekrit, Abdurrahmani, hyri në dhomë me një misvak në dorën e tij. I Dërguari i Zotit e ndoqi me sy misvakun. Nëna jonë e mprehtë e kuptoi se Ai dëshironte ta përdorte misvakun dhe e pyeti:

“A të ta sjell?”

Ajo e mori atë nga vëllai i saj për t’ia dhënë të Dërguarit të Zotit. Por misvaku ishte aq i ashpër saqë Aishja e pyeti:

“A të ta zbus pak?”

Ai përsëri pohoi me kokë. Ajo e zbuti misvakun dhe ia dha të Dërguarit të Allahut.<sup>235</sup>

Pasi pastroi dhëmbët, Ai ngriti gishtin lart. Sytë i ishin drejtuar në tavan dhe buzët lëviznin. Aishja e afroi veshin e saj afërt gojës së Tij për ta dëgjuar.

“Të lutem më fal dhe më rretho me mëshirën Tënde, së bashku me Profetët, dëshmorët dhe besimtarët e vërtetë mbi të cilët ke shpërndarë bekimin Tënd. Më prano mua në banesën Tënde më të lartë.”<sup>236</sup>

Aishen e brente një dyshim, sepse gjatë kohës që Ai kishte qenë mirë me shëndet, ajo e kishte dëgjuar të thoshte:

“Shpirti i asnjë profeti nuk është marrë kurrë, pa ia treguar atij më parë vendin e tij në Xhenet. Pas kësaj, Ai ose vazhdon të jetojë, ose i jepet mundësia për të zgjedhur mes jetës dhe vdekjes.”

Sapo dëgjoi se Ai po kërkonte për banesën më të lartë, Aishja solli ndër mend thënien e Tij dhe tha me vete, “Ai nuk do të jetë më midis nesh.”<sup>237</sup>

Nuk ekzistonte asnjë fjalë për ta përshkruar atë moment. Lutja e Zotit nga thellësia e zemrës, është veprimi më jetik për besimtarin. Aishja iu përgjërua Allahut duke mbajtur në duart e saj dorën e Profetit. Kur ajo nuk e priste, Ai e tërhoqi dorën prej saj. Ishte koha për të ikur, dhe Ai nuk mund të qëndronte më në këtë botë.

Kur Ai dha frymën e fundit, kokën e Tij të bekuar e kishte të mbështetur në gjoksin e saj.<sup>238</sup>

Kjo ishte dita më e trishtë për Aishen. Duke mbuluar fytyrën me duar, ajo rënkoi me dënësë. Ajo u përpoq të qëndronte e fortë dhe i vendosi një jastëk nën kokë të Dërguarit të Zotit. Atëherë ajo i thirri njerëzit për t’u dhënë atyre lajmin e trishtuar.

Për sahabët që kishin pritur me padurim momentin kur Ai do të kthehej në mesin e tyre, kjo ishte një katastrofë. Medina u mbulua menjëherë nga një atmosferë zie. Disa, si Omeri, të cilët e konsideronin të pamundur për të jetuar në një botë pa praninë e Profetit, nuk dinin çfarë të bënin. Por vdekja ishte urdhër i Allahut. Ajo kishte ardhur dhe e kishte marrë të Dërguarin e Zotit në anën tjetër të perdes së hollë që ndan këtë botë nga Ahireti.

Ishte koha për të kryer detyrimin përfundimtar ndaj të Dërguarit të Zotit. Sahabët, të cilët nuk dinin se çfarë të bënin të zhytur në vuajtjet e tyre, ishin të pavendosur rreth vendit ku duhej ta varrosnin trupin e Tij të pastër. Pastaj Ebu Bekrit, babait të Aishes menjëherë iu kujtua diçka:

---

<sup>235</sup> Buhari, *hums*, 4.

<sup>236</sup> Buhari, *tefsir*, 69.

<sup>237</sup> Buhari, *megazi*, 79.

<sup>238</sup> Buhari, *xhenaiz*, 94.

“M'u kujtua diçka që kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut, por që e kisha harruar; i Dërguari i Zotit më ka thënë: ‘Nuk ka dyshim, që Zoti i Plotfuqishëm ia merr shpirtin një Profeti në vendin ku Ai dëshiron që të varroset!’ Pra, ne duhet ta varrosim aty ku ndodhet shtrati i Tij.”<sup>239</sup>

I Dërguari i Zotit në këtë mënyrë do të shtrihej për të pushuar përjetë në dhomën e Aishes. I prekur nga kjo skenë, Ebu Bekri i tha Aishes:

“Shikoje, kjo është e para dhe më e mbara e hënave tuaja, o Aishe. Kjo ishte një thënie të cilën vetëm Aishja mund ta kuptonte.

Vite më parë, Aishja kishte parë një ëndërr në të cilën tri hëna, njëra pas tjetrës, u ngritën mbi dhomën e saj. Kur ajo i kishte thënë Ebu Bekrit rreth ëndrrës, ai i tha:

“Nëse kjo është një ëndërr e vërtetë, tre njerëzit më të mbarë në tokë do të varrosen në dhomën tënde.”<sup>240</sup>

Tashmë, hëna më e mbarë po ngrihej mbi dhomën e saj, sepse Profeti ishte duke u varrosur atje.

I Dërguari i Zotit do të qëndronte pranë saj. Ky vend ishte i mbushur aq shumë me ngrohtësi, sa që ajo u largua vetëm kur shkoi në Mekë për pelegrinazh, apo për vizita të shkurtra. Kjo praktikë do të vazhdonte deri në fund të jetës së saj.

---

<sup>239</sup> Tirmidhi, *xhenaiz*, 33.

<sup>240</sup> Hakim, *mustedrek*, 3/62; Malik, *muuatta*, *xhenaiz*, 1/232.



## PERIUDHA E KATËR KALIFËVE DHE MUAVIJES

Edhe pse të gjithë e vuanin shumë mungesën e Profetit, jeta vazhdonte. Megjithëse i Dërguari i Zotit mungonte, Aishja, e cila kishte kaluar gjithë kohën me Të, dhe e cila e kishte vëzhguar me kujdes Atë në një sërë situatash, kishte mbetur e vetmuar.

Në praninë e saj ishte kishte një komunikimi dyplanësh - ose njerëzit vinin dhe e pyesnin Aishen, ose Aishja ndërhynte kur ndodhte ndonjë gjë e keqe. Përcjellja e mesazhit vazhdoi, me Aishen si mësuese. Ajo ndante me të tjerët njohuritë që kishte fituar nga i Dërguari i Zotit, dhe sigurohej që brezat e ardhshëm të kishin informacion të shëndetshëm në lidhje me fenë.

Një ditë, pati një mosmarrëveshje për një çështje toke ndërmjet Ebu Selemes dhe disa të tjerëve, të cilët nuk arrinin të binin dakord se ku i takonte toka. Ebu Seleme e ndau shqetësimin e tij me Aishen, ndoshta ngaqë priste mbështetjen e saj. Por pasi e dëgjoi, Aishja i tha Ebu Selemes ta linte me kaq çështjen e asaj toke, sepse kishte dëgjuar nga i Dërguari i Allahut se ai që sillet padrejtësisht qoftë edhe për një pëllëmbë tokë, do të dënohet ashpër pas vdekjes.<sup>241</sup>

Një ditë tjetër, dikush erdhi tek ajo dhe i tha se disa njerëz e recitonin të gjithë Kuranin në një natë, në një ose dy sesione, dhe ai donte të dinte nëse kjo ishte e drejtë. Ajo tha:

“Ata recitojnë, por në të vërtetë, nuk kuptojnë! I Dërguari i Zotit dhe unë kemi falur një herë namazin së bashku gati tërë natën. Ai recitoi suret Bekare, Al Imran dhe Nisa. Kur ai erdhi në një ajet që përmbante një shprehje kërcënuese, menjëherë kërkoi strehë tek Allahu nga ai dënim. Ndërsa kur recitoi një ajet që përmbante një sihariq, u kthye nga Zoti dhe iu lut për atë shpërblim.”<sup>242</sup>

Ashtu si edhe më parë, njerëzit vazhduan të sillnin fëmijët e tyre të porsalindur në shtëpinë e lumturisë për të kërkuar prej saj lutje dhe bekime, dhe Aishja i lutej Allahut t'i bekonte ata. Në një ditë të tillë, ndërsa ajo ishte duke vënë fëmijën përsëri në jastëk, vuri re një hajmali që përdorej për të sjellë fat. E pa me kujdes, e largoi mënjane, dhe e pyeti:

“Çfarë është kjo?”

“Ajo do të na e ruajë fëmijën nga djalli.”, iu përgjigjën.

---

<sup>241</sup> Buhari, *medhalim*, 14.

<sup>242</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/92.

Aishja u zemërua. Kjo ishte një devijim, dhe një devijim i tillë kaq herët pas vdekjes së të Dërguarit të Zotit, do të thoshte një ftesë e hapur për të bërë më shumë gabime në të ardhmen. Ajo e flaku tutje hajmalinë dhe tha:

“Nuk ka asnjë dyshim se i Dërguari i Zotit i ka ndaluar hajmalitë dhe zemërohej shumë me ata që bënin gjëra të tilla.”<sup>243</sup>

Pas pushtimit të tokave të reja, njerëzit habiteshin në lidhje me lejueshmërinë e pijeve që ata kishin parë kohët e fundit, dhe kështu ata erdhën për ta pyetur Aishen. Ajo e trajtoi me kujdes çdo çështje, dhe u kujtoi atyre deklaratat e të Dërguarit të Allahut rreth pijeve dehëse, dhe i këshilloi ata që t’u shmangen pijeve të një natyre të panjohur.<sup>244</sup>

Gjatë sezonit të Haxhit, kur të gjitha rrugët të çonin në Mekë, gratë mblidheshin rreth Aishes dhe i bënin asaj pyetje që u vinin ndër mend. Kjo ka ndodhur aq shpesh, sa që ajo gjithmonë do të ecte së bashku me ndonjë grup grash që mblidheshin rreth saj. Ajo e konsideronte bisedën me to si një moment i përshtatshëm për të përcjellë mesazhin dhe për t’i këshilluar ato.<sup>245</sup>

Kur ndodhej në Mina, Aishja vuri re disa adoleshentë që qeshnin së bashku me njëri-tjetrin. Duke bërë me shenjë nga ata, ajo i pyeti ato që kishte afër se çfarë i bëri ata të qeshnin.

Ato iu përgjigjën:

“Dikush u pengua në litarin e çadrës dhe u rrëzua; ai ishte gati duke thyer qafën dhe duke humbur syrin.

Ajo i paralajmëroi ata:

“Kujdes, mos qeshni. Unë njëherë kam dëgjuar nga i Dërguari i Zotit të thoshte: "Myslimanit i është dhënë një gradë e atillë e lartë shpirtërore, për arsye se për çdo gjemb që i shpon këmbën apo edhe nga ndonjë vuajtje më të madhe se kjo, atij i falet një nga mëkatet e tij.”<sup>246</sup>

Aishja gjithmonë ka pasur për qëllim të përfaqësonte drejtësinë, pa marrë parasysh se kush i adresojte asaj. Njerëzit e dinin se ajo ishte një thesar i diturisë, dhe i bënin shpesh vizita asaj për të marrë përfitimin maksimal.

### **Kalifati i Ebu Bekrit**

Pasi vdiq i Dërguari i Allahut, kalif u bë Ebu Bekri. Megjithëse ishte një njeri i butë dhe i dhembshur, Ebu Bekri kujdesej që mbi çdo gjë tjetër të mbante miratimin e Allahut. Osmani njëherë erdhi tek ai gjatë ditëve të kalifatit të tij dhe i parashtrroi çështjen e trashëgimisë së disa prej grave të të Dërguarit të Allahut. Por në të vërtetë, Resulullahu nuk kishte lënë asgjë pas. Ebu Bekri vendosi të pyeste të bijën, Aishen, nëse ajo dinte ndonjë gjë më tepër në lidhje me këtë çështje, sepse e dinte se ajo nuk ishte mes atyre që pretendonin për trashëgimi.

Pasi e dëgjoi këtë, Aishja u rrëqeth dhe tha:

“Lavdi i qoftë Zotit! Nuk mund të bëhet fjalë trashëgimi, kur vetë i Dërguari i Zotit ka thënë: ‘Ne profetët nuk lënë trashëgimi, ne lëmë vetëm lëmoshë.’”

---

<sup>243</sup> Buhari, *edebul mufred*, 1/314.

<sup>244</sup> Buhari, *eshribe*, 7.

<sup>245</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/225.

<sup>246</sup> Muslim, *birr*, 46.

Gratë e tjera dhe Kalifi pastaj e kuptuan; asnjë gjykim i ri nuk ishte i nevojshëm për një çështje e cila tashmë kishte një gjykim të qartë. Gratë e të Dërguarit të Zotit hoqën dorë nga kërkesa e tyre dhe u rikthyen në jetën e tyre të thjeshtë.<sup>247</sup>

Që prej atëherë e tutje, Aishja ishte një burim i rëndësishëm i informacionit për kalifin Ebu Bekër. Kur njerëzit jo të ndershëm përpiqeshin për ta ngatërruar ose për t'i futur njerëzit në qorrrokak në lidhje me ndonjë çështje, ai konsultohesh shpesh me Aishen. Në ato ditë, Ebu Bekri kishte probleme shumë të mëdha, të mjaftueshme për t'i thërrmuar malet sa të ktheheshin në pluhur. Njohuritë e Aishes qenë të paçmueshme. Gati dy vjet e gjysmë kaluan shpejt. Gjatë kësaj kohe ishin vërejtur tradhtarë dhe profetë të rremë. Ebu Bekri ndjehej i lodhur, por kishte qetësinë e përmbushjes së besimit të të Dërguarit të Zotit.

Ebu Bekri ra i sëmurë. Ai vazhdoi të tregonte ndjeshmëri të njëjtë gjatë sëmundjes së Tij. Ai e mbajti vajzën e tij pranë dhe ndante me të mendimet e tij konfidenciale. Sjellja e tij e përgjithshme dukej se tregonte se ai kishte marrë një ftesë nga qielli - u bë e qartë se koha e qëndrimit të tij në tokë kishte marrë fund. Ebu Bekri kishte qenë në gjendje të duronte humbjen e të Dërguarit të Allahut për vetëm për dy vjet, tre muaj dhe dhjetë ditë.

Aishja, e cila kishte përjetuar ditët e fundit të të Dërguarit të Zotit gjithashtu, u kujdes edhe për babain e saj gjatë sëmundjes së tij.

Ebu Bekri ishte po aq i ndjeshëm në agoninë e tij siç kishte qenë edhe gjatë gjithë jetës. Ai e thirri Osmanin për të shkruar një pakt. Pastaj i kërkoi Aishes t'i dërgonte pagat e tij të mbetura në thesarin e shtetit pas vdekjes. Ai tha:

“Omeri ma kërkoi këtë gjë dhe unë u detyrova të marr gjashtë mijë derhemë nga thesari. Të gjitha ato janë fshehur nën mur në filan vend, ju lutemi t'i gjeni dhe t'ia ktheni ato para Omerit.”<sup>248</sup>

Fjalët e tij përcillnin perceptimin dhe mençurinë e tij, dhe gjithashtu treguan qartë se cilin zgjedhje ai si pasues.

Ai kishte diçka tjetër për t'i thënë Aishes, dhe i tha asaj të vinte më afër, e saora e këshilloi:

“Unë nuk kam shpenzuar as edhe një derhem apo dinar të popullit mysliman që kur kam marrë mbi supe përgjegjësinë që të kujdesem për ta. Përkundrazi, unë kam qëndruar i uritur dhe i veshur në rroba të vjetra.”

Shqetësimi i Ebu Bekrit dhe rrahjet e zemrës së tij rriteshin në çdo minutë që kalonte, dhe ai kërkonte me nxitim të hiqte barrën e rëndë që kishte mbi supe. Ai e shikonte vajzën e tij me dhembshuri. Ai e trajtonte atë si nënën e vet, pasi ajo ishte martuar me të Dërguarin e Zotit. Ngrohtësia e tij dukej se tregonte se sa shumë e donte atë. Dashuria e tij nuk e ndali gjithsesi Ebu Bekrin nga ndarja e problemeve të vështira që ai kishte lënë prapa, prandaj i tha:

“Bija ime e çmuar, ti e di që unë dua dhe të admiroj ty më tepër se këdo në mesin e njerëzve. A të kujtohet se unë të kam dhënë ca tokë, por a mund të ma rikthesh atë përsëri mua, sepse unë nuk jam i kënaqur plotësisht me mënyrën se si e kam ndarë atë. Unë dua që ndarja e pasurisë në mesin e fëmijëve të mi të jetë në përputhje me Librin e Zotit. Në prani të Allahut, unë nuk dua të jem në pozitën e atij që ka preferuar disa nga fëmijët e tij mbi të tjerët.”

Pa asnjë hezitim, ajo iu përgjigj se do ta përmbushte menjëherë dëshirën e tij.<sup>249</sup>

---

<sup>247</sup> Buhari, *hums*, 1.

<sup>248</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 3/193.

<sup>249</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 3/195.

Ebu Bekri e pyeti të bijën:

“Në cilën ditë ka vdekur i Dërguari i Allahut?”

“Ditën e hënë.”

Nga mimika e fytyrës së tij, ajo e kuptoi menjëherë se çfarë po bluante në mendje. Ai pyeti përsëri:

“Çfarë dite është sot?”

“E hënë.”

Ai mori frymë thellë dhe nga buzët e tij dolën fjalët e mëposhtme të cilat shprehnin dëshirën e tij:

“E lus dhe i përgjërohem Allahut që të mos kaloj një natë tjetër pas kësaj!”

Pastaj pyeti:

“Sa çarçafë u patën mbështjellë rreth trupit të të Dërguarit të Allahut pasi vdiq?”

Aishja u përgjigj:

“E mbështollëm trupin e tij me tri copa të reja e të bardha, të cilat quhen *sahulija*. Xhybja dhe veshja e tij nuk ishin mes tyre.”

Duke treguar rrobat që kishte veshur, ai tha:

“Laji këto rroba sepse në to ndodhet një njollë shafrani. Shto edhe dy copa të tjera dhe më mbështillni me to.”

Graviteti i situatës ishte bërë më i dukshëm me kalimin e kohës. Babai i saj dhe kalifi i myslimanëve ishte gati të vdiste. Aishja ndjehej e hutuar dhe e kishte harruar dhimbjen e saj, sepse ajo ishte aq e zënë me kërkesat që vinin njëra pas tjetrës. Ajo në përgjithësi tregoi ndjeshmëri të madhe në përmbushjen e kërkesave të babait të saj përpara vdekjes së tij, por këtë të fundit ajo nuk e miratoi. Ai nuk ishte dokushdo, ai ishte kalifi udhëheqës i besimtarëve, pasuesi i besuar të Dërguarit të Zotit. Ajo kundërshtoi:

“Por ajo është e vjetër.”

Por Ebu Bekri ishte i vendosur në të tijën dhe i tha:

“Kjo është në rregull. Njerëzit që jetojnë kanë nevojë më shumë për rroba të reja se ato që kanë vdekur. Sido që të jetë, qefini i vdekjes do të kalbet.”<sup>250</sup>

Ai kishte një tjetër kërkesë. Ai dëshironte të ruante përsëri afërsinë me të Dërguarin e Zotit që kishte filluar qysh me shpalljen dhe kishte zgjatur për njëzet e tre vjet. Ai dëshironte të varrosej pranë të Dërguarit të Zotit, larg zhurmës dhe bujës. Ai donte që gruaja e tij, Esma binti Umejse t'i lante trupin dhe djali e tij Abdurrahmani ta ndihmonte atë. Sytë e Aishes u mbushën me lot.

Ashtu siç kishte shpresuar, ai u ribashkua me të Dërguarin e Zotit atë natë, dhe u varros pranë tij. Hëna e dytë, të cilën Aishja e kishte parë në ëndërr dhe të cilën Ebu Bekri e kishte interpretuar, u ngrit mbi dhomën e saj. Shtëpia e lumturisë e Aishes priti hënë e kalifit të parë pranë hënës së Profetit.

## Kalifati i Omerit

---

<sup>250</sup> Buhari, *xhenaiz*, 92.

Gjatë kalifatit të Omerit, Aishja mbeti një autoritet i rëndësishëm me të cilën duhej konsultuar për çështjet që dolën. Edhe pse ai i respektonte të gjitha të vejat e të Dërguarit të Allahut, njohuritë e Aishes e bënë atë unike. Ai i drejtohej asaj si "më e dashura e të Dërguarit të Zotit."

Omeri së pari kishte parasysh të vejat e Profetit, kur ai bënte shpërndarjen e pasurisë së fituar në zgjerimet territoriale, duke i dhënë secilës prej tyre dhjetë ose dymbëdhjetë mijë derhemë në vit. Ai i dha dy mijë më shumë Aishes, për shkak të pozicionit të saj në krah të të Dërguarit të Zotit.<sup>251</sup>

Omeri mbajti mbi supe një barrë të rëndë. Ai ndërhyri menjëherë kur pa se dikush gabimisht jepte vendime fetare jo të sakta, dhe ai nuk lejoi që çështjet fetare të konsideroheshin dosido. Në të vërtetë, ai synonte të shmangte përzierjen e Kuranit dhe Sunetit me çështje të tjera. Nën dritën e epokës së tij, ai ishte një vendim i mençur. Në Medinë, gjatë kohës së Omerit, kur njerëzit nuk e merrnin fenë si diçka të lehtë apo sipas dëshirës, Aishja ishte një prej udhëheqësve të dhënies së fetvave kur çështjet ishin të pasigurta.

Omeri ishte një vizitor i rregullt i Aishes, ai e pyeste atë për ndonjë gjë në të cilën ai nuk kishte njohuri, dhe shpesh merrte vendime të bazuara në pikëpamjet e Aishes. Qëndrimi i tij ndaj saj ishte i njëjtë si për të vejat e tjera, ai i takonte ato dhe u jepte atyre gjithmonë përparësi. Ai i pyeste nëse kishin nevojë për ndonjë gjë, dhe i favorizonte ato në përfitimin nga çdo mundësi ose pasuri të fituar nga ai. Kur ai merrte ndonjë sasi frutash jashtë sezonit, ai i vendoste ato nëpër shporta të veçanta dhe i dërgonte për gratë e Profetit. Kur ai therte ndonjë kafshë, së pari mendonte për to. Aishja ka thënë:

"Omeri mendonte për çdo detaj, pa diskriminuar asnjërin, dhe kurrë nuk e linte pas dore dërgimin tek secila prej nesh të pjesës sonë nga një kafshë e therur."

Kur u pushtua Mesopotamia, erdhi koha për të shpërndarë plaçkën e luftës. Sahabët më të shquar u mbledhën për të marrë një vendim për ndarjen e tyre. Pas disa diskutimesh, Omeri tha:

"Sipas mendimit tim, preja e tyre i përket atyre që kanë punuar më shumë në këtë triumf, dhe duhet të ndahet midis tyre.

Të gjithë e mbështetën mendimin e tij. Kështu Omeri pyeti:

"Pra me kë duhet të fillojmë?"

Ata u përgjigjën:

"Kush tjetër i meriton ato më shumë se ti? Sigurisht duhet të fillosh nga vetvetja."

Si kalif, të tjerëve ndoshta iu duk se ai meritonte më shumë se të tjerët për shkak të statusit të tij. Megjithatë, ai kurrë nuk e kishte parë të Dërguarin e Zotit të sillej në këtë mënyrë. I Dërguari i Allahut preferonte të ishte i fundit kush shpërndahej plaçka e luftës, edhe pse ai ishte i pari në vijën e frontit dhe në sakrifica. Prandaj ai u përgjigj:

"Jo, unë do të filloj nga familja e të Dërguarit të Allahut."<sup>252</sup>

Përsëri, pas të njëjtit pushtim, një qese e vogël lecke plot me bizhuteri u soll te kalifi. Ai i pyeti njerëzit rreth tij:

"A e dini vlerën e kësaj?"

Askush nuk e dinte. Meqë askush nuk ishte i sigurt për vlerën e saj, Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të) nuk mundi ta ndante atë në mënyrë të drejtë. Pra, ai pyeti:

---

<sup>251</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/9.

<sup>252</sup> Imam Shafi, *Musned*, 1/326.

“A më lejoni t’ia dërgoj më të dashurës së të Dërguarit të Allahut?”

Më e dashura e të Dërguarit të Allahut ishte e dashur për çdo njeri dhe pa hezitim, ata u përgjigjën në mënyrë pohuese.

Me një korrier, Omeri e dërgoi atë qese të vogël lecke tek Aishja. Me gjakftohtësi, ajo e hapi çantën me kujdes. Kur pa bizhuteritë, ajo psherëtiu dhe u ngashërye. Ndoshta ajo në ato çaste po sillte ndër mend jetën modeste të të Dërguarit të Allahut. Me lot në sy tha:

“Përse ma bëri këtë Omeri mua pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut?”

Me duar të ngritura lart, ajo u lut: “O Allahu im, mos ma jep më mundësinë ta përjetoj këtë mirësi; të lutem ma merr shpirtin përpara se të shoh një dhuratë tjetër të tillë!”<sup>253</sup>

Omeri shfaqti të njëjtën ndjeshmëri kur shpërndau fitimet pas pushtimit të Hajberit. Ai nuk i harroi gratë e Profetit, duke u dhënë atyre mundësinë për të zgjedhur mes tokave apo një pensioni mujor.<sup>254</sup>

Aishja ishte e ndrojtur përpara Omerit, sepse ajo kishte parë që i Dërguari i Zotit sillej ndryshe me të, dhe i Dërguari i Zotit kishte thënë madje se edhe vetë shejtani frikësohej prej tij. Respekti reciprok mes tyre ishte në plan të parë. Kur shtrohej problemi i njohurive rreth fesë, statusi i Aishes ishte i padiskutueshëm për Omerin. Ai gjithashtu vazhdoi traditën e Ebu Bekrit në vizitat që i bënte Aishes ose duke dërguar një emisar për t’u konsultuar me të për problemet me të cilat përballej. Kjo nuk ishte mënyra e vetme për kalifët; kjo konsideratë pasqyronte qëndrimet e përgjithshme të sahabëve dhe brezin e mëposhtme të dijetarëve myslimanë veçanërisht kur bëhej fjalë për një çështje që lidhej me njohjen e hadithit.<sup>255</sup>

Një ditë, Omeri dëgjoi se Amër ibn Umeje u kishte dhënë një sasi rrobash disa të përdalave, të cilat ishin të përjashtuara nga shoqëria për shkak të korrupsionit të tyre moral, dhe ai u zemëruar shumë. Omeri i tha Amrit se një lëmoshë e tillë nuk do të pranohej si sadaka nga Allahu. Por Amri këmbënguli, duke thënë ato që i Dërguari i Zotit kishte thënë rreth të përdalave:

“Edhe gjërat që u jepni atyre ju llogariten si sadaka.”

Mbrojtja e tij e rriti zemërimin e Omerit dhe ai tha se kjo ishte shpifje për të Dërguarin e Zotit. Meqenëse grindja e tyre mori përmasa të mëdha, ata ranë dakord të shkonin tek Aishja për të kërkuar një zgjidhje. Amri tha:

“Për hir të Zotit, dua që të na tregosh: a nuk e ke dëgjuar të Dërguarin e Zotit duke thënë: ‘edhe gjërat që u jepni atyre konsiderohen si lëmoshë për ju?’”

Përgjigjja e Aishes ishte e qartë:

“Kam Allahun dëshmitar, po, e kam dëgjuar.”

Përgjigjja e saj e bëri Omerin të tërhiqej i tronditur, sepse gjykimi i tij ishte diçka publike. Ai filloi t’i thërriste mendjes dhe mendonte me vete: “Kushedi sa gjëra kam humbur pa i dëgjuar nga i Dërguari i Allahut ndërsa merresha me punët e mia.”<sup>256</sup>

Ditët pasonin njëra-tjetrën, dhe tashmë kishin kaluar dhjetë vjet. Kishte ardhur koha për udhëtimin e paracaktuar të Omerit - kalifi u vra, dhe ai u shtri i mbuluar në gjakun e tij. Një kamë e shkurtër e helmuar e goditi, dhe Kalifi ishte gati për t’i dhënë lamtumirën kësaj bote. Ai ishte i

<sup>253</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/9; Ahmed bin Hanbel, *fedailu Sahabe*, 2/875.

<sup>254</sup> Buhari, *muzaraa*, 7.

<sup>255</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 2/375.

<sup>256</sup> Zerkeshi, *ilxhabe*, 20.

shqetësuar, sepse deri atëherë i kishte munguar guximi për t'i thënë Aishes se ai dëshironte të varrosej pranë të Dërguarit të Zotit, tek këmbët e tij. Leja e Aishes ishte e nevojshme. Por koha punonte kundër Omerit dhe ai ishte gati për ta humbur këtë shans. Thirri të birin, Abdullahun, dhe i tha:

"Shko tek nëna e besimtarëve, Aishja dhe ki kujdes të mos i thuash se të ka dërguar kalifi. Prej tani e tutje, unë nuk jam më udhëheqës për besimtarët. Thuaj 'Omer ibn Hatabi më ka dërguar' dhe pastaj thuaji: 'ai kërkon leje nga ti për t'u varrosur pranë dy miqve të tij të mëparshëm.'"

Ky ishte një mesazh shumë delikat. Sjellje të mira të bashkësisë së themeluar nga i Dërguari i Allahut ishin përtej çdo krahassimi. Edhe pse zemra e tij donte shumë që t'i plotësohej kërkesa, ai nuk donte të ushtronte presion mbi Aishen duke përdorur titullin e tij. Ai donte që e tija të pranohej si kërkesa e një njeriu të zakonshëm. Abdullahu shkoi tek Aishja menjëherë. Aishja e kishte dëgjuar lajmin prekës, dhe po qante për atë që i kishte ndodhur Omerit. Pasi e përshëndeti, Abdullahu kërkoj leje për të folur, dhe i tha:

"Omeri të dërgon përshëndetjet e tij. Ai dëshiron të varroset pranë dy miqve të tij."

Kush nuk dëshironte të varrosej pranë të Dërguarit të Zotit dhe shokut të tij besnik? Kjo ishte ajo që edhe Aishja e dëshironte shumë. Por ajo e dinte se duhet të preferonte vëllezërit dhe motrat e saj myslimane përpara vetes. Ajo u kthye nga Abdullah ibn Omeri dhe i tha:

Unë e kisha planifikuar atë vend për vete, por sot unë preferoj Omerin në vend të vetes sime."

Me të mësuar për përgjigjen e Aishes, Omeri mori frymë thellë. Meraku që kishte ndjerë ishte zhdukur, dhe sytë e tij ishin të qeshur. Ishte koha për t'u larguar. Pastaj një ankth i fundëm iu shfaq në mendje. Ndoshta leja ishte marrë nën ndikimin e autoritetit të kalifit. Ai vendosi ta konfirmonte edhe një herë dhe e thirri përsëri të birin e i tha: "O Abdullah, kur unë të vdes, më vendos në tabutin tim, më çoj tek dera e Aishes dhe thuaji, 'Omeri, i biri Hatabit kërkon leje nga ti.' Nëse ajo e jep lejen e saj përsëri, më varros atje. Nëse ti e kupton se ajo ka ndryshuar mendje, ki kujdes dhe mos këmbëngul. Në këtë rast, më varros në varrezat publike si gjithë të tjerët. Kam frikë se ajo e ndjeu veten të detyruar nga titulli im si kalif kur ta dha lejen."

Omeri nuk e humbi arsyen edhe kur po luftonte me vdekjen. Me dhënien e frymës së fundit, ai u nis për në udhëtimin e Tij të përjetshëm. Medinën e pllakosi një dhimbje e thellë, sikur qyteti të mos kishte përjetuar kurrë fatkeqësi deri atë ditë. Ishte koha për përmbushjen e amanetit të tij të fundit.

Abdullah ibn Omeri erdhi përsëri tek Aishja dhe i tregoi se çfarë kishte thënë i ati. Aishja, e mbushur plot me një admirim të habitshëm, për një moment bëri një pauzë - çfarë leksioni kortezie kishte dhënë ai njeri kur po e linte këtë botë. Sigurisht, Omeri tregoi me këtë gjest gjithë madhësinë, mirësjelljen dhe delikatesën e tij, por natyrisht që këto karakteristika nuk ishin vetëm të tijat.

Por ajo e kishte dhënë njëherë fjalën dhe e konsideroi të panevojshme që ta rikonfirmonte lejen. Ajo i përsëriti edhe një herë fjalët që kishte thënë në mënyrë që çështja të sqarohet njëherë e mirë dhe njerëzit të ndjeheshin të qetë. Kështu, Omeri e nisi pushimin e tij të amshuar në vendin që Aishja e kishte ruajtur për veten.<sup>257</sup> Për pasojë, ëndrra e Aishes u bë realitet dhe hëna e tretë lindi përmbi dhomën e saj.

Varrimi i Omerit përbënte fillimin e një periudhe të re për Aishen, për arsye se ajo nuk e ndiente më veten rehat kur vizitonte të Dërguarin e Allahut dhe të atin e saj. Pas varrosjes së Omerit, ajo e

---

<sup>257</sup> Buhari, *fedailu sahabe*, 8.

mbulonte fytyrën kur ishte aty, gjë të cilën nuk e kishte bërë më përpara. Megjithëse Omeri kishte vdekur, ajo rrinte e mbuluar kur ishte pranë vendit ku ai ishte i varrosur. Për shkak se dhoma e saj nuk ishte aq e madhe sa edhe për një person të katërt, Aishja u shpërngul tek një vend aty pranë.<sup>258</sup>

### Kalifati i Osmanit

Statusi i Aishes gjatë periudhës së dy kalifëve të parë, mbeti i njëjtë edhe gjatë periudhës së kalifatit të Osmanit. Njerëz nga zonat e fituara rishtaz, vinin tek Aishja, për të marrë informacionin me anën e të cilit ata kërkonin të fitonin dritën. Osmani ishte një udhëheqës në mesin e tyre, por qëndrimi i tij nuk ishte i ndryshëm nga ai i Omerit në lidhje me gratë e të Dërguarit të Allahut, sidomos Aishen. Ai u përpoq për të përmbushur dëshirat e tyre dhe t'i bënte ato të ndiheshin rehat kur kryenin adhurimin, si dhe u përpoq për të përmirësuar kushtet e tyre.

Vihej re një qëndrim i rezervuar i Aishes drejt Osmanit, qëndrim i cili njihej nga të gjithë, sepse edhe vetë i Dërguari i Zotit kishte ndjerë ndrojtje ndaj tij gjithashtu. Rreth Osmanit, i Dërguari i Zotit ka thënë:

“Si mos të kem ndrojtje ndaj një njeriu për të cilin ndjejnë ndrojtje edhe engjëjt?”<sup>259</sup>

I Dërguari i Allahut i kishte martuar dy nga vajzat e tij me të dhe ishte lutur për të shumë herë.<sup>260</sup>

Siguria qetësia dhe paqja mbizotëruan në gjashtë vitet e para të kalifatit të tij, që zgjati dymbëdhjetë vjet. Por në vitin e shtatë, u vunë re shenjat e para të trazirave dhe disa grupe njerëzish filluan të shprehnin kundërshtimet e tyre. Dera e fitnes ishte thyer dhe disa njerëz filluan të mendonin ndryshe nga kalifi. Disa madje nisën ta përgojonin haptazi dhe pa takt, dhe si rezultat, Kalifi u bë një shënjestër sulmesh. Disa persona, të tillë si ibn Sebe, synonin ta ulnin vlerën e Islamit përmes kalifit.

Aishja pikëllonte shumë kur dëgjonte për grindjet e brendshme, dhe i paralajmëronte ata që qëndronin pas këtyre sherreve:

“Njerëzit të cilët mallkojnë Osmanin nuk e kuptojnë ende se ata vetë do të jenë objekt i çdo lloj mallkimi. Me siguri Allahu do t'i mallkojë ata gjithashtu. Një ditë kam parë të Dërguarin e Zotit të ulur me gjunjët e Tij që preknin ato të Osmanit. Ai po merrte një mesazh hyjnor dhe unë fshiva djersën nga balli i Tij. Për më tepër, i Dërguari i Allahut i pat martuar dhe dy bijat e Tij me të. Ai me përkëdheli e quante atë 'Osman i dashur.' Mos harroni se njeriu i cili ishte aq i denjë për të Dërguarin të Zotit, është gjithashtu një rob i çmuar i Allahut.”<sup>261</sup>

Ajo thoshte gjithashtu se i Dërguari i Allahut i ka thënë tri herë Osmanit:

“O Osman, kur të vijë dita, Allahu do të bëjë që ti të veshësh një këmishë të rëndësishme duke të bërë udhëheqës; nëse hipokritët duan të ta marrin atë këmishë, ki kujdes dhe mos ia jep atë!”

Edhe gjatë sëmundjes së tij, i Dërguari i Allahut u pat kthyer nga Aishja dhe i pat thënë:

“Dua që të më thërrasësh një shok timin.”

Aishja e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, a të të thërras Ebu Bekrin?”

Ai heshti. Aishja e pyeti përsëri:

<sup>258</sup> Nedeui, *Siretu sejidatu Aishe*, 154, 155.

<sup>259</sup> Buhari, *edebul mufred*, 1/211.

<sup>260</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/261.

<sup>261</sup> Po aty, 6/250.



“A të thërras Omerin?”

Ai vazhdonte të heshtte. Ishte e qartë se ai kërkonte dikë, por emrin nuk po ia thoshte. Aishja e pyeti:

“A të thërras Osmanin?”

Një buzëqeshje u shfaq menjëherë në fytyrën e Tij të bekuar dhe ai i tha Aishes:

“Po.”

Osmani u thirr në praninë e të Dërguarit të Zotit dhe ata folën mjaft gjatë së bashku. I Dërguari i Zotit me sa duket i rikujtoi atij rëndësinë e përgjegjësisë që do të kishte mbi shpatulla, kur të shfaqeshin mosmarrëveshjet. Duke ia hapur paksa perden e të ardhmes së panjohur, Ai e këshilloi që t'i menaxhojë me durim mosmarrëveshjet. Kjo ngjarje do të bëhej publike prej tij vite më pas, kur gjithçka ishte bërë gati për të ndodhur. Ai tha:

“I Dërguari i Allahut ma ka dhënë premtimin, prandaj unë do ta mbart këtë përgjegjësi me durim!”<sup>262</sup>

Aishja, sigurisht ishte e vetmja e cila e kishte kuptuar më mirë nga të gjithë pozitën e Osmanit në krah të të Dërguarit të Allahut. Megjithatë ajo nuk ngurroi të vinte në dukje gabimet që vinte re. Ajo nuk e kishte problem të fliste rreth këtyre gabimeve, sidomos për sa i takon vendimeve politike dhe nuk reshti së paralajmëruari mikun e vjetër të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Në kohën kur kufijtë ishin zgjeruar dhe nisën të shfaqeshin probleme të brendshme, disa fise të njohur dolën në ballë të atyre që kundërshtonin, gjë e cila e rriti dëshirën e të tjerëve për të kundërshtuar autoritetin e kalifatit. Ky ishte mjedis i përsosur për ata që përpiqeshin të fusnin përçarje, siç ishte Abdullah ibni Sebe. Ai përhap një thashethem sikur i Dërguari i Zotit ia kishte lënë Aliut pozitën e kalifit. Territoret e kontrolluara nga myslimanët ishin zgjeruar që nga Perandoria Bizantine e deri në Afrikë, dhe ai mblodhi dhe provokoi njerëz duke i ftuar ata që të rebelohen. Ata zgjodhën Egjiptin si bazën e tyre.

Trazirat u përhapën edhe në zona të tjera dhe kjo bëri që edhe njerëz të sinqertë të bëheshin të pavendosur. Muharrik ibni Thumame, një lider në Basra, hezitonte të vepronte, si rezultat i atyre që kishte dëgjuar. Ai e dërgoi motrën e tij Umu Kulthum binti Thumamen tek Aishja që t'i kërkonte asaj një mendim:

“Shko tek Aishja dhe kërkoji mendimin e saj në lidhje me Osman ibn Afanin. Njerëzit këtu thonë shumë gjëra rreth tij.”

Ai i nisi gjithashtu një letër ku i tregonte me imtësi ato çfarë kishte dëgjuar dhe ku kërkonte mendimin e Aishes për Osmanin. Umu Kulthumi ia dorëzoi letrën Aishes dhe i tha:

“O nëna ime e dashur, disa nga fëmijët e tu më dërguan tek ti. Ata të shprehin përshëndetjet dhe respektin e tyre dhe kërkojnë të dinë mendimin tënd rreth Osman ibni Afanit.”

Aishja e nisi fjalën e saj duke thënë:

“Allahu e mallkoftë atë që mallkon Osmanin.”

Një për një, Aishja ia tregoi asaj vendin e nderuar të Osmanit në sytë e të Dërguarit të Zotit. Atëherë ajo tha se ata që thonë gjëra të pavërteta apo harbutëria rreth tij do të jenë përjetë të mallkuara.<sup>263</sup>

---

<sup>262</sup> Tirmidhi, *menakib*, 19.

<sup>263</sup> Buhari, *edebul mufred*, 1/288.

Një ditë, Osmani dëgjoi lajmin se mijëra njerëz të mbledhur nga rajone të ndryshme ishin mbledhur dhe kishin filluar të lëviznin në drejtim të Hixhazit "për të kryer haxhin." Edhe pse kjo lëvizje dukej pa ndonjë qëllim të keq, synim i vërtetë i tyre ishte Kalifati. Duke e kuptuar siç duhet situatën, Osmani caktoi Aliun t'i kthente ata nga kishin ardhur. Aliu shkoi dhe bisedoi me ta deri në detajet më të imta.

Ata ishin njerëz të cilët kishin kaluar çdo kufi. Ata e lavdëruan dhe e ngritën në qiell Aliun. Megjithatë, Aliu në fjalën e tij u tregoi atyre se e kishin gabim. Me qëllim që të kontrollonin situatën, ata pretenduan se u qetësuan, megjithëse do të riktheheshin më pas për të marrë Kalifatin. Edhe vëllai i Aishes, Muhamed ibn Ebu Bekër ishte mes tyre. Zgjedhja e tij e hidhëroi Aishen. Ajo i tha atij se ishte në rrugë të gabuar, por nuk qe në gjendje t'ia ndryshonte mendjen. Ajo madje i kërkoi atij për të kryer haxhin me të, për ta mbajtur larg nga rebelët, por nuk arriti të merrte prej tij një përgjigje pozitive. Kalifi i të Dërguarit të Zotit u detyrua të dorëzohej, dhe ata nuk lejuan t'i çohet atij as edhe një pikë uji. Edhe një përpjekje e Umu Habibes për t'i çuar pak ujë Kalifit dështoi dhe ata gati sa nuk e vranë Umu Habiben e cila u detyrua të ikte me vrap nëpër turmë.<sup>267</sup> Kjo situatë vazhdoi për tri javë rresht.

Në një kohë kur atmosfera në Medinë ishte aq errët sa nuk kishte ku të vente më, sezoni i haxhit erdhi. Aishja shkoi në Mekë për të kryer haxhin. Edhe kur njerëzit i thanë asaj se do ishte më mirë të qëndronte në Medinë në paqe, Aishja solli ndërmend atë çfarë kishte ndodhur me Umu Habiben dhe tha:

"Edhe unë sikur të isha atje e të flisja kundër tyre, do të më kishte ndodhur edhe mua si Umu Habibes."<sup>268</sup>

Pas kryerjes së Haxhit, ajo u rikthye në Medinë ku i rrëfyej lajmin e hidhur se Kalifi i tretë i Allahut, ishte martirizuar. Përgjigjja e saj e parë ishte ndaj atyre të cilët e kishin kritikuar Osmanin:

"Kjo që ndodhi ishte për shkak të kritikave tuaja rreth gjithçkaje që ka bërë kalifati!"

Kriticizmi i tyre rreth Osmanit, i cili ishte përpjekur të afronte pranë vetes disa udhëheqës të cilët kishin shkaktuar çrregullime, ishte venitur. Osmani kishte dashur të ulte tensionet në shoqërinë e drejtuar prej tij duke i afruar kundërshtarët dhe duke iu dhënë atyre poste të rëndësishme. Por njerëzit nuk arritën t'i kuptonin përpjekjet e tij për paqe. Ata nuk kishin mundur të shmangnin veten nga kritikën rreth Osmanit si dhe ndaj deklarimeve të hapëta se ai po vepronte gabim.

Kur Aishja u takua me Talhën dhe Zubejrin, i pyeti:

"Çfarë të rejash kemi nga ju?"

Ajo kishte qenë larg atmosferës helmuese të Medinës për njëfarë kohe, për të shkuar drejt qytetit paqësor të Mekës. Njerëzit që mbushnin rrugët ishin larguar nga drejtësia dhe ndershmëria, dhe nuk ishte e qartë se çfarë kishin ndër mend të bënin. Aishja recitoi një pjesë të sures Huxhurat:

*"E nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtojini ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me pa të drejtë, derisa t'i bindet udhëzimit të Allahut, e nëse kthehet, atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre, mbajeni drejtësinë se vërtet Allahu i do të drejtët. S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kijeni frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti)."*<sup>264</sup>

Ajo më pas shtoi:

---

<sup>264</sup> Huxhurat, 9-10.

“Sa nevojë kanë njerëzit të mbahen fort pas këtyre ajeteve në këtë moment.”<sup>265</sup>

Aishja u krodh në mendime; goja e saj u vulos nga vuajtjet. Në vend që të shkonte drejt kaosit, ajo u kthye përsëri në Mekë, drejt Qabes. Ajo nuk fliste fare dhe nuk dëshironte të dëgjonte asgjë nga askush. Ajo vajti tek dera e Qabes e pastaj tek Guri i Ismailit, dhe ra në sexhde aty, duke vajtuar për atë që po i ndodhte umetit mysliman.

Kur njerëzit dëgjuan se ajo ishte aty, erdhën e u mblodhën rreth saj duke formuar një turmë të madhe. Ata prisnin që Aishja të fliste.

Ajo përmblodhi me pak fjalë ato çfarë kishin ndodhur dhe i këshilloi ata të vepronin në përputhje me parimet e Islamit. Në fund, tha:

“Ata ushtruan shumë trysni mbi të, saqë edhe nëse pretendimet e shpifjes rreth tij do ishin të vërteta, ai do të mbetet aq i pastër sa ari i mbledhur nga pluhuri, apo si rrobat e lara me ujë, dhe në këtë mënyrë, ai do të shkojë i pastruar nga çdo mëkat në praninë e Allahut.”<sup>266</sup>

Edhe pse atë ditë, nuk kishte ndonjë dobi në të kuptuarit e gabimeve të djeshme, ajo shpresonte t’u jepte një mësim nga e kaluara, për t’i ndihmuar ata të shmangnin të njëjtat gabime në të ardhmen.

Ndjenjat e Aishes ishin lënduar dhe ajo e kishte të vështirë të pranonte realitetin. Eshter Nehaiu erdhi tek ajo gjatë ditëve të para, kur tronditja e incidentit akoma nuk ishte kapërcyer, dhe e pyeti:

“Cili është mendimi yt në lidhje me martirizimin e kalifit?”

Ajo u përgjigj:

“Ruajna Zot! Si mund të jem dakord unë me vrasjen e udhëheqësit të myslimanëve? Si mund ta pranonte zemra ime atë gjë?”<sup>267</sup>

Por problemet e djeshme i duheshin lënë së shkuarës, dhe ishte koha për të ndërmarrë një hap të ri. Nga aftësia për të kontrolluar rrugët varej edhe caktimi i kalifit të ri. Kandidati i Aishes për kalif ishte Aliu dhe ajo ia tha këtë cilitdo që e pyeti për këtë çështje.

Ndërtimi i shtetit mysliman pas periudhës së Osmanit ishte i rëndësishëm në vetvete, ndaj duheshin hartuar plane të kujdesshme. Por situata aktuale ishte një pengesë për të menduarit e shëndoshë; pastërtia e kohës së të Dërguarit të Allahut çdo ditë e më shumë zhdukej dhe çdo gjë dukej e vrazhdë dhe e megjullt. Kjo ishte shenjë paralajmëruese e trazirave më të mëdha. Fitneja që e kishte kthyer jetën kokëposhtë vazhdonte dhe askush nuk ishte në gjendje të dinte se kur do të ndalonte apo cilin do të përfshinte. Në rrethana të tilla të errëta, duart e fshehta ndërhyjnë nga jashtë, duke shpresuar që të kequdhëzojnë edhe besimtarët më të singertë. Ashtu siç kishte paralajmëruar i Dërguari i Zotit vite më parë, ata po hynin në një epokë të re. Aishja donte të shtynte edhe pak kthimin e saj në Medinë derisa mosmarrëveshjet të kishin përfunduar.

Trazira kulmoi me vrasjen e kalifit Osman. Ata kishin derdhur gjakun që ishte i ndaluar për t’u derdhur, në qytetin ku gjakderdhja ishte e ndaluar, dhe ishin përpjekur të fitonin kapital gjatë muajve të shenjtë, gjë që ishte e ndaluar. Aishja tha se edhe në qoftë se rebelët do të ishin aq të shumtë sa të ishin të mjaftueshëm për të mbushur gjithë botën, ajo nuk i konsideronte ata të gjithë bashkë, as sa edhe një gisht i Osmanit, për shkak të ligësisë së veprimeve të tyre.<sup>268</sup>

<sup>265</sup> Malik, *muuatta*, sijer, 1002; Hakim, *Mustedrek*, 1/168.

<sup>266</sup> Taberiu, *tarik*, 3/6.

<sup>267</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/485.

<sup>268</sup> Taberani, *Musnedu Shamijin*, 2/75.

## Kalifati i Aliut

Në mënyrë që të ndalonte trazirat dhe të rivendoste sigurinë, Aliu e filloi punën me zëvendësimin e guvernatorëve të provincave, të cilat ishin përfshirë në fitne. Por kjo do të sillte probleme të reja e të pafundme për Aliun.

Aishja ishte bërë më e preokupuar për Medinën, prej nga vinin vazhdimisht lajme shqetësuese. Njerëzit u mbledhën rreth saj, duke përfshirë edhe udhëheqësit e provincave të periudhës së Osmanit. Edhe pse e kishin pranuar kalifatin e Aliut, udhëheqës të tillë si Talha dhe Zubejri erdhën tek Aishja në Mekë, të paaftë të duronin të vetëm pikëllimin e tyre, veprim ky i cili tërhoqi vëmendjen e të tjerëve.

Meka u bë vendtakimi për ata që ishin të shqetësuar në lidhje me ngjarjet e fundit. Qyteti u bë një vend qendror për ata që donin të hakmerreshin për vrasjen e Osmanit, vrasësit e të cilit ende nuk ishin sjellë para drejtësisë. Turmat e njerëzve dukeshin të shqetësuar në lidhje me shkatërrimin e punës shumëvjeçare, ata që ishin të sigurtë qëndruan së bashku për të gjetur përsëri paqen e humbur. Edhe pse sezoni i haxhit kishte përfunduar dhe njerëzit pritej të largoheshin nga Meka, ata nuk u larguan. Zërat që dilnin nga turma thoshin:

“Ne nuk ikim prej këtej derisa të gjendet vrasësi i Osmanit.”

Udhëheqësit u mbledhën për të diskutuar mendimet e tyre. Ndërsa disa propozuan të qëndronin në Mekë, disa të tjerë mendonin se ata duhet të ktheheshin në Medinë. Shumica besonin se objektivi i tyre duhet të ishte Basra, sepse ata ishin të mendimit se njerëzit të cilët kishin vrarë Osmanin ishin nga Basra. Pra, Basra u bë objektivi i tyre. Synimi i tyre ishte për t'u hakmarrë për vrasjen e Osmanit dhe të rivendosnin sistemin që kishte rënë.

Një ushtri e cila do të ndëshkonte ibni Seben dhe mbështetësit e tij rebelë, u krijua duke ndërtuar një shtab në Abtah; disa dhuruan me qindra kuaj dhe deve, ndërsa disa të tjerë siguruan furnizimet luftës, të tjerët dhuruan një sasi të madhe argjendi dhe ari.

Aishja dhe bashkëshortet e tjera të të Dërguarit të Allahut ishin së bashku. Por ato qëndruan prapa kur ushtria shkoi në Basra, dhe me lot në sy, u uruan atyre një udhëtim të sigurt.

Aliu u nis me një ekspeditë ushtarake që të shkonte drejt Mesopotamisë, në mënyrë që të rivendoste autoritetin. Por kur mori lajmin për Aishen dhe turmën që lëvizte drejt Basrës, u kthye. Ai donte të qetësonte turmën që përfshinte sahabët kryesorë, e në radhë të parë Aishen. Sahabiu Imran ibni Huseini, dhe udhëheqësi i tabiinëve Ebu Esued Dueli, shkoi tek Aishja. Guvernatori i Basrës, Osman ibni Hunejfi gjithashtu dërgoi një grup njerëzish për të mësuar synimet e grupit që po vinte në drejtim të tyre. Ata thanë:

“Udhëheqësi ynë na dërgoi tek ju në mënyrë që të mësojë qëllimet tuaja.”

Aishja tha:

“Unë betohem në Zot, se një person si unë nuk vepron fshehurazi apo duke mos u thënë të vërtetën fëmijëve të saj.” Ajo shpjegoi gjerë e gjatë shqetësimet mbi zinxhirin e gabimeve, dhe se si ajo e kishte filluar këtë udhëtim për hir të urdhërimit për mirë dhe ndalimit nga e keqja.<sup>269</sup>

Talha dhe Zubejri dhanë një përgjigje të ngjashme. Të gjithë donin të gjenin vrasësit e Osmanit dhe t'i vinin kapak trazirave.

---

<sup>269</sup> Taberiu, *tarih*, 3/14.

Ata nxitonin të rivendosnin paqes dhe i ftuan njerëzit për t'u qetësuar. Predikimet e Aishes patën një efekt të thellë tek ata që e dëgjuan. Turma u nda në dy pjesë dhe një grup i madh prej tyre ndaloi së kundërshtuari Aishen.<sup>270</sup>

Ata që e pasonin, Aishja i këshilloi që kurrë që të mos i zhveshin shpatat e tyre përveçse nëse ata detyroheshin ta bënin këtë. Pavarësisht nga tensioni, ajo shpjegoi se askush nuk kishte leje për të luftuar ose lënduar një person tjetër, përveçse për vetëmbrojtje. Aishja kërkoi që të lirohej Osman ibni Hunejfi, i cili ishte kapur rob në rrëmujën që shpërtheu gjatë trazirave. Ajo tha se atij duhet t'i jepej mundësia për të shkuar kudo që ai të dëshironte.<sup>271</sup>

Aishja, e cila u dërgoi letra njerëzve në Kufë të ngjashme me ato që ajo i kishte dërguar për njerëzit në Basra, u kërkoi atyre që të ndihmonin në krijimin e një mjedisi paqësor. Drejtuesit ishin në mesin e atyre, të cilët morën letrat e saj; ajo u kërkoi atyre në mënyrë të drejtpërdrejtë që të tregonin ndjeshmëri.<sup>272</sup>

Muhamed ibni Ebu Bekrit dhe Muhamed ibni Talhas, të cilët e pyetën Aishen se si duhej vepruar në situatat kur myslimanët luftonin vëllezërit e tyre myslimanë, ajo u rikujtoi historinë e trishtuar të dy bijve të Ademit. Edhe pse Kabili kishte për qëllim ta vriste, Habili premtoi të mos ngrejë dorë kundër tij. Aishja u tha:

“O bijtë e mi të dashur! Nëse ju jeni në gjendje të bëni atë që bëri djali më i mbarë i Ademit, atë bëni!”<sup>273</sup>

### **Sprova e myslimanëve me vëllezërit e tyre: ndodhia e devesë**

Kur Aliu u largua nga Medina doli me vetëm shtatëqind njerëz, ndërkohë ky numër u rrit në shtatë mijë veta deri në momentin kur ai mbërriti në Kufë. Kur me ta u bashkuan edhe njerëzit që vinin nga Basra, numri total shkoi në rreth njëzet mijë. Nga ana tjetër, ata që ishin me Aishen numëroheshin në rreth tridhjetë mijë vetë. Kjo situatë ngjante me një rrugë që nuk kishte dalje, por vetëm një fund të hidhur. Shpatat që fillimisht ishin nxjerrë për të luftuar jobesimtarët dhe për të rivendosur në vend drejtësinë, tani ndoshta do të drejtoheshin kundër vëllezërve të dashur, të cilët deri atë ditë ishin falur pranë njëri-tjetrit për hir të Allahut. Ishte një skenë e trishtuar për të dy grupet. Beteja e Devesë do të ishte prova më e vështirë me të cilën komuniteti mysliman ishte ballafaquar deri atëherë.

Të dy grupet u takuan në Dhakar. Së pari, korrieri i Aliut, Ka'ka ibni Amri, erdhi tek Aishja dhe i tha:

“O nëna ime e dashur, ju lutem mund të më thoni arsyen përse keni ardhur në këtë qytet, dhe arsyet që ju çuan të ndërmerrni një hap të tillë?”

Çdo fjalë e tij shprehte mirësjellje, dhe Aishja u përgjigj me të njëjtën mirësjellje:

“Të sjellim paqen mes njerëzve tanë.”

Ata kishin përdorur të njëjtën gjuhë dhe kishin të njëjtin qëllim. Aliu kërkoi që Talha dhe Zubejri të vinin në praninë e tyre në mënyrë që të ndërmjetësohej pasi të ishin dëgjuar edhe ata. Kur

---

<sup>270</sup> Taberiu, *tarih*, 3/15. Pavarësisht gjithçkaje, të dyja palët u vunë përballë njëra-tjetrës të nesërmen dhe shpatat u nxorën. Megjithatë, edhe disa njerëz të cilët i kundërshtonin mendimet e saj, nuk toleruan asnjë fyerje kundër Aishes, prej personave të tjerë në anën e tyre. (Nedeui, *Siretu Sejidatu Aishe*, 180.)

<sup>271</sup> Taberiu, *tarih*, 3/15.

<sup>272</sup> Po aty, 3/20, 21.

<sup>273</sup> Ibni Ebi Shejbe, *Musanef*, 7/544.

ata erdhën, ai u bëri atyre të njëjtën pyetje dhe shtoi edhe fjalët e Aishes. Përgjigjet e tyre nuk ishin të ndryshme nga të mësipërmet. Ndoshta çështja mund të zgjidhet para se të fillonte me të vërtetë. Korrieri i Aliut, Ka'ka u tha:

“A mund të më tregoni ju lutem se si mund të vendoset kjo paqe?”

“Duke u hakmarrë për vrasjen e Osmanit nëpërmjet dënimit të vrasësit të tij, sepse po të mos bëhet kjo, do të thotë të mos ndiqen udhëzimet e Kuranit!”, - u përgjigjën ata.

Ata kishin të drejtë, por ishin edhe të vërteta të tjera për t'u marrë parasysh. Ka'ka u tha:

“Le të themi se ju i vratë vrasësit e Osmanit nga Basra. Por a mos vallë situata juaj para se t'i vrisni ata do të të jenë më e mirë se situata juaj, pasi t'i vrisni? Ju do të tentoni për të vrarë gjashtëqind njerëz, dhe si rezultat gjashtë mijë njerëz do të dalin në rrugë kundër jush. Njeriu që ju kërkoni është Harkus ibni Dhuhejri, i cili e vrau Osmanin, por gjashtë mijë njerëz kanë rënë dakord të mos jua dorëzojnë atë juve. Nëse veproni kështu, a nuk do të ishte ky një hap kundër paqes? Nëse ju i vrisni ata, a nuk do të bëhet situata më keq nga sa është tani? Nëse ju ndërmerrni hapa për të ndëshkuar Harkus ibni Dhuhejrin, ju do të gjeni përballë gjashtë mijë njerëz të cilët nuk duan ta dorëzojnë vrasësin e vërtetë tek ju. Kjo çështje nuk mund të zgjidhet aq lehtë. A nuk ka të drejtë në këtë pikë Aliu? Ai sigurisht dëshiron ta gjejë dhe ta ndëshkojë vrasësin e Osmanit, por ai është duke pritur që trazirat të qetësohen, në mënyrë që të mos derdhet më shumë gjak. Ai është duke pritur për kohën e duhur për të ushtruar dënimin.”

Aishja e ndërpreu atë:

“Pra, si mendon ti Ka'ka?”

“Është e vërtetë që ekziston një çështje e pazgjidhur lidhur me këtë, e cila është e mundur të zgjidhet vetëm në kushte të qeta. Kur trazirat të pakësohen, gjithçka do të bëhet siç duhet. Unë ju këshilloj që të zgjidhni paqen, pa vepruar me ngut, të ripërtërin njohjen tuaj të Aliut si kalif, të jeni udhëzuese për vepra të mira ashtu siç keni qenë më parë, dhe të mos ndihmoni pa dashje ata që kërkojnë të krijojnë përçarje.”

“Ke të drejtë. Fole bukur. Shko tek Aliu dhe nëse edhe ai ka të njëjtin mendim, thuaji se çështja u mbyll dhe se paqja është thelbësore për ne.” - ia ktheu Aishja.

Meqë gjakrat u ulën, Kaka u kthye tek Aliu dhe i shpjegoi atij gjithçka. Fjalët e tij e kënaqën kalifin Ali, i cili priste që problemi të shuhej. Dukej se çështja do të mbyllej pa gjakderdhje të panevojshme. Aliu ishte shumë i kënaqur dhe dëshironte ta ndante kënaqësinë e tij me ushtarët. Ai u ngrit në këmbë përpara tyre dhe e ndau me ta lumturinë për arritjen e marrëveshjes.<sup>274</sup>

Kjo ishte një kohë e përshtatshme për paqe, sepse si Aliu dhe njerëzit e tij, ashtu edhe Aishja dhe njerëzit e saj u takuan në paqe dhe ranë dakord për ta shtyrë zgjidhjen për në kohën e duhur. Meqenëse edhe Kalifi nuk mendonte ndryshe për ndëshkimin e vrasësit të Osmanit, ata duhej ta linin këtë çështje në përgjegjësinë e tij. Aishja dhe njerëzit e saj u përgatitën për t'u kthyer.

Duke folur me Talhën dhe Zubejrin, Aliu iu drejtua:

"O vëllezërit e mi! Unë nuk jam një njeri që nuk e njoh atë për të cilin ju po flisni. Por si mund ta bëj këtë ndërkohë që mbizotëron anarkia, njerëzit kanë marrë rrugët dhe mbi të cilin ne nuk kemi asnjë autoritet? Shikojini pak - skllëvërit tanë ecin bashkë me ta e madje edhe disa arabë prej të cilëve ne nuk e prisnim kurrë, i shoqërojnë ata. Ju po e shikoni vetë se ata ecin mes jush ashtu si t'ua

---

<sup>274</sup> Taberiu, *tarih*, 3/29; Ibni Kethir, *Bidaje*, 7/238.

ketë qejfi. Më thoni, a është e mundur për mua për ta përmbushur menjëherë kërkesën tuaj në këto kushte?”

Kjo ishte koha për t'u kthyer me shpirt të kënaqur. Ndërkohë që vazhdonin përgatitjet, papritmas të gjithë sytë u kthyen nga Aishja. Diçka i kishte ndodhur asaj dhe ishte e qartë se ajo ndjehej në faj; çdo lëvizje e saj tregonte pendim.

Kur kishte kaluar ca kohë, ajo pyeti ata që kishte afër: "Ku jemi këtu?"

Ata u përgjigjën: "Në Hauab."

Plot trishtim ajo tha:

"Hauab? Sigurisht ne i përkasim Allahut dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!"

Asaj iu rrit edhe më shumë brenga. Ankthi iu bë shqetësim dhe pastaj iu shndërrua furishëm në dhimbje. Njerëzit që u mblodhën rreth saj nuk mund ta kuptonin sjelljen e saj. Me kureshtje dhe padurim, ata vërenin ndryshimin që po ndodhte tek Aishja.

Pastaj fjalë dëshpërimi dhe keqardhjeje dolën nga buzët e saj:

"Betohem në Allah se u vërtetua që unë jam ajo për të cilën aludohet tek qentë e Hauabit. Duhet të rikthehemi menjëherë."

Njerëzit ende nuk po kuptonin asgjë. Sjellja e saj u bë edhe më e pakuptueshme dhe kurioziteti i tyre u rrit. Me qëndrimin e tyre, ata donin të thoshin se nuk do të ndërmerrnin as edhe një hap më shumë nëse ato nuk u tregonte se çfarë po ndodhte. Me dëshpërim, Aishja tha:

"Kam dëgjuar të Dërguarin e Zotit të na thotë: 'Njëra ndër ju do të vijë në vete kur të dëgjojë lehjet e qenve të Hauabit' Atë ditë, unë buzëqesha më të dëgjuar këtë, por ai më paralajmëroi duke më thënë: 'Ki kujdes o Humejre, mund të jesh ti ai person!'"<sup>275</sup>

Ndërkohë që lehja e qenve jehonte në veshët e saj, ajo donte të thërriste:

"O i Dërguari i Allahut, të vërtetën ke thënë!"<sup>276</sup>

Atë ditë, Zubejri i tha Aishes:

"Përderisa Allahu do të sjellë paqen përmbi ty, përse kërkon të tërhiqesh dhe të kthehesh prapa?"

Edhe të tjerë shfaqnin mendime të ngjashme:

"Përkundrazi, ti duhet të vazhdosh në rrugën që ke nisur, në mënyrë që Allahu i Madhëruar të sjellë paqen mes njerëzve."<sup>277</sup>

Dëshira për paqe dhe qetësi mbizotëronte tek njerëzit e Aishes.

Tani më shumë se kurrë, ata e kuptuan dobinë e vendimit për të mos luftuar. Ata planifikuan të pushonin gjatë natës dhe të ktheheshin në Medinë sapo të zbardhte agimi.

Por kishte edhe plane të tjera gjithashtu. Hipokriti Abdullah ibni Sebe dhe miqtë e tij, të cilët gëzoheshin që kishin krijuar grindje, nuk ishin të kënaqur me paqen. Gjatë natës, ata përgatitën planet mjerane për t'i kundërvënë dy grupet ndaj njëri-tjetrit. Ata sulmuan të dyja palët njëkohësisht në errësirë. Ata që e sulmuan Aishen dhe njerëzit e saj u hoqën sikur ishin ushtarë të Aliut, ndërsa të tjerët të cilët sulmuan ushtrinë e Aliut përdornin emrin e Aishes.

---

<sup>275</sup> Hakim, *Mustedrek*, 3/129. Pasi e tha këtë, Profeti u kthye nga Aliu dhe i tha atij ta trajtonte mirë Aishen, nëse ndodh ndonjë konflikt ndërmjet tyre në të ardhmen.

<sup>276</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/52.

<sup>277</sup> Po aty, 6/92.

Njerëzit i zuri një panik i madh. Meqenëse njerëz të armatosur i sulmuan ata papritmas, njerëzit zgjoheshin me ngut nga gjumi për të gjetur armët e tyre dhe natyrisht përpiqeshin që të mbronin veten. Njëherazi dëgjoheshin klithmat për ndihmë nga aktorët sipas skenarit të planifikuar, duke pretenduar se ata ishin tradhtuar. Kjo ishte një betejë dhe qe e vështirë për të kuptuar se çfarë po ndodhte.<sup>278</sup>

Të dy grupet filluan të mendonin se pala tjetër i kishte tradhtuar. Në një situatë ku gjakrat ishin nderur kaq shumë, mendimi dhe arsyetimi ishte i pamundur. Ata nuk ishin në gjendje të shihnin se kush i sulmoi apo kush po kërkonte ndihmë. Nëse do të kishin qenë më të kujdesshëm dhe të mprehtë, do ta kishin kuptuar se sulmuesit e tyre ishin po ata të cilët kishin dalë nëpër rrugë, duke bërë titur: "E kemi vrarë Osmanin." Ah sikur ta kishin kuptuar!

Ishte një luftë për jetë a vdekje. Nuk merrej vesh se kush vriste e kë vriste. Ata ia nxorën shpatat njëri-tjetrit dhe shumë prej tyre u vranë.

As këshillat e kalifit Ali dhe as përpjekjet e Aishes, Talhës dhe Zubejrit nuk pinë ujë. Shpresa për paqe shuhej me çdo pikë gjak që derdhej dhe zemrat thyheshin me çdo gjymtyrë të plagosur. Po të mos kishin përdorur shpatën për të mbrojtur vetët, atyre do t'u ishte prerë koka. Kur ata të merrnin hakun e tyre, do të kishin gjakun e vëllezërve të tyre nëpër duar. Kjo ishte një sprovë e vështirë dhe e tmerrshme.

Ibni Sebe dhe njerëzit e tij u kthyen edhe nga Aishja, dhe e bënë objekt të shigjetave koshin e saj përmbi deve. Aishja tha:

"O Allah! O Allah! Kijeni frikë Allahun! Kujtoni Ditën e Gjykimit."

Por asnjëri syresh nuk po ia vinte veshin. Zemra e Aliut po rrihte me shqetësim. Për të shpëtuar Aishen, e cila ishte një objektiv i hapur mbi devenë e saj në këmbë. Medoemos duhet ta bënë devenë të ulej. Ky ishte një moment kur edhe sekondat kishin rëndësi të veçantë. Në mënyrë që të shpëtonin Aishen, ata godisnin këmbët e devesë me shpata për ta detyruar atë të ulej. Aishja shpëtoi, sepse dhoma e saj kishte një shtresë prej dhjami përreth saj, që filloi të dukej si një iriq, me tërë ato shigjeta të ngulura në të.

Në përlëshje, gjatë mbrojtjes, nga njerëzit e saj ranë gjithsej shtatëdhjetë martirë. Në fund, Amar ibni Jasiri dhe vëllai i saj, Muhamed ibni Ebu Bekri, e nxorën atë nga koshi. Në atë kohë, vëllai i saj i preku pak shpinën. Ajo u kthye menjëherë, dhe pavarësisht se ishte duke luftuar për jetë a vdekje, e qortoi:

"Dora e kujt është kjo? Hiqe atë nga trupi im. Dora e askujt tjetër përveç asaj të të Dërguarit të Zotit nuk ka prekur mbi mua deri më sot."<sup>279</sup>

Edhe kur ajo e kuptoi se kishte qenë vetëm dora e vëllait të saj, ajo përsëri ndjehej e ofenduar dhe i tha:

"Kopuk."<sup>280</sup>

Aliu, i mërzhitur kur dëgjoi se çfarë kishte ndodhur, shkoi tek Aishja dhe e pyeti:

"Si je o nëna ime e dashur?"

Ai i urdhëroi njerëzit e tij të ndërtonin një tendë për Aishen në një vend të sigurt.

Aishja iu përgjigj:

<sup>278</sup> Taberi, *tarih*, 3/39, 40; Ibni Kethir, *Bidaje*, 7/240.

<sup>279</sup> Taberi, *tarih*, 3/55.

<sup>280</sup> Po aty.



“LëvdUAR qoftë Allahu, jam mirë.”

“Allahu i Gjithëmëshirshëm të dhuroftë mëshirë e falje!” - u lut Aliu për të.

“Edhe ty gjithashtu!” - ia ktheu ajo.

Aliu ndërmori një rrezik tejet të madh duke mbrojtur Aishen, e cila ishte objektiv i Ibni Sebes dhe njerëzve të tij. Dukej se nuk ekzistonte më asnjë mundësi për t'i dhënë zgjidhje kësaj krize. Ajo nuk mund të zgjidhej nga shpata, andaj u bë i domosdoshëm përdorimi i fuqisë së fjalës. Aliu u përpoq të ndalte trazirat duke iu drejtuar atyre që mund t'i kuptonin fjalët e tij më së miri. Ai bisedoi me Talhën dhe Zubejrin, me të cilët kishte luftuar krah për krah që nga ditët e para të shpalljes. Ata ishin trima si Aliu, dhe ishte e pamundur të mos i përgjigjeshin ftesës që po i bënte kalifi. Të dy ata shkuan në vijën e frontit. Aliu tha:

“Talha, si arrite të pranoje që të luftosh karshi familjes së të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të, ndërkohë që familja jote është e sigurt në shtëpi?”

Aliu foli si një mik i ngushtë, i cili dukej që ishte jashtëzakonisht i lënduar, dhe deklaratat e një miku të ngushtë, ndonjëherë, mund edhe të të djegin. Por kush mund të kishte një përgjigje të qartë për këtë pyetje të vërtetë e të sinqertë?

Pastaj ai tha:

“Ti, o Zubejr! A të kujtohet ajo ditë kur hyra në praninë e të Dërguarit të Zotit dhe Ai buzëqeshi me ardhjen time? Atëherë duke m'u referuar mua, i Dërguari i Zotit të pyeti ty, 'A e do ti këtë?' dhe ti u përgjigje 'po'. Pastaj ai tha: 'Veçse, një ditë, ti do të sillesh padrejtësisht, duke luftuar kundër tij.'”

Këto deklarata ishin tamam ashtu siç i mbante mend edhe Zubejri. Fjalët e Aliut ishin arma më efikase, që i bëri njerëzit t'i fushnin shpatat e tyre përsëri në mille. Zubejrit sikur iu kthye bota me kokë poshtë, dhe arriti të nxirrte vetëm këto fjalë:

“Ke të drejtë. Më bëre të rikujtoj ato që i pata harruar.”

Ky ishte vendimi i një personi të mençur. Ai uli shpatën dhe e braktisi fushën e betejës. Nga beteja u largua edhe Talha.

Vajtja për të luftuar kishte qenë e menjëhershme, por kthimi nuk ishte aq i lehtë. Fati do të thoshte fjalën përfundimtare për të dy ata. Disa njerëz e vunë në shënjestër Zubejrin, i cili ishte duke u kthyer me keqardhje të madhe; organizuan një pritë dhe e vranë në vend.<sup>281</sup> Fati i Talhës nuk ishte më i ndryshëm. Shumë shpejt, një shigjetë e goditi edhe atë, duke e bërë të largohej nga kjo botë. Ndjenja e tyre e drejtësisë që u manifestua me largimin nga fusha e betejës, nuk u pëlqeu asfare atyre që i kishin varur gjithë shpresat e tyre në kaos, andaj Zubejrit dhe Talhës iu desh ta paguanin me jetët e tyre.

Orvatjet e Aishes së nderuar, e cila e kishte parë me mëdyshje dhe pikëllim njëherësh gjithë atë çfarë kishte ndodhur, ishin të padobishme, sepse Talha dhe Zubejri nuk ishin më mes tyre. Çdo njeri që e kuptonte se ata ishin duke u bërë dëshmitarë të një drame të tmerrshme, u mblodhën rreth e qark dhomës së Aishes. Ata ishin në kërkim të një prijësi që t'i udhëhiqte në të ardhmen, dhe kishin qëllime të mira, por tubimi ishte diçka që paraqiste një tjetër rrezik.

Pastaj Aliu thirri vëllanë e Aishes, Muhamedin. Ai kishte përgatitur një vend të sigurt për të, ndaj e ftonte të shkonte aty, duke ia dërguar mesazhin nëpërmjet vëllait të saj. Të dy ishin shumë të shqetësuar. Mbi të gjitha, ai e siguroi Aishen se ajo do të mund të shkonte shëndoshë e mirë në Mekë, dhe se askush nuk do të ishte në gjendje t'i bënte keq.

---

<sup>281</sup> Po aty.

Aliu organizoi udhëtimin e Aishes në Mekë dhe caktoi dyzet udhëheqëse femra të Basrës që ta shoqëronin, në mënyrë që ajo të mos e ndihej vetëm.

Pavarësisht nga pikëllimi që kishin përjetuar, të dyja palët silleshin me përkushtim, që të ishin sa më të drejtë. Edhe pse ishte kohë emocionesh të forta, gjë që e atrofizonte krejt arsyen, të dy, si Aishja ashtu edhe Aliu, treguan se ishte e domosdoshme që të mos kalohej gjithçka në kaos. Në ditën kur Aishja po largohej, para se të ikte, u drejtua nga ata që ishin mbledhur rreth saj, dhe u tha:

“O bijtë e mi, për fat të keq ne e lënduam jashtëzakonisht shumë njëri-tjetrin. Përjetuam gjëra të pahijshme nga më tronditëset, dhe u lodhëm mjaft. Pas kësaj, askush nuk duhet ta shohë njëri-tjetrin me keqdashje, apo të luftojë për atë që ka ndodhur, ose për deklaratat e gabuara që të tjerët kanë bërë për të. Absolutisht, mes meje dhe Aliut nuk ka asnjë problem, që të jetë më i madh se çdo çështje normale mes një gruaje dhe dhëndrit të saj. Edhe pse kam përjetuar disa probleme me të, ai është njeriu më i mbarë, për të cilin dëshiroj veç mirësi dhe mirëqenie.”<sup>282</sup>

Aishja ndjehej e penduar rëndë, duke e ditur se Aliu kishte pasur një vend të veçantë në anën e të Dërguarit të Zotit paqja qoftë mbi Të. Vite më parë, ajo nuk kishte lejuar të thuhej asgjë e keqe kundër Hasan ibni Thabitit, i cili kishte rënë në një grackë gjatë fushatës së shpifjes për Aishen, dhe e konsideronte ende atë si "mbrojtësin e të Dërguarit të Zotit." Aishja do të trajtonte Aliun siç e kishte trajtuar gjithmonë, duke ia bërë copë e çikë shpresat atyre që donin si e si që ta zmadhonin më tej ngatërresën. Aliu u prek, sepse ajo që fliste ishte mësuar nga i Dërguari i Allahut. Por ai ishte lënduar shumë, sepse shumë nga të afërmit e tij u vranë, në mënyrë që të siguronin paqen. Duke iu përgjigjur deklaratës që kishte zbutur plagët në zemrën të tij, Aliu tha:

“Ajo ka thënë të vërtetën dhe unë betohem në Zot, se është shprehur mjaft bukur.”

Kjo ishte mënyra më e dobishme për t'i mjekuar plagët e hapura. Ishte e nevojshme që të dyja palët të qetësoheshin, në mënyrë që të mos plagoseshin edhe një herë tjetër po në të njëjtin vend. Aishja nuk mund të lihej pa mbështetje, kështu që Aliu u kthye nga ata që kishte pranë dhe u tha:

“Ekziston vetëm kjo distancë e vogël mes meje dhe asaj. Vërtet, ajo është gruaje më e dashur e të Dërguarit të Zotit, si në këtë botë ashtu edhe në ahiret.”<sup>283</sup>

Udhëtimi i tyre filloi përsëri. Aliu i përcolli njerëzit që ecnin me Aishen dhe i uroi asaj një udhëtim të mbarë. Bijtë e tij e shoqëruan atë, ashtu si edhe vetë Aliu i cili u tha atyre që ta shoqëronin për njëfarë kohe.

Aishja kishte për qëllim të shkonte në Mekë e të qëndronte deri në periudhën e haxhit. Asaj i dukej sikur kishte jetuar shumë vite dhe se ishte plakur shumë; ajo kishte përjetuar aq shumë dhembje, saqë asaj tani i vinte keq që i kishte thënë “po” kërkesave që i kishte bërë turma. Ajo e shprehu keqardhjen e saj me fjalë të tilla si: “Ah sikur të mos isha krijuar dhe të mos kisha fare trup, sikur të kisha qenë vetëm një pemë, një shkëmb apo një tullë e tharë në diell, e cila, në gjuhën e saj, madhëron vetëm Zotin! Ah sikur të kisha vdekur njëzet vite më parë!”<sup>284</sup>

Aishes i vinte turp, madje edhe të shkonte për vizitë pranë të Dërguarit të Zotit(s.a.s.). Deri kohët e fundit, ajo kishte planifikuar të varrosej pranë bashkëshortit të saj të dashur, por tani ajo tha: “Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, unë kam qenë e përfshirë në shumë ndodhi trishtuese”, ndaj ajo shprehu dëshirën të varrosej në varrezën “Xhenet’ul Baki”<sup>285</sup>, sikurse gratë e tjera të tij.

---

<sup>282</sup> Taberi, *tarih*, 3/60-61.

<sup>283</sup> Taberi, *tarih*, 3/61.

<sup>284</sup> Ibni Ebi Shejbe, *Musanef*, 7/554, Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/73-74.

<sup>285</sup> *arab*. Parajsa e përjetshme – shën. red.

Kur falej apo kur lexonte Kuran, në momentin kur mbërrinte tek ajeti që thoshte: “*qëndroni në shtëpitë tuaja...*”<sup>286</sup>, i cili në veçanti u drejtohej bashkëshorteve të Profetit, ajo ndalonte së lexuari dhe qante derisa rrobat i lageshin plotësisht nga lotët.<sup>287</sup>

Një ditë, Ukbe ibn Sahbani i bëri një vizitë dhe e pyeti për domethënien e ajetit:

“*...e prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë, e ka prej tyre që janë me ndihmën e Allahut, të parët në punë të mira, e kjo është ajo mirësia e madhe.*”<sup>288</sup>

Ai dëshironte të dëgjonte interpretimin që Aishja do t’i bënte.

“O biri im i dashur, të gjithë ata janë njerëzit e Xhenetit. Ata që lënë pas njëri-tjetrin përmes veprave të mira ishin njerëzit që jetuan së bashku me të Dërguarin e Zotit gjatë epokës së tij, ata të moderuarit ishin njerëzit që e pasuan atë, dhe ata që janë dëmtues të vetvetes janë njerëzit si ti dhe unë.”<sup>289</sup>

Ata i kishin mbijetuar një përvoje tejet prekëse. Aishja ishte e trishtuar, ashtu siç ishin të gjithë besimtarët. Kjo nuk do të ishte e mjaftueshme për ta kthyer edhe njëherë mbrapsht të shkuarën. Nuk ka dyshim se ata nuk e gjykonin botën e tyre nga ngjarjet e fundit; ata vijuan marrëdhëniet mes tyre me arsyetimin e natyrshëm, tevona, ata duhet të vazhdonin jetën. Nga ky këndvështrim, ne vërejmë se Aliu vinte tek Aishja për çdo çështje që nuk ishte në gjendje t’i gjente zgjidhje, ndërsa Aishja këshillohej me Aliun sa herë që ishte e pavendosur në një çështje.

Megjithatë, portat e mosmarrëveshjeve dhe rebelimit në epokën e tyre u prishën dhe lajme të pabaza që kishin qarkulluar, e shkatërruan paqen dhe qetësinë e gjindjes. Disa thanë se i Dërguari i Zotit e kishte bërë Aliun kalif që para se të vdiste. Kur Aishja e dëgjoi këtë lajm, ajo ka reaguar në atë mënyrë siç përplaset një derë në fytyrën e atij i cili e pret me padurim hapjen e saj:

“Kur ka ndodhur kjo? I Dërguari i Zotit e kishte kokën e mbështetur në gjoksin apo në gjurin tim teksa po i jepte lamtumirën kësaj bote. Pastaj më kërkoi t’i sillja një tas, dhe e dha frymën e fundit në atë pozicion. Unë kam qenë me të gjatë minutave të tij të fundit, kur e paska dhënë këtë dëshmi për Aliun?”<sup>290</sup>

## Kalifati i Muavijes

Pas vrasjes së Aliut si pjesë e një plani të pabesë, vendin bosh të kalifit e zuri Muavija.

Ngatërresa nga më të dhimbshmet zëvendësuan njëra-tjetrën, dhe megjithëse Aishja e ndjente veten thellësisht të lënduar nga ato që po ndodhnin, nuk mund të bënte dot asgjë. Ajo që kishte ndodhur gjatë Ndodhisë së Devesë iu kthye në një mësim të vlefshëm; ajo nuk dëshironte ta ngacmonte më plagën në të njëjtin vend. Ajo u përpoq t’i qetësonte ata që erdhën dhe i kërkonin ndihmë, duke i këshilluar me kujdes dhe vetëm sipas normave islame. Ajo u zhyt në një meditim aq të thellë e të heshtur, saqë ngjante sikur i kishte vënë shulin derës që e lidhte me këtë botë dhe njerëzit që gjallonin në të, duke u përqendruar kësisoj vetëm në botën tjetër. Ajo nuk shkëputej asnjëherë nga adhurimi, dhe nuk u mor me asgjë tjetër, përveçse me rendjen pas diturisë.

Aishja ishte si një diell që ndriçonte mbi të gjithë ata që e kishin bërë natyrë të këshilloheshin me të. Ajo ishte si një liman i sigurt, një rob i qetë për ata që ndjeheshin të hidhëruar dhe të zemëruar

---

<sup>286</sup> Ahzab, 32.

<sup>287</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 8/80; Ebu Nuajm, *Hiljetul Eulija*, 2/49.

<sup>288</sup> Fatir, 32.

<sup>289</sup> Hakim, *Mustedrek*, 2/462; Hejthemiu, *Mexhmuatul zeuaid*, 7/96.

<sup>290</sup> Buhari, *uesaja*, 1.

me shoqërisë moderne të asaj kohe. Dhe lajmet e trishtuara nuk kishin të sosur. Nipi i të Dërguarit të Allahut, Hasani, kokën e të cilit ai e kishte përkëdhelur dikur, dhe të cilin e kishte rritur me aq kujdes, u vra. Dëshira e tij më e madhe ishte që të varrosej pranë të Dërguarit të Allahut. Një ditë ai i kërkoi vëllait të tij të shkonte e ta pyeste Aishen e nderuar, nëse e lejonte edhe ajo diçka të tillë:

“Nëse unë vdes, shko tek ajo dhe kërkoi leje për të më varrosur pranë të Dërguarit të Zotit. Nëse ajo e lejon atë, atëherë më varrosni, atje, në shtëpinë e saj. Por ndoshta njerëzit nuk do ta japin pëlqimin për atë që ti po kërkon. Nëse ata e refuzojnë idenë dhe si rezultat mund të shfaqet ndonjë kundërshtim, mos këmbëngul. Në këtë rast, të më çoni tek varrezat myslimane dhe të më varrosni atje!”

Kur Hyseni u përpoq për të përmbushur dëshirën e fundit të vëllait të tij, ai ndeshi në një reagim të ashpër nga guvernatori i Medinës, Meruan ibni Hakemi, edhe pse Aishja i ishte përgjigjur pozitivisht kërkesës së tij. Njerëzit ishin mbledhur rreth Hysenit dhe guvernatorit e njerëzve të tij, dhe dukej se ishte gati të shpërthente një protestë e madhe. Pastaj foli udhëheqësi, Ebu Hurejre, duke u kujtuar atyre fjalët e Hasanit për rebelimin, dhe saora vendosën ta varrosnin në Xhenet’ul Baki. Hasani që prej asaj dite do të prehej pranë nënës së Tij, Fatimes së nderuar (r.a.).<sup>291</sup>

Një ditë, një njeri nga Mesopotamia, Abdullah ibn Shedadi, vizitoi Aishen për t’i bërë disa pyetje, si dhe për t’i kërkuar që të lutej për të. Por edhe Aishja dëshironte ta pyeste atë për diçka:

“O Abdullah, a më premton se do të më thuash vetëm të vërtetën në përgjigje të asaj që unë do të pyes? Për hir të Zotit, pse dhe si e vranë Aliun?”

Abdullah ibn Shedadi tha:

“E përse mos të ta them të vërtetën?”

“Na e thuaj pra atëherë!”

Abdullah ibn Shedadi filloi të shpjegonte. Aliu ishte përpjekur për të bindur ata që e kishin kundërshtuar, por asnjëri syresh nuk e dëgjonte. Ata kishin ngritur një fushatë kundër autoritetit të Kalifatit, prandaj edhe kishin zgjedhur një fjalës në mes. Aliu recitoi ajetin kuranor, që kërkonte nga dy dëshmitarë prej secilës palë që të zgjidhej problemi mes një burri dhe një gruaje. Pastaj ai pyeti: “A nuk është problemi i shoqërisë së Muhamedit (s.a.s.) më i rëndësishëm se problemi në mes të një çifti?” Pastaj Aliu u kujtoi atyre traktatin e nënshkruar me Suhejl ibni Amrin në Hudejbije. Por askush nuk e dëgjoi. Abdullah ibn Abasi u përpoq të qetësonte gjakrat, por dhe pse ky i fundit arriti të ndikonte tek disa njerëz, në përgjithësi shumica as që u tut në qëndrimin e tyre. Aliu nuk e kishte ndryshuar qëndrimin e tij të palëkundur, qëndrimin në rrugën e Kuranit dhe Sunetit, andaj, tha: “Padyshim që Allahu dhe i Dërguari i Tij thonë vetëm të vërtetën!”

“Për hir të Allahut, a je i sigurt se ai nuk ka thënë gjë më tepër? A nuk ka thënë ndonjë gjë tjetër?” - vazhdoi të pyeste ajo.

“Në emër të Zotit jo! Ai nuk ka thënë asgjë tjetër përveç këtyre që unë sapo përmenda.”

“Sa bukur paska folur. Zoti dhe i Dërguari i Tij thonë të vërtetën. Allahu i Plotfuqishëm e dhuroftë mëshirën e Tij mbi Aliun. Vërtet, Allahu dhe i Dërguari i Tij thonë vetëm të vërtetën. Populli i Mesopotamisë paska shkuar shumë larg, duke thënë shumë kësi gjërash, që me siguri ia kanë pikëlluar zemrën.”<sup>292</sup>

<sup>291</sup> Ibn Abdilberr, *istiaab*, 1/392; Sujuti, *tarihu'l hulefa*, 1/170; Ibn Ethir, *el Kamil fi tarih* 3/460.

<sup>292</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/86-87; Hakim, *Mustedrek*, 2/165.

Kjo ishte një periudhë kur njerëzit jetonin të ndarë nëpër grupe. Populli i Egjiptit dhe i Mesopotamisë ishin kundër Osmanit të nderuar (r.a.), ndërsa njerëzit e Damaskut ishin të një mendimi, por kundër Aliut. Që të dyja grupet i përçmuan kalifët e tyre. Harixhitë u rebeluan kundër të dy kalifëve, madje edhe folën haptazi kundër tyre. Thellë e trishtuar, Aishja tha:

“Ata janë urdhëruar që të pendohen në lidhje me sahabët e të Dërguarit të Allahut, dhe aq më keq, nëse ata bëjnë deklaratat vulgare rreth tyre!”<sup>293</sup>

Aishja ndjehej shumë e fyer prej Harixhive, të cilët kishin vrarë Aliun, duke u bërë kësisoj shkaku kryesor i trazirave. Meqë shumica e tyre u mblodhën në rajonin e quajtur Harura, Aishja i quante ata Haruritë. Ajo i dënoi ata sepse kishin kuptuar gabim, pasi ata pretendonin se ishin të vetmit myslimanë të vërtetë. Një ditë, një grua erdhi te Aishja për ta pyetur nëse mund t'i kryente faljet e përditshme kur ishte me menstruacione. Kjo ishte një pyetje e çuditshme, sepse të gjithë e kishin kuptuar që nga fillimi i shpalljes se gratë me menstruacione ishin të çliruara nga falja e namazit. Dukej një kontradiktë e madhe për Aishen fakti se njerëzit të cilët tregonin padurim për të kryer namazin e përditshëm, madje edhe në ditët kur ata ishin me menstruacione, nuk kishin ngurruar aspak për të vrarë një person të bekuar si Aliun. Për të shprehur këtë mospërputhje hidhëruese, Aishja reagoi duke e pyetur:

“A je edhe ti një Haruri?”<sup>294</sup>

Ashtu si kalifët e mëparshëm, edhe Muavija ishte tejet i ndjeshëm ndaj Aishes. Ai tregoi respekt të madh, gjithmonë interesohej për mirëqenien e saj, dhe e pyeste Aishen për problemet që ai nuk kishte qenë në gjendje t'ia zgjidhte, madje i dërgonte edhe dhurata. Ndërsa Aishja, e cila preferonte të bënte një jetë të përkorë, gjithmonë i shpërndante tek të varfrit këto dhurata, pavarësisht se kush i kishte dërguar.

Një ditë, njerëzit e kalifit Muavije e vizituan atë dhe i sollën, argjend, veshje dhe gjëra të tjera mjaft të bukura. Aishja me t'i parë ato, zuri të qante. Ajo murmuriti diçka nëpër dhëmbë, sa që të dërguarit nuk arritën ta dëgjonin, por njerëzit pranë saj e dëgjuan fjalë për fjalë atë tek nxori këto fjalë prej goje:

“I Dërguari i Zotit nuk preku kurrë asnjë prej këtyre, zaten nuk e zotëronte asgjë të tillë.”

Aishja u kthye nga njerëzit rreth saj dhe u kërkoi atyre që t'ia shpërndanin njerëzve në nevojë të gjitha dhuratat e prura. Si mund ta plotësonin këtë që po dëshironte kjo grua e bekuar? Deri në darkë nuk ngeli asgjë, as edhe një dërrhem nga ato ç'kishte dërguar Muavija.

Një ditë, kalifi i dërgoi një letër, në të cilën ishin rreshtuar disa këshilla që ai kërkonte prej saj. Në përgjigje të kësaj letre, Aishja, shkroi:

“Paqja e Zotit qoftë mbi ty! Për ta përmbledhur shkurtimisht, kam dëgjuar të Dërguarin e Zotit të thoshte: ‘Kushdo që vepron në kërkim të pëlqimit të Allahut, megjithëqë njerëzit e kundërshtojnë, Allahu i Plotfuqishëm do ta mbrojë atë kundër trazirave të shkaktuara po nga njerëzit. Kushdo që kujdeset vetëm për dëshirat e popullit, pa marrë në konsideratë zemërimin e Allahut, Allahu i Plotfuqishëm do të manifestojë zemërimin e Tij mbi të, duke e lënë atë person në duart e popullit të tij, dhe zemërimit të tyre.’ Paqja qoftë mbi ty!”<sup>295</sup>

Aishja nuk ndenji pa e kritikuar Muavijen, pavarësisht nga dhuratat dhe respekti i tij karshi saj. Ajo ndjente turp kur fliste për veprimet e tij të gabuara, por e bënte atë në mënyrë që ai të hiqte dorë

---

<sup>293</sup> Muslim, *tefsir*, 15.

<sup>294</sup> Buhari, *hajd*, 20.

<sup>295</sup> Tirmidhi, *zuhd*, 64.

nga ato. Ajo kritikoi vrasjen e Huxhr ibni Adijit dhe të shtatë shokëve të tij, të cilët ashtu si Aliu, u vranë pas zhvillimeve të ndryshme, duke përfshirë ndarjen në grupe pas Ndodhisë së Devesë. Në një letër të cilën ajo e dërgoi me Abdurrahman ibni Harithin, ajo kërkonte prej Muavijes që:

“Nëse premtimi juaj ka vlerë, dhe nëse ne jemi në gjendje të ndryshojmë mbarëvajtjen e punëve, ne dëshirojmë që të parandalohet vrasja e Huxhrit. Kjo është një sprovë e vështirë për të gjithë ne.”

Por përpjekjet e saj nuk ishin të mjaftueshme që Huxhri dhe shokët e tij të shpëtonin. Ajo u trondit nga lajmi i martirizimit të tyre, ndërsa Abdurrahmani ishte rrugës për tek Muavija. Tashmë ishte shumë vonë dhe Aishja, e mërzhitur, sepse ishte vonuar në orvatjet për ta liruar Huxhrin, u shpreh rreth tij me mirënjohje.

Kur Aishja erdhi në prezencë të kalifit, i tha:

“Ku butësia dhe durimi i Ebu Sufjanit, e ku ti?!”

Ajo u përpoq t'i bënte të qartë dallimin mes Muavijes dhe të atit.

Më pas, Muavija erdhi në Mekë për të kryer haxhin e me këtë rast vizitoi dhe Aishen. Aishja, si njeri që gjithmonë kishte folur sinqerisht, menjëherë e solli bisedën rreth Huxhrit dhe e pyeti:

“O Muavije, a nuk pate frikë nga Allahu kur vrave Huxhrin dhe shokët e tij? Pse nuk pate mëshirë për të? Pse ia mohove edhe atë?”

Muavija u ndie në siklet, dhe tha:

“Huxhrin dhe shokët e tij, nuk i vrava unë.”

Kjo nuk e qetësoi asfare Aishen. Ai ishte kalifi, dhe kjo vrasje kishte ndodhur në territorin dhe nën kontrollin e tij. Në të vërtetë, Muavija e ndjente përgjegjësinë e tij, andaj e ndjente veten të shtypur nën peshën e saj:

“Ne nuk mund ta gjykojmë këtë çështje këtu, në këtë botë. Të lutem ta lëmë çështjen mes tyre dhe meje për në atë ditë, kur do të ribashkohemi me Zotin tonë!”

## AISHJA DHE DIJA

### Burim dijeje për çdokënd

Nuk ishin vetëm kalifët ata që vinin tek Aishja për dije dhe informacion, një numër i madh i njerëzve e vizitonin atë shpesh, duke i konsideruar këshillat e saj, si mënyrën më të sigurt për të mësuar. Aishja ishte burimi i dijes për të gjithë. Ata që nuk kishin mundësi për ta vizituar atë, ose ia dërgonin mesazhet përmes dikujt tjetër, ose i nisnin asaj një letër.

Zijad ibni Ebu Sufjani, guvernator i Basrës dhe i Kufes gjatë kalifatit të Muavijes, i shkroi një ditë një letër për ta pyetur nëse një deklaratë e Abdullah ibni Abasit ishte e vërtetë. Abdullah ibni Abasi kishte deklaruar se personi që dërgon një kafshë për kurban në Mina, pavarësisht se nuk shkon vetë në haxh, të gjitha privimet e haxhit janë të vlefshme edhe për të deri në çastin që do të flijohet kafsha.

Aishja i shkroi:

“Kjo nuk është e vërtetë. Unë i pata përgatitur litarët për kafshët e kurbanit të të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të dhe ai i lidhi ato me duart e veta, dhe pastaj i dërgoi në Mina me babanë

tim. Deri në kohën që kafshët janë therur asgjë që ia lejonte Allahu nuk ishte e ndaluar për Të Dërguarin e Zotit!”<sup>296</sup>

Disa sahabë kishin menduar se hedhja e parfumit ishte e ndaluar ndërsa kryhej rituali i haxhit, pas prerjes së flokëve dhe gjatë qëndrimit në Mina. Por Aishja nuk e konsideronte parfumin si një problem që datonte nga koha e të Dërguarit të Zotit.<sup>297</sup> Kur e dëgjuan këtë nga Aishja, Abdullah ibni Abasi dhe të tjerët hoqën dorë nga kërkesat e tyre dhe vepruan ashtu siç i këshilloi Aishja.

Një ditë tjetër, ibni Abasi u gabua në një interpretim rreth heqjes së petkut të pelegrinazhit, dhe kur çështja i erdhi në vesh Aishes, ajo përsëri e zbuloi të vërtetën përmes shembujve nga jeta e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Shkëmbimi i njohurive mes tyre ishte një gjë aq e natyrshme, sa që Abdullah ibn Abasi, i cili pati probleme me sytë nga fundi i jetës, pyeti Aishen se ta aplikonte trajtimin që mjekët i kishin rekomanduar, dhe nuk filloi ta përdorte atë derisa ai nuk ishte më në gjendje të kryejnë abdesin dhe namazet e përditshme.

Një ditë Ebu Hurejre tha:

“Nuk mund të agjërojë dikush, i cili pasi zgjohet nga gjumi në mëngjes, vëren se i duhet të marrë gusël.”

Ndoshta ai nuk ishte i informuar për gjykimin e ri, ose mbështetej mbi informacion të dobët. Kur Ebu Bekër ibni Abdurrahmani e dëgjoji këtë, ia tregoi Abdullah ibni Harithit. Dhe pikëpyetja rreth kësaj çështjeje vazhdoi, sepse njerëzit e asaj kohe nuk e konsideronin asgjë që dëgjonin si fakt të saktë, deri sa të dëgjonin konfirmimin e saj. Kjo ndjeshmëri është vërejtur sidomos në çështjet që dukej se ishin kundër njohurive të përgjithshme. Abdullah ibni Harithi i tha të atit, i cili gjithashtu e konsideroi këtë informacion të çuditshëm. Së fundmi, ata vendosën të shkonin tek Aishja që ta sqaronin njëherë e mirë këtë keqkuptim.

Umu Selemja ishte bashkë me Aishen, ndaj u pyetën të dyja. Ato iu përgjigjën:

“Në mëngjeset, kur i Dërguari i Zotit zgjohej kështu, ai i agjëronte ato ditë.”

Çështja doli në dritë. Të dy shkuan tek guvernatori i Medinës, Meruan ibni Hakemi për t’i treguar se si qëndronte situata. Për shkak se gjithandej po qarkullonte një informacion i pasaktë e korrigjimi i tij ishte i nevojshëm, Meruani tha:

“Është detyra juaj të shkoni dhe t’ia thoni edhe Ebu Hurejres atë që më thatë mua! Jam unë ai që po jua kërkoj një gjë të tillë.”

E lanë Meruanin aty, dhe shkuan për tek Ebu Hurejre, i cili i pyeti:

“A është e vërtetë kjo?”

Ata iu përgjigjën në mënyrë pohuese.

“Nënat tona e dinë më mirë këtë gjë.”

Prej atëherë e tutje, ai filloi të agjërojë në këto raste sepse ai e kishte mësuar atë nga bashkëshortet e Profetit të nderuar paqja qoftë mbi Të.<sup>298</sup>

Në një ditë tjetër, Imam Shurajhu e vizitoi Aishen, dhe shprehu shqetësimin e tij mbi diçka që i ishte thënë:

---

<sup>296</sup> Muslim, *haxh*, 39.

<sup>297</sup> Buhari, *gusl*, 12,13.

<sup>298</sup> Muvatta, *Sijam*, 4; Bejhekiu, *Sunen*, 4/214; Nesei, *Sunenul Kubra*, 2/180.

“O nëna e besimtarëve, kam dëgjuar se Ebu Hurejre ka transmetuar një hadith prej të Dërguarit të Zotit, i cili, nëse është i vërtetë, do të thotë se ne do të jemi të gjithë në humbur.”

Kushdo që ka humbur tashmë është i vdekur, por më thuaj, cila është arsyeja që ju shqetëson më shumë? ” - pyeti Aishja.

I Dërguari i Zotit ka thënë: ‘Kushdo që dëshiron të bashkohet me Allahun dhe i pëlqen kjo ide, edhe Allahu dëshiron të ribashkohet me të, por kushdo i cili e konsideron ribashkimin me Allahun të padëshirueshëm, edhe Allahu e konsideron atë të padëshirueshëm.’ Por cili prej nesh nuk e ka frikë vdekjen dhe e konsideron atë si të padëshirueshme?”

Më vonë, Aishja e kuptoi arsyen e transformimit të Shurajhut dhe i kërkoi atij që të thotë fjalët e mëposhtme për t’i lehtësuar të gjithë besimtarët:

“Po, i Dërguari i Zotit e ka thënë këtë, por kjo nuk është siç mendoni ju. Zoti dhuroftë mëshirë mbi Ebu Hurejren, ai ju ka transmetuar fundin e hadithit, por jo fillimin. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Kur Zoti i Plotfuqishëm dëshiron të shpërblejë një prej robërve të Tij, i dërgon atij një engjëll në vitin që ai do të vdesë dhe i jep lajmin e mirë, duke e mbështetur atë për në botën tjetër. Në këtë mënyrë, kur engjëlli i vdekjes vjen tek ai, dhe i thotë, ‘O qenie e bindur, erdha të të shpie drejt mëshirës dhe kënaqësisë së Allahut,’ dhe i qëndron afër atij, ndaj personi ndjen padurim për të ikur nga kjo botë sa më shpejt që të jetë e mundur, e kjo nënkupton se Zoti dëshiron të bashkohet me atë rob të Tijin. Kur Allahu i Madhëruar dëshiron ta ndëshkojë ndonjë nga robërit e Tij, Ai i dërgon atij një djall në vitin e fundit të jetës dhe ky djall e keqduhëzon atë. Kur engjëlli i vdekjes vjen tek ai e i thotë, ‘O shpirt i komanduar nga e keqja, bëhu gati për mërinë dhe zemërimin e Allahut’, e në këtë çast, robi përpëlitet si gjethe dhe fillon të gulçojë. Ai nuk dëshiron më të takohet me Allahun, dhe as Allahu nuk dëshiron të takohet me të. Kur i vjen pranë vdekja dhe ai nuk është në gjendje të reagojë, shpirti fillon të dalë dhe lëviz nga gjoksi, gishtat paralizohen, dhe qimet e lëkurës duket sikur e shpojnë me një dhimbje të mprehtë. Cilido që dëshiron të takohet me Allahun, edhe Allahu dëshiron të takohet me të, ndërsa cilido që nuk dëshiron të takohet me Allahun, edhe Allahu nuk dëshiron të takohet me të.”<sup>299</sup>

Kur një sahab i rëndësishëm, Ebu Said el Hudriu ishte në shtratin e vdekjes, ai bëri përgatitjet e tij përfundimtare për të shkuar pranë Allahut. Ai i ndërroi rrobat e tij të vjetra me të reja, duke kujtuar thënien e mëposhtme nga i Dërguari i Zotit:

“Nuk ka dyshim se i vdekuri do të rilindë me ato rroba me të cilat ishte i veshur në momentin e fundmë të vdekjes.”<sup>300</sup>

Ai mendonte se hadithi e ka fjalën për qefinin e vdekjes, veshjen e fundit të atij që ka vdekur. Por mendimet e të tjerëve, duke përfshirë edhe të Aishes, ishin të ndryshme, dhe ajo tha:

“Allahu lëshoftë mëshirën e Tij mbi Ebu Saidin.”

Detyra e zbulimit të së vërtetës ra përsëri mbi shpatullat e saj. Aishja e kishte interpretuar ndryshe hadithin, sepse ajo e kishte analizuar atë në përgjithësi dhe e kishte kombinuar atë me diçka tjetër që tashmë e dinte. Veshja e kësaj bote nuk ka ndonjë vlerë në botën tjetër, dhe ringjallja matanë është e njëjtë me ardhjen e parë të dikujt në këtë botë. Ajo shpjegoi:

---

<sup>299</sup> Muslim, *dhikr*, 17; Nesei, *xhenaiz*, 10; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2/346.

<sup>300</sup> Ebu Davud, *xhenaiz*, 18.



“Në këtë hadith, i Dërguari i Zotit e ka fjalën për veprat e personit, deri kur ai vdes, sepse i Dërguari i Zotit gjithashtu ka thënë, ‘Në atë ditë (Ditën e Kiametit), njerëzit do të rilindin pa rroba, lakuriq, siç ishin kur lindën nga nënat e tyre.’”<sup>301</sup>

Është gjithashtu e vërtetë se nga dija e gjerë e Aishes nuk kanë përfituar vetëm ata që kanë jetuar gjatë kohës së saj, por trashëgimia e saj vazhdoi të ndriçojë edhe pas vdekjes, e padyshim që ka për të vazhduar deri në Ditën e Gjykimit. Ajo kërkohet nga ata që e njihnin vlerën e dijes së saktë. Omer ibn Abdulazizi nganjëherë i dërgonte letra Muhamed ibn Amr ibn Hazminut, dhe në këto letra i shkruante:

“Kërko mirë gjithandej. Nëse gjen ndonjë hadith të të Dërguarit të Zotit, apo ndonjë Sunet që ka mbetur pas tij, apo ndonjë thënie që i përket Amrës, më lajmëro menjëherë në lidhje me të. Në kohën kur njerëzit e dijes janë duke na lënë një nga një, unë kam frikë se disa njohuri mund edhe të humbasin.”<sup>302</sup>

Amra ishte një nxënëse e veçantë e Aishes, dhe halla e guvernatorit të Medinës, Ebu Bekr ibni Muhamedit.

### **Aishja dhe transmetimi i dijes**

Nuk ka asnjë dyshim se Aishja ishte një prijëse në fushën e dijes në mesin e sahabëve. Që në fillim, ajo analizoi çdo gjë që ka ndodhur, asimiloi informacionin e ri, sqaroi çështje të errëta nëpërmjet pyetjeve që i bënin, dhe rrëfeu detaje intime që të tjerët nuk mund t'i dinin, duke e pyetur drejtpërdrejt të Dërguarin e Zotit paqja qoftë mbi Të. I Dërguari i Zotit ishte në qendër të jetës së saj, dhe ajo ia kishte dedikuar vetveten kauzës së Tij. Rrethanat e favorshme e mbështetën punën e saj, sepse ajo ndau të njëjtën dhomë me Profetin. Ditën dhe natën, Aishja shkonte tek pusi e Tij dhe e mbushte kovën e saj me ujë të freskët deri sa ajo mbushej plot. Ajo e pyeste Atë për çdo gjë, madje edhe për gjërat intime të cilat njerëzit e tjerë nuk mund t'i pyesnin për shkak të modestisë, dhe merrte menjëherë përgjigje nga Krenaria e Njerëzimit. Ajo përdori gjithnjë përparësinë e të pasurit një dhomë e cila ishte ngjitur me Xhaminë e Profetit, dhe gjithashtu ndoqi të gjitha predikimet që mbante i Dërguari i Zotit. Sa herë që diçka e mbante të mbërthyer mendjen e saj, duke e preokupuar keqazi, ajo e zgjidhte atë duke i kërkuar shpjegim të Dërguarit të Zotit një t'u kthyer në shtëpinë e lumturisë. Ajo nuk linte gjë pa pyetur derisa të sqarohej plotësisht.<sup>303</sup>

Natyra e brendshme e Aishes zotëronte virtytet e larta të kureshtjes dhe meditimit. Ajo nuk ndjehej rehat dhe kurrë nuk e besonte diçka që ajo shihte apo dëgjonte, derisa të mësonte të vërtetën që fshihej pas tyre.

Duke e përshkruar atë, Ibn Ebu Mulejke ka përdorur thënien e mëposhtme: "Kur ajo përballej me diçka që nuk e dinte, nuk duronte dot pa u thelluar që të mësonte më shumë rreth saj."<sup>304</sup>

Dijetarët e mençur, të tillë si Hakimi, kanë thënë se një e katërta e volumit të njohurive fetare është transferuar te ne përmes Aishes. Në kohën e saj, njerëzit vinin tek ajo për të zgjidhur problemet nën udhëzimet e saj, por edhe sot, ajo është ende burim i një sasive të madhe informacioni autentik.

Duke shprehur superioritetin e saj, Ebu Musa el Eshariu ka thënë:

<sup>301</sup> Bejhekiu, *shuabul iman*, 1/318. Shih gjithashtu Buhari, *rikak*, 45; Muslim, *xhenne*, 56.

<sup>302</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/480; Ibni Abdibarr, *tahmid*, 17/251; Ibni Haxher, *tahzibu tahzib*, 12/466.

<sup>303</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/75.

<sup>304</sup> Tefsiri Baghaui, 1/374; Ajni, *Umdatul Kari*, 2/136.

“Si sahabë të të Dërguarit të Allahut, sa herë që hasnim në ndonjë paqartësi, ne menjëherë rendnim për tek Aishja, sepse ajo ishte aq e ditur, sa të na jepte zgjidhje për çdo vështirësi.”<sup>305</sup>

Kjo ishte aq e qartë, sa që Ata ibn Ebu Rabahu thoshte:

“Aishja ishte më e zgjuara, një njeri plot dije, si dhe kishte grumbulluar mendimet dhe opinionet më të mira mes njerëzve.”<sup>306</sup>

Pleqtë si Hisham ibn Urveja, rrëfenin:

“Unë nuk kam parë askënd më të përgatitur se Aishja në shkencat mjekësore, fik'h dhe në poezi.”<sup>307</sup>

Ndërsa Imam Mesruku është shprehur:

“Unë kam parë sahabët më të afërt të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) të pyesnin Aishen për detyrimet ligjore që lidhen me ndarjen e trashëgimisë.”<sup>308</sup>

Një tjetër imam i shquar, Muhamed ibn Shihab Dhuhri ka thënë:

“Ajo ishte më e ditura ndër gjindje. Për këtë arsye, sahabët më të rëndësishëm të të Dërguarit të Zotit i mësonin gjërat duke pyetur atë<sup>309</sup>... në qoftë se dituria e Aishes do të krahasohej me diturinë e të gjitha grave, duke përfshirë edhe gratë e tjera të të Dërguarit të Allahut, dituria e Aishes do të mbizotëronte me thellësinë e saj.”

Ebu Seleme, i biri i Abdurrahman ibn Aufit, ka thënë:

“Unë nuk kam parë askënd që ta njihnte Sunetin më mirë se Aishja, i cili të ishte më i thellë se ajo në njohuritë rreth fikhut dhe i cili të dinte më saktë sesa Aishja se ku dhe kur ka zbritur aksh ajat.”<sup>310</sup>

Nipi i saj dhe nxënësi i veçantë, Kasim ibn Muhamedi, nënvizonte thellësinë e njohurive të saj në elokuencën dhe teologjinë islamike:

“Unë nuk e kam hasur në mesin e burrave apo grave, si para ashtu dhe pas saj, asnjë njeri aq elokuent sa ç'ishte Aishja, apo dikë i cili ta ketë njohur teologjinë islame ashtu si ajo.”<sup>311</sup>

Njohuritë e saj unike nuk tërhiqnin vetëm vëmendjen e dijetarëve. Pothuajse të gjithë binin dakord për meritat e saj. Një ditë, kalifi Muavije e thirri Zijadin, një emër i rëndësishëm i epokës, në praninë e tij dhe e pyeti:

“Kush është më i dituri në mesin e njerëzve?”

“Sigurisht ti, o udhëheqësi i besimtarëve.”

Por Muavija, i vetëdijshëm se kjo përgjigje reflektonte më shumë lajka sesa të vërtetën, këmbënguli:

“Për hir të Allahut, më thuaj të vërtetën.”

“Për hir Allahut që më e ditura është Aishja.”<sup>312</sup>

Superioriteti i saj në dituri ishte aq i qartë sa në vitet e mëvonshme, do të kishte vepra të tëra të posaçme, të shkruara vetëm për atë aspekt të personalitetit të saj. Kureshtja e saj intelektuale ishte e

---

<sup>305</sup> Tirmidhi, *menakib*, 63.

<sup>306</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/15; Dhehebi, *sijer*, 2/185, 200.

<sup>307</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/12.

<sup>308</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/12; Darimi, *Sunen*, 2/442.

<sup>309</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/374.

<sup>310</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/375.

<sup>311</sup> Isbahani, *egani* 20/331.

<sup>312</sup> Hakim, *mustedrek* 4/15.

pakrahasueshme; ajo asnjëherë nuk e ndiente veten të qetë derisa të merrte dituri nga kushdo që e zotëronte atë. Kur i Dërguari i Zotit i tha Fatimes një sekret para vdekjes së Tij, Aishja ishte e vetmja që e mësoi atë sekret menjëherë pas vdekjes të Tij. Nëse ajo nuk do të këmbëngulte për ta marrë vesh atë sekret, askush nuk do ta kishte mësuar asnjëherë.

Personaliteti i saj kureshtar nuk ndryshoi që prej ditës kur ajo hyri në shtëpinë e lumturisë; ajo e dinte qysh më herët se dera e dijes do të hapej vetëm duke bërë sa më shumë pyetje, dhe kësodore, ajo e pyeste të Dërguarin e Zotit në lidhje me çdo gjë që i ndodhte. Kjo ishte një karakteristikë dalluese e saj. Ajo gjykonte vetëm mbi atë që kishte dëgjuar ose parë, dhe ishte skrupuloze në shtimin e njohurive të saj. Ajo e krahasonte informacionin e ri me ato që dinte, dhe e pyeste të Dërguarin e Zotit në lidhje me ndonjë mospërputhje.

Si një dëshmitare e gjallë e shpalljes, Aishja e kishte rregulluar kopjen e saj të Kuranit, duke i vënë kapitujt dhe vargjet sipas recitimit të Xhebrailit (a.s.) si tërësi. Kjo kopje do të shndërrohej në standard në kohët që do të pasonin dhe njerëz nga pjesë të largëta të kufijve të zgjeruara të Islamit kërkonin ta mësonin medoemos renditjen e saj të Kuranit.

### Interpretimi (Tefsiri)

Interpretuesi më i madh i Kuranit ishte i Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi Të. Ai ishte i vetmi që e dinte qëllimin hyjnor dhe e dinte se kur i duhej dhënë njerëzve ky informacion. Aishja i ndiqte me rigorozitet shpjegimet e të Dërguarit të Allahut në lidhje me Kuranin dhe i mësonte pikat e paqarta në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ajo fitoi aftësinë për të kuptuar qëllimin e Kuranit, dhe për të interpretuar parimet e përgjithshme brenda kuadrit të Islamit. Ajo nuk ishte vetëm një transmetuese që përcillte ato që kishte dëgjuar dhe parë, por edhe një interpretuese e përmbajtjes së pasur të tyre. Rrëfimet që kanë të bëjnë me kuptimin e Kuranit, përgjithësisht vijnë nga dy burime: Abdullah ibni Abasi dhe Aishja, gjë që flet për rëndësinë e madhe të Aishes si interpretuese.

Një ditë, nipi i Aishes, Urveja, shkoi dhe e pyeti atë për një ajet:

*“Në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj jetimëve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri e me katër. E nëse i frikësoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robërshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni.”*<sup>313</sup>

Ajo iu përgjigj:

“O nipi im! Jetimet e përmendura në këtë ajet janë ato nën kujdesin e kujdestarit të tyre dhe pas njëfarë kohe, kur ato rriten dhe tërheqin vëmendjen për shkak të bukurisë së tyre, kujdestarët mund të fillojë t'i lakmojnë ato dhe duan t'i mbajnë ato si gra, por pa i dhënë ndonjë shumë të përshtatshme martesore, ose duke i dhënë një shumë të vogël. Në këtë ajet, kujdestarëve u ndalohej sjellja e tyre e mëparshme, dhe porositen të martohen me femra të tjera.”

Pas shpjegimit të ajetit të mësipërm, njerëzit kërkuan sqarim të mëtejshëm nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Pastaj erdhi një tjetër ajet:

*“Kërkojnë prej teje (Muhamed) përgjigje për (çështjen) gratë. Thuaju: 'Allahu ju sqaron për to dhe kjo që po lexohet nga Libri (Kurani) përkitazi me gratë jetime, me të cilat lakmoni të martoheni, e nuk*

---

<sup>313</sup>Nisa, 3.

*u jepni atë që është caktuar (nikah ose miras), (ju sqaron) lidhur me të paaftit (fëmijët jetimë) dhe që të mbani drejtësi ndaj jetimëve! Dhe çfarëdo të mire të bëni, Allahu i di shumë mirë.*”<sup>314</sup>

Në ato kohë, një vajzë jetime do të ishte e lakmuar në qoftë se ajo ishte e bukur dhe e pasur. Ajo fejohej në përputhje me shpërblimin e duhur martesor dhe gjenealogjinë. Por kjo nuk ndodhte nëse ajo kishte mangësi në bukuri apo pasuri. Në rrethana të tilla, mashkulli nuk kishte fare të bënte me jetimen dhe martohej me gra të tjera. Prandaj u urdhërua që vajzës jetime t’i jepej shuma e përshtatshme e kurorës, të cilën ajo e meritonte, pavarësisht nëse ajo ishte e lakmuar apo e braktisur.<sup>315</sup>

Njohuritë kuranore të Aishes shkonin përtej të kuptuarit të sahabëve të tjerë, edhe pse ata ishin të parët në dije. Abdullah ibn Abasi pati thënë se ajeti: *“Kush është i pasur le të ruhet (shfrytëzimit të pasurisë së jetimëve), e kush është i varfër, le të hajë me maturi.*”<sup>316</sup>, u abrogua me shpalljen e ajetit: *“Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre me zjarr dhe do të futen në zjarrin e Xhehenemit.*”<sup>317</sup>

Në përgjigje të këtij pretendimi, Aishja tregoi se kushdo që keqpërdor pasurinë e jetimëve do të dënohet, përveç atyre kujdestarëve të varfër që kishin nevojë për pasurinë e jetimëve, në mënyrë që të kujdeseshin për ta. Ajo tha se nuk kishte asnjë kontradiktë mes dy ajeteve. Dënimi është i rezervuar për shkelësit që marrin pasurinë e jetimëve pavarësisht se nuk u takon.<sup>318</sup>

Veçantia e Aishes në interpretimin e Kuranit qëndronte tek afërsia që ajo kishte me të Dërguarin e Zotit. Disa sahabë patën arritur në përfundimin se namazi i mesëm i shprehur në ajetin: *“Vazhdoni rregullisht namazet (faljet), e edhe atë namazin e mesëm, dhe ndaj Allahut të jeni respektues (në namaze)*”<sup>319</sup>, ishte namazi i sabahut, ndërsa sahabë të tjerë, si Zejd ibn Thabiti dhe Usameja, pretendonin se fjala bëhej fjalë për namazin e drekës. Por Aishja tha se ishte fjala për namazin e ikindisë, duke u bazuar në atë çfarë vetë i Dërguari i Allahut i kishte thënë. Ajo gjithashtu e vuri në dukje opinionin e saj mbi kopjen e Kuranit që ajo mbante, pranë ajetit të lartpërmendur, si namazin e ikindisë.<sup>319</sup>

Qëndrimi i saj pasqyrore shumicën e opinionit të sahabëve, e kryesisht atë të Aliut, Abdullah ibn Mesudit dhe Semure ibn Xhundubit.<sup>320</sup>

Diçka e ngjashme ka ndodhur në lidhje me ajetin:

*“...për atë që keni në shpirtin tuaj, e shfaqët haptazi ose e mbajtët të fshehtë, Allahu ka për t’ju bërë përgjegjës...”*<sup>320</sup>

Imamët kryesorë, si Abdullah ibni Omeri, Abdullah ibni Abasi dhe Aliu, pretendonin se ky ajet u shfuqizua nga ajeti: *“Allahu nuk e ngarkon asnjë njeri përtej mundësive të tij.”*, i cili u shpall menjëherë pas tij. Por Aishja tha se diçka e këtillë nuk mund të ishte e vërtetë:

*“Askush nuk më ka pyetur ndonjëherë në lidhje me ajetin në fjalë për të cilin kam pyetur të Dërguarin e Zotit. Ai tha: ‘Kjo është për ata që kanë temperaturë të lartë ose sëmundje, ose çdo lloj fatkeqësie ose pasurie, që kanë frikë mos e humbasin pasi e posedojnë atë, pasuri e cila u është*

---

<sup>314</sup>Nisa, 127.

<sup>315</sup>Buhari, *nikah*, 1, 38.

<sup>316</sup>Nisa, 6.

<sup>317</sup>Po aty, 10.

<sup>318</sup>Buhari, *buju*, 95; *uasaja*, 23; *tefsir*, 81.

<sup>319</sup>Bekare, 238.

<sup>320</sup>Bekare, 284.

dhënë në administrim nga Allahu. Për shkak të këtyre gjërave, një rob mund të pastrohet nga mëkatet e tij si ari që është pastruar nga pluhuri dhe ndryshku.”<sup>321</sup>

## Hadithi

Sigurisht, shtëpia e lumturisë ku jetonte Aishja, ishte shkolla burimore e njohurive mbi hadithin. Një radhë e gjerë njerëzish, mjeshtra dhe studentë, fëmijë dhe gra, të rinj dhe të moshuar, arabë dhe joarabë, e vizituan shpesh këtë shkollë. Dhe Aishja ishte mësuesja së cilës ata i drejtoheshin më së shpeshti. Dhoma e saj ishte ngjitur me xhaminë e Profetit Muhamed paqja qoftë mbi Të, kështu që ajo e dinte se çfarë ishte folur në xhami, edhe kur ajo ishte në dhomën e saj. Ajo shpesh shkonte në xhami dhe ndiqte rregullisht namazet e përbashkëta të Profetit, dhe nuk i humbiste kurrë predikimet e Tij. Ajo i ka ndjekur të gjitha parimet fetare dhe shpalljet e sapozbritura. Para pothuajse kujtdo tjetër, Aishja e kishte të përditësuar informacionin mbi Islamin.

Në shkencën e hadithit, disa sahabë si Ebu Hurejre, Abdullah ibni Omeri, dhe Enes ibni Maliku, kanë transmetuar aq shumë hadithe nga i Dërguari i Allahut, sa që ata janë quajtur "Mukthirun"<sup>322</sup>. Edhe këtu, pozicioni i Aishes në mesin e Mukthirunëve ishte i rrallë, sepse në shumicën e atyre që ajo ka transmetuar, ajo ishte burimi i vetëm i informacionit. Kjo ishte si rezultat i natyrshëm i të qenit të saj me të Dërguarin e Zotit në vende krejt të pamundura për të tjerët. Të tilla hadithe që ajo ka transmetuar janë quajtur *ferd* (individuale) ose *munferid* (individualisht). Dhe nuk ishte vetëm intimiteti i saj që ia falte këtë përparësi. Aishja është burimi kryesor i informacionit rreth jetës familjare të të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të në sensin privat, për sa i përket namazeve të natës, dhe se si e ka shpenzuar ai kohën e lirë. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se nëse Aishja nuk do të kishte qenë aty, shumë gjëra rreth jetës private të të Dërguarit të Allahut do të kishin humbur dhe umeti do të ishte privuar nga një thesar i tillë kaq i çmuar.

Nëse ajo do të kishte ndjekur të gjitha tubimet në të cilat ka qenë i pranishëm i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ashtu si të gjithë *mukthirunët* e tjerë, sikur të kishte marrë pjesë nëpër shumë udhëtime, dhe sikur të mos kishte shpenzuar shumicën e kohës së saj në shtëpinë e tyre të përbashkët, atëherë hadithet që Aishja do të rrëfente duke u bazuar drejtpërdrejt nga goja e të Dërguarit të Allahut do të kishin qenë më të shumta. Numri i haditheve të rrëfyera nga Aishja që vinin drejtpërdrejt nga goja e të Dërguarit të Allahut është mbi dymijë.

Kur merret një vendim i peshuar, duhet të njihet edhe arsyeja e vërtetë e tij. Aishja gjithmonë e mësonte arsyen për çfarëdolloj gjykimi duke e përjetuar menjëherë atë që ndodhte, si dhe duke pyetur direkt personin përgjegjës. I Dërguari i Allahut rekomandoi marrjen e guslit gjatë të premeve. Ndërsa sahabët e tjerë, të cilët e transmetuan këtë hadith nuk hynin në hollësira të mëtejshme, rrëfimi i Aishes, përfshin edhe detaje të cilat shpjegojnë edhe arsyen për këtë. I Dërguari i Allahut dëshironte që besimtarët të cilët ishin të mbytur në djersë nga puna që kishin bërë që në mëngjes, të hiqnin nga trupi i tyre të gjithë papastërtinë dhe të lyheshin me parfum kur të vinin të falnin namazin e përbashkët që do t'i pastronte ata edhe shpirtërisht. Rrëfimi i Aishes fillon me fjalët:

“Të premeve, persona të veçantë që vinin nga larg, ishin të mbuluar nga djersa dhe pluhuri, dhe atyre u vinte një erë e rëndë. Kur një ditë isha pranë Profetit, erdhi një njeri i tillë në xhami dhe Profeti e pyeti: ‘Përse nuk e ke pastruar veten sot?’”

<sup>321</sup> Tirmidhi, *tefsir*, 3.

<sup>322</sup> Ata që kanë transmetuar më shumë hadithe.

Një hadith tjetër të cilin e transmeton Aishja, fillon kështu:

“Njerëzit ishin të zënë me punët e tyre dhe vinin të falnin namazin e xhumasë në të njëjtën gjendje siç kishin qenë në punë. Në atë kohë unë u thashë atyre, ‘dua që ju të vini pasi të lani krejt trupin.’”<sup>323</sup>

Gjatë festës së Kurban Bajramit, i Dërguari i Allahut ka thënë:

“Askush nga ju nuk duhet ta hajë mishin e kurbanit për më shumë se tri ditë.”

Ndërsa sahabë të shquar si Abdullah ibni Omeri dhe Ebu Said Hudriu mendonin se ky ishte një rregull absolut që nënkuptonte se nuk duhej ruajtur mishi i kurbanit për më shumë se tri ditë<sup>324</sup>, Aishja kishte një mendim tjetër. Ajo tha se hadithi ishte një nxitje për të mos e ruajtur mishin e një kafshe të sakrifikuar për më shumë se tri ditë, në mënyrë që t’i shpërndahej një sasi sa më e madhe prej tij njerëzve në nevojë. Ruajtja e mishit të kafshës së sakrifikuar duke e regjur atë, përbënte një praktikë të zakonshme në ato kohë. Meqenëse ruajtja e mishit për më shumë se tri ditë ishte e mundur teknikisht, kuptimi i hadithit duhej të sqarohej. Rabies e cila e pyeti:

“A është e vërtetë se i Dërguari i Allahut e ka ndaluar mishin e kafshës së kurbanit?”

Aishja iu përgjigj:

“Jo. Në ato kohë, numri i njerëzve të cilët bënë kurban ishte mjaft i vogël dhe atyre u kërkohesh që një pjesë të atij mishi t’ua jepnin për bamirësi atyre të cilët nuk ishin në gjendje të therrnin një kafshë për kurban. Ne e patëm ngrënë këmbën e përparme të një qengji edhe pas dhjetë ditësh nga festa e Kurban Bajramit.”<sup>324</sup>

Ndërkohë që disa njerëz mendonin se i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të pëlqente mishin e shpatullave të qengjit, Aishja na tërheq vëmendjen për sa i përket këtij detaji:

“Mishi i shpatullës së qengjit nuk ishte ajo pjesë të cilën i Dërguari i Allahut e pëlqente më së shumti. Në ato kohë, mishi ishte kaq i pakët sa ata të cilët e kishin atë, menjëherë do të rendnin t’ia sillnin të Dërguarit të Allahut. Mishi i shpatullës ishte ajo pjesë e cila mund të gatuhej më lehtë dhe më shpejt.”

Çdo vit, i Dërguari i Allahut dërgonte një nëpunësit për të mbledhur zekatin në Hajber. Transmetimet tregojnë se një nëpunës, ishte në gjendje të llogariste sasinë e frutave të prodhuara atje, por pa e shpjeguar përsenë e kësaj. Por rrëfimi i Aishes ofron një shpjegim për këtë:

“I Dërguari i Zotit e urdhëroi nëpunësin përgjegjës për mbledhjen e lëmoshës për të vlerësuar sasinë e mundshme të lëmoshës bazuar në sasinë e frutave që disa syresh mund të kishin ngrënë.”

Plotësinë e transmetimeve të Aishes e shpjegojnë faktorë të tillë si të përjetuarit shumë herë të incidenteve, të pyeturit në lidhje me çështjet që ajo nuk kishte qenë dëshmitare, apo në lidhje me ato gjëra që binin në kundërshtim me njohuritë e saj të mëparshme. Në këtë mënyrë, Aishja ishte shumë e ndjeshme dhe gjithmonë kërkuese. Ajo e ndiqte deri në fund çdo informacion që kishte dëgjuar, duke u përpjekur për të marrë konfirmimin nga burimi i saj origjinal.

Një ditë, dy vizitorë i thanë asaj një hadith:

“Fati i keq ndodhet tek tre gjëra: gruaja, ngjitja në kalë dhe tek shtëpia” Dhe ata e pyetën, “Çfarë mendoni se është domethënia e saj?” Këto fjalët e zemëruan mjaft Aishen, dhe zemërimi i saj ishte i dukshëm në sjelljen e saj. Duke shikuar përreth, ajo tha:

---

<sup>323</sup> Buhari, *xhumu’a*, 13, 14.

<sup>324</sup> Muslim, *Adahi*, 26.

“Betohem në Atë i Cili ia shpalli Kuranin Ebu Kasimit, se kjo çështje nuk qëndron ashtu siç thotë Ebu Hurejre. Njëherë, ndërsa i Dërguari i Allahut ishte duke folur, hyri Ebu Hurejre. Në atë moment, i Dërguari i Allahut ishte duke thënë:

“Gjatë Periudhës së Injorancës, njerëzit thoshin: ‘Fati i keq ndodhet tek tre gjëra: gruaja, ngjitja në kalë dhe tek shtëpia!’”

Ebu Hurejre kishte dëgjuar fundin e hadithit, por jo fillimin. Pasi e shpjegoi atë, Aishja recitoi ajetin e njëzetedytë të sures Hadid që thotë: “*Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në Visarin e Ruajtur, para se të ngjasë ajo, e kjo për Allahun është lehtë.*”

Me këtë ajet, Aishja shpjegoi se nuk mund të ketë keqkuptime të tilla në prani të Vullnetit Absolut dhe tërhoqi vëmendjen për fushën e vullnetit të njeriut.

Gjatë Epokës së Injorancës, struktura e familjes kishte ndryshuar dhe shumë modele të ndryshme të martesës ishin shfaqur në shoqëri. Praktika e *Mu'tas*-martesës së përkohshme, ishte shumë e zakonshme.

Vendimi përfundimtar i Islamit rreth Muta-s është shpallur në vitin e shtatë të hixhretit, gjatë pushtimit të Hajberit. I Dërguari i Allahut u tha me vendosmëri njerëzve të tij se *Mu'ta* ishte e ndaluar. Megjithatë, kishte edhe nga ata të cilët nuk e kishin dëgjuar ende këtë dhe e përkrahnin. Kur disa njerëz e dëshmuuan këtë dhe i thanë Aishes, ajo kërcëu përpjetë nga zemërimi:

“*dhe ata që e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robërshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar.*”<sup>325</sup>

Njëherë, Aishja dëgjoi një rregull që gratë duhet të prishnin gërshetat e flokëve, kur ata merrnin gusël. Abdullah ibni Amr ibni Asi e pohoi këtë, dhe ajo menjëherë tha:

“Unë jam i befasuar me deklaratën e Abdullah ibn Amr ibn Asit. Ai i urdhëron gratë që të prishin gërshetat e flokëve, ndërsa ata lajnë trupin plotësisht! Pse nuk i urdhëron ato që të rruajnë edhe kokat e tyre? Megjithatë, i Dërguari i Zotit dhe unë kemi marrë gusël në të njëjtin vend, dhe unë vetëm sa kam derdhur ujë mbi kokën time tri herë.”<sup>326</sup>

Një ditë tjetër, Aishja kishte dëgjuar fetvanë e Abdullah ibn Omerit, i cili pohonte se puthja e dhënë bashkëshortes e prishte abdesin. Ai ishte duke dhënë një gjykim në bazë të parimeve të përgjithshme në një fushë në të cilën ai nuk ishte i mirinformuar. Por Aishja e ndjeu se ajo duhet ta korrigjonte deklaratën e tij. Ajo shpjegoi mënyrën se si vetë i Dërguari i Zotit kishte vepruar:

“I Dërguari i Zotit i ka puthur disa nga gratë e tij dhe ka shkuar pastaj në namaz pa marrë sërish abdes.”<sup>327</sup>

Ajo gjithashtu u mësoi të tjerëve për mënyrën e të folurës së Profetit, dhe se si duhet të raportojë një hadith. Dikush kishte pyetur në lidhje me stilin e të folurës së të Dërguarit të Zotit, dhe Aishja u përgjigj:

“Ai e kishte zakon të fliste kaq ngadalë sa që pa dyshim, kushdo që dëshironte t’i numëronte fjalët e tij, mund ta bënte këtë me lehtësi.”<sup>327</sup>, ndërsa në një rast tjetër, ndërkohë që Aishja ishte duke falur namazin, ajo dëgjoi dikë jashtë që po transmetonte një hadith. Ai i përmendi thëniet e të Dërguarit të Allahut, por fliste shumë shpejt dhe pothuajse asnjëra prej fjalëve të tij nuk kuptohej.

---

<sup>325</sup> Mu'minun, 5-6.

<sup>326</sup> Muslim, *hajd*, 59; Ibni Maxhe, *taharet*, 108.

<sup>327</sup> Kur personi, i cili ka transmetuar hadithin e pyeti Aishen nëse ishte fjala për të, ajo buzëqeshi dhe iu përgjigj në mënyrë pohuese. Shih: Ebu Davud, *taharet*, 69; Tirmidhi, *taharet*, 63.

Aishja, natyrisht, u shqetësua nga transmetimi i hadithit në këtë mënyrë pranë dhomës së saj.

“Një njeri erdhi dhe transmetoi hadith prej të Dërguarit të Zotit para dhomës sime në një mënyrë që unë arrita ta dëgjoj, dhe pastaj u zhduk menjëherë. Unë isha e zënë me recitimin e lutjeve të mia, dhe ai përfundoi hadithin para se unë të kisha mbaruar lutjet. Po të kisha qenë në gjendje ta kapja, do t'i kisha thënë: ‘I Dërguari i Zotit kurrë nuk do ta kishte shprehur diçka ashtu siç bëre ti!’”<sup>328</sup>

## Fikhu

Aishja ishte një nga të paktët njerëz që arriti të shpallte vendime të reja bazuar në njohuritë e saj të mëparshme rreth Kuranit dhe sunetit. Fikhu varet nga kuptimi i arsytimit dhe justifikimit për gjykime. E quajtur *il'le* (shkaku i vërtetë) në jurisprudencë, ajo shpjegon qëllimin kryesor në gjykimet fetare. Kur nuk ekziston asnjë shpallje e qartë, mund të merret një vendim duke u nisur vetëm nga arsytimi, dhe njohuritë e Aishes në këtë fushë ishin më të përparuara në krahasim me bashkëkohësit e saj.

Siç është shpjeguar më parë, Aishja e pyeste të Dërguarin e Zotit për arsyen që qëndronte prapa shumë çështjeve kur ajo nuk ishte në gjendje të kuptonte shkakun e tyre të ligjshëm, duke e marrë përgjigjen kështu menjëherë prej Tij. Ajo i korrigjonte keqkuptimet me anë të shembujve nga jeta e vetë Profetit.

Aishja, e cila u shpreh se një grua e divorcuar ose e ve shtatzënë mund të martohej me dikë tjetër kur ajo të lindte, arriti në përfundimin se periudha e pritjes së gruas merrte fund me lindjen e foshnjës. Ajo e ka bazuar këtë vendim në një ngjarje që kishte përjetuar, kur i Dërguari i Zotit e pat lejuar Subeja Eslemijen, e cili lindi fëmijë pas vdekjes së burrit të saj, për t'u martuar me dikë tjetër.<sup>329</sup>

Duke shpjeguar pse pjesa farz e namazit të akshamit është me tre rekate, Aishja tha: "Për shkak se ajo është vitri i ditës!" Ajo e dinte pse namazi i sabahut është me dy rekate, dhe e konsideroi atë se kishte lidhje me recitimin e Kuranit - duke u shprehur se thelbësore ishte cilësia, dhe jo sasia.<sup>330</sup>

Aishja i paralajmëronte njerëzit që të mos mbeteshin të mbërthyer në aspektet fizike të haxhit, dhe deklaronte se veprime të tilla si rrotullimi rreth Qabes, ecja para-prapa në radhë ndërmjet Safas dhe Merues, si dhe gurëzimi i djallit ishin thjesht mjete për të kujtuar Zotin.<sup>331</sup> Ajo shpjegoi gjithashtu se vizita në Luginën Muhasab, e cila më vonë u quajt Abtah, nuk ishte e nevojshme në pelegrinazh, dhe u shpreh se meqenëse lugina e lartpërmendur ishte në rrugën më të shkurtër gjatë asaj periudhe, ajo ishte trajektorja e parapëlqyer.<sup>332</sup>

Aishja e pati pyetur të Dërguarin e Zotit nëse Hatimi, një vend në formë hëne ngjitur me Qaben, do të konsiderohej pjesë e Qabes, dhe i pat thënë, "Pse nuk është përfshirë ai në vizitën e Qabes?"

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Sigurisht, gjatë atyre ditëve, njerëzit ishin në vështirësi financiare. Të menduarit rreth mjeteve të tyre të udhëtimit nuk i lejonte ata ta bënin këtë.”

Ajo e pati pyetur prapë:

---

<sup>328</sup> Buhari, *menakib*, 20.

<sup>329</sup> Muslim, *talak*, 36; Tirmidhi, *nikah*, 37.

<sup>330</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/241.

<sup>331</sup> Ebu Davud, *menasik*, 51;

<sup>332</sup> Buhari, *haxh*, 146.



“Përse dera e Qabes është kaq e lartë?”

Ai iu përgjigj:

“Njerëzit e kanë bërë të tillë në mënyrë që të lejonin njerëzit që dëshirojnë të hyjnë brenda dhe të ndalojnë ata që nuk duan të hyjnë.”<sup>333</sup>

Ajo e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, a nuk mendon se duhet ta rindërtosh atë mbi burimin e Profetit Ibrahim?”

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Nëse populli yt nuk do të ishte shpëtuar së fundmi nga paganizmi, edhe mund ta kisha bërë atë.”<sup>334</sup>

Një mendje e tillë brilante si e saja do të nxirrte shumë përfundime të rëndësishme nga këto shprehje. Ajo mori një mësim që të mos këmbëngulte më me kokëfortësi në një çështje, të cilën njerëzit nuk do të ishin në gjendje ta pranonin përpara kohës dhe vendit të duhur, dhe se ishte më e arsyeshme që të shtyheshin disa çështje për ditët, vitet, madje edhe shekujt e mëvonshëm. Aishja ishte një nga të paktët që e kuptoi pikën thelbësore që aktvendimet mund të ndryshojnë në përputhje me kohën dhe kushtet. Për shembull, ajo besonte se vendimi që i inkurajonte gratë për të marrë pjesë në namazet me xhemat në xhami duhej ndryshuar në vitet e mëvonshme. Ajo thoshte se kushtet kanë ndryshuar, dhe pastërtia e njerëzve të kohës së Profetit nuk ishte më ajo e para. Kështu, rregulli duhet të rishqyrtohej në bazë të kushteve aktuale dhe se duhet të merrej një vendim i ri.<sup>335</sup>

Njohuritë e Aishes rreth fikhut e kishin origjinën drejtpërdrejt nga Kurani dhe Suneti, ashtu si edhe njohuritë e saj në fushat e interpretimit dhe hadithit. Ajo nxori konkluzione duke rimodeluar informacionin nga këto burime, dhe e ka shprehur qartë opinionin e saj sa herë që ishte çasti i duhur. Kur një çështje parashtrohej përpara saj, ajo më parë i drejtohej Kuranit dhe Sunetit, pastaj kontrollonte për ndonjë gjykim të ngjashëm apo analogji. Në çështjet ku ajo mund të gjente ndonjë burim bazë, Aishja i interpretonte ato sipas logjikës. Kur ajo u pyet nëse mishi i kafshëve që theren nga adhuresit e zjarrit mund të hahej, Aishja u kujtoi atyre ndalimin nga Kurani për të ngrënë mishin e kafshëve që nuk janë therur në emër të Allahut. Ajo tregoi se meqenëse persianët thernin kafshë jo emër të Allahut, mishi i tyre ishte i ndaluar.<sup>336</sup>

Aishja kishte gjithashtu një mendim të ndryshëm nga të tjerët për sa i takon çështjes së interpretimit të gjatësisë së periudhës së detyrueshme të pritjes për gratë e divorcuara, siç thuhet në Kuran. Nëse gruaja e divorcuar dëshiron të martohet me një njeri tjetër, ajo duhet të presë derisa të sigurohet se nuk është shtatzënë. Aishja e ka interpretuar këtë gjatësi, si deri në fund të tri cikleve menstruale e mosfillimin e tyre, dhe u tha të tjerëve për të vepruar në këtë mënyrë. Ebu Bekr ibn Abdurrahmani ka thënë: “Unë nuk kam parë ndonjë dijetar tjetër fikhu përveç saj, i cili ta këtë interpretuar dhe shpjeguar këtë çështje si ajo.”<sup>337</sup>

Ndërsa disa sahabë e konsideronin ndarjen si një divorc, Aishja theksonte se në këtë rast nuk ekziston asnjë divorc. Mbështetja e saj për këtë variant vinte nga vetë përvoja e saj. Atyre që çuditeshin nga ky arsyetim, ajo tha:

---

<sup>333</sup> Buhari, *haxh*, 405; Buhari, *ilm*, 48.

<sup>334</sup> Buhari, *ilm*, 48.

<sup>335</sup> Buhari, *sifatu salat*, 79.

<sup>336</sup> Bekare, 173; Kurtubi, *el-xhami*, 2/224.

<sup>337</sup> Malik, *muatta, talak*, 1198.

“I Dërguari i Zotit na dha mundësinë e zgjedhjes për ta lënë apo të qëndrojmë me të dhe ne preferuam të qëndronim me të. Ai kurrë nuk e konsideroi këtë si divorc.”<sup>338</sup>

Një ditë, Sad ibn Hishami e pyeti:

“Doja t’ju pyesja për beqarinë. Çfarë mund të thoni ju për ata që bëjnë një jetë prej beqari?”

Aishja pa ngurrim iu përgjigj:

“Mos e bëj atë. A nuk e ke dëgjuar se Allahu i Madhëruar ka thënë: *‘Ne dërguam para teje të dërguar dhe atyre u mundësuam të kenë gra e fëmijë’*<sup>339</sup>. Rri larg nga beqaria.”<sup>340</sup>

Shumë dijetarë të njohur i kanë vlerësuar njohuritë e saj rreth fikhut. Dijetarët si Ebu Seleme ibn Abdurrahmani<sup>341</sup> janë shprehur se ata kurrë nuk kanë parë dikë më të ditur se Aishja. Ndërsa njerëz si Ebu Omer Ibn Abdulberri mendonin se Aishja ishte një produkt unik i kohës së saj<sup>342</sup>, të tjerët si Kasim ibn Muhamedi thoshin se ajo ishte shndërruar në një zyrë autonome fetvash gjatë kalifateve të Ebu Bekrit, Omerit dhe Osmanit.<sup>343</sup> Në ato kohë, njerëz nga Basra në Damask, nga Kufe në Egjipt, dyndeshin në turma të mëdha për në Medinë që të pyetnin Aishen rreth fesë. Ata që nuk mund të shkonin vetë, i dërgonin asaj letra dhe dhurata. Nxënëse të veçanta të Aishes, si Aishe binti Talhaja, shkruanin përgjigjet e letrave të tyre dhe dërgonin duke iu bërë edhe dhurata letërshkruesve.<sup>344</sup>

## Teologjia islame

Aishja ishte shumë e ndjeshme ndaj informacioneve që kundërshtonin Kuranin. Pas Miraxhit, disa sahabë, të tillë si Abdullah ibni Abasi, kishin mendimin se i Dërguari i Zotit kishte parë Allahun. Ata paraqitën disa prova dhe pohonin se ajetet e mëposhtme e provonin më së miri këtë: *“Dhe se ai e pati parë Atë (Xhebrailin) në horizontin e qartë qiellor”*<sup>345</sup>, *“Atë (Xhebrailin) e ka parë edhe herën tjetër. (E ka parë) tek Sidretul Munteha.”*<sup>346</sup>, *“Ai (Muhamedi) vërtet pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.”*<sup>347</sup>. Dijetari i famshëm Abdullah ibni Abasi ka thënë:

“Allahu i Plotfuqishëm, i cili e ngriti Profetin Ibrahim në rangun e Halilullahut, duke e bërë unike marrëdhënien e Tij me të, dhe i cili e ngriti Profetin Musa në rangun e Kelimullahut (atij të cilit Allahu i foli), duke e nderuar atë me fjalën e Tij, me siguri e ka lartësuar Profetin Muhamed, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, me bekimin e të Shikimit të Tij.”<sup>348</sup>

Jo të gjithë u pajtuan me të, e pikërisht udhëheqësit e tillë të dijes si Aishja, Ebu Dherri, Abdullah ibn Mesudi dhe Ubej ibn Ka'bi, të cilët thanë se ai që i Dërguari i Zotit kishte parë ishte Xhebraili, dhe se hadithi në lidhje me Miraxhin duhet të konsiderohej nga ky këndvështrim. Pasi i dëgjoi këto kundërshtime, Abdullah ibn Abasi shkoi në derë të Aishes, dhe e pyeti:

“O nëna ime e dashur, a e pa Muhamedi Zotin e tij?”

Aishja iu përgjigj:

---

<sup>338</sup> Buhari, *talak*, 4.

<sup>339</sup> Ra'd, 38.

<sup>340</sup> Tirmidhi, *nikah*, 2; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/97.

<sup>341</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/375.

<sup>342</sup> Zerkeshi, *exhabe*, 9.

<sup>343</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/375.

<sup>344</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/93, 95; Buhari, *edebul mufred*, 1/382.

<sup>345</sup> Tekuir, 23.

<sup>346</sup> Nexhm, 13-14.

<sup>347</sup> Nexhm, 18.

<sup>348</sup> Shih tefsirin e Ibni Kethirit dhe Taberit, Nexhm, 13-15.

*“Kur kam dëgjuar fjalët tuaja, ndjeva sikur gjaku më ngriu. Ka tre pika që duhen thënë. Së pari, kush thotë ‘Muhamedi pa Zotin e tij,’ nuk thotë të vërtetën, ‘Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshijnë Atë, e Ai i përfshin të parët. Ai është shumë i kujdesshëm, hollësisht i njohur”<sup>349</sup>, dhe ‘Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anën e frymëzimit ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (melek). Së dyti, ai i cili thotë se ‘i Dërguari i Zotit e dinte se çfarë do të ndodhte të nesërmen’ gënjen, sepse Allahu i Plotfuqishëm thotë: ‘nuk e di kush përveç Tij se çfarë do t’i ndodhë nesër’<sup>350</sup>. Së treti, kush thotë se ‘Muhamedi e ka mbajtur të fshehur një pjesë të shpalljes’ duhet ta dish se ai person gënjen, sepse Allahu i Plotfuqishëm e ka urdhëruar qartë të Dërguarin e Tij: ‘Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrë’<sup>351</sup>. Megjithatë, ai e ka parë Xhebrailin dy herë në formën e tij të vërtetë.”<sup>352</sup>*

### Aftësitë letrare të Aishes

Aishja ishte një mjeshtre e gjuhës arabe. Ajo e dinte mjaftë mirë se çfarë të thoshte dhe si ta thoshte. Kur fliste, ajo e bënte të domosdoshme vëmendjen e të tjerëve. Fuqia e saj e përshkrimi ishte e madhe, dhe ajo tregonte ndjeshmëri në përzgjedhjen e fjalëve. Për shembull, ndërkohë që përshkruante shpalljen e parë të të Dërguarit të Zotit, ajo përdorte shprehjen, “Ai kurrë nuk e kishte parë kurrë as në ëndërr, porse ajo erdhi si drita e mëngjesit.”<sup>353</sup> Kur Aishja shprehte shqetësimin e të Dërguarit të Zotit teksa i erdhën këto vargje, ajo thoshte, “Pastaj kushtet që u shfaqën gjatë shpalljes u vërejtën sapo ai mori shpalljen Hyjnore. Ai u djersit për shkak të peshës së Fjalës së shpallur. Edhe pse ishte dimër, rruaza djerse si perla derdheshin teposhtë fytyrës së Tij.” Në ditët kur ajo mësoi që ishte duke u përgojuar nga hipokritët, ajo e shprehu në këtë mënyrë shqetësimin e saj: “Atë ditë, unë qava aq shumë sa që nuk mbeti lot në sytë e mi, madje më ngjate sikur të më ishin tharë kanalet e lotëve. Unë nuk fjeta, e as i mbylla sytë qoftë edhe aq kohë sa duhet për të vendosur bojën nëpër qepalla.”<sup>354</sup> Ajo kishte natyrë poetike, nuk kënaqej me përdorimin e shprehjeve të përditshme, por përdorte fjalë që përcillnin thellësinë e kuptimit dhe aftësinë për të të bindur.

Aishja e kishte mësuar shkencën e gjenealogjisë dhe historinë nga i ati i saj, Ebu Bekri. Ndjeshmëria e saj ndaj poezisë, elokuencës dhe estetikës vinin nga i njëjti burim.<sup>355</sup> Ebu Bekri ishte një burim i dijes edhe për dijetarët më të shquar të kohës.<sup>356</sup> Njëherë, i Dërguari i Zotit e adresoi poetin e famshëm, Hasan ibn Thabitin, tek Ebu Bekri, duke i thënë:

“Shko tek Ebu Bekri, sepse ai e njeh gjenealogjinë e fiseve të tjera më shumë se ti.”

Nga njohuritë që Hasani mori nga Ebu Bekri, ai qe në gjendje pastaj të thurte vargje që i kundërpërgjigjeshin denjësisht paganëve. Atë ditë, duke dëshmuar se ai recitoi poezi të thella plot mençuri, kurejshët shfaqën mosnjohjen e mirë të tyre dhe pohuan përparësinë e Ebu Bekrit:

“Vetëm ibn Ebu Kuhafja mund ta dijë përmbajtjen e këtyre poezive në një shkallë të tillë. Nuk ka asnjë dyshim që këto janë poezi të ibni Ebu Kuhafes.”<sup>357</sup>

<sup>349</sup> En’am, 103.

<sup>350</sup> Lukman, 34.

<sup>351</sup> Maide, 67.

<sup>352</sup> Buhari, *bed’ul halk*, 7; Taberani, *Muxh’emul kebir*, 12/90; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/241.

<sup>353</sup> Buhari, *bed’ul uahj*, 1.

<sup>354</sup> Buhari, *shehadet*, 15; *megazi*, 34.

<sup>355</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/67.

<sup>356</sup> Muslim, *fedailu sahabe*, 157.

<sup>357</sup> Ibni Abdibarr, *istiab*, 1/342.

Dijetarët klasikë dhe modernë thonë se Aishja ishte më e rrjedhshmja dhe elokuentja e kohës së saj. Nën tutelën dhe udhëzimin e të Dërguarit të Zotit, i cili do të linte një shenjë të pashlyeshme në të ardhmen me deklaratat e Tij, si dhe duke u rritur nën kujdesin e një mjeshtri të gjuhës si Ebu Bekri, ajo u bë një fëmijë i përkëdhelur prej fatit.

Musa ibn Talha, një dijetar i rëndësishëm dhe nxënës i Aishes ka thënë:

“Unë nuk kam parë askënd më të mirë se Aishja në gojëtar apo në qartësinë e të shprehurit.”<sup>358</sup>

Një tjetër dijetar i shquar, Ahnef ibn Kajs ka thënë:

“Kam dëgjuar predikimet e Ebu Bekrit, Omer ibn Hatabit, Osman ibn Afanit dhe Ali ibn Ebu Talibit si dhe të gjithë kalifëve të tjerë që kanë qenë deri më sot. Por prej tyre nuk kam dëgjuar shprehje të tilla të rrjedhshme dhe të bukura siç kam dëgjuar nga Aishja!”<sup>359</sup>

Ndërsa ishte për vizitë tek Aishja, Muavija u përkul nga Zekuani i cili ishte bashkë me të dhe i tha:

“Betohem në Zotin, se me përjashtim të të Dërguarit të Zotit, unë kurrë nuk kam parë askënd më qartëfolës sesa Aishja!”<sup>360</sup> Përveç nivelit të lartë letrar të babait të saj Ebu Bekrit, arsytet për shprehinë e njohur të Aishes ishin njohja e saj e Kuranit, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në predikimet e të Dërguarit të Zotit paqja qoftë mbi Të, vullneti dhe zotësia për të kuptuar dhe memorizuar deklaratat e të Dërguarit të Allahut, si dhe kultura beduine e shekullit të shtatë të Arabisë, me theksin e saj të veçantë në traditën gojore, të poezisë dhe rrëfimit. Ajo gjithashtu ka parë e dëgjuar poetë myslimanë që erdhën në Medinë nga vende të tjera.

Ajo i zgjidhte fjalët me kujdes, dhe i këshillonte njerëzit që të përdornin frazat e Kuranit Fisnik teksa flisnin. Kur Jezid ibn Babnusi dhe shoku i tij e vizituan atë, ai iu drejtua asaj nga ana tjetër e perdes për ta pyetur në lidhje me marrëdhëniet e një burri me gruan e tij, ndërsa ajo është me menstruacione.

Aishja e vuri re se ai nuk po përdorte shprehjet e Kuranit në shpjegimin e tij të situatës, prandaj ajo e paralajmëroi atë:

“Përdor fjalët që i pëlqejnë Allahut.”<sup>361</sup>

Ajo gjithmonë i paralajmëronte ata që ndërprisnin marrëdhëniet e tyre me Kuranin, dhe nuk e pëlqente të angazhuarit me diçka tjetër përveç librit të Zotit. Fjalët e saj i ftonin të tjerët për të rifituar ndërgjegjen e tyre, kur ajo vërente se ishin duke përdorur fraza të papëlqyeshme.

Një ditë Ibn Ebu Saibi erdhi tek ajo. Kur e pa atë, Aishja tha:

“Ka tri gjëra për të cilat ti duhet të më dëgjosh, ose përndryshe unë do të luftoj kundër teje deri në fund.”

“O nëna e besimtarëve, më thuaj cilat janë dhe unë me siguri do të ta dëgjoj fjalën!”

“Ndërsa ju jeni duke u falur, mos mbani një qëndrim apo sjellje që cenon seriozitetin e të qenit në praninë e Allahut, sepse kurrë nuk e kam parë të Dërguarin e Allahut apo shokët e Tij të bëjnë diçka të këtyllë. Në vend që t’u mbash ligjërata çdo ditë, më mirë këshilloji njerëzit vetëm një herë të premtëve, ose në qoftë se dëshiron më shumë, ndoshta dy herë, ose më së shumti, tri herë. Mos bëj që njerëzit të humbasin entuziazmin e tyre për këtë libër, për Kuranin. Unë shpresoj se unë nuk do

---

<sup>358</sup> Tirmidhi, *menakib*, 62

<sup>359</sup> Hakim, *Mustedrek*, 4/12.

<sup>360</sup> Dhehebi, *sijer*, 2/183.

<sup>361</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/219.

të të shoh më t'i ndërpresësh njerëzit kur ata janë duke folur në një tubim. Kur të jesh përpara një situatë të tillë, lëri dhe ik. Nëse pastaj tregojnë respekt dhe të kërkojnë vetë t'i këshillosh, kthehu dhe fol me ta.”<sup>362</sup>

Aishja fliste qartë dhe pastër, siç kishte parë nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Mënyra e saj e të folurit kishte një domethënie të veçantë, sidomos kur ajo i drejtohej turmave të mëdha të njerëzve. Kur mendjet janë të hutuara ose të çoroditura nga informatat kundërthënëse, duhet të flitet me autoritet, dhe ndoshta edhe të përsëriten disa fraza për ta përcjellë siç duhet atë që është për t'u kuptuar. Aishja i kundërshtonte ata që flisnin nxitimthi. Ajo thoshte se fjalët duhet të artikulohen me kujdes, dhe përmendte të Dërguarin e Allahut si shembullin më përfaqësues. Aishja këmbëngulte që fjalët duhet të jenë të zgjedhura në mënyrë që të futen menjëherë e në zemra.

Aishja e përshkruante bujarinë e të Dërguarit të Allahut si një erë të pandërprerë që merrte gjithçka me vete.<sup>363</sup>

Fjalët e saj i jepnin përgjigje problemeve më të thella që ekzistonin në shoqërinë e saj.

“Sigurisht, fejesa është si shërbim ndaj Zotit. Ju duhet të jeni të kujdesshëm kur zgjidhni atë me të cilin e fejonit vajzën tuaj.”<sup>364</sup>

### **Shpirti poetik dhe oratoria**

Poezia ishte dhunti e arabëve. Sa herë që flisnin, ata shpreheshin me gjuhën e poezisë. Aishja lindi në një epokë kur babai i saj, Ebu Bekri ishte në gjendje të recitonte përmendësh poezi për ditë me radhë, pa u ndalur. Gjatë asaj kohe, malli më me vlerë në treg ishte poezia, ata e rrëfenin historinë nëpërmjet poezisë, shpreheshin përmes poezisë si dhe gjallëronin tubimet e tyre me poezi. Sipas Aishes, poezia ishte e ndarë në: poezi të mira dhe të bukura, dhe poezi të këqija dhe të shëmtuara. Ajo porosiste: “lëreni të keqen dhe të shëmtuarën dhe kërkonit të mirën dhe të bukurën.” Ajo e kishte dëgjuar këtë drejtpërsëdrejti nga i Dërguari i Allahut.<sup>365</sup>

Një ditë, Shurajhu e pyeti Aishen:

“A ka recituar ndonjëherë ndonjë poemë i Dërguari i Allahut?”

Ajo u përgjigj se i Dërguari i Zotit kishte recituar një poezi të shkruar nga Abdullah ibn Reuaha, dhe nuk e linte pas dore dhënien e vazhdueshme të shembujve nga poemat.<sup>366</sup>

Aishja kishte një kujtesë fotografike. Ajo kurrë nuk i harronte ato që dëgjonte, dhe gjithmonë arrinte t'i rikujtonte ato në kohën dhe vendin e duhur.

Vite më vonë, ajo u ndal në vjershat që kishte dëgjuar prej mekasve në lidhje me shpartallimin që kishin përjetuar në Luftën e Bedrit, ajo u tregoi besimtarëve për urrejtjen dhe smirën që mekasit kishin ndjerë ndaj Islamit.<sup>367</sup> Aishja kishte ndjenjat e sinqerta të një gruaje të vjetër, e cili vite më parë, pati shpëtuar nga errësira e botës pagane, dhe e pati pajisur vetveten me klimën e ngrohtë të Xhamisë së Profetit.<sup>368</sup> Aishja ia pati paraqitur disa prej tyre të Dërguarit të Zotit paqja qoftë mbi Të.

---

<sup>362</sup> Zerkeshi, *el-ixhabe*, 176.

<sup>363</sup> Buhari, *bed'ul uahj*, 1.

<sup>364</sup> Said ibni Mansur, *Sunen*, 1/191; Ibnul Xhezui, *zadul mead*, 5/189.

<sup>365</sup> Buhari, *edeb'ul mufred*, 1/299.

<sup>366</sup> Po aty, 1/300.

<sup>367</sup> Buhari, *menakib'ul ensar*, 45.

<sup>368</sup> Buhari, *salat*, 57; *Menakib'ul ensar*, 26.

Dhe ishte përsëri Aishja, e cila i transmetoi poezitë plot nostalgji që i përkisnin Ebu Bekrit, Bilalit dhe Fuhejrës, të cilët ajo i kishte vizituar pas hixhretit.<sup>369</sup>

Një ditë, Aishja recitoi nga dy fragmente nga një poet i kohës së injorancës, Ebu Kabir Huzaliut, pranë të Dërguarit të Zotit. Në poemë, Ebu Kabir Huzaliu shkruante për djalën e tij dhe guximin e tij legjendar. Atëherë Aishja tha:

“Nëse Ebu Kabir Huzaliu do të të kishte parë Ty, ai me siguri do të konsideronte si subjektin më të denjë të poezive të tij.”

Pas fjalëve të Aishes, i Dërguari i Zotit u ngrit dhe e puthi ballin e saj, e i tha:

“Allahu i Plotfuqishëm të shpërbleftë me çmimin më të bukur dhe të dobishëm, o Aishe. Zoti të kënaqtë ashtu siç ti më kënaqe mua!”<sup>370</sup>

Aishja tregon lidhur me mënyrën se si Sad ibn Muadhi kishte recituar një poezi ditën e Betejës së Hendekut. Në përgjigje të jobesimtarëve të cilët thumbonin pa reshturi Islamit dhe myslimanët, i Dërguari i Zotit u kërkoi Abdullah ibn Rauahs, Ka'b ibn Malikut dhe Hasan ibn Thabitit t'i dëlnin zot Islamit. Aishja që ajo e cila i transmetoi këto poezi. Ajo transmetoi gjithashtu edhe poezi të cilat gratë myslimane të Medinës i recitonin nëpër dasma.<sup>371</sup>

Sigurisht, poezitë e Aishes nuk kufizoheshin me kaq. Ajo ishte një grua me një thesar pa fund të poezive që ruheshin në kujtesën e saj, rrëfesheshin kur ishte momenti i duhur, ndaj ajo ishte e aftë të përdorte gjithë bukurinë e poezisë për të shprehur vlerat në të cilat ajo besonte.<sup>372</sup>

Ajo thoshte:

“Ushqejini fëmijët tuaj me poezi, në mënyrë që gjuha e tyre të bëhet e ëmbël.”

Ajo mendonte se ishte jetike për t'u mësuar fëmijëve poezi në mënyrë që t'i ndihmojmë ata të flasin më rrjedhshëm, si dhe për të kultivuar aftësinë e tyre për t'u shprehur qartë.<sup>373</sup>

Është fakt gjithashtu që poezia të ketë edhe një fytyrë të bukur, por njëkohësisht dhe një të shëmtuar. Gjëja më e rëndësishme për besimtarët është që ta përdorin gjuhën në mënyra të mira dhe të dobishme. Aishja argumentonte se gjuha mund të përdoret si një gjarpër për të lënduar zemrat njerëzore:

“Personi më mëkatar është ai që tallet pa dallim me një fis apo një grup njerëzish në poezinë e tij.”<sup>374</sup>

Kjo ishte gjithashtu edhe këshilla e Profetit, sepse Abdullah ibn Omeri ka transmetuar nga Profeti se "poezia mbështetet në fjalën, bukuria e saj është si bukuria e fjalës, e gjithashtu edhe shëmtia e saj është si shëmtia e fjalës.”<sup>375</sup>

Kur Ebu Bekri vdiq, Aishja dëgjoi se disa njerëz kishin vepruar prapa krahëve të babait të saj dhe u mërzit edhe më shumë. Ishte e qartë se kjo ishte një përpjekje e qëllimshme nga ana e hipokritëve. Duhej thënë e vërteta, përpara se njerëzit t'u besonin fjalëve të gënjeshtërtë. Ajo mblodhi grupin e njerëzve të cilët ajo besonte se do t'i dëgjonin këshillat e saj. Aty ajo mbajti një fjalim për t'ua bërë

<sup>369</sup> Buhari, *fedail'ul Medina*, 12; *Menakib'ul Ensar*, 46; *Merda*, 8, 22.

<sup>370</sup> Bejheki, *Sunen*, 7/422.

<sup>371</sup> Muslim, *fedailu sahabe*, 156.

<sup>372</sup> Për më tepër shembuj të detajuar të poemave që ka recituar Aishja, shih: Bejhekiu, *Sunen*, 7/289; Taberiu, *tarih*, 3/7;

<sup>373</sup> Ibni Abdirabbi, *el-ikdul Farid*, 5/239.

<sup>374</sup> Buhari, *edeb'ul mufred*, 1/302.

<sup>375</sup> Buhari, *edeb'ul mufred*, 1/299.

edhe një herë më shumë të qartë pozicionin e kalifit të ndjerë, duke u ndalur në detaje të cilat prej disave mund të anashkaloheshin.

Pasi e kishte përfunduar fjalimin e saj, ajo priste mendimin e njerëzve. Ajo pyeti:

“Për hir të Zotit ju lutem më thoni, a ka ndonjë gjë që ju është dukur pa vend apo e pavërtetë në ato që po ju them?”

Përgjigjja doli nga buzët e njerëzve të drejtë që ishin mbledhur aty:

“Jo, ne betohemi në Allah se çdo gjë që ti the ishte e vërtetë!”<sup>376</sup>

Kur Aishja mori lajmin se ishte vrarë Osmani, ajo pyeti nëse kjo ishte e vërtetë. Atëherë ajo tha:

“Allahu i Plotfuqishëm dhuroftë mëshirën e Tij mbi të dhe e faltë atë. Megjithatë, ai shpëtoi nga problemet e kësaj bote. Meqë në të kaluarën ju nuk patët ngritur asnjë kundërshtim ndaj atyre që e kundërshtuan dhe i bënë rezistencë atij dhe u dorëzuat para tyre, sot ju duhet ta mbështesni më shumë drejtësinë, dhe duhet të punoni më shumë për të shtuar fuqinë e Islamit, duke e lartësuar atë. Edhe pas kësaj dashamirësie aq të madhe nga Allahu, i cili ka dhuruar mbi ju bekimet e të mirave të fesë tuaj, ju ende e shikoni me lakmi këtë botë dhe e lini pas dore idenë e të ndihmuarit të fesë së Tij. Ju e dini shumë mirë se shkatërrimi i diçkaje është shumë më i lehtë sesa ndërtimi i saj. Mos harroni se në momentin që ju prisni falenderime për mosmirënjohjen tuaj, bekimet që keni fituar do të zhduken.”<sup>377</sup>

Një ditë tjetër, Osman ibni Hunejf e pyeti:

“O nëna ime e dashur, cila është arsyeja e vizitës tuaj këtu? A është kjo një detyrë që i Dërguari i Zotit ta ka premtuar ty apo është thjesht interpretimi juaj?”

Ajo iu përgjigj:

“Jo përkundrazi, unë kam ardhur këtu me vullnetin tim, por dëgjova se është vrarë Osmani. Me vrasjen e Osmanit ju keni shkelur tri ndalesa dhe realizuat tri veprime të ndaluara në të njëjtën kohë. Ju injoruat shenjtërinë e kësaj zone, shkelët mbi nderin e Kalifatit, dhe sfiduat muajt e shenjtë. Edhe pse ai ua kishte plotësuar dëshirat tuaja, ju i shkaktuat atij probleme mbi probleme dhe e vratë, duke e flakur tutje si një leckë të bardhë me të cilën keni pastruar ndyrësitë tuaja. Tirania juaj e bëri atë të vuante, dhe unë jam e zemëruar me ju për atë që i bëtë atij. A mendoni se është e tepërt që të zemërohem se keni ngritur shpatën kundër Osmanit?”<sup>378</sup>

Edhe pse Aishja ishte një grua e vogël, ajo kishte një zë kumbues. Një të ngritur ajo pak zërin, dhe turma shtensionohej për një çast. Aishja e përdori shumë herë fuqinë e saj të konsiderueshme shprehëse që të arrihej paqja gjatë Ndodhisë së Devesë. Në një nga predikimet e saj të mrekullueshme, ajo tha:

“Siç është e vërtetë që unë kam të drejtën e mëmësisë mbi ju, unë kam të drejtë edhe t’ju këshilloj.”

Ajo shpjegoi se qëllimi i saj ishte vendosja e paqes - ajo foli për të mirat që Zoti i Plotfuqishëm i kishte dhuruar asaj për shkak të të Dërguarit të Allahut, dhe përpjekjeve të babait të saj për të siguruar drejtësinë gjatë kalifatit të tij.

Ajo iu referua atyre me mirënjohje:

<sup>376</sup> Ibni Abdirabbi, *el-ikdul Ferid*, 2/206; Kalkashandi, *Subhul Aishe*, 1/248; Nuvejri, *Nihajatul Arab*, 7/230.

<sup>377</sup> Ebu Hajjan, *imta*, 511; Ibni Tajfur, *Balagatul Nisa*, 5; Buti, *Aishe*, 81.

<sup>378</sup> Ibni Kethir, *el-bidaje*, 7, 232.

“Siç e dini, mua, vetëm ata që rebelohen kundër Allahut, mund të më akuzojnë. I Dërguari i Allahut ndërroi jetë, ndërsa ai e kishte kokën në gjirin tim. Unë jam njëra nga gratë e tij në qiell. Zoti im më ka përgatitur posaçërisht për Të, duke më mbrojtur dhe siguruar mua nga çdo e keqe. Ju e dini që unë besoj me të vërtetë, dhe hipokritët u përpoqën të shkaktojë mosmarrëveshje midis jush. Sepse për shkakun tim, Allahu i Plotfuqishëm dha për ju lehtësimin e marrjes abdes me pluhur të pastër. Ju e dini që babai im ishte një nga dy personat, i treti i të cilëve ishte Allahu. Ai ishte myslimani i katërt. Ai pat marrë titullin Besnik. I Dërguari i Zotit ishte i kënaqur me të ndërsa ai ishte duke vdekur, dhe kjo me siguri i dha forcë atij për kalifatin. Kur uniteti i Islamit u trondit, ishte ai që i mbledhi të dy palët së bashku dhe i forcoi ato më tej. Por, fitneja ishte vendosur, dhe disa u bënë jobesimtarë pasi kishin besuar.”

Këto predikime lanë një përshtypje të thellë mbi gjithë dëgjuesit. Populli i Basrës u nda në dy pjesë, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre hoqi dorë së mbajturi qëndrim kundër saj. Ata që e kishin dëgjuar predikimin e saj, më vonë thanë se ata kurrë nuk kishin dëgjuar më parë një fjalim të tillë, kaq të qartë dhe të thukët, kështu që hoqën dorë nga bindja ndaj Osman ibni Hunejfit, i cili kishte qenë në krye të tyre.

## Mjekësia

Aishja kishte përvojë edhe në fushën e mjekësisë. Natyrisht krahasimi i mjekësisë së asaj kohe me shkencën e mjekësisë në periudhën moderne dhe paramoderne është i pamundur. Kurat merreshin kryesisht duke përdorur përzierje të ndryshme barërash, nga bimët dhe kafshët. Zakonisht, një marrëdhënie mjeshtër-nxënës ishte e nevojshme për transferimin e kësaj dijeje në brezat e ardhshëm. Ata që kishin njohuri për këtë shkencë ua dorëzonin njohuritë dhe përvojën brezave të ardhshëm, e kështu me radhë.

Por Aishja ishte e pazakontë në sensin që ajo as nuk mori një edukim në mjekësi, e as nuk kishte qenë nxënëse e ndokujt. Mjeku më i njohur i kohës së Aishes ishte Harith ibn Kaldai, i mbiquajtur "doktori i popullit arab."<sup>379</sup> Gratë ishin të njohura për aftësitë e tyre për të kuruar fëmijët e vegjël. Duke parë gjendjen e përgjithshme të shoqërisë, shohim se ka pasur një ndarje të detyrave mes burrave dhe grave. Ndërsa burrat luftonin në fushë beteje, gratë ndërmerrnin detyrën e trajtimit të të plagosurve. Meqenëse Aishja kishte qenë e pranishme në shumë beteja, nuk është aq e vështirë të mendohet se si përvojat kanë ndikuar mbi një intelekt të mprehtë si të sajën.

Aishja, me një shpejtësi dhe kureshtje karakteristike, kurrë nuk e harronte atë që ajo e kishte dëgjuar ose parë, dhe nuk ishte e qetë derisa pyetjet e saj të merrnin përgjigje. Aishja hetonte gjithçka që ndodhte rreth saj.

Shtëpia e Profetit ishte një shkollë shumëfunktionëse. Jo vetëm që ajo e ndoqi dijen, por edhe dija erdhi tek ajo. Kjo ishte mënyra se si ajo e mësoi mjekësinë. Informacioni i saj përbënte lajm dhe njerëzit vinin për ta pyetur atë për shumë gjëra. Sigurisht, ka pasur disa njerëz, madje edhe në mesin e të afërmit të saj, të cilëve u dukeshin të çuditshme njohuritë e saj rreth mjekësisë, dhe e pyesnin se si i kishte marrë ajo gjithë ato njohuri. Urve ibn Zubejri, djali i motrës së saj të madhe, Esmasë, erdhi një ditë tek Aishja dhe e pyeti:

“O nëna ime e dashur, unë kurrë nuk jam habitur në lidhje me inteligjencën tënde, thellësinë e njohurive, të kuptuarit dhe kujtesën, sepse unë kam thënë me vete: ‘Ajo është gruaja e të Dërguarit

---

<sup>379</sup> Buhari, *uasaja*, 2; *feraiz*, 6.



të Zotit dhe e bija e Ebu Bekrit,' dhe e kam konsideruar këtë më setë natyrshme. Mua kurrë nuk më janë dukur të çuditshme njohuritë tuaja rreth poezisë apo historisë, dhe i kam pranuar ato duke thënë: "Ajo është vajza e Ebu Bekrit, më të diturit tënjëzëz dhe dijetar i kurejshëve. Por unë nuk arrij t'ipërkap njohuritë tuaja rreth mjekësisë. Të lutem më thuaj, si e ke mësuar atë zanat dhe ku e keni marrë shkollimin për të?"

Aishja e vendosi dorën në supin e tij dhe i tha:

"O Urveja im, gjatë ditëve të fundit të jetës së të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), ai u sëmurve kaq shpesh sa që kishtëpërreth grupe të tëra mjekësh, si arabë ashtuedhe persianë, të cilëtvinin tek ai për t'i bërë lloje të ndryshme trajtimesh. Aplikimi i kurave ishte detyra ime dhe unë i kam praktikuar ato në trupin e të Dërguarit të Allahut. Ky është burimi i dijes sime."<sup>380</sup>

Sipas vetë thënieve të saj, Aishja i kishte mësuar metodat e trajtimit nga një varg burimesh dhe i zbatonte ato sa herë që të ishte e nevojshme. Shumë njerëz kërkonin të përfitonin nga përvoja e saj, dhe i referoheshin asaj sikur të ishte autoriteti mjekësor i kohës. Por është gjithashtu e mundur të thuhet se kjo çështje mbeti në plan të dytë, sepse gjatë periudhës së trazirave sociale, nevoja për të kërkuar dhe për t'i vënë në zbatim njohuritë fetare të Aishes ishte më parësore. Në një rast ne shohim Urven të ankohej për faktin se Aishja u pyet kaq shpesh në lidhje me shkencat fetare sa që nuk kishte kohë për shkencat mjekësore, dhe vëllime të pallogaritshme të informacionit rreth mjekësisë humbën me vdekjen e saj.<sup>381</sup>

### **Nxënësit e saj**

Aishja kishte një talent të veçantë për përçimin e informacionit e saj edhe te të tjerët. Duke mos pasurasnjë fëmijë të saj in për të rritur dhe edukuar, ajo ishte nëna e të gjithëve. Ajo gjente jetimë dhe njerëz në nevojë, dhe luftonte për t'i edukuar të gjithë anëtarët e dobishëm të shoqërisë. Ajo jo vetëm plotësonte nevojat e tyre materiale, por edhe synonte t'i shndërronte ata në nga një vitrinë të dijes.

Gjatë asaj periudhe, Medina ishte zemra e botës myslimane në aspektin e njohurive. Dijetarja kryesor i këtij qyteti ishte Aishja, e cila u vizitua aq shpesh nga të gjithë ata që kërkonin njohuri që i përkisnin lëmenjve nga më të ndryshmit. Kur shkoi ajo në Mekë për të kryer haxhin, në mes të maleve të Hiras dhe Sabirit, dhe populli e vizitonte atë atje dhe kthehej i sqaruar për çdo mëdyshje që e ngacmonte kahera.<sup>382</sup>

Aishja, e cila i përdori të gjitha ditët e saj në tokë për të mësuar dhe nxënë sa më shumë, mësoi shumë të rinj, në fusha të ndryshme, kryesisht në fushën e hadithit. Është falë përkushtimit të saj në dije, që përpara çdo myslimani janë në dispozicion deri në Ditën e Fundit.

Dera e saj rrinte e hapur për të gjithë, si për njerëzit e lirë ashtu edhe për skllevërit, që nga të afërmit e afërt e deri tek atamë të largmit, me kusht që secili duhet të respektonte pikat themelore të fesë. Ata vinin pranë saj që të dëgjonin me vëmendje të madhe mësimet që ajo jepte, dhe iknin me qëllimin e mirë dhe të vetëm, që t'ua përcillnin ato edhe të tjerëve.

Në lidhje me çështjet fetare, Aishja ka ndjekur një mënyrë pune të tillë që kushdo të mund ta kuptonte, dhe i përgjigjej pyetjeve me një shpjegim të lehtë që çdokush mund t'i kuptonte lehtësisht. Kur ajo shihte që dikush ishte i turpshëm për t'i bërë asaj ndonjë pyetje të caktuar, ajo i inkurajonte

<sup>380</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/67; Hakim, *Mustedrek*, 4/218.

<sup>381</sup> Dhehebi, *sijer*, 2/183.

<sup>382</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/40; Ibni Sa'd, *tabakat*, 5/595; 8/68.

ata dhe ua bënte më të lehtë të pyeturit dhe të mësuarit për ndonjë gjë që ata e mbanin të fshehur përbrenda.<sup>383</sup>

Aishja ishte zanafilla e një valë dijeshe e cila do të arrinte tek më shumë njerëz dhe do të bëhej më e vlefshme në brezat e ardhshëm.

Stili i të Dërguarit të Zotit ndjehej qartë brenda mësimeve të saj. Për vizitorët e saj të rregullt, Aishjandalej mbi çështjet në të cilat ajo kishte qenë e pranishme gjatë bisedave me Dërguarin të Zotit dhe shokëve të Tij, me po të njëjtin stil ligjërimit që kishte përdorur edhe Ai. Ajo shmange të shpjeguarit me nxitim, duke adoptuar një qëndrim të veçantë ndaj atyre që mendonin se mund të përfitonin gjithçka menjëherë që në mësimin e parë. Ajo u thoshte atyre se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk kishte vepruar asnjëherë kësimmënyre.<sup>384</sup>

Shkolla e dijes së Aishes është frekuentuar nga Omeri dhe djali i tij, Abdullah ibn Omeri, Ebu Hurejreja, Ebu Musa el Eshariu, Abdullah ibn Abasi, Abdullah ibn Zubejri dhe nga sahabë të tjerë të njohur si Amr ibn Asi, Zejd ibn Halid el Xhuheni, Rabia ibn Amr el Xhurejshi, Saib ibn Jezidi, dhe Harith ibn Abdullahu.

Dijetarët e brezit të mëvonshëm pas Profetit konkurruan me njëri-tjetrin që të përfitonin sa më shumë prej këtij burimi. Thuhet se këta dijetarë, të cilët merrnin pjesë nëpër ligjëratat e saj dhe shkonin për të dëgjuar mësimet e saj ishin rreth njëqind e pesëdhjetë vetë. Urve ibn Zubejri, Kasim ibn Muhamedi, Abdullah ibn Jezidi, Alkame ibn Kajsi, Muxhahidi, Ikrimja, Shabiu, Zirr ibn Hubejshi, Mesruk ibn Exhdai, Ubejd ibn Umejri, Said ibn el-Musajibi, Asuad ibn Jezidi, Taus ibn Kajsani, Muhamed ibn Sirini, Abdurrahman ibn Harith ibn Hishami, Ata ibn Ebi Rebahu, Sulejman ibn Jaseri, Ali ibn Hyseni, Jahja ibn Ja'mer dhe ibn Ebi Mulejke ishin disa prej tyre. Këta janë emra të shquar që ndriçuan jo vetëm brezin e tyre, por dhanë një kontribut të paçmueshëm për periudhat e mëpasme.

Ebu Amri, Zekuani, Nafiu, Ebu Junusi, ibn Farruhu, Ebu Mudile, Ebu Lubabe Meruani, Ebu Jahjai dhe Ebu Jusufi ishin skllëvër të liruar dhe ishin edhe ata në mesin e nxënësve të Aishes.<sup>385</sup>

Shkolla e saj e dijes përbëhej jo vetëm nga burrat. Në tubimet e saj, ka pasur gra të rëndësishme, të tilla si motra e saj Umu Kulthum binti Ebu Bekri, Amra binti Abdurrahmani, Amra binti Aishe binti Talha, Esma binti Abdurrahmani dhe Muadha el-Adeuije, Aishe binti Talhaja, xhesre bin Dexhaxhe, Hafsa binti Abdurrahman binti Ebu Bekër, Safija binti Shejbe, Berire, Sajibja, Merxhanja si dhe Hajra, e ëma e Hasan Basriut. Numri i përgjithshëm i grave që morën pjesë nëpër ligjëratat e saj ishte aty tek të pesëdhjetat.

Të qenët një epigon i Aishes përbënte një virtyt të veçantë. Njerëzit më të afërt të saj ia kishin zili këtë, por pa keqdashje. Pozita e Urves, nipit të saj tërhiqte vëmendjen e pothuajse të gjithëve.<sup>386</sup>

## Urve Ibn Zubejri

Urve ibn Zubejri ishte i ri, i lindur në vitin e njëzet e tretë të kalendarit islam, gjatë vitit të fundit të kalifatit të Omerit. Ai e kërkoi diturinë që në fëmijërinë e hershme. Ne mund ta vërejmë tek ai dëshirën për t'u bërë një vitrinë e dijes në të cilën njerëzit mund të përfitojnë, në kohën kur ai dhe tre shokët e tij, me të cilët u takua në Hixhr, ngjitur me Qaben, ishin duke folur për të ardhmen.

<sup>383</sup> Ibni Maxhe, *taharet*, 111; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/97, 265.

<sup>384</sup> Buhari, *menakib*, 20.

<sup>385</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/32, 258; Tirmidhi, *daauat*, 129.

<sup>386</sup> Ibni Haxher, *tahzibu tahzib*, 12/463.

Edhe pse Musab ibni Zubejri, Abdullah ibni Zubejri dhe Abdullah ibni Omeri kishin secili dëshira të ndryshme, ai u lut:

“O Zoti im, dhuromë mua dije që njerëzit të përfitojnë nga ajo pas vdekjes sime.”<sup>387</sup>

Ndoshta si rezultat i lutjes së tij, më vonë brenda një kohe të shkurtër, ai u bë njëri prej dijetarëve të Medinës, duke qenë i respektuar nga të moshuarit, pavarësisht moshës së tij të re. Ai qëndroi gjithmonë pranë Aishes, vështirë se e linte atë ndonjëherë vetëm, duke u përpjekur për të marrë sa më shumë informacion prej saj. Kabisa ibni Zuejbi është shprehur:

“Sigurisht Urveja ishte njëri ndër ne që i njihte më mirë se kushdo tjetër njohuritë e Aishes rreth hadithit, sepse ai ishte i vetmi ndër ne që ka hyrë në praninë e Aishes pa asnjë vështirësi.”<sup>388</sup>

Ibn Shihab Dhuhri, edhe ai vetë një lider në shkencën e hadithit, është shprehur rreth njohurive të Urves duke e përshkruar atë si një oqean, fundi i të cilit ishte i paarritshëm.<sup>389</sup>

Vetë Urveja ka thënë:

“Gjatë katër ose pesë vjetëve të fundit të Aishes, mendoja me vete, "Në qoftë se nëna jonë Aishja, ikën nga kjo botë, nuk ekziston asnjë hadith në thesarin e saj të çmuar të diturive të cilin unë të mos e di.”<sup>390</sup>

Një ditë, Urve ibn Zubejri dhe i biri i tij, Muhamedi, shkuan për të vizituar Velid ibni Abdulmalikun. Ata ishin në hambar, kur kuajt e trembur dolën të gjithë jashtë kontrollit. Muhamedi vdiq atje, gjatë asaj rrëmuje. Vetë Urveja mori një goditje në këmbën e tij, e cila më vonë u desh të pritej për shkak se plaga iu kthye në gangrenë. Edhe pse ai në fillim nuk ishte dakord, ai mori parasysh këshillën e kalifit Velid. Guximi që tregoi ai, ndërsa këmba e tij po i këputej përpara syve të tij pa anestezi, ishte mbresëlënëse. Kur operacioni përfundoi, ai lexoi kuptimin e ajetit: “*Ne patëm ca vështirësi në këtë udhëtim tonin.*” Askush nuk e mbante atë, derisa në fund, i ra të fikët.

Kur erdhi në vete, ai fshi u djersën nga balli i tij dhe u kërkoi atyre që ishin atje për t’ia dhënë këmbën e këputur. Ndërsa e mbante atë në duar, tha:

“Betohem në Zotin, i cili më ka lartësuar mua duke ecur me ty, se unë nuk u futa as edhe në një mëkat me ju e as eca drejt tij.”<sup>391</sup>

Pastaj njerëzit rreth tij e dëgjuan të lutej:

“O Zoti im! Kam pasur katër gjymtyrët, dy duar dhe dy këmbë. Ti më more një prej tyre dhe më le mua tre të tjera, sigurisht, si gjithmonë, falënderimi qoftë mbi Ty! Unë kisha katër djem. Ti më more njërin prej tyre dhe me le mua edhe tre të tjerë, sigurisht, si gjithmonë, falënderimi qoftë mbi Ty! A nuk janë ata të cilët bëhen të përjetshëm, pasi je Ti Ai që i merr?”<sup>392</sup>

Urvja kishte trashëguar mjaft nga virtytet e përsosura të Aishes, si bujarinë dhe adhurimin. Ishte ai që i përcolli zakonet e saj të adhurimit për brezat e ardhshëm. Ai i kalonte netët e tij duke lexuar Kuran, duke e përfunduar çerekun e tij në një natë të vetme si dhe duke qëndruar për periudha të gjata në namaz. Edhe pasi këmba e tij ishte këputur, Urve kurrë nuk e shkurtoi namazin. Vetëm një natë ai nuk qe në gjendje ta kalonte natën në namaz dhe duke recituar Kuran - natën kur iu hoq këmba- por ai e plotësoi adhurimin natën tjetër. Ai nuk dëshironte kurrë të humbiste vendin e tij në

<sup>387</sup> Ebu Nuajm, *Hiljetul Eulija*, 1/309; 2/176; Ibni Asakir, *Tarihu Dimeshk*, 40/267.

<sup>388</sup> Ibni Haxher, *tahzibu tahzib*, 12/463.

<sup>389</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 5/181.

<sup>390</sup> Ibni Haxher, *Tahzibu tahzib*, 7/165; 12/463.

<sup>391</sup> Ibni Asakir, *Tarihu Dimeshk*, 61/410.

<sup>392</sup> Ebu Nuajm, *Hiljetul Eulija*, 2/179.

rangun shpirtëror. Ai e këshillonte familjen e tij të lutej gjatë gjithë kohës. “Kur ndonjë nga ju sheh diçka që i pëlqen në këtë botë, duhet të shkojë menjëherë në shtëpi dhe të këshillojë personat e familjes për të kryer namazin, ju duhet të anoni drejt adhurimit, sepse Allahu i Plotfuqishëm e këshillon Profetin e tij: *“Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarë), e për t’i sprovuar me të, sepse shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe është i përjetshëm”*<sup>393</sup>.

Në lidhje me Urven, i biri Hashimi ka thënë:

“Babai im ka agjëruar gjatë gjithë jetës, madje edhe ditën që vdiq ishte me agjërim.”<sup>390</sup>

Urveja trashëgoi gjithashtu edhe bujarinë e Aishes. Në sezonin kur vilesnin hurmat, ai i këpuste ato nga pemët, i shpërndante ato në murin e tij dhe i ftonte njerëzit të hynin në kopshtin e tij për të marrë ca kokrra. Njerëzit vinin nga e gjithë bota për të vizituar shtëpinë e tij dhe askush nuk largohej duarbosh. Kurdo që ai hynte në kopshtin e tij thoshte: *Mashaallah!* dhe pastaj recitonte ajetin: *“Çfarë dëshiron Allahu bëhet, s’ka fuqi pa ndihmën e Tij!”*<sup>394</sup>

Fjalët e mëposhtme të cilat shprehin gjithë thellësinë e shpirtit të tij, janë mjaft domethënëse:

“Kur shihni dikë duke bërë një vepër të mirë, dijeni se aty pranë tij ndodhen shumë vëllezër të vullnetit të mirë. Në mënyrë të ngjashme, nëse shihni dikë duke bërë një vepër të keqe, dijeni se aty pranë tij ndodhen shumë vëllezër të tij vullnetkëqinj. Kështu, nëse një vepër e mirë është pararendëse e veprave të tjera të mira, një vepër e keqe është një shenjë e veprave edhe më të këqija.”

Urve vdiq në vitin e nëntëdhjetë e katërt të kalendarit mysliman. Meqë pati edhe shumë dijetarë të tjerë, të cilët e filluan udhëtimin e tyre të përjetshëm në të njëjtin vit, ai filloi të quhej ‘viti i dijetarëve të fikhut’<sup>395</sup>.

## Kasim Ibni Muhamedi

Meqenëse babai i tij kishte rënë dëshmor, Kasim ibn Muhamedi u rrit pranë Aishes, dhe të gjitha njohuritë i fitoi në praninë e saj. Ajo u kujdes për atë, e mori nën mbrojtjen e saj që nga fëmijëria e hershme, dhe u kujdes personalisht për arsimimin e tij. Aishja madje ia priste flokët dhe e vishte atë bukur në ditët e Bajramit. Por trashëgimia më e rëndësishme që Aishja i la atij ishte me siguri dituria. Është thënë se Kasimi, së bashku me Urven dhe Amrën, ishte një prej tre njerëzve që e kishin përvetësuar plotësisht diturinë e gjerë të Aishes mbi hadithin.<sup>396</sup> Në të njëjtën kohë, ai ishte shumë i thjeshtë. Ai nuk parapëlqente të konsiderohej si i rëndësishëm, dhe nuk e mendonte asnjëherë veten më lart se të tjerët.

Një ditë, dikush nga Badija e pyeti nëse ai ishte më i ditur se dijetari i famshëm Selimi apo jo. Kasim ibn Muhamedi nuk dëshironte, as të lartësonte Selimin nëpërmjet një thjeshtësie false, e as t’i jepte rëndësi vetes duke u mburrur. Në përgjigje të këmbënguljes së njeriut, Kasimi tha atij të shkonte e t’ia bënte këtë pyetje Selimit.<sup>397</sup>

Ashtu si Urveja, edhe Kasimi ka jetuar pa kërkuar asgjë nga njerëzit e tjerë dhe nuk pati as më të voglën prirjeje ndaj çdo sjelljeje që mund të dëmtonte moralin dhe seriozitetin e tij. Një ditë, Omer ibni Ubejdullahu i dërgoi atij një mijë dërrhemë, por ai ia ktheu të gjitha. Disa njerëz këmbëngulën se

<sup>393</sup> Ta’ha, 131.

<sup>394</sup> Kehf, 39.

<sup>395</sup> Ibni Sa’d, *tabakat*, 2/180.

<sup>396</sup> Ibni Haxher, *Tahzibu tahzib*, 8/300.

<sup>397</sup> Po aty.

ai duhet të mbante të paktën njëqind prej tyre, por qëndrimi i tij nuk ndryshoi asses. Kasimi nuk do të përvetësonte as edhe një grimcë nga çdo mirësi që i ofrohej.

Kalifi i asaj kohe, Omer ibn Abdulazizi e trajtonte Kasimin me respekt të madh dhe u kujdes për të gjatë gjithë jetës së tij. Ai madje dëshironte ta rekomandonte emrin e Kasimit si një kandidat për kalif pas tij, dhe nuk ngurroi madje që ta deklaronte haptazi këtë.<sup>398</sup>

Kur Kasimi i pa njerëzit duke spekuluar në lidhje me interpretime të ndryshme rreth kaderit, ai i paralajmëroi ata:

“Ju gjithashtu duhet të silleni me kujdes në pikat që Zoti nuk i ka shfaqur haptazi.” Ai i interpretoi mosmarrëveshjet e njerëzve të cilët kishin jetuar para tij, kryesisht sahabëve, si mëshirën e madhe të Allahut për brezat e ardhshëm.<sup>399</sup> Kur ai humbi shikimin në moshën shtatëdhjetë vjeçare, thirri pranë tij të birin, sapo vuri re se vdekja i ishte afruar dhe ia shprehu atij amanetin e vet:

“Përdor rrobat me të cilat jam falur duke përfshirë këmishën, *izarin* dhe *Rida*-në time si qefin.”

I biri e pyeti:

“O babai im i dashur, përse të mos përgatisim dy copa qefin të zakonshëm për ty?” Përgjigjja e tij ishte e njëjtë me atë të Ebu Bekrit, të cilin ai e konsideronte si shembull:

“O biri im i dashur, Ebu Bekri e la këtë botë me tri copa të veshjes së tij. Mos harro se të gjallët kanë më tepër nevojë për rroba sesa të vdekurit.”<sup>400</sup>

### **Amra Binti Abdurrahman**

Amra binti Abdurrahman ishte motra e Esad ibn Zuraes të fisit Beni Nexhar, një nga udhëheqësit e ensarëve, si dhe mbesa e Zurare ibni Sadit. Ajo ishte një e afërme e të Dërguarit të Zotit nga ana e nënës së Tij.

Aishja, pasi e mori Amrën dhe vëllezërit e motrat e saj nën mbrojtjen e vet, e shndërroi këtë familje në një familje dijetarësh të shquar në të ardhmen. Ajo ndjehej përgjegjëse për përhapjen e njohurive që kishte akumuluar gjatë epokës së të Dërguarit të Zotit, në mesin e fëmijëve talentin e të cilëve ajo e kishte vënë re që më parë.

Ashtu si vëllezërit e motrat e saj, Amra e vlerësonte mjaft konsideratën e Aishes, ndaj zuri vendin e saj në histori si dijetare kryesore e kohës së saj. Dijetari i njohur ibni Medini ka thënë: "Amra ishte ndër dijetarët më të besueshëm, të cilët e njihnin gjithë bagazhin e hadithit të Aishes", dhe "Amra binti Abdurrahmani e ka njohur mirë këtë fushë dhe kishte vizionin e pabesueshëm për të përvetësuar dhe kuptuar prej njohurive të Aishes.

Ibni Hibani ka thënë: "Ajo ishte më e ditura e njerëzve rreth dijes së hadithit të Aishes." Sufjan e ka quajtur atë "personi më i mirinformuar e cila i kuptonte më mirë se kushdo njohuritë e Aishes për hadithin.

Bashkohësit e donin shumë. Kushdo që ishte i interesuar për Aishen, ishte gjithashtu i interesuar edhe për të. Të gjithë e shfaqnin dashurinë e tyre me dhurata. Por ajo i dërgonte këto dhurata tek

---

<sup>398</sup> Dhehebi, *Tedhkiratul Hufadh*, 1/97.

<sup>399</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 5/181.

<sup>400</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 5/204.

njerëzit në nevojë, ashtu siç e kishte mësuar nga Aishja. Dhe ajo kurrë nuk e kthente duarbosh dërguesin.<sup>401</sup>

Detyra e korrigjimit të gabimeve në interpretim, pas Aishes, i ra Amrës. Ajo korrigjonte gjykime dhe përpiquej për të shpjeguar të vërtetën, së bashku me arsyetimin përkatës.<sup>402</sup>

Një ditë, Kasim ibni Muhamedi e pyeti Imam Dhuhriun:

“Unë po të shoh se je shumë i etur për të mësuar. A dëshiron të të tregoj një enë të mbushur plot me njohuri?”

“Po.”

“Ti duhet të shkosh menjëherë për tek Amra bint Abdurrahmani, sepse ajo është mësuar nga Aishja.”

Dhuhriu, i cili shkoi tek Amra bint Abdurrahman pas rekomandimit të Kasim ibn Muhamedit, më vonë tha:

“E kuptova menjëherë se ajo ishte si një oqean, të cilit nuk mund t’i gjendej fundi.”<sup>403</sup>

Në periudhën kur ka jetuar Amra sigurisht kishte edhe shumë njerëz të tjerë që kërkonin dituri, por ajo qëndronte mbi të gjithë. Kur ajo i hapi sytë në këtë botë, Aishja ishte pranë saj; që nga fëmijëria e hershme, ajo u rrethua nga thesari i çmuar i ditorisë dhe informacionit të Aishes. Amra ishte një nga të paktit njerëz që ndoqën rrugën e Aishes në kërkimin e dijes dhe në zbatimin e saj në jetë, e veçanërisht në shkencat e hadithit dhe fikhut. Ajo ka transmetuar hadithe nga shumë personalitete, madje edhe nga Umu Seleme, dhe ajo që është më e rëndësishmja mes tyre, Aishes së nderuar.

Në një kohë kur informacioni i saktë kërkohej vazhdimisht, njerëzit e vizitonin atë shumë shpesh. Ajo e ktheu shtëpinë e saj në një medrese, një vend të mësimdhënies dhe të të nxënit, duke arsimuar kështu shumë nxënës.

Ajo ndërroi jetë në vitin e nëntëdhjetë e tetë të kalendarit islam. Vdekja e saj shkaktoi trishtim të madh në mesin e dijetarëve dhe njerëzve të cilët ishin vazhdimisht në kërkim të dijes që ajo kishte lënë prapa si trashëgim. Kalifi Emevit, Omer ibn Abdulazizi, i cili kishte treguar një respekt të veçantë për Amrën, ndërsa ajo ishte ende gjallë, dhe këshillohej me të në çështjet që ishin të paqarta tha:

“Askush nuk ka mbetur mes nesh, që ta njohë plotësisht diturinë e Aishes rreth hadithit, pas vdekjes së Amrës.”

Ai caktoi një ekip njerëzish për të kërkuar për çdo informacion, rreth hadithit apo zbatimit të tij, që ajo ua kishte lënë brezave të ardhshëm.<sup>404</sup>

## **Muadhe El Adeuije**

Muadha el Aveuije, e njohur me pseudonimin Umu Sahba, ishte e veja e Sile ibni Eshjemit, i cili ishte vrarë në një fushë beteje pranë Kabilit së bashku me djalin e tij, Sahban. Muadha, e cila kishte trashëguar sjelljen e mirë dhe njohuritë e Aishes, kishte një forcë të tillë karakteri, sa që pasi dëgjoi

---

<sup>401</sup> Buhari, *edebul mufred*, 1/382.

<sup>402</sup> Malik, *muuatta*, Hudud, 11.

<sup>403</sup> Dhehebi, *Tedhkiratul Hufadh*, 1/112; *A'lam*, 4/508; 5/347.

<sup>404</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/480; Dhehebi, *sijer*, 4/507, 508.

lajmin për vdekjen e burrit dhe djalit të saj, ajo iu kthye me këto fjalë grave që erdhën për t'i shprehur ngushëllimet:

“Nëse keni ardhur për të më uruar, jeni të mirëpritura. Por në qoftë se keni ndonjë qëllim tjetër, do të ishte më mirë të mos kishit ardhur.”

Kjo grua e madhe, e cila premtoi se do të kalonte jetën e saj në adhurim, rrinte zgjuar çdo natë, sidomos pas martirizimit të burrit të saj. Ajo ishte e njohur si një prej njerëzve më të devotshëm të asaj kohe. Muadha, e cila tërhoqi vëmendjen e njerëzve për shkak të thellësisë së saj të besimit dhe adhurimit, një ditë, u tha atyre që kishte përreth:

“Unë betohem në Zot se dashuria ime për këtë botë nuk është për shkak se unë dëshiroj për vete begati, kënaqësi apo lumturi. Unë betohem për Zotin, se e dua këtë botë vetëm për shkak se unë qysh këtu dëshiroj t'i afrohem më pranë Zotit tim. Në këtë mënyrë, unë shpresoj se Zoti i Plotfuqishëm do të më lejojë të takohem me tim bir dhe Ebu Sahban në qiell.”<sup>405</sup>

Ajo falte namaz nga mbrëmja deri në mëngjes, dhe kur ajo ndjente përgjumje ose përtesë, endej paksa rreth e rrotull për t'i dhënë vetes pak energji, dhe thoshte me vete:

“O egoja im! Këtu gjumi është më i drejtë për ty, nëse i dorëzohem nefsit, duhet të di se do të fle në varrin tim për shumë më tepër kohë. Por ka një ndryshim - ky gjumë do të më sjellë ose mall me keqardhje ose lumturi me mëshirë.”<sup>406</sup>

Kur çasti i vdekjes iu afrua dhe shenjat e saj filluan të shiheshin, ata që ishin afër saj panë se ajo qau me dhimbje të madhe, dhe pastaj buzëqeshi. Ata e pyetën:

“Përse qave dhe tani po qesh?”

Po mendoja se sëmundja ime do të më mbajë larg nga namazi, agjërimi dhe përkujtimi i Zotit, kështu që e ndjeva veten të trishtuar, e sakaq fillova të qaja. Ndërkohë, Ebu Sahba, i veshur me një cohë të gjelbër dy-copash, së bashku me një grup njerëzish u shfaq në kopsht. Betohem në Zot, se kurrë nuk kam parë bukuri si të tyren në këtë botë, kështu që buzëqesha nga gëzimi. Unë nuk mendoj se do të jem këtu edhe për një namaz tjetër.

Ashtu siç e kishte parashikuar, Muadha el Adauia vdiq atë ditë, në vitin e tetëdhjetë e tretë të kalendarit islam, përpara se të vinte koha për namazin tjetër.<sup>407</sup>

## MOSHA E MARTESËS SË AISHES ME PROFETIN TONË TË DASHUR

Kur studion jetën e Profetit, një nga temat më të debatueshme është ajo e moshës së Aishes kur u martua me Të. Mosha e re e supozuar e saj ka qenë përdorur në fushatat e panumërta të shpifjeve kundër Profetit.

---

<sup>405</sup> Ibnul Xhezui, *sifatu Safua*, 4/23.

<sup>406</sup> Po aty, 4/22.

<sup>407</sup> Po aty.

Raportimet që tregojnë se Aishja binti Ebu Bekër ishte 6 apo 7 vjeçe kur ajo u fejua dhe 10 vjeçe kur u martua, kanë qenë faktori bazë në formulimin e pikëpamjeve rreth moshës së saj të martesës. Gjithashtu, nuk duhet harruar se faktorë të tillë si praktikat e ngjashme që ishin mjaft të përhapura në atë kohë, si dhe zhvillimi fizik i fëmijëve i cili plotësohej në një moshë më të hershme në ato kohë, gjithashtu kontribuan në përhapjen e kësaj pikëpamjeje. Për këtë arsye, kjo temë nuk është bërë kurrë një çështje për debat deri përpara pak kohësh.

Orientalistë të cilët nuk marrin në konsideratë kushtet e periudhës kohore në të cilën një veprim ka ndodhur dhe të cilët e shqyrtojnë Islamin nga "jashtë", e kanë kthyer këtë çështje në një çështje aktuale e të debatueshme. Reagimi i botës myslimane për këtë shumësi pikëpamjesh ka qenë i përzier. Ndërsa disa kanë ngulur këmbë se mosha e lartpërmendur e Aishes në martesë është e saktë, të tjerët janë të mendimit se Aishja, asokohe, ka qenë më e madhe në moshë. Në këtë situatë, kur nuk është gjithmonë e mundur që të mbahet një qëndrim i ekuilibruar, qëndrime të ndryshme janë përhapur si përgjigje ndaj pretendimeve të orientalistëve, duke përfshirë edhe ato teprime, pra ata që zgjedhin të mohojnë raportimet apo ata që injorojnë ekzistencën e alternativave të tjera si përgjigje ndaj këtyre pikëpamjeve.

Para së gjithash, duhet të dihet se gjithkush është një fëmijë i kohës në të cilën jeton dhe për këtë arsye ai duhet të vlerësohet në përputhje me kontekstin kulturor të kohës përkatëse. Ekzistojnë vlera të caktuara të cilat përbëjnë zakonet e një shoqërie dhe kur një shoqëri merret në shqyrtim, këto vlera duhet të merren në konsideratë. Përndryshe, në qoftë se ne bëjmë përpjekje për t'i vlerësuar ngjarjet historike në kontekstin e kushteve të sotme, duhet të dimë se do jemi të detyruar të bëjmë gabime.

Është fakt i njohur se gjatë kohës së Profetit, vajzat e reja janë martuar në një moshë të hershme dhe se diferenca në moshë nuk ishte e rëndësishme në martesë.<sup>412</sup> Sidomos për sa i takon vajzave të reja, nuk duhet harruar se ka ekzistuar një lloj trysnie sociale për këtë, se ato piqeshin më herët për shkak të kushteve klimatike dhe gjeografike, dhe se ato janë parë si plaçka që nevojitej të rriteshin në shtëpinë e burrit të tyre. Për më tepër, kjo çështje nuk ishte e lidhur vetëm për vajzat; edhe djemtë i martonin që në moshën 8, 9 apo 10 vjeçare dhe ata bëheshin kështu kryetarë të një familjeje në një moshë që sot perceptohet si shumë e vogël.<sup>413</sup> Ndoshta është kjo kulturë që qëndron në thelbin e kësaj çështjeje e cila ka bërë që një problem i tillë të mos merrej parasysh në konsideratë deri në kohët e fundit. Përndryshe, do të ishte e pamundur për një mentalitet që ka dashur të krijojë një stuhi në lidhje me martesën e Profetit me Zejneb bint Xhahshin, dhe që ka shpifur për Aishen pas kthimit të saj nga ekspedita Murajsi, të mos e kritikonte një çështje të tillë në atë kohë.

Në ajetet e Kuranit që u shpallën në të njëjtën kohë, mosha për martesë u përmend dhe u theksua se fëmijët duhet të martohen, kur ata të piqen fizikisht.<sup>414</sup> Pra, kundërshtimi i një propozimi hyjnor nuk mund të vihej në diskutim. Nëse do ishte vepruar me mentalitetin e Omerit, në qoftë se këtu do të nevojitej ndonjë ndërhyrje, Profeti do me siguri do të ishte paralajmëruar për një shpallje të ardhshme dhe kështu do të ndërmerrej një hap për të zgjidhur çështjen. Në çdo rast, martesa e Profetit me Aishen u bë në përputhje me orientimin që vinte nga vullneti hyjnor.<sup>408</sup>

Duke lënë mënjanë teprimet, dhe duke përdorur kriteret e moderuara, burimet që lidhen me moshën e martesës së Aishes janë shqyrtuar si më poshtë:

1. Ndërsa renditen emrat e myslimanëve gjatë ditëve të para të Islamit, emri i Aishes, së bashku me atë të motrës së saj më të madhe, Esmanë, janë të shënuara menjëherë pas emrave të Sabikun el

---

<sup>408</sup> Buhari, *tabir*, 21; *menakibul Ensar*, 44.



euelun (të parët) si: Osman ibn Afani, Zubejr ibni Auami, Abdurrahman ibni Aufi, Sad ibni Ebi Uakkasi, Talha ibni Ubejdullahu, Ebu Ubejde ibn Xherrahu, Erkam ibni Ebi'l Erkami dhe Osman ibni Madhuni. Duke qenë personi i tetëmbëdhjetë që pranoi Islamin, emri i Aishes i paraprin emrave të Umejir ibni Ebi Uakkasit, Abdullah ibni Mes'udit, Salit ibni Amrit, Xhafer ibni Ebi Talibit, Abdullah ibni Xhahshit, Ebu Hudhejfes, Suhajb ibni Sinanit, Amar ibni Jasirit, Omer ibni Hatabit, Hamza ibni Abdulmutalibit, Habab ibni Eretit, Said ibni Zejdit dhe Fatime binti Hatabit.<sup>416</sup> Kjo do të thotë se ajo ishte gjallë atëherë dhe se ishte e pjekur mjaftueshëm për të bërë një zgjedhje të tillë dhe të ushtronte vullnetin e saj. Përveç kësaj, informacioni në rrëfimet që tregon se "ajo ishte një vajzë e vogël atëherë", tregon se emri i saj përmendet në mënyrë të vetëdijshme.<sup>409</sup>

Kjo datë i referohet ditëve të para të Islamit, sepse dihet se Esmaja motra e Aishes, e cili ka lindur në vitin 595, ishte 15 vjeçe kur ajo u bë myslimane.<sup>418</sup> Kjo tregon se në vitin 610, kur Profeti ka filluar t'i vijë shpallja, Aishja ishte të paktën 5, 6 apo 7 vjeçe ato ditë, dhe se ajo ishte të paktën 17 ose 18 vjeçe kur u martua me Profetin në qytetin e Medinës.

2. Në lidhje me ditët në Mekë, Aishja thotë: "Unë isha një vajzë e vogël që luaja me lodra, kur të Dërguarit të Allahut iu shpall ajeti: 'Por jo, afati i tyre është kiameti, e kiameti është edhe më i vështirë, edhe më i hidhur'<sup>410</sup>" Ky informacion hap një dritare në lidhje më moshën e saj. Ajeti në fjalë është ajeti i 46 i sures Kamer, në kaptinën e 54-t i Kuranit, i cili shpjegon mrekullinë e hënës së ndarë më dysh. E shpallur si një e tërë, kjo sure zbriti, ndërsa Profeti ishte në shtëpinë e Ibni Erkamit në vitin e katërt (614)<sup>411</sup>, ose të tetë (618) ose të nëntë (619)<sup>412</sup> të misionit të Tij, sipas transmetimesh të ndryshme. Më tepër duke i thirrur nevojës, disa dijetarë janë fokusuar në vitin 614 për shpalljen e kësaj sureje, e nëse merret parasysh kjo datë, Aishja ose nuk kishte lindur ende, ose sapo kishte lindur. Ndërsa marrim parasysh këtë datë, duket se ajo duhet të ketë qenë e lindur të paktën tetë ose nëntë vjet përpara, dhe situata nuk ndryshon shumë, nëse merret viti 618 ose 619 si vit i shpalljes së sures Kamer. Në këtë rast ajo duhet të kishte qenë vetëm 4 ose 5 vjeçe, pra në një moshë në të cilën ajo nuk do të ishte dot në gjendje për ta kuptuar këtë ngjarje dhe për ta rrëfyer pastaj atë vite më vonë. Sipas mundësisë së dytë, ajo ka lindur ndoshta kur profetësia e Muhamedit sapo kishte filluar.

Një tjetër çështje e cila ia vlen të përmendet këtu është se ndërsa përshkruan atë ditë, Aishja thotë: "Unë isha një vajzë që luaja me lodra." Fjala që ajo përdor për të përshkruar veten, *xharije*, është përdorur në atë kohë për të përshkruar kalimin në pubertet. Nëse e studiojmë këtë çështje duke marrë vitin 614 si vitin kur Surja Kamer u shpall, Aishja do të kishte lindur të paktën tetë vjet përpara misionit profetik, në vitin 606. Në qoftë se ne pranojmë versionin e vitit 618, viti i saj i lindjes do të kishte qenë pastaj 610, dhe kjo ngjarje vetëm sa e bën të pamundur për të që të ketë qenë 9 vjeçe kur u martua.

Nëse do ta krahasonim emrin e saj me listën e emrave të myslimanëve të parë, ne do të shohim se Aishja ka lindur në vitin 606. Rrjedhimisht, ajo do të kishte qenë të paktën 17 vjeçe kur u martua.

3. Sigurisht, kujtimet e Aishes rreth Mekës nuk janë të kufizuara vetëm në këtë rast. Përveç kësaj, kujtimet e mëposhtme e vërtetojnë këtë çështje:

---

<sup>409</sup> Ibni Hisham, *sira*, 1/271; Ibni Is'hak, *sira*.

<sup>410</sup> Kamer, 46.

<sup>411</sup> Sujuti, *itkan*, 1/29, 50.

<sup>412</sup> Diferenca në moshë sipas kalendarit hënor.

a) Rrëfimet e saj që tregojnë se ajo kishte parë dy lypësa që kishin mbetur që nga viti i elefantit, e cila ka ndodhur 40 vjet përpara misionit profetik dhe është pranuar si një moment historik për përcaktimin e historisë, dhe rrëfimi i këtij informacioni vetëm motrës së saj Esmasë.<sup>413</sup>

b) Rrëfimi i saj i përshkruar në detaje se gjatë kohëve të vështira në Mekë, i Dërguari i Zotit kishte ardhur çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje në shtëpinë e tyre dhe se babai i saj, Ebu Bekri, i cili nuk mund t'i duronte këto vështirësi, u përpoq të emigronte drejt Etiopisë.<sup>414</sup>

c) Rrëfimi i saj që thoshte se së pari ishte e detyrueshme të faleshin vetëm nga dy rekate të namazeve farze dhe se më vonë kjo u ndryshua në katër rekate për banorët vendës, por që gjatë fushatave ushtarake namazet farze janë falur vetëm me dy rekate.<sup>415</sup>

d) Në raportimet për ditët e para, kanë qenë thënie të tilla si: "Ne dëgjuam se Isafi dhe Naila kishin kryer një krim në Qabe dhe për këtë arsye Allahu i ktheu ata në gur ashtu siç kishte bërë me një burrë dhe një grua nga fisi Xhurhum."<sup>416</sup>

4. Qenia e saj e rezervuar për dikë tjetër përpara fejesës me Profetin: Një tjetër faktor që mbështet pikëpamjen e mësipërme është se në kohën kur martesë e Profetit ka qenë temë diskutimi, Aishja ishte në fjalë për t'u fejuar me të birin e Adij ibni Mut'imit, Xhubejrin. Sugjerimi për Profetin, që Ai të martohej me Aishen erdhi nga Haula binti Hakimi, gruaja e Osman ibn Madhunit, një personi jashtë familjes. Të dyja këto situata tregojnë se ajo kishte arritur në moshën e martesës dhe njihej si një vajzë e re, e gatshme për martesë.

Siç dihet, kjo dhënie fjale për fejesë u prish nga familja e Ibni Adijit për shkak të ndryshimit të fesë së mundshme të djalit të tyre në Islam, dhe vetëm pas kësaj u krye fejesa midis Aishes dhe Profetit Muhamed paqja qoftë mbi Të.<sup>417</sup> Për rrjedhojë, marrëveshja e martesës është bërë më përpara, ose gjatë periudhës së misionit profetik ose kur thirrja në Islam nisi të bëhej haptazi (tre vjet pasi Profetit filloi t'i zbriste shpallja). Në qoftë se kjo ka ndodhur në momentet e para të misionit, pretendimi se Aishja ishte 9 vjeçe kur ajo u martua tronditet nga themeli i saj, e kjo nënkupton se Aishja ka lindur edhe më herët nga sa është menduar. Për këtë arsye, disa thonë se ajo ishte një vajzë 13 apo 14-vjeçare atëherë.<sup>418</sup>

Nuk duhet harruar se ky vendim është marrë gjatë periudhës kur thirrja në Islam kishte filluar të bëhej haptazi. Në lidhje me vitin, kjo do të thotë diku rreth viteve 613-614. Nëse supozohet se Aishja ka lindur katër vjet pas misionit, duhet të pranohet se ajo nuk kishte lindur ende atëherë, kështu që nuk është e mundur të flitet për një marrëveshje martesore në këto rrethana. Në këtë rast, duhet të pranohet se ajo ishte së paku 7 ose 8 vjeçe, kur marrëveshja u prish fjala me Ibni Adijin, kështu që ndoshta viti i lindjes ishte viti 605.<sup>419</sup>

Këtu, mund të përmendet edhe një mundësi tjetër, domethënë, një marrëveshje martesore e rregulluar për të ardhmen e ngjashme me "fejesën në djep" një marrëveshje kjo ndërmjet prindërve në vitet e para pas lindjes së një fëmije. Megjithatë, nuk ka asnjë të dhënë në tekstet në shqyrtim për ta konfirmuar këtë hipotezë.

5. Diferenca e moshës mes vëllezërve dhe motrave të Aishes duhet të kihet parasysh. Siç dihet, Ebu Bekri kishte gjashtë fëmijë. Esmaja dhe Abdullahu kanë lindur nga Kutajla binti Umejsi, Aishja

<sup>413</sup> Ibni Hisham, *sira*, 1/176; Hejthemi, *Mexhmatuz Zeuaid*, 3/285; Ibni Kethir, *tefsir*, 4/553; *bidaje*, 2/214.

<sup>414</sup> Buhari, *salat*, 70; Kafala, 5, *menakibul Ensar*, 45; *edeb*, 64; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/198.

<sup>415</sup> Muslim, 3/463; *Mu'xhemul Eusat*, 12/145; Ibni Hisham, *sira*, 1/243.

<sup>416</sup> Ibni Hisham, *sira*, 1/83.

<sup>417</sup> Buhari, *nikah*, 11; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/210; Hejthemi, *Mexhmuatu zeuaid*, 9/225; Bejhekiu, *Sunen*, 7/129; Taberiu, *tarih*, 3/161-163.

<sup>418</sup> Savash Rëza, *Revista e D.E. Fakulteti i Teologjisë, Çështja e katërt*, Izmit, 1995, fq. 139-144.

<sup>419</sup> Berki, Ali Hikmet, Osman Eskioğlu, *Hatemul Enbiya Hz. Muhamed ve Hayati*, 210.

dhe Abdurrahmani nga Umu Rumani, Muhamedi nga Esma binti Umejsi dhe Umu Kulthumi nga Habibe binti Harixha. Esmaja dhe Abdullahu kishin të njëjtën nënë, siç e kishin edhe Aishja me Abdurrahmanin. Dallimi mes moshave të fëmijëve me nënë të njëjtë mund të hedhë dritë mbi çështjen tonë në shqyrtim.

Vajza e parë e Ebu Bekrit, Esmaja ka lindur në vitin 595, plot 27 vjet përpara hixhretit.<sup>431</sup> Në kohën e hixhretit, ajo ishte e martuar me Zubejr ibni Auamin dhe ishte gjashtë muajshe shtatzënë.<sup>432</sup> Abdullahu, djali i saj ka lindur tre muaj më vonë në Kuba, ndërsa ajo ishte duke emigruar për në Medinë. Ajo vdiq në vitin e 73-të të hixhretit, në moshën 100 vjeçare dhe dhëmbët ende nuk i kishin rënë.

Këtu kemi një tjetër pjesë tejet të rëndësishme të informacionit. Diferenca mes moshës së Aishes dhe Esmasë, motrës së saj, ishte 10 vjet. Sipas kësaj, viti i lindjes së Aishes ishte viti 605 ( $595+10=605$ ) dhe mosha e saj në periudhën e Hixhretit ishte 17 vjeçare ( $27-10=17$ ). Meqenëse martesja e saj u bë gjashtë, shtatë apo tetë muaj pas hixhretit, ose më saktë menjëherë pas Luftës së Bedrit,<sup>434</sup> kjo nënkupton se Aishja në patë kohë ishte 17 ose 18 vjeçe.

b) Dallimi mes moshës së Aishes dhe Abdurrahmanit, vëllait të saj, është gjithashtu mjaft i rëndësishëm. Abdurrahmani u bë mysliman pas nënshkrimit të Traktatit të Hudejbijes, gjashtë vjet pas hixhretit. Ai ishte i kujdesshëm për të mos u ndeshur me babanë e tij në Luftën e Bedrit, në vitin e dytë pas hixhretit, dhe atë ditë Abdurrahmani ishte 20 vjeç.<sup>420</sup> Me fjalë të tjera, ai duhet të ketë lindur në vitin 604. Duke marrë parasysh kushtet e asaj kohe, probabiliteti që motra e një fëmije të lindur në vitin 604, të ketë lindur 10 vjet më vonë, në 614, është i ulët. Nga ana tjetër, në një kohë kur diferenca e moshës mes vëllezërve dhe motrave me të njëjtën nënë është një ose dy vjet, një diferencë e tillë prej dhjetë vjetësh ndërmjet Aishes dhe vëllait të saj duket jo bindëse.

6. Raportimet lidhur me vdekjen e Aishes janë gjithashtu të një natyre të përshtatshme për të hedhur dritë mbi këtë çështje. Viti në të cilin ajo ka vdekur është shënuar si viti i 55, 56, 57, 58 ose 59 pas hixhretit<sup>421</sup> dhe mosha e saj në atë kohë ishte 65, 66, 67 ose 74 vjeçe.<sup>422</sup> Ashtu siç nuk ka një mendim të përbashkët lidhur me datën e saj të lindjes, nuk ka asnjë mendim të përbashkët lidhur edhe me datën e saj të vdekjes. Transmetimet që thonë se ajo vdiq në vitin e 58 pas hixhretit dhe se ajo ishte 74 vjeçe kur vdiq, të japin përshtypjen se ata janë më të qëndrueshme se sa të tjerat, sepse ato japin informacione të detajuara të tilla si ditën që ajo vdiq ishte e mërkurë, dhe i korrespondonte ditës së 17-të të Ramazanit, që me kërkesën e saj, u varros natën pas namazit të vitrit në varrezat Parajsa e Përrjetshme, që përsëri me kërkesën e saj të fundit, namazi i xhenazës është udhëhequr nga Ebu Hurejre dhe se ajo ishte futur në varr nga persona të tillë si Esmaja, e motra e saj me të dy bijtë, Abdullahun dhe Urven, dy djemtë e Muhamedit, vëllait të saj, Kasimi dhe Abdullahu, si dhe djali i vëllait të saj Abdullahut, Abdurrahmani.<sup>423</sup> Prandaj, kur llogaritjet bëhen në bazë të kësaj date, ne shohim se ajo jetoi 48 vjet pas vdekjes së Profetit ( $48+10=58+13=71+3=74$ ). Kjo do të thotë se ajo ka lindur tre vjet para profetësisë së tij dhe në funksion të këtij informacioni, ajo ishte 17 vjeçe kur ajo u martua me Profetin ( $74-48=26-9=17$ ).

Në mbështetje të atyre sa thamë më lart, prania e saj në frontin e betejës në Uhud, në vitin e tretë pas hixhretit, kur madje edhe djemtë iknin larg nga tmerri, thellësia e saj në çështjet shkencore dhe

---

<sup>420</sup> Ibni Athir, *Usdul Gaba*, 3/467.

<sup>421</sup> Ibni Abdibarr, *istiab*, 2/108.

<sup>422</sup> Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/75; Nedeui, *Sirete Sejdati Aishe*, 202.

<sup>423</sup> Ibni Abdibarr, *istiab*, 2/108.

qëndrimi i matur dhe deklaratat që ajo ka parashtruar në lidhje me çështjen e shpifjes, diferenca midis moshës së saj dhe moshës së Fatimes, vajzës së Profetit; njohuritë e saj dhe ndërgjegjësimi rreth hixhretit dhe zhvillimet e mëvonshme, pas mbërritjes në Medinë, konsumimi i martesës nën sugjerimin e të atit të saj dhe pasi mehri ishte paguar<sup>424</sup>; pozita e Profetit si një udhërrëfyes në shoqëri; ndjeshmëria e Profetit dhe dhembshuria e tij atërore; dallimet në transmetimet në lidhje me datën e martesës së tyre duke mos dalë në asnjë përfundimin të njëzëshëm; përdorimi nga Aishja i shprehjes së dyshimtë "gjashtë apo shtatë" kur iu referua moshës së saj, mospërcaktimi i saktë i datës së lindjes dhe të vdekjes në shoqërinë e asaj kohe, e jo siç ndodh sot -e gjithë kjo e forcon mundësinë që ajo të ketë lindur përpara fillimit të Islamit, të jetë fejuar në moshën 14 apo 15-vjeçare dhe të jetë martuar me Profetin tonë të Dashur diku në moshën 17 ose 18-vjeçare.

Në këtë situatë, është në dorën tonë t'ia atribuojnë kuptimin "Më duket se isha" raportit "Unë isha 6 ose 7 vjeçe kur unë u fejova dhe 9 vjeçe kur u martova" dhe t'i pajtojmë këto dy shprehje. Fakti që Aishja ishte fizikisht e hollë, e forcon këtë interpretim. Ajo u ndikua nga ndryshimet fizike më shpejt dhe kishte një trup më të vogël se moshataret e saj. Ngjarjet si sëmundja e saj gjatë emigrimit në Medinë,<sup>425</sup> fakti që nëna e saj ka treguar vëmendjen të veçantë duke u përpjekur që ta shërojë,<sup>426</sup> humbja e gjerdanit të saj pas ekspeditës së Murajsit dhe koshi i mbyllur i vendosur mbi deve duke menduar se ajo ishte në të,<sup>427</sup> të gjitha këto i japin forcë këtij opinioni.

Me pak fjalë, pavarësisht nëse mosha Aishes kur u martua ishte 9, 17 apo 18 vjeçe, nuk ka asgjë të çuditshme në lidhje me të. Është e nevojshme për ta vlerësuar çdo shoqëri sipas rregullave të veta në epokën e vet. Kur hedhim sytë në shembuj të ngjashëm, vërejmë se ishte një zakon mjaft i përhapur martesë, si e djemve ashtu edhe vajzave në moshë shumë të re. Megjithatë, kur ne hedhim sytë në informacionin e mbërritur deri në ditët tona, nuk duhet të harrojmë se ky variant në lidhje me Aishen, se ajo ka lindur në vitin 605, është fejuar në moshën 14 ose 15-vjeçare dhe është martuar në moshën 17 ose 18-vjeçare, është mjaft bindës, dhe vështirë për t'u mohuar.

---

<sup>424</sup> Taberani, *kabir*, 23/25; Ibni Abdibarr, *istiab*, 4/1937; Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/63.

<sup>425</sup> Buhari, *menakibul Ensar*, 43, 44; Muslim, *nikah*, 49; Ibni Maxhe, *nikah*, 13.

<sup>426</sup> Buhari, *menakibul ensar*, 44; Muslim, *nikah*, 69; Ebu Davud, *edeb*, 55; Ibni Maxhe, *nikah*, 13; Darimi, *nikah*, 56; Taberani, *kabir*, Ibni Abdibarr, *istiab*, 4/1938; Ibni Sa'd, *tabakat*, 8/63.

<sup>427</sup> Buhari, *shehadet*, 15; *megazi*, 34; *tefsir*, 6; Muslim, *teube*, 56; Tirmidhi, *tefsir*, 4; Ibni Sa'd, *tabakat*, 2/65; Ibni Hisham, *sira*, 3/310.

## ALIU DHE AISHJA

Një tjetër gënjeshtër e fabrikuar kundër Aishes është ajo e gjoja ofendimit të saj prej Aliut, prej së cilës madje, ajo u zemërua shumë me të. Është thënë se gjoja Aishja nuk i ka folur Aliut deri në fund të jetës së saj, si rezultat i incidentit të shpifjes, për shkak të asaj që ai kishte thënë atë ditë, por gjithashtu është hedhur në hapësirë edhe varianti sipas të cilit Ndodhia e Devesë ishte rrjedhojë e këtij aludimi. Prova e vetme për këtë është përdorimi i shprehjes "njeriu tjetër", prej Aishes për t'iu referuar Aliut, si njëri prej dy njerëzve që e ndihmuan të ecte të Dërguarin e Allahut paqja qoftë mbi Të kur ai erdhi në xhami gjatë sëmundjes së Tij përfundimtare. Ata pretendojnë se Aishja nuk mund ta përmendte me gojë emrin e Aliut, për shkak të zemërimit dhe urrejtjes që ajo ndjente karshi tij.

Po cila është shkalla e vërtetë e kësaj ngatërrese? A është e vërtetë se Aishja ishte me të vërtetë e zemëruar me Aliun dhe e ofenduar prej tij? A ka ndonjë informacion ose dëshmi tjetër edhe këtu, siç kishte rreth moshës së Aishes? Cili ishte qëndrimi i përgjithshëm i Aishes, ishte e mundur që të përjetoheshin edhe fyerjet, zemërimi, urrejtja dhe hakmarrja? Si reagoonte ajo kur përjetonte gjëra të tilla?

Para së gjithash, përveç kësaj ngjarjeje, nuk ka as edhe treguesin më të vogël që të ketë pasur ndonjë situatë ofendimi mes Aishes dhe Aliut.

Së dyti, vërtetësia e shprehjeve të thëna gjoja nga Aliu gjatë incidentit të shpifjes është e dyshimtë. Këto transmetime janë të dobëta dhe do të nuk do të ishte aspak profesionale të bazohemi për një çështje të tillë të rëndësishme në një transmetim të dobët, sidomos kur ekzistojnë dëshmi më të besueshme.

Së treti, edhe pse është ende e mundur që Aliu të ishte personi i nënkuptuar me fjalët "njeriu tjetër", dijetarët e hadithit thonë se personi në fjalë mund të ketë qenë Usameja ose Fadl ibn Abasi.<sup>428</sup>

---

<sup>428</sup> Ajni, *Umdatul Kari*, 3/92, 5/188; Ibni Haxher, *Fet'h'ul Bari*, 1/263; 8/141.

Dijetarë të tjerë kanë përmendur mundësinë e dy personave të tjerëve të quajtur Burejre dhe Nuba. Thuhet gjithashtu se "njeriu tjetër" ishte një rob emri i të cilit nuk dihej.<sup>448</sup>

Ekzistojnë dy mundësi - ose kjo ngjarje ka ndodhur më shumë se një herë, ose personi i dytë i cili e mbajti për krahësh të Dërguarin e Allahut paqja qoftë mbi Të ka ndryshuar. I vetmi që nuk ndryshoi ishte Abasi, xhaxhai i të Dërguarit të Zotit, meqenëse ai ishte i afërm i Profetit, ai qëndroi pranë Tij për shumë kohë, e vazhdimisht e mbante për krahësh. Nëse ka pasur një rotacion në personin që e mbante krahun tjetër të të Dërguarit të Zotit, ai mund të ketë qenë Usamja, Aliu, Fadli, Burejra, Nuba ose ndonjë rob tjetër, emri i të cilit nuk ishte i njohur atëherë.<sup>449</sup>

Ndoshta, në vend që të përmendte emrat e të pesë njerëzve të cilët ndërronin vendet mes njëri-tjetrit gjatë të njëjtës ngjarje, Aishja e përshkruan si "njeriu tjetër", atë që ndërrohej." Prandaj, Aliu nuk ishte i vetmi emri i të cilit nuk është përmendur, kanë qenë edhe Usamja, Fadli, Burejra, Nuba dhe një rob tjetër emrin e të cilit nuk e dimë. Nuk ka gjasa që Aishja të mbante një qëndrim negativ ndaj të pesë këtyre njerëzve, gjë që e bën mungesë të përmendjes së emrit të Aliut në përshkrimin e saj jo të qëllimshëm.

Së katërti, gjatë incidentit të shpifjes, Aliu pati thënë: "O i Dërguari i Zotit, pse po e vret mendjen kaq shumë? Allahu i Plotfuqishëm të ruajtë nga përjetimi i vështirësive të mëtejshme! Ka kaq shumë gra të tjera përveç asaj! Pse nuk pyet njëherë këtë vajzën që është robinjë? Unë jam i sigurt se ajo do të të tregojë diçka që do të të bëjë të ndjehesh më mirë."<sup>450</sup> Fjalët e tij kishin një qëllim të qartë: ruajtjen e të Dërguarin të Zotit nga telashet e tij, dhe duhet të interpretohet si: "Unë jam i shqetësuar vetëm për ty, në rastin kur ti je i lënduar, çdo çështje tjetër, për mua, është dytësore." Ndoshta Aliu i dha drejtim çështjes nga Berira për të realizuar qëllimin e nxjerrjes së Aishes të pafajshme nga dikush që e njihte atë shumë mirë. Për më tepër, Aliu e njihte shumë mirë Islamin. Një muaj pasi filloi të qarkullonte shpifja ndaj Aishes, u shpall ajeti: *"E përse kur e dëgjuan atë (shpifjen) besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete e të thoshin: 'Kjo është shpifje e qartë?'"*<sup>429</sup> Këto fjalë tregojnë se besimtarët duhet të reagojnë ndaj gënjeshtreve dhe shpifjeve të pabaza. Historia na tregon se shumë nga sahabët mbajtën qëndrim të saktë ato ditë, dhe nuk ka asnjë dëshmi që Aliu të mos ishte njëri prej tyre.

Së pesti, atë ditë, Aliu ka përdorur shprehje të qarta për të mbrojtur pafajësinë e Aishes. Omeri, Osmani dhe Aliu, të cilët hynë në shtëpinë e lumturisë ndërsa i Dërguari i Allahut ishte duke folur me shokët e Tij mbi këtë çështje, e shfajësuan Aishen dhe thanë se nuk kishte asnjë dyshim se këto fjalë ishin veç shpifje. Aliu e trajtoi çështjen me vendosmëri dhe saktësi, duke e shfajësuar Aishen me fjalët e mëposhtme:

"O i Dërguari i Zotit, unë e kuptoj se ajo është e pastër dhe e pafajshme nga çdo e metë. A të kujtohet, një ditë kur po na prijë në namaz i veshur me sandale dhe në një moment ti e hoqe njërin nga sandalet. Kjo ishte diçka e çuditshme për të gjithë ne, prandaj të pyetëm vallë ishte edhe kjo një pjesë e Sunetit. Ti u përgjigje në mënyrë mohuese dhe na shpjegove se Xhebraili kishte ardhur tek ti, dhe të kishte thënë se njëra nga sandalet tuaja ishte e ndotur, andaj kjo do ta bënte të papranueshëm namazin Tënd. O i Dërguari i Allahut, në qoftë se Allahu i Plotfuqishëm të mbron në çështje të tilla kaq të vogla, a është e mundur që Ai t'ju lërë vetëm kur bëhet fjalë për familjen Tëndë?"<sup>430</sup>

---

<sup>429</sup> Nur, 12.

<sup>430</sup> Halebiu, *sira*, 2/624.

Këtu, tregohet i gjithë karakteri dhe qëndrimi i vërtetë i Aliut, dhe ashtu siç bënë edhe Omeri dhe Osmanin, edhe ai gjithashtu tha se Aishja ishte e pafajshme. Ndërsa qëndrimi i tij e kënaqi të Dërguarin e Zotit, ky qëndrim mbështetej edhe nga Kurani njëkohësisht.

Së gjashti, në të kundërt, ne jemi të detyruar të pranojmë se Aliu e besoi shpifjen rreth Aishes, edhe pse faktet historike e mohojnë këtë qartësisht. I Dërguari i Zotit i dënoi Hasan ibni Thabitin, Mistah ibni Usasen dhe Hamnah binti Xhahshin, të cilët e patën përhapur shpifjen të paktën një herë, pasi ajetet rreth pastërtisë së Aishes u shpallën. Nëse do të ishte e mundur të interpretoheshin fjalët e Aliut si të besuarit e tij në shpifje, ai do të ishte dënuar si të tjerët. I Dërguari i Zotit ka deklaruar qartë se Ai do t'i ndëshkojë të gjithë ata që e meritojnë me të vërtetë, pa e theksuar se për kë bëhej fjalë.<sup>431</sup>

Për më tepër, në jetën e Aishes nuk kishte vend për mërira apo urrejtje të vjetra. Për të do të ishte e pamundur që të vepronte kështu, kur ajo ishte personi më i afërt për Profetin, misioni i së cilës përfshinte ndërmjet të tjerave edhe dhënien fund çdo hakmarrjeje dhe mërie të periudhës së Injorancës, duke i shkullur rrënjët e hakmarrjes nga shoqëria beduine. Aishja ishte ajo e cila na tregoi se i Dërguari i Zotit nuk veproi qoftë edhe një herë të vetme me synimin më të vogël për hakmarrje.<sup>432</sup> Aishja, e cila ndoshta ishte përcjellësja më e rëndësishme e fesë dhe nxënësja më e veçantë e Profetit, i cili i është kundërvënë vazhdimisht kundërpërgjigjes së urrejtjes me urrejtje,<sup>433</sup> është me siguri larg nga kjo lloj lajthitjeje personale. Ekzistojnë shumë shembuj për këtë. Për shembull, pasi e vërteta e pastërtisë së saj u shfaq në ajetet rreth shpifjes, Aishja kurrë nuk mbajti një qëndrim negativ ndaj Hasan ibn Thabitit, i cili në fakt u pat dënuar për shoqërimin e hipokritëve në shpifjen e tyre, duke u mashtruar prej tyre. Përkundrazi, ajo u bë mbrojtësja e tij kryesore. Kur Aishja dëgjoi dikë që po përfliste Hasanin, ajo ndërhyri me shpejtësi që t'i dilte në mbrojtje sahabit, që në poezitë e tij kishte mbrojtur të Dërguarin e Zotit.<sup>433</sup>

Shembujt e faljes së Aishes nuk kufizohen vetëm në këtë rast; edhe më mbresëlënëse ishte qëndrimi që ajo mbajti kundër atyre që i kishin vlarë të vëllanë. Kur e vizitoi Aishen, ajo i bëri ca pyetje Abdurrahman ibni Shumases. Kur ajo e kuptoi se ata ishin të kënaqur me Muavijen si kalif, i tha atij: "Ajo çfarë ka ndodhur me vëllanë tim Muhamed ibn Ebu Bekrin nuk përbën aspak pengesë për mua që t'ju tregoj për atë që kam dëgjuar prej të Dërguarit të Zotit." Ajo i rrëfeu pastaj ato hadithe të të Dërguarit të Zotit në të cilën ai lavdëron udhëheqësin nën të cilin është i kënaqur edhe populli i tij.

Bëhet kështu e pamundur të mendosh se Aishja ka përçmuar një njeri si Aliun, i cili ishte gjithmonë në anën e Zotit dhe të Dërguarit të Tij, ndërsa ajo mbrojti dhe u soll në mënyrë të butë ndaj atyre të cilët kishin vlarë vëllanë e saj, dhe të cilët kishin pjesën e tyre të përgjegjësisë për periudhën ndoshta më të errët gjatë krejt jetës së saj. Ideja e ruajtjes së një urrejtjeje të tillë deri në fund të jetës së saj është absolutisht e pamundur.

Së shtati, Aishja i pati shkruar një letër Muavijes rreth Huxhr ibn Adijit, i cili u vra së bashku me shtatë shokët e tij për shkak të afërsisë së tij me Aliun. Në dhunën përçarëse që u shfaq pas Ndodhisë së Devesë, ajo përdori çdo mundësi për t'i dhënë fund këtyre sjelljeve vrastare. Ajo shprehu keqardhjen dhe mërzinë që ndjente, duke qortuar Muavijen, "A nuk pate frikë nga Allahu

---

<sup>431</sup> Buti, *Aishe Umul Mu'minin*, 60.

<sup>432</sup> Furkan, 72.

<sup>433</sup> Buhari, *megazi*, 32; *edeb*, 91.

kur vrave Huxhrin dhe shokët e tij? Pse nuk pate mëshirë për Huxhrin, përse nuk ia kurseve atij jetën?”<sup>434</sup>

Së teti, ne pamë se Aishja ka qenë mbështetësja e Aliut në momentet më kritike.<sup>435</sup> Pas vdekjes së Osmanit, ajo tha se kalifi i ri duhet të jetë një njeri i cili të jetë në gjendje të mbajë mbi supe përgjegjësinë e Kalifatit dhe gjithashtu i nxiti të tjerët që t'i besuar atij.<sup>436</sup> Aishja gjithashtu drejtonte njerëzit për tek Aliu, kur ata kishin pyetje të cilat ai ishte më i përshtatshëm për t'iu përgjigjur.<sup>437</sup>

Edhe në ditën kur pikëllimi i saj arriti kulmin gjatë Ndodhisë së Devesë, Aishja u kthye nga ata që gjendeshin përreth saj dhe u tha:

“O bijtë e mi, për fat të keq ne e lënduam jashtëzakonisht shumë njëri-tjetrin, përjetuam incidente nga më tronditëset, dhe u lodhëm së koti. Pas këtij momenti, askush nuk duhet ta shikojë më njëri-tjetrin me keqdashje apo të luftojë për atë që ka ndodhur ose për deklaratat e gabuara që kanë bërë të tjerët. Sigurisht, nuk ka asnjë problem ndërmjet meje dhe Aliut që të jetë më i madh se çdo çështje normale mes një gruaje dhe dhëndrit të saj. Edhe pse kam përjetuar disa probleme me të, ai është njeriu më i mbarë për të cilin unë dëshiroj vetëm mirësi dhe mirëqenie.”

Deklaratat e mësipërme dëshmojnë për madhështinë e shpirtit të Aishes. Ajo e dinte se Aliu kishte një vend të veçantë në anën e të Dërguarit të Zotit, dhe ajo ndjehej e zhgënjyer nga ata të cilët dëshironin ta shfrytëzonin këtë çështje. Aliu vetë madje u largua së bashku me Aishen atë ditë kur e përcolli për në Medine, dhe i këshilloi djemtë e tij që ta shoqëronin atë gjatë udhëtimit, duke treguar të njëjtën ndjeshmëri familjare.<sup>438</sup>

Ata ishin njerëz të shkëlqyer në çdo kuptim. Përkundër asaj që kishte ndodhur më parë mes tyre, ata i mbronin të drejtat e njëri-tjetrit dhe nuk lejonin të thuhej asgjë kundër njëri-tjetrit. Një ditë, një njeri erdhi tek Aishja dhe filloi të ankohej për Aliun dhe Amarin. Ajo ndërhyri menjëherë duke mos e lejuar të fliste më shumë, dhe nuk ngurroi t'i rendiste njëra pas tjetrës të gjitha virtytet e Aliut dhe Amarit.<sup>439</sup> Edhe pse ajo e dinte se çfarë kishte thënë i Dërguari i Zotit rreth Amarit, Aishja ishte gjithashtu e vetëdijshme se Amari luftonte së bashku me mbështetësit e Aliut. Amari, i cili kishte qenë i njoftuar nga i Dërguari i Allahut se ai do të vritej nga një komunitet i papërmbytur dhe i egër, u vra kur luftonte në anën e Aliut. Nga ana tjetër, njerëz si Dhu Sudaja, i njohur për tejkalim të normave në mizori, e dha frymën e fundit në krahun e kundërt. Aishja i pati shqyrtuar hollësisht ngjarjet aktuale dhe e dinte se të gjitha incidentet e ndodhura justifikonin Aliun. Duke parë problemet e tij, ajo shpesh shprehej për të se ai ishte një njeri i mirë, për të cilin ajo lutej në mungesë. Ajo mbajti qëndrim kundër Harixhive që kishin punuar kundër Aliut, edhe pas asaj që ata kishin i bërë Osmanit, andaj u shpreh: “Ndërsa ata u urdhëruan që të kërkojnë faljen e sahabëve të të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të, tani ata bëjnë deklaratat edhe më shumë dashakeqe për ta.”<sup>440</sup>

Aisha, e cila u trondit thellë nga vrasja e Aliut, e pyeti Abdullah ibn Shedadini për ditët e tij të fundit. Pasi kishte dëgjuar për të gjithë zellin dhe përpjekjet që ai kishte shfaqur për Islamin, ajo u

---

<sup>434</sup> Ahmed bin Hanbel, 4/72.,

<sup>435</sup> Tirmidhi, *menakib*, 61; Nesai, *hasais*, 35; Hakim, *Mustedrek*, 3/167

<sup>436</sup> Ibni Ebi Shejbe, *Musaneef*, 7/545; Ibni Haxher, *Fethul Bari*, 13/57.

<sup>437</sup> Muslim, *taharet*, 85; Nesei, *taharet*, 99; Ibn Maxhe, *taharet*, 86); Ahmed ibn Hanbel, *Musned*, 1/96; Abdurrezak, *Musannef*, 3/128.

<sup>438</sup> Taberi, *tarih*, 3/61.

<sup>439</sup> Zerkeshi, *el-ixhabe*, 863-864.

<sup>440</sup> Muslim, *tefsir*, 15; Is'hak bin Rahuja, *Musned*, 2/321.



lut për të dhe e bëri të qartë se vrasësit e tij ishin mëkatarë.<sup>441</sup> Aishja madje edhe e përshkroi qytetin e Haruras, ku ata e kishin rezidencën, si qendër të së keqes. Dihet se në ditët e mëvonshme, kur ajo vërente ndonjë qëndrim të pahijshëm nga ndokush, ajo e pyeste: "*Unë rri dhe pyes veten mos vallë edhe ti je një Haruri?*"<sup>442</sup>

Së nënti, qëndrimi i Aliut nuk ishte shumë i ndryshëm nga ai i Aishes. Ai kurrë nuk lejonte të thuhej asgjë kundër saj në praninë e tij, dhe asnjëherë nuk hoqi dorë nga sjellja tërë respekt karshi saj. Pas Ndodhisë së Devesë, një nga sprovat më të rënda të jetës së tij ishte se ai u ndje i trishtuar, madje pikëllimin e tij e përshkroi me fjalë të dhimbshme për shkak se ai kishte qenë i detyruar të ndeshesh me Aishen.<sup>443</sup> Kur të dyja ushtritë u takuan si rezultat i komplotit të Ibn Sebes, Aliu u frikësua. Ai e kishte shpëtuar Aishen nga të qenët në qendër të shënjestrës së hipokritëve, dhe kur ai pa se koshi mbi devenë e Aishes ishte bërë objekt i një rrebeshi shigjetash, rendi drejt saj, duke rrezikuar edhe jetën e tij për të mbrojtur të sajën. Ai urdhëroi njerëzit e tij të ngrinin një tendë për të dhe e zhvendosi atë në një vend më të sigurt.<sup>444</sup> Atë ditë, Aliu i dha këshilla të vëllait të Aishes, Muhamed ibn Ebu Bekrit, i cili ishte në ushtrinë e tij. Ai e dërgoi Aishen në Medinë me vëllain e saj dhe ushtarët e tij, së bashku me dyzet gra të tjera nga Basra. Ai i këshillonte me këmbëngulje ushtarët e tij që të mos dëmtojnë askënd që do të shihnin me Aishen, duke u përpjekur që t'i bindnin ata.<sup>445</sup> Ai tha: "Sot, unë shpresoj se Zoti i Plotfuqishëm do t'i dërgojë në Xhenet të gjithë ata që janë në gjendje të kontrollojnë ndjenjat e tyre", dhe udhëhoqi namazin e xhenazes për dëshmorët e rënë gjatë asaj dite.<sup>446</sup>

Kjo epërsi nuk i përket vetëm Aliut dhe Aishes. Një ndjeshmëri e njëjtë shihet në qëndrimet e atyre që ishin në ushtrinë e Aliut.<sup>447</sup> Të gjitha këto argumente së bashku, tregojnë se nuk ka pasur kurrfarë mërie apo zemërimi mes Aliut dhe Aishes. Është e pamundur të thuhet se kjo ka qenë arsyeja e Ndodhisë së Devesë.

---

<sup>441</sup> Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/86-97; Hakim, *Mustedrek*, 2/165; Bejheki, *Sunen*, 8/180; Ebu Ja'la, *Musned*, 1/367.

<sup>442</sup> Buhari, *hajd*, 20.

<sup>443</sup> Fet'hul Bari, 13/55; Taberi, *tarih*, 3/61; Ibni Kethir, *el-bidaje*, 7/246.

<sup>444</sup> Taberi, *tarik*, 3/29; Ibni Kethir, *el-bidaje*, 7/238.

<sup>445</sup> Bejheki, *Sunen*, 8/181.

<sup>446</sup> Taberi, *tarik*, 4/534; Ibni Haldun, *tarik*, 2/606.

<sup>447</sup> Nedeui, *Siratu Sejidatu Aishe*, 180.

---

## BIBLIOGRAFIA

- ABDURRAZZAK IBNHAMMAM, Ebu Bala as-San'ani, *al-Musannaf*, Botim kritik nga Habiburrahman al-Maktabu'l Islami, Beirut 2003.
- EBU DAVUD, Sulejman ibn Ash'as as-Sixhistani al-Azdi, *Sunan*, Botim kritik nga Muhammed Muhjiddin Abdulhamid, Talik Kemal Yusuf Hut, Daru'l-Fikr, Beirut.
- Aishja Binti Ebi Bekr es-Siddik*, Botim kritik nga Abdulgafur Husejn, Darul-Aksa, Kuvait, 1985
- Sualatu Ebi Davud 1,0 Imam Ahmed ibn Hanbal fi Xharhi'r Ruvat*, Botim kritik nga Zijad Muhammed Mansur, *Maktabatu'l Ulum evel Hikam*, Botimi i parë, Medina: 1414.
- EBU HAJJAN, Asiruddin Muhammed ibn Jusuf al-Andalusi, *Bahrul Muhit*, Daru'l Fikr: 1983.
- EBU HAJJAN ET-TEUHIDI, Ali ibn Muhammed ibn Abbas, *al-Imta ve've' l Muanasa*,
- EBU NUAJM, Ahmed ibn Abdillahi al-Isfahani, *Hiljetul Evlija ve Tabakatul Asfiya*, Darul Kitabi'l Arabi, Beirut: 1405 AH.
- Musnadu Ebi Hanife*
- EBU JA'LA, Ahmed ibn Ali al-Mavsili, *Musnad*, Daru'l Ma'mun li't Turas, Botim kritik nga Husejn Selim Asad, Damask : 1984.
- EBU'L FARAXH AL-ISFAHANI, al-Agani, Botim kritik nga Samir Xhabit, Daru'l Fikr, Beirut.
- EBU'L HASAN ALAADDIN ALT IBN BALABAN, *al-Ihsan bi Tartibi Sahihi ibn Hibban*, Botim kritik nga Jusuf Hut, Dani'l Kutubil Ilmijja, Bejrut, pa datë.
- AHMED IBN HANBAL, Ebu Abdillahi ash-Shajbani, *al-Musnad*, Zejl: Shuajb Arnavut, Muassasatu Kurtuba, Kairo, pa datë.
- AL-AXHLUNI, Ebu'l- Fida Ismail ibn Muhammed, *Kashfu' Kafa*, Daru'l Kutubi'l Ilmijja, Beirut: 1988.
- ALT AL-MUTTAQI AL-HINDI, *Kanzu'l Ummal*, Muassasatu'r Risala, Beirut: 1989
- ALUSI, *Ruhu'l Maani*, Daru Ihjai't Turasi'l Arabi, Beirut, pa datë.
- AJNI, Ebu Muhammed Mahmud ibn Ahmed, *Umdatul'Qari*, Daru Ihjai't Turasi'l Arabi, Beirut, pa datë.
- AZIMABADI, Ebu't Tajjib Muhammed, *Shemsul-Hak, Avnul-Ma'budSharhu Sunan Ebi Davud*, Darul-Kutubi'l Ilmiyya, Beirut, 1415 AH.
- AZIMLI, MEHMET, "Hazreti Aişe'nin Evlilik Yaşı Tartıulannda SavunmacıTarihçiliğınCikmazi", *İslâmi Araştırmalar*, Vol. 16, Çështja 1, 2003.

BAGAVI, Ebu Muhammed Husejn ibn Mas'ud, *Sharhu's Sunna*, Botim kritik nga Shuajb Arnavut and Muhammad Zuhajr Shavish, al-Maktabu'l Islami, Beirut: 1983.

BAJHAKI, Ebu Bekr Ahmed ibn Husejn ibn Ali ibn Musa, *Sunanul Kubra*, Botim kritik nga Muhammed Abdulkadir Ata, Maktabatu Dari'l Baz, Mekë: 1994.

*al-Madhal ila Sunani Kubra*, Matbaatu Dairati'l Maarifi'n Nizamijja, Botimi i parë, Haj]darabad, 1344 AH.

*Shuabul Iman*, Daru'l Kumbil Ilmijja, Beirut, 1410 AH.

BERKI, ALI HIKMET, OSMAN ESKIOGLU, *Hatemul Enbiya Hazreti Muhamed ve Hayatt*, Diyanet işleri Başkanligr, Ankara: 1981.

BUKHARI *al-Xhamijjus's Sahih*, Stamboll, 1401 AH.

*at Tarihul Kebir*, Daru Ihjai't Turasi'l Arabi, Beirut.

*Tarihi Saghir*, Maktabatu Dari't Turas, Kairo: 1977

*Adabu'l Mufrad*, Botim kritik nga Muhammed Fuad Abdulbaki, Daru'l Bashairi'l Islamijja, Beirut: 1989.

BURSEVI, Ismail Hakki, *Ruhul Beyan*, Daru't Tibaati'l Amire, Bulak, 1255 AH.

BUTI, Muhammed Said Ramazan, *Aisha: Urnmul Mu'minin*, Daru'l Farabili'l Maarif, Damask: 1997.

DARAKUTNI, Ali ibn Umar Ebu'l Hasan, *Sultan*, Darul Marifa, Beirut: 1966,

DARIMI, Ebu Muhammed Abdullah ibn Abdirrahnan, *Sunan*, DarulKitabil Arabi, Beirut: 1407.

DHAHABI, Abu Abdillah Muhammed ibn Ahrned ibn Osman, *Sijaru Nubala, Muassasatu'r Risala*, Botimi i nëntë, Beirut: 1993. *Tarikul Islam*, Maktabatu Kudsi, Kairo: 1367

*Tazkiratul Huffaz*, Daru Ihjai't Turasil Arabi, Beirut, pa datë. DOGRUL, Omer Riza, *Asr-iSaadet*, Eser Kitabevi, Stamboll: 1974.

FEVZI, Xhihan Rafat, *es-Sejjidatu AishjaveTavsiquha li's Sunna*, Maktabatu'l Hanxhi, Kairo, 2001.

FIRUZABADI, Abu't Tahir Maxhuddin Muhammed ibn Ja'kub ibn Muhammed Shirazi, *al-Kamusul Muhit*, Matbaa-i Hasanijja al-Misrijja, Botimi i dytë, 1344 AH.

AL-GAZZALI, Abu Hamid Muhammed ibn Muhammad, *Ihjau Ulumiddin*, DaruIhjail Kutubil Arabijja, Beirut, pa datë.

GULEN, M. Fethullah, *Kodrat e Smeralda të Zemrës: Koncepte Kyçe në Praktikën e Sufizmit*, Tughra Books, NJ, 2011.

M. Fethullah, *iDërguarii Allahut*, Tughra Books, NJ, 2011.

HAFNA, Abdulmin'im, *\_Mavsuatu Ummil Adu'rninin Aisha, bint-i Ebi Bekër*, Maktabatu Madbuli, 2003.

HAKIM AN-NAJSABURI, Abu Abdillah Muhammed ibri Abdillah, *al-Mustadrak Ala's Sahibayn*, Botim kritik nga Mustafa Abdillkadir Ata, Daru'l Kutubu'l Ilmijja, Beirut: 1990.

HALABI, *as-Siratu'n Nebevijja*, Daru'l Marifa, Beirut: 1400 AH.

HANNAD, *Zuhd*, Daru'l Khulafa Li'l Kitabi'l Islami, Kuvajt: 1406 AH.

HATIB AL-BAGHDADI, Ebu Bekr Ahmed ibn Ali ibn Sabit, *al-Xhami" Li*

*Akhlaki'r Ravi va Adabis Sami'*, Botim kritik nga Mahmud Tahhan, Maktabatu'l Maarif, Rijad, 1403 AH.

*al-Kifaja fi Rivaya*, Botim kritik nga Abu Abdillahi as-Savraki dhe Ibrahim Hamdi al-Madani, al-Maktabatul Ilmijja, Medina, pa datë.

*Tarik-i Bagdad*, Darul Kitabi'l Arabi, Beirut, pa datë.

HAJTHAMI, *Maxhmuatu'z Zavaid ve Manbaul Favaid*, Daru'l Fikr, Beirut, 1412 AH.

*Mavaridu'z Zam'an*, al-Maktabatu'sh Shamila, Daru's Sakafati'l Arabijja, Beirut: 1990.

HAJTHAMI, NUREDDIN DHEHARITH IBN EBI USAMA, *Musnad-i Harith*, Markaz-i Hidmati's Sunna, Medina al-Munavvare: 1992.

IBN ABDILBARR, *Istiaab fi Marifatil Ashab*, Daru'l-Kutubil Ilmiyya, Beirut: 1995.

*at-Tamhid*, Vizaratu Umumil Avkaf ve'sh Shuuni'l Islamijja, Marok: 1387 AH

IBN ABDIRRAHMAN, *al-Iktu'l Farid*,

IBN Ebu'l Kasim Ali ibn Husejn ibn Hibatillah, *Tarik-i Dimashk*, Daru'l Fikr, Beirut 1998.

IBN ABI'DDUNIA. Makarimi'l Ahlak, Maktabatu'l Kuran, *Kairo*, Pa datë.

IBN EBI HATIM, *Al-Xharh ve Ta'dil*, Matbaatu Mexhlisi Dairatu'l Maarifi'l Osmanijja, Botimi i Parë, Hajdarabad, 1371 AH.

IBN EBI SHAJBA, Ebu Bakr Abdullah ibn Muhammed al-Kufi, *al-Musannaf fi'l Ahadith ve'l En.sar*, Botim kritik nga Kamal Jusuf Hut, Maktabatu'r Rushd, Rijad: 1409 AH.

IBN HAXHAR, Abu'l Fadl Shihabuddin Ahmed ibn Ali al-Askalani ash-Shafii, *Fathul Bari Sharhu Sahihi'l Bukhari*, Daru'l Marifa, Beirut: 1379 AH.

*Hadju's Sari*, Daru'l-Marifa, Botimi i dytë, Beirut, pa datë.

*al-Isaba fi Tajmizi's Sahaba*, Botim kritik nga Ali Muhammad Buxhavi, Darul Xhil, Beirut: 1412 AH.

*Takribu't Tahzib*, Dirasa ve mukabala: Muhammed Avvama, Daru'r Rashid, Botim i katërt, Siri: 1992.

*Tahzibu't Tahzib*, Daru'l Fikr, Botimi i parë, 1404 AH.

IBN HALDUN, *Tarik*, Daru Ihjai't Turasi'l Arabi, Beirut, pa datë.

IBN HIBBAN, Muhammed ibn Hibban Ebu Hatim al-Busti, *Sahib, Muas-sasatu'r Risala Botim kritik nga Shuaib Arnavut*, Beirut: 1993.

*as-Sikat*, Dairatu'l Maarifi'l Osmanijja, Hajdarabad: 1973

IBN HISHAM, *es-Siratu'n Nebevijja*, Daru'l Xhil, Beirut: 1411.

IBN HUZAJMA, Ebu Bekr Muhammed ibn Is-hak as-Sulami, *Sahih Ibn Huzajme*, Botim kritik nga Muhammed Mustafa al-A'zami, al-Maktabu'l Islami, Beirut, pa datë.

IBN IS-HAK, *Sira*, Konya: 1981.

IBN XHA'D, Ebu'l Hasan ibn Ubejd al-Xhavhari, *Musnad*, Botim kritik nga Amir Ahmed Hajdar, Muassasam Nadir, Beirut, 1990.

IBN KETHIR, Ebu'l Fida Ismail ibn Umar al-Kurashi Ad-Dimashki, *Tafsiirvil Azim*, Botim kritik nga Sami ibn Muhammed Salama, Dary Tajba, Botim i dytë, 1999.

*al-Bidaja ve'n Nibaja*, Maktabatu'l Maarif, Beirut, pa datë.

IBN MAXHA, *Sunan*, Daru'l Fikr, Beirut, pa datë.

IBN MANDA, *Ma'rifatu's-Sahaba*, Biblioteka Koprulu, Nr: 242, Varak: 195b.

IBN MANZUR, Ebu'l Fadl Muhammed ibn Mukarram ibn Ali al-AnsariXhamaluddin, Al Ifriki, *Lisanul Arab*, Daru Sadir, Botimi i parë, Beirut, pa datë.

IBN KAJJIM AL-XHAVZIJA, Ebu Abdillan Muhammad ibn Ebi Bekr, *I'lamu'l Muvakkian*, Darul'Xhil, Beirut, 1973.

*al-Manaru'l Munif fi's Sahibi va'd Daif*, Maktabu'l Matbuati'l Islamiija, Aleppo: 1983.

*Zadu'l Maad Hadji Hajri'l Ibad*, Botim kritik nga ShuajbArnavut Abdulkadir. Arnavut, Muassasatu'r Risala, Beirut: 1986.

IBN SAD, *Tabakat*, Daru Sadir, Beirut, pa datë.

IBN TEJFUR, *Balaghatu'n Nisa*, Daru'l Fadila, Kairo, pa datë.

IBNU'L ATHIR, *Usdul Gaba fi Marifati's Sababa*, Daru'l Fikr, Beirut: 1995.

IBNU'L XHAVZI, *Sifatu's Safva*, Botim kritik nga Fahuri and Kal'axhi, Daru'l Marifa, Beirut, 1979.

IBRAHIM MUSTAFA *et al*, *al-Muxhamul Vasi*, Cagri Yayinlari, Stamboll: 1990.

IS-HAK IBN-I RAHUJA, *Musnad*, *Maktabatul Iman*, Medina: 1991.

XHAHIZ, Ebu Osman Amr ibn Bekr, *al-Bajan ve't Tabajjun*, Daru Sa'b, Beirut: 1968.

XHAVHARI, Ebu Nasr Ismail ibn Hammad al-Farabi, as *Sihah Taxhu'l Lugha ve Sihahi'l Arabi* (Taxhu'l Lugah), Botim kritik nga Ahmed Abdulgafur Attar, Daru'l Ilm, Botimi i katërt, Beirut: 1990.

KALKASHANDI, Ahmed ibn Ali, *Subhul A'sha fi Sinaatil Insha*, Daru'l FikrDamask: 1987.

KANDAHLAVI, *Hajatu's Sahaba*, Hajdarabad: 1959.

KAJRAVANI, *Zahrul Adak*

LALAKAI, Hibatullah Ebu'l Kasim, *I'tikadu.Sunna*, Botim kritik nga Ahmed Sa'd Hamdan, Daru Tajba, Rijad: 1402 AH.

MAHMUD SAID MAMDUH, *Is'afit-'l Mulihhin hi Tartibi Abadithi lIvaUlumu'd Din*, Daru'l Bashairi'l Islamiija, Liban: 1986.

MALIKIBN ANAS, *Muvatta*, Daru Ihjai't Turasi'l Arabi, Egypt, pa datë.

MAKDISI, *al-Abadithul Mukhtara*, Maktabatu Nanda, Mekë: 1410.

MAS'UDI, *Muruxhu'dh Dhahab*,

MIZZI, Abu'l HaxhxhaxhJusuf ibn Zaki Abdi'r Rahman ibn Jusuf, *Tahzibu'lKamal*. Botim kritiknga Bashshar Avvad Maruf, Muassasatu'r Risala, Botim i parë, Beirut: 1980.

MUNAVI, Zejnuddin Muhammed Abdurrauf, *Fejzu'l Kadir Sharhu'l Xahmii'sSaghir*, Daru'l Kutubi'l Ilmijja, Beirut: 1994.

M UN ZIRI *at Targrib ve't Tarhib*, Daru'lKutubi'l Ilmijja Bejrut 1994.

MUSLIM, Ebu Hussein ibn Haxhxhaxh al- Kushajri an-Najsaburi, *Sahihu Muslim*, Botim kritik nga Muhammed Fuad Abdalbaki, Daru Ihjai't Turasi'l Arabi, Bejrut, pa datë.

NADAVI, Sajjid Sulejman, *Hazreti Aise*, pwrkthyer nga Ahmet Karataş, Timaş, Stamboll: 2004.

*Siratu's Sajjidati AishjaUmmul Mu'minin*, Botim kritik nga Muhammed Rahmarullah Hafiz an-Nadavi, Daru'l Kalam, Damask: 2003.

NASAI, Abu Abdirrahman Ahmad ibn Ali ibn Shuajb, *Sunanul Kubra*, Botim kritik nga

Abdulgaffar Sulejman al-Bundari, Daru'l Kutubi Ilmijja, Botimi i parë, Beirut: 1991.

Sunan, Botim kritik nga Abdulfattah Ebu Gudda, Maktabatul Matbuati'l Islamijja, 1968.

NEVEVI, *Tahzibu'l Asma*, Botim kritik nga Mustafa Abdulkadir Ata, alMaktabaru's Shamila, pa datë.

NUVVAJRI, *Nihajatu'l Arab*

KURTUBI, *Tafsir (al-Xhami Li Abkamil Kuran)*, Daru Ihjai't Turasi'l Arabi, Beirut: 1985.

RAGHIB AL-ISFAHANI, Ebu'l Kasim, Husejn ibn Muhammed ibn Mufaddal, *al-Mufradat fi Gharibil Kuran*, Botim kritik nga Safivan Adnan, Daru'l Kalam, Botimi i dytë, 1418 AH.

SAID IBN MANSUR, Abu Osman ibn Shuba, al-Hurasani, *Sunan-i Said ibn Mansur*, Botim kritik nga Sa'd ibn Abdillahi ibn Abdilaziz Ali Humajjad, Daru's Sami'i, Botimi i parë, Rijad: 1993.

SAHAUI, Abu'l Hajrr Shemsuddin Muhammed ibn Abdirrahman, *al-Magasidul Hasana fi Bajani Katbirin minal Ahadithil Mushtahira Ala'l Alsina*, Botim kritik nga Muhammed Osman al-Husht, DarulKitabi'l Arabi, Botimi I dytë, Beirut: 1994.

SALAFI, Abu Tahir Ahmed ibn Muhammed, *Muxharnu's Safar*, al-Maktabattu't Tixharijja, Mekë, pa datë.

SAM'ANI, *Adabul Imla ve'l Istimla*, naafi Kutubil Ilmijja, Beirut: 1401.

SAMHUDI, *Hulasatu'l Vafa*, Kairo: 1908.

SAN'ANI, *Subulu's Salam*, Daru'l Kitabi'l Arabi, Beirut: 1987.

SAVAS, Riza, "Hazreti Aişe'nin Evlenme Yaşı ile Ilgili Farklı Bir ilahiyat Fakültesi Dergisi, Issue 4, Izmir: 1995.

*al-Itkan fi Ulumil Kuran*, Beirut, 1987.

SHALABI, Mahmud, *Hajatu Aisha*, pa datë.

SHAVKANI, Muhammed ibn Ali ibn Muhammed, Najlu'l Avtar min Ahadithi Sajjidi'l Abrar, 6/170, Idratu't Tibaati'l Mudirijja, pa datë.

Al-Favaid-I Maxhmua, al-Maktubu'l Islami, Beirut: 1407.

SUYUTI, Abu'l Fadl Xhalaladdin Abdurrahman ibn Ebi Bekr, *al- Xhamiu's Saghir fi Ahadithi'l Bashiri'n Nazir*, Daru'l Kutubi'l Ilmijja, Beirut: 1990.

*ad-DurrulMansur fi't Tafiiri bi'l Ma'sur*, Daru'l Fikr, Beirut: 1993.

TABARANI, Abu'l Kasim Sulejman ibn Ahmed, *al-Muxhamul Avsat*, Botim kritik nga Tarik ibn Ibadullah, Daru'l Hararnajn, Kairo: 1415 AH.

*Muxhamu's Saghir*, Daru Ammar, al-Maktabu'l Islami, Beirut: 1985.

*Muxhamul Kabir*, Maktabaru'l Ulum ve'l-Hikam, Mosul: 1983.

TABARI, *Tarikul Umamvel-Muluk*, Daru'l Kutubil Ilmijja, Beirut: 1407.

TAHAVI, Ahmed ibn Muhammed ibn Salama ibn Abdilmalik ibn SalamaEbu Xhafar, *Sharhu Maanil Asar*, Botim kritik nga Muhammed Zuhrian-Naxhxhar, Daru'l Kutubil Ilmijja, Beirut: 1399 AH.

*Sharhu Mushkili'l Asar*, Shuaib Arnavut, Beirut: 1994.

TAHMAZ, Abdulhamid Mahmud, *es-Sejjidatu Aisha*, Daru'l Kalam, Damask, 1999.

TANTAVI, *Ebu Bekr es-Siddik*, Daru'l Manar, Xheddah: 1986.

- TAJALISI, *Ebu Davud, Musnad*, Daru'l Marifa, Beirut, pa datë.
- TIRMIDHI, Ebu Isa Muhammed ibn Isa, al-Xhamiu'l *Kabir (Sunan)*, Tahkik tahririve talik: Bashshar Avvad Maruf, Daru'l Garbi'l Islami, Botimi i parë, Beirut: 1996.
- ÛNAL, Ali, Kurani me shënime interpretimi në Anglishten moderne, Tughra Books, Neë Jersey: 2008.
- VEHBE ZUHAIJI, Islam Fikhi Ansiklopedisi, Risale Yayinlari, Germany:1994.
- VENSINCK et al, al-Muxhamu'l Mufahras Li Alfazi'l Hadithi'n Nebevi, ÇağrıYayinlari, Istanbul: 1988.
- YAKUT AL-HAAMAVI, Ebi Abdillahi Shihabu'd Din ibn Abdilkih, Muxhamu'l Buldan, Botim kritik nga Farid Abdulaziz al-Xhundi, Darul Kutubil Ilmijja, Beirut, pa datë.
- YÛCE, Abdülhakim, *Efendimizin Bir Günü, Işık* Yayınlları, Stamboll: 2007.
- ZAGHLUL, Ebu Haxhar Muhammed Said Ebu Hajxhar Muhammed Said ibn Basjuni, MevsuatuaAtrafil Hadithi'n *Nebevijji'sh Sharif*, al-Maktabatu't Tixharijja, Mustafa Ahmaed al-Baiz, Daru'l Fikr, Beirut: 1994
- ZABIDI, Ebu'l Fejz Murteza Muhammed, *Taxhul Arus Min Xhavahiri'l Kamus*, Daru'l Fikr, Beirut: 1414.
- ZARKASHI, Badruddin, *al-Ilxhaba Lima Istadrakathu Aishjaala's Sahaba*, Maktabatu Mishkati'l Islamijja.
- ZAHLAI, Ebu Muhammed Abdullah ibn Jusuf al-Hanafi, *Nasbu'r Raxha Li Ahadithi'l Hidaja*, Botim kritik nga Muhammed Jusuf al-Bannuri, Daru'l Hadith, Egjipt: 1357 AH.
- ZIRIKLI, A 'lam, Darul Ilm li'l Malajin, Beirut: 1980.

## KOPERTINA E PASME

Ky libër portretizon një nga personalitetet më domethënëse të historisë së Islamit. Duke pasur parasysh keqkuptimet dhe akuzat e pabaza në lidhje me të, Aishja duhet të kuptohet drejtë, më shumë se çdo bashkëshorte tjetër e Profetit. Ky studim i Reshit Hajllamazit, një njohës shumë i mirë i historisë së epokës dhe i jetëshkrimit të Profetit dhe sahabëve të Tij, e pasqyron jetën e saj në aspekte të ndryshme, sipas raportimeve të besueshme. Ky libër sqaron rolin e saj kritik në themelimin e shkollës islame, me referencë të veçantë në rolin e saj në rrëfimin e çështjeve private që kanë të bëjnë me gratë dhe marrëdhëniet martesore, ashtu si edhe në ruajtjen e thënieve autentike të Profetit. Meqenëse ndjeshmëria e saj në praktikimin e fesë është e lidhur me një varietet të pasur shembujsh, shumë çështje të debatuar si, mosha e saj, kur u martua, si dhe qëndrimi ndaj Aliut të nderuar, janë trajtuar në kapituj të veçantë.